



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 26, 27 MARS DHE 2 PRILL 2015**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 26., 27. MARTA I 2 APRILA 2015. GODINE**

**MARS/PRILL - MART/APRIL
2015**

Rendi i ditës

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit nga seanca e mëparshme,
4. Shqyrtimi i Projektligjit për Ratifikimin e Marrëveshjes për Financim ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim lidhur me Projektin për Eficiencën e Energjisë dhe Energjinë e Ripërtëritshme,
5. Shqyrtimi i Projektligjit për Ratifikimin e Marrëveshjes për Financim ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim për Projektin për reformën shëndetësore,
6. Shqyrtimi i raportit të auditimit të sistemeve të prokurimit në Sektorin shëndetësor,
7. Zgjedhja e Avokatit të Popullit,
8. Propozimi për emërimin e anëtarit të Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës,
9. Kërkesa e Grupit Parlamentar të AAK-së për formimin e Komisionit Hetimor Parlamentar,
10. Debat parlamentar për Radiotelevizionin e Kosovës,
11. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit të posaçëm për zgjedhjen e një gjyqtari në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

Dnevni red

1. Vreme za deklarisanja van dnevnog reda,
2. Vreme za parlamentarna pitanja,
3. Usvajanje zapisnika sa prethodne sednice,
4. Razmatranje Nacrta zakona o ratifikaciji dogovora o finansiranju, između Republike Kosova i Međunarodne asocijacije za razvoj, u vezi projekta efikasnosti iobnovljive energije,
5. Razmatranje Nacrta zakona o ratifikaciji dogovora o finansiranju, između Republike Kosova i Međunarodne asocijacije za razvoj, u vezi Projekta za zdravstvenu reformu,
6. Razmatranje Izveštaja revizije sistema nabavki u zdravstvenom sektoru.
7. Izbor Narodnog advokata,
8. Predlog za imenovanje člana Upravnog odbora Sudskog instituta Kosova,
9. Zahtev Parlamentarne grupe AAK za formiranje Parlamentarne istražne komisije,
10. Parlamentarna debata o Radioteleviziji Kosova,
11. Razmatranje preporuke Posebne komisije za imenovanje jednog sudije Ustavnog suda Republike Kosova.

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
I nderuar Kabinet qeveritar,
I hap punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës sipas rendit të ditës të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare.

Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës:

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Koha për deklarime jashtë rendit të ditës është e kufizuar deri në 30 minuta. Diskutimi në emër të grupit parlamentar zgjat deri në pesë minuta, ndërsa diskutimi i deputetit deri në tre minuta.

Deputetët e paraqitur për diskutim duhen të deklarohen se në çfarë cilësie e kërkojnë fjalën.
Për Grupin Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, fjalën e ka deputeti Hajdar Beqa.

HAJDAR BEQA: Faleminderit, kryetar!
Të nderuar deputetë,
I nderuar Kabinet qeveritar,
Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,
Kuvendi i Kosovës është institucion legjislativ, i cili ka synim nxjerrjen dhe miratimin e ligjeve që kanë për qëllim rregullimin e jetës së qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Ditëve të fundit jemi njoftuar me një lëshim që ka ndodhur nga ky Parlament qysh në vitin 2007-2008 me hyrjen në fuqi të Ligjit numër 02/L-70 për sigurinë në komunikacionin rrugor.

Ka shumë ligje të Republikës së Kosovës që kërkojnë për t'u rishikuar, e sidomos ato që janë derivat i administratës së UNMIK-ut pas në shumë raste nuk janë të përshtatshme, nuk janë të harmonizuara, e aq më shumë bien ndesh edhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës mbi parimin e barazisë dhe të drejtave të garantuara të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Ditëve të fundit jemi dëshmitarë të shumë ankesave të qytetarëve, të cilat janë drejtuar edhe në Grupin Parlamentar të Partisë Demokratike si grupi më i madh parlamentar, e natyrisht edhe pritjet e qytetarëve janë më të mëdha në realizimin e kërkesave të tyre.

Ajo që kemi trajtuar ne është fakti se Ligji për siguri në komunikacionin rrugor është një ligj diskriminues dhe nuk ka të bëjë fare me barazinë e qytetarëve para ligjit. Patentëshoferët disa janë me afat, disa janë pa afat, e një gjë e tillë e ka krijuar një huti të madhe te qytetarët e vendit tonë.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike, përveç që kërkon që Ligji numër 02/L-70 për siguri në komunikacionin rrugor të sillet nga Qeveria dhe të amendamentohet. Ne kërkojmë që urgjentisht t'u dalim në ndihmë mijëra qytetarëve të cilët tashmë nuk janë të barabartë si të gjithë të tjerët dhe kanë probleme serioze me ligjin në fjalë.

Probleme këto, duke filluar nga mospasja e së drejtës së ngasjes së automjetit, qoftë ai edhe vozitësi i vetëm në familje, e deri te rrezikimi i vendit të punës.

Të nderuar deputetë,

Kërkojmë nga Qeveria që të mos presë amendamentimin apo rishikimin në tërësi të ligjit, pasi diçka e atillë mund të bëhet më pastaj, por urgjentisht ta sjellë plotësim-ndryshimin e ligjit, përkatësisht nenin 276 të Ligjit 02/L-70, i cili thotë: “Shoferët duhet t’u nënshtrohen edhe një herë të gjitha testeve apo provimit teorik dhe praktik, nëse brenda një vitin nga dita e skadimit të vlefshmërisë së patentëshoferit, nuk aplikohet për vazhdim”.

Ky është një nen diskriminues, sepse jo që nuk është i njëjtë për të gjithë shoferët e Kosovës, por është kundër parimeve të drejtave njerëzore dhe parimit të mosdiskriminimit.

Janë mijëra qytetarë që gjenden para një akti të kryer dhe ne duhet urgjentisht t’u dalim në ndihmë duke e amendamentuar këtë ligj, përkatësisht nenin përkatës 276 të tij dhe t’i sigurojmë ata që të mos kenë brengë as për riprovim, e as për koston financiare për këtë çështje. Faleminderit!

KRYETARI: Njomza Emini, e ka fjalën.

NJOMZA EMINI: Faleminderit, kryetar!

Në fakt, edhe unë e kam të njëjtën çështje si kolegu im, mirëpo konsideroj që është me një rëndësi të veçantë dhe prapë nuk është përsëritje.

I nderuari kryetar i Kuvendit,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Ju kolegë deputetë,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Aksidentet në komunikacion konsiderohen si të rënda dhe me pasoja fatale për qytetarët e Republikës së Kosovës.

Kosova nga viti në vit ka shënuar ulje dhe ngritje të numrit të viktimave të komunikacionit, duke marrë për bazë kushtet dhe arsyet e ndryshme.

Kemi dëgjuar në vazhdimësi që kualiteti i lëshimit të patentëshoferëve nuk është ai të cilin do të dëshironim ta kishim për arsye që shpeshherë kemi dëgjuar në biseda joformale raste të caktuara të keqpërdorimit me ta.

Divizionet e patentëshoferëve shpeshherë kanë qenë në media për raste të ndryshme, duke filluar nga pushimi jo mirë i planifikuar i stafit të këtyre qendrave, deri te rastet e dyshuara për lëshim jokorrekt të patentëshoferëve për vozitje.

Përveç se përballja me shoferë jo të kualifikuar mirë në trafik po shkakton frustrim te qytetarët, ata shpeshherë kanë qenë viktimë e aksidenteve të ndryshme të shkaktuara nga vozitja e papërgjegjshme nëpër rrugët e Republikës së Kosovës.

Trajtimi i qytetarëve në mënyrë të papërgjegjshme nga këta zyrtarë dhe ankesat që po i dëgjojmë ne si deputetë të Kosovës më kanë shtyrë që ta trajtoj këtë çështje në Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe të pres nga ministri i Infrastrukturës që të marrë masa ose të krijojë politika që të përmirësohet ky nivel i shërbimit që nuk duhet të jemi hetues të veçantë që të arrijmë në këtë përfundim, sepse vetëm në biseda joformale me qytetarë mund ta vërejmë këtë gjendje në mënyrën më të mirë.

Unë konsideroj që edhe në familjet tuaja ka pasur raste të viktimave që kanë pësuar në aksidente dhe konsideroj që është me një rëndësi shumë të veçantë që ministri të ndërmarrë masa dhe po ashtu kërkoj vëmendje nga deputetët, sepse kjo na prek të gjithë ne në komunikacion.

Po ashtu, një shqetësim i qytetarëve tanë që janë drejtues të automjeteve janë tarifat e kontrollit teknik të automjeteve, e që ministria përkatëse do të duhej ta konsideronte mënyrën e intervenimit, të rishikohen tarifat e kontrollit teknik të automjeteve, që të mos jenë barrë e rëndë për qytetarët tanë.

Nëse korniza aktuale ligjore nuk lejon që eventualisht të mos jenë këto tarifa, mund të rishikohen, e do të kishte qenë mundësi e mirë eventualisht të rishikohet mundësia e nivelimit të tregut të kontrollit teknik të automjeteve dhe të përfshihen edhe bizneset tjera. Kjo do të ndikonte drejtpërdrejt në uljen e çmimeve nga këta operatorë të kontrollimit teknik të automjeteve, si dhe do të ndikonte direkt në ngritjen e cilësisë të shërbimeve konform një takse më të vogël që do ta paguanin qytetarët për këtë shërbim.

Të nderuar kolegë deputetë,

Përmirësimin e këtyre kushteve për qytetarët dhe ngritja e mbikëqyrjes për Divizionin e Patentëshoferëve po besoj se do ta ulte një varg problemesh në komunikacion dhe do të shmangte lëshimin jomeritor të dokumenteve aq të rëndësishme për jetën e qytetarëve tanë.

Për rrjedhojë, me shoferë më të kualifikuar, së paku do të mund të presim ulje të numrit të aksidenteve ku jo medoemos përvoja në vozitje ndikon në uljen e këtyre aksidenteve, por është një indikator i mirë se si të arrijmë ta përmirësojmë këtë nivel.

Para një jave ishte mediale rasti i ngasjeve të veturave, të cilave u ka skaduar patentëshoferi, që e ceku edhe kolegu im paraprak, e është paradoks që një pjesë e qytetarëve posedojnë patentë shofer të paafatizuar në to. Kurse një pjesë e posedojnë patentëshoferin me afat të limituar. Besoj që ministria e autorizuar do ta marrë në konsideratë këtë dukuri dhe me ndërhyrjen e ligjeve dhe udhëzimeve administrative qytetarët do të trajtohen me të njëjtin standard.

Duke falënderuar përcjelljen e deritashme të ministrit të Infrastrukturës, zotin Lutfi Zharku, po shpresoj që të ndërmerren masa dhe të përmirësohet niveli i efikasitetit të ministrisë në përgjithësi sa i përket kësaj teme, por duke mos i anashkaluar edhe investimet dhe projektet tjera që ministria i implementon në vazhdimësi në kuadër të përmirësimit të jetës së qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Po ashtu, duket e padrejtë që afatizimi i patentëshoferëve me dallime për ata që kanë patentëshofer deri në vitin 2000, domethënë kanë patentëshofer për pesë vjet, ndërsa pas këtij viti

të paafatizuar. Pse ky dallim? Të gjithë janë shtetas të Republikës së Kosovës. Faleminderit për vëmendjen dhe konsideroj që ministri të duhet të ndërmarrë masa të duhura. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Ismajl Kurteshi, në emër të Grupit Parlamentar Lëvizja “Vetëvendosje”, e ka fjalën.

ISMAJL KURTESHI: Deputetë të nderuar,
Derisa Serbia po planifikon që Asociacionin e Komunave Serbe në Kosovë ta bëjë kategori kushtetuese, që përfundimisht do ta bëjë jofunksional shtetin e Kosovës, Serbia para syve të botës dhe dy shteteve shqiptare po i diskriminon në forma më të rënda shqiptarët autoktonë në Luginën e Preshevës.

Komisioni Parlamentar i Arsimit gjatë vizitës në komunat e Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës u njoftua gjerësisht me problemet me të cilat po ballafaqohet popullata shqiptare në Luginën e Preshevës, që sot janë qytetarët më të diskriminuar në Evropë.

Në 1100 kilometra katrorë të tri komunave të Luginës së Preshevës aktualisht jetojnë rreth 80 mijë banorë, e rreth 70% e tyre janë shqiptarë. Kurse në institucionet shtetërore në Luginë punojnë rreth 1 600 zyrtarë, prej tyre vetëm 387, ose 24% janë shqiptarë.

Në Luginë mungojnë tekstet shkollore në gjuhën shqipe, kurse tekstet nga Kosova nuk lejohen. 5 000 tekste shkollore në gjuhën shqipe të dërguara nga Kosova janë konfiskuar nga policia. Mungesa e kuadrit të kualifikuar për shkak të mosnjohjes së diplomave të universiteteve të Kosovës është po ashtu problem i madh për shqiptarët e Luginës.

Serbia nuk i njeh as diplomat e shkollave të mesme, e as dëftesat e shkollave fillore nga Kosova.

Mësimi i historisë kombëtare në Luginë është reduktuar në maksimum. Në Luginë nuk ka spitale, e ata që kanë nevojë për të shtrihen në spital duhet të shkojnë në Vranjë, në Nish ose në Beograd.

Në anën tjetër, Serbia nuk e lejon hapjen e maternitetit, i cili tanimë është i ndërtuar në Preshevë dhe vetëm e pret lejen nga shteti për fillimin e punës. Serbia nuk e lejon as regjistrimin e foshnjave që lindin në Kosovë edhe kur dy prindërit janë banorë të Luginës. Gratë atje shpesh janë të detyruara të lindin në shtëpitë e tyre, pa përkujdesje mjekësore.

Banorët e Luginës që për një kohë dalin jashtë vendit për të punuar, edhe pse familjet dhe pasurinë e kanë në vendlindje, shlyhen nga evidenca e shtetësisë së Serbisë dhe kështu atyre u merren të gjitha të drejtat, duke përfshirë këtu edhe të drejtën e votës.

Në disa agjenci shtetërore nuk ka të punësuar asnjë shqiptarë. Në polici, 70% e të punësuarve janë serbë. Në Gjykatën Themelore në Bujanoc punojnë vetëm 3 gjykatës shqiptarë, kurse në Luginë nuk ka gjykatë të shkallës së dytë.

Barazia në përdorimin e gjuhëve është vetëm në letër. Në Radiotelevizionin Publik të Serbisë nuk ka asnjë minutë program në gjuhën shqipe.

Investim i vetëm i Serbisë në Luginën e Preshevës është ndërtimi i bazave ushtarake dhe të xhandarmërisë që ushtrojnë presion të vazhdueshëm te shqiptarët atje.

Investime në fushën e zhvillimit ekonomik në Luginë nuk ka. Prodhimet bujqësore apo ato të ndonjë kompanie private nuk kanë treg. Ato nuk mund të sillen në Kosovë, kurse në Serbi bojkotohen.

Shqiptarët e Luginës së Preshevës kanë nevojë për ndihmë, prandaj Shqipëria dhe Kosova duhet ta ngrehin në institucionet ndërkombëtare çështjen e diskriminimit të shqiptarëve në Luginën e Preshevës:

- 1) Shqipëria dhe Kosova duhet t'ua sigurojnë nxënësve në Luginën e Preshevës tekstet shkollore falas dhe ta detyrojnë Serbinë që ta lejojë përdorimin e tyre.
- 2) Dy shtetet shqiptare duhet t'i bëjnë presion Serbisë që t'i nostrifikojë diplomat e universiteteve publike të Shqipërisë dhe Kosovës.
- 3) Studentët e Luginës, në dy shtetet shqiptare, duhet të trajtohen si studentët e Shqipërisë, përkatësisht të Kosovës në çdo aspekt.
- 4) Dy shtetet shqiptare duhet ta përkrahin themelimin e një universiteti publik në Luginën e Preshevës.
- 5) Dy shtetet shqiptare duhet ta ndihmojnë hapjen e maternitetit në Preshevë.
- 6) Dy shtetet shqiptare duhet t'i përkrahin projektet ekonomike që do të hapnin vende të reja pune dhe krijonin kushte për të jetuar në Luginë.
- 7) Kosova duhet t'i heqë të gjitha pengesat administrative që pengojnë lëvizjen e lirë të shqiptarëve të Luginës së Preshevës dhe prodhimeve të tyre.
- 8) Dy shtetet shqiptare duhet të hapin zyrë ndërlidhëse për Luginën e Preshevës dhe të vënë kontakte të rregullta institucionale.
- 9) Tri komunat e Luginës së Preshevës duhet ta themelojnë asociacionin e komunave.
- 10) Dy shtetet shqiptare duhet menjëherë ta iniciojnë dhe fillojnë procesin e riatdhesimit të shqiptarëve të dëbuar masivisht nga Lugina e Preshevës në vitin 2001. Paraprakisht, këtyre qytetarëve duhet t'u ndërtohen shtëpitë dhe infrastruktura e nevojshme në vendlindjet e tyre në Luginë.
- 11) Për zgjidhjen e të gjitha këtyre problemeve që shqiptarëve të Luginës së Preshevës ua bëjnë të pamundur jetën në vendin e tyre, Qeveria e Kosovës, bisedimet e mëtutjeshme me Serbinë duhet t'i kushtëzojë me parimin e reciprocitetit. Në të kundërtën, ikja e shqiptarëve nga Lugina është e paevitueshme e përgjegjësia do të bjerë mbi dy shtetet shqiptare dhe bashkësinë ndërkombëtare që po hesht para kësaj politike raciste të Serbisë mbi shqiptarët autoktonë të Luginës së Preshevës. Derisa Qeveria e Kosovës po negocion me Beogradin sikur të mos ekzistonte fare Lugina e Preshevës, nga kjo që u tha më lart del se Serbia është kampione e shkeljes së të drejtave të njeriut dhe atyre kombëtare në Evropë. Ky problem serioz i shqiptarëve dhe i Evropës nuk zgjidhet duke e heshtur. Ky problem kërkon zgjidhje të drejtë gjersa nuk është bërë vonë.

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.)

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Kurteshi! Fjalën e ka zoti Ramush Haradinaj, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së.

RAMUSH HARADINAJ: I nderuar kryesues!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Shikoni, shumë tema që lidhen me Gjyqësorin në Kosovë janë aktuale, prej atyre që janë obligime të Kosovës. Me Ligjin e Kosovës, ose ligjin ndërkombëtar, e deri te gjendja e Gjyqësorit në vend, mirëpo ajo që sot dua ta veçoj është situata me emërimin e kryeprokurorit. Ka një zvarritje dhe kjo po shkon edhe me hallkat e veta, domethënë kyçet Gjykata Kushtetuese. Pak a shumë, na po e dimë që kyçet Gjykata Kushtetuese, kur ka interes që një temë ta pezullojë për një kohë për t'ia ruajtur vendin ndoshta ndonjë ministri ndonjëherë, ose kur të vijë koha e rokadës, kur të shkojë kryetari i Gjykatës, e kemi kuptuar pra këtë lojë, e nuk është në rregull. Mendojmë se një qasje e tillë është gabim. Ata që janë më të involvuar e dinë për çka e kam fjalën.

Njëkohësisht, puna me grevën e gjyqtarëve të Gjyqësorit nuk është temë bash e vogël. Ne gjithë ditën po ankohe mi pse nuk na besoi bashkësia ndërkombëtare që ne t'i trajtojmë të gjitha ato aspekte që lidhen me ligjin në vend. Njëkohësisht ankohe mi se na janë bërë të padrejta, ndërsa vetë i lëmë gjyqtarët tanë në grevë. Ekziston një normë për kompensim e arritur dakord, e nuk zbatohet. Si ta bindim ne dikë si Kosovë që ndonjëherë do të bëjmë Gjyqësor në rregull dhe do të ketë ligj në rregull, në rast se gjyqtarëve tanë nuk ua përmbushim normën për kompensim, në rast se nuk u ndajmë buxhet që të kemi gjyqtarë të mjaftueshëm dhe në rast se nuk e kemi preokupim numrin e lëndëve, qoftë atyre që presin me vite, qoftë atyre që veç janë të përmbaruara, që nuk kanë më vlerë, dhe problemet që ka Gjyqësori.

Në rast se duam ta bindim dikë, por së pari veten, qytetarët e vendit, që do të ketë ligj në Kosovës, mos harroni që nuk guxojmë ta lëmë këtë temë kaq gjatë, pa u marr me të. Prandaj, sot nuk qenka ministri i Drejtësisë këtu, nuk ka lidhje, askush nuk do të mbetet pa punë, e as ai, edhe në rast se nuk është ministër ndonjëherë nuk është mirë që institucionet e larta të shtetit të mbahen peng, të prijë për fatin e një individi, sikur në fakt është duke ndodhur tash. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Bajrami e ka fjalën!

VALDETE BAJRAMI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Është për habi se si jemi bërë të heshtur për skandalet që janë bërë përditshmëri dhe rutinë në vendin tonë. Skandalet e njëpasnjëshme, duke filluar nga sistemi i arsimit, me dështimin e tij total, kur thuaja se çdo ditë raportohet për një universitet që prodhon diploma fals, e nga po këto universitete kinse po dalin kuadro, punësime pa konkurs të papunëve dhe të tilla po ka së fundi edhe në qytetin e Gjilanit, ku sistemi i shëndetësisë, e që nuk qëndron hiç më mirë se sistemet tjera, ku ishte skandali i stendave, mungesa e barnave esenciale nëpër qendrat familjare, trajtimi joadekuat i pacientëve, zvarritja e atyre që cilët presin për intervenime të ndryshme, ku kjo ministri e bën listën siç do, e jo në bazë të gjendjes së pacientëve, por edhe shumë e shumë raste të tjera, të cilat edhe ju vetë i dini dhe jeni dëshmitarë, por kjo heshtje e juaja po e konfirmon të kundërtën.

Kjo heshtje juaja po dëshmon se Kosova, gjithnjë sipas jush, është vendi ideal dhe ku gjithçka është duke funksionuar perfekt, por jo sigurisht dhe me bindje të plotë e them që është vendi ideal, ku ju mund të bëni çfarë të doni, ku ju mund të punësoni kë të doni, ku ju mund ta largoni kë të doni. Aty ku ju mund të korruptoheni dhe të mos gjykoheni, aty ku mund të shantazhoheni, aty ku ju mund edhe të dënoni, e të bëni komplete për kë të doni me fakte ose pa fakte, ku sistemi i drejtësisë është në kolaps total.

Jemi dëshmitarë se çfarë situatë kemi në Këshillin Prokurorial, në Prokurorinë e Shtetit. Të gjithë i keni parë akuzat që ia kanë bërë prokurorët njëri-tjetrit, duke shkuar deri aty sa edhe ata vetë pohojnë se bandat kriminale e kanë kapur Prokurorinë e Shtetit.

Fatkeqësisht, Ministri i Drejtësisë sot nuk gjendet këtu mirëpo kam disa pyetje konkrete për të: Zoti ministër, kush janë ato banda që e kanë kapur Këshillin Prokurorial? Pse nuk keni kërkuar hetim për deklarimin e prokurorëve se bandat kriminale kanë ndikim në Këshillin Prokurorial ju që jeni si ministër i Drejtësisë dhe si anëtar i Këshillit Prokurorial.

Me sa kemi parë edhe në media, ju jo vetëm që nuk keni bërë asnjë hap për të kërkuar zbardhjen e pohimeve nga vetë prokurorët, anëtarë të këtij Këshilli Prokurorial, por ju përkundrazi e keni luajtur rolin e pajtimit dhe heshtjes së këtyre akuzave brenda anëtarëve të Këshillit Prokurorial. Ju, në vend që të shqetësoheni për mosfunksionimin e këtij këshilli të kapur nga bandat dhe t'i hetoni ato akuza të rënda, të ndërsjella ndërmjet të prokurorëve në këshill, ju e keni zgjedhur rrugën tjetër - t'i heshtni dhe t'i bëni edhe prokurorët t'i heshtin ato akuza që ia kishin bërë njëri-tjetrit në këshill dhe në vend të rrugës ligjore, ju e zgjodhët logjikën politike. I pajtuat prokurorët ndërmjet tyre, duke i shtyrë t'i kërkojnë falje njëri-tjetrit, duke thënë çka ishte - ishte, u pajtuam dhe u mbyll kjo çështje.

Jo zoti ministër, ky skandal në sistemin e drejtësisë nuk mund të mbyllet me stil politik.

Ju i keni ata njerëz pajtuar për ato akuza të rënda skandaloze se Këshilli Prokurorial është i ndjekur nga bandat kriminale, që kanë mbetur aty dhe ata kërkojnë hetim ligjore dhe duhet të zbardhet e vërteta se sistemi i drejtësisë është i kapur dhe është para shkatërrimit që tregon po ashtu skandali tjetër, edhe atë në gjykatën më të lartë të shtetit - në Gjykatën Supreme. Gjyqtarët e Gjykatës Supreme dalin në publik dhe thonë: “Jemi të kërcënuar dhe po na bëhet shantazh për motivet e ndryshme” dhe Qeveria e vendit tonë dhe Ministria e Drejtësisë përsëri heshtin.

Detyrë kryesore e ministrit të Drejtësisë është të garantojë funksionimin e institucioneve të drejtësisë dhe kjo ministri nuk ka bërë dhe nuk bën asgjë për ta garantuar këtë funksionim dhe për këtë më së miri dëshmon kolapsi në dy institucionet më të larta të drejtësisë, në Këshillin Prokurorial dhe në Gjykatën Supreme të Kosovës.

Prandaj, ne dhe qytetarët e Kosovës me të drejtë jemi të shqetësuar, sepse para syve tanë po e shohim shkatërrimin e drejtësisë në vendin tonë dhe po e shohim Qeverinë tonë, jo vetëm që hesht dhe nuk bën asgjë, por fatkeqësisht edhe po e ndihmon këtë sistem.

Qytetarët e këtij vendi pyesin se si është e mundur që Qeveria, konkretisht Ministria e Drejtësisë, deri më tani nuk është prononcuar në lidhje me skandalet e publikuara nga “Koha Ditore”, kur qytetarët e këtij vendi dalin para organeve të drejtësisë duke pritur që të gjykohen me të drejtë

dhe me një gjykim të drejtë duke iu referuar respektimit të ligjit, por para tyre del një panel gjyqësor, i formuar në kundërshtim me ligjin dhe me vendim paraprak për t'i dënuar pa e shqyrtuar fare lëndën.

Pse zoti ministër ju nuk jeni deklaruar në këtë rast? Pse nuk keni kërkuar hetim në lidhje me këtë skandal? Ne mund ta kuptojmë heshtjen tuaj dhe ta dimë arsyen tuaj, por qytetarët nuk mund ta kuptojnë dhe nuk e dinë pse po heshtni.

Fatkeqësisht, sot qytetarët e Kosovës jetojnë në një shtet të kapur në të gjitha segmentet e tij. Qytetari i Kosovës është tërësisht i pambrojtur. Jetojmë në një shtet ku nuk ka barazi ligjore, në një shtet ku shkelet e drejta elementare e njeriut, të cilën e ka të garantuar me konventa ndërkombëtare...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Fjalën e ka zoti Pajaziti!

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti kryesues!

Meqenëse u konsumua po ashtu tema për të cilën unë planifikova të flas, do ta jap vetëm versionin e shkurtër. Është fjala për grevën e gjykatësve, për më tepër trajtimin e kërkesave të tyre. Sa për të përsëritur një fakt, rritja e pagave në Republikën tonë, ndër të parët e ka prekur sistemin e drejtësisë, gjykatësit, prokurorët, dhe ideja ka qenë atëherë që ata materialisht të trajtohen, në mënyrë që sistemi i drejtësisë të jetë sa më efikas.

Pas kësaj kohe kemi ende probleme të tilla. Unë për më tepër besoj që edhe ministri duhet ta shpjegojë se si është puna. Unë e di se në të njëjtën mënyrë janë paguar ose janë kompensuar edhe prokurorët. Nuk e di pse tash ajo shtesë u është hequr vetëm gjykatësve, e për më tepër, pavarësisht se bëhet fjalë për një shumë të të hollave që ata duhet t' i marrin si kompensim, si pagë, fjala është për një vonesë jashtëzakonisht të madhe në trajtimin e lëndëve, për një dëm që po i bëhet sistemit të drejtësisë. Edhe ashtu vazhdimisht për çdo vit kemi pasur vërejtje se sistemi i drejtësisë po çalon, gjykatat e kanë një grumbullim të madh të lëndëve të pa trajtuara dhe kjo vonesë tash e ka thelluar edhe më tepër hendekun, ose këtë nevojë. Me siguri do të kemi vërejtje të tilla që do të na adresohen edhe nëpërmjet Raportit të Progresit.

Mendoj se Qeveria duhet shpejt t' i trajtojë këto, t' i zgjidhë shpejt këto probleme. Mendoj se ashtu siç ka qenë e mundur pak më herët të jepet ai buxhet, është mirë të menaxhohet, të vazhdohet t' ju jepet, për më tepër nëse nuk kemi për t' ua rritur pagat, të mos u hiqen, dhe për më tepër se sa paga duhet të menaxhohet që ata të kthehen në vendet e tyre të punës dhe të mos kemi vonesa në trajtimin e lëndëve. Ju e dini që kohëve të fundit kemi edhe raste tragjike nëpër rrugë tona ku vriten njerëzit, për më tepër edhe zyrtarë të shtetit, e për pasojë është një nivel jo i mirë i trajtimit të lëndëve e të kontesteve që drejtësia jonë i zgjidh.

Pra, sa më shpejt ata të kthehen në vendet e tyre të punës, të trajtohet me urgjencë çështja e pagesave të tyre dhe të mos kemi vonesa në trajtimin e lëndëve edhe çështjeve tjera nga qytetarët.

Dhe, po e shfrytëzoj rastin krejt shkurtimisht, meqë e kam një çështje krejt tjetër. E kam një kërkesë nga qytetarët e një fshati, që veç ka filluar një procedurë për t'u bërë komunë. Është fjala për Zhegrën. Është një kërkesë që më është deponuar nga qytetarët atje që duan të marrin informata nga Qeveria se deri ku ka shkuar ky proces, edhe nga Ministria e Pushteti Lokal, edhe nga Qeveria...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Bulliqi e ka fjalën. Ju deputetët e rinj, kur keni për të folur, shtypeni sustën, sepse duhet lajmëruar që në fillim që keni për të diskutuar. Bulliqi, e ke fjalën? Në rregull, atëherë zoti Baxhaku.

HATIM BAXHAKU: Faleminderit i nderuar kryesues i seancës!

I nderuar Kabinet qeveritar

Të nderuar deputetë,

Unë sot para jush edhe para qytetarëve të Kosovës duhet ta ngre shqetësimin dhe indinjatën time të mjekëve dhe punëtorëve të tjerë shëndetësorë në institucionet publike lidhur me sulmet, fyerjet, akuzat e pabaza dhe joprofesionale, që për një kohë të gjatë po bëhen në adresë të punëtorëve shëndetësorë nga disa medie, por edhe politikanë të pandërgjegjshëm.

Të nderuar deputetë dhe qytetarë të Kosovës,

Ne mjekët dhe punonjësit shëndetësorë gjatë punës sonë shpeshherë ballafaqohemi me sëmundje të rënda, të cilat rrezikojnë shëndetin, shpesh dhe jetën e pacientëve dhe nganjëherë angazhimi jonë, edhe pse i përkushtuar dhe me profesionalizëm, për shkak të natyrës së sëmundjes përfundon tragjikisht dhe nuk mund të arrijmë suksesin e pritur, si nga ana jonë ashtu edhe e pacientit.

Dua të jem i qartë, se unë nuk dua të them se në institucionet tona publike nuk ka mangësi, as nuk e them se nuk ka ndonjë rast të veçuar të ndonjë dukurie negative dhe as nuk kërkoj, që ato të heshtën dhe të fshihen, por vetëm kërkoj informim të drejtë për këto dukuri.

Është e pafalshme, bile shumë e dëmshme, kur mediat dhe politikanët pa asnjë analizë krijojnë lajmin, duke u bazuar vetëm në deklaratën e ndonjë pacienti, ose familjari të cilën ai e jep në momentet e rënduara emocionale, kur ka të sëmurë më të afërmin e vet, ose në rastin më të keq, kur humbë më të dashurin.

Të nderuar deputetë,

Unë dua vetëm t'ju sjell disa nga shkrimet, thëniet dhe deklaratat nëpër portale dhe medie të shkruara, si dhe ato televizive dhe pastaj ju vet gjykoni, se a i shërbejnë këto institucioneve tona dhe qytetarëve.

Së pari, po ju përmend rastin kur një gazetar udhëheqës i një emisionit të televizionit publik, në një emision kur mysafir kishte doktor Rifat Latifin, kirurgun e mirënjohur shqiptar, që punon dhe jeton në Amerikë, deklaroi: "Kur njëherë unë isha për një të afërm në QKUK, një motër më tha në konfidencë, spitalet tona janë të specializuara për të mbytur njerëz...", taksativisht kështu ka thënë, "... dhe jo për të shëruar". Ose, kur politikanë të ndryshëm të pandërgjegjshëm me

dhjetëra herë përsërisin konstatimet e veta, se spitalet tona janë shndërruar në vende ku pacientët shkojnë për të vdekur dhe jo për t'u shëruar. Ju gjykoni vetë, sa janë këto të arsyeshme, të vërteta dhe të dëmshme. Ose, tituj skandalozë nëpër gazeta dhe portale, siç janë: “Foshnja i ra mjekut nga duart dhe i kërciti koka për tokë”, ose “mjekëve tanë nuk duhet t'ua lëmë as kafshët në dorë”. Këta janë titujt e gazetave dhe të portaleve tona.

Shkrime dhe deklarata të tilla, jo vetëm që nuk janë të vërteta, ato janë skandaloze dhe absurde dhe shumë të dëmshme për sistemin tonë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Topalli, i fundit.

FATON TOPALLI: Të nderuar deputetë,
Prej përfundimit të luftës e deri më sot, të gjitha instancat gjyqësore të vendit tonë, prej Gjykatës Komunale në Ferizaj e deri tek Gjykata Kushtetuese, kanë vendosur që t'i kompensojnë rrogat e punonjësve të Fabrikës së Gypave në Ferizaj.

Pra, po flasim për një vendim, për të cilin janë shteruar të gjitha mjetet e mundshme juridike, për ta kundërshtuar.

Parlamenti i Kosovës ka votuar tri herë për ekzekutimin e vendimit të Gjykatës. Më 21 shkurt të vitit 2013, me propozimin e zotit Beqiri, më 23 janar të vitit 2014, me propozimin e zotit Reçica dhe më 19 mars të vitit 2014, me propozimin e ish-kryeministrit të Kosovës.

Është konfirmuar gjithashtu, publikisht se këto mjete do të paguhen nga fondi rezervë dhe një kërkesë e tillë është bërë edhe zyrtarisht. Unë nuk dua të shtyhem me askënd, se kush mban më shumë e kush më pak përgjegjësi, ata që kanë organizuar dreka apo ata që kanë luajtur me daulle vallen e fitores në qendër të Ferizajt, por, fakt është që as Partia Demokratike e Kosovës, as Lidhja Demokratike e Kosovës nuk e kanë plotësuar këtë kërkesë, të cilën e shtron gjyqësori.

Të gjitha këto nuk janë të reja. E re në gjithë këtë histori është gjyqi, që kryeministri i Kosovës ua ka bërë punëtorëve të Fabrikës së Gypave, duke komunikuar këtu, në këtë sallë, në këtë foltore, që vendimin e Gjykatës Kushtetuese nuk do ta ekzekutojë.

Si paska të drejtë një kryeministër t'i kundërvihet Kuvendit, që tri herë ka votuar për ekzekutimin e këtij vendimi?

Si paska të drejtë një kryeministër të mos ekzekutojë vendimin e Gjykatës Kushtetuese?

Si paska të drejtë një kryeministër të vendos vetë, se cilat të drejta, cilat vendime gjyqësore do t'i ekzekutojë dhe cilat jo?

Kjo është skandal, zonja dhe zotërinj, ky është shembulli më tipik i kapjes së shtetit nga ana e politikës.

Unë i ftoj zotin Beqiri, zotin Reçica dhe ish-kryeministrin e Kosovës, të deklarohen publikisht, se a qëndrojnë prapa mbështetjes që ua kanë bërë punëtorëve të Fabrikës së Gypave, vitin e kaluar dhe të angazhohen që qysh në muajin prill, vendimi i Gjykatës Kushtetuese të zbatohet.

Zoti Mustafa,

Ju ftoj të hiqni dorë nga roli i prokurorit dhe gjyqtarit. Kërkoni falje publike për ngatërresën që keni krijuar dhe jepni një shembull të mirë të respektimit të ligjit, një shembull të mirë të ndarjes së pushteteve. Askush s'mund të prishë punë ...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Koha e deklarimeve jashtë rendit të ditës është shteruar.

Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës:

2. Koha për pyetje parlamentare

Në bazë të nenit 45, paragrafi 1 i Rregullores së Kuvendit, koha për pyetje parlamentare zgjat 60 minuta.

Për këtë seancë janë parashtruar 38 pyetje parlamentare. Ftoj zotin Fisnik Ismaili, që të shtrojë pyetje për ministrin Skënder Hyseni. Nuk është. Deputeti Ismail Kurteshi pyetje për ministrin Arban Abrashi.

ISMAIL KURTESHI: Faleminderit!

Zoti ministër,

Një numër i madh i ish të punësuarve në Zvicër, që aktualisht i kanë mbi 65 vjet moshe e që jetojnë në Kosovë, nuk po mund t'i realizojnë pensionet që u takojnë, që nga marsi i vitit 2010, për shkak të mos vazhdimit me kohë të marrëveshjeve të Qeverisë së Kosovës me autoritetet e Zvicrës.

Qeveria e kaluar u ka premtuar publikisht këtyre pensionistëve se do ta zgjidhë këtë problem, por problemi ende nuk është zgjidhur.

Zoti ministër, kërkojmë nga ju të na njoftoni, se çka ka ndërmarrë Qeveria, gjegjësisht Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, për zgjidhjen e këtij problemi, kur dihet që më 16 shtator të vitit 2010 Kuvendi i Kosovës i ka aprovuar 8 rekomandime, që kanë të bëjnë me arritjen e Marrëveshjes Kosovë - Zvicër lidhur me sigurimet shoqërore e që direkt ndikojnë edhe në marrjen e pensioneve të këtyre mijëra punëtorëve shqiptarë, të cilët kanë kaluar jetën duke punuar në Zvicër. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti ministër, e keni fjalën. S'është. Në rregull! Zonja Haxhiu, pyetje për kryeministrin Isa Mustafa. kryeministri s'është këtu. Fjalën e ka zonja Teuta Haxhiu.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, kryesues!

Meqenëse nuk mu dha rasti, e kërkoj që disa herë fjalën, i kisha dy çështje shumë me rëndësi, çështjen e patentë-shoferëve, që e diskutuan edhe anëtarët nga partitë tjera, që janë në pushtet. Pra këta edhe e kanë obligim për ta kryer këtë çështje, që është shqetësim i qytetarëve, pra për afatin e skadimit të patentë-shoferëve, por dhe një çështje shumë me rëndësi, heqja nga regjistrat civilë e shqiptarëve në Medvegjë, Preshevë dhe Bujanoc.

Kërkoj nga Qeveria, që urgjentisht të diskutojë këtë çështje edhe me faktorin ndërkombëtar, për diskriminimin e vazhdueshëm, që po u bëhet shqiptarëve atje dhe kërkoj, jo më pak të drejta se sa ka minoriteti serb këtu në Kosovë.

Dhe, po i kthehem pyetjes, e cila është shtruar që më 25 shkurt, do të thotë, kanë kaluar një muaj, kur unë kam kërkuar nga kryeministri i Kosovës, të tregojë se në Qeverinë e tij, sa zëvendësministra i ka. Sepse, në vazhdimësi nga një, dy, tre fshehurazi po i qesin zëvendësministrat dhe nuk po tregojnë, se mund të jenë rreth 50 sosh e nga përlogaritjet që i kam bërë unë me numrat e matematikës, ka dalë që shtetit të Kosovës i kushtojnë diku 160 mijë euro.

Pra, është mirë që të dalë dhe të tregojë sa zëvendësministra ka dhe sa po e kursen buxhetin e Kosovës, duke shtuar në vazhdimësi, jo vetëm se janë shtuar shumë ministri, por edhe shumë zëvendësministra dhe ta dimë se nga janë ata zëvendësministra, a janë profesionalë apo thjesht janë vetëm militantë partiakë?

Po, unë megjithatë do ta bëjë prapë këtë pyetje derisa të marr përgjigje nga kryeministri. Faleminderit!

KRYESUESI: Zakonisht, zanat për ministër as për zëvendësministër s'ka, politikë janë gjithmonë. Zonja Gaxherri e ka pyetjen për zëvendëskryeministrin Thaçi. Dëshironi ta bëni pyetjen?

BESA GAXHERRI: Faleminderit, zoti kryesues!

Unë kam ngritur në shkurt çështjen e demarkacionit me Kosovë e Malin e Zi dhe për këtë muaj kam bërë edhe pyetje parlamentare, edhe pse ministri s'qenka këtu, pyetjen po e lexoj dhe besoj që ministri një ditë do të jetë këtu dhe të na përgjigjet, sepse çështja është shumë e ndjeshme.

Me rastin e vizitës së fundit të zotit Thaçi, të ministrit të Punëve të Jashtme në Republikën e Malit të zi, deklaroi se çështja e demarkacionit Kosovë – Mali i Zi tashmë 90% e procesit ka përfunduar.

Zoti ministër, ju e dini se Mali i Zi tashmë ka shfaqur pretendimet ndaj territorit të Kosovës në 40 km gjatësi të kufirit, duke filluar nga Rugova në thellësi 7 km dhe duke përfunduar në Kullë me 5 km thellësi. Mali i Zi pengon qytetarët e komunës së Pejës dhe të Deçanit, që t'i shfrytëzojnë pronat e veta.

Pyetja është: Ju lusim të na informoni me procesin e demarkacionit me Malin e Zi, mbi çfarë baze ligjore dhe kushtetuese po diskutohet ky proces, a po respektohen kufijtë e vitit 1974? A ka Komisioni qeveritar material dokumentues për këtë çështje mjaftueshëm, sepse një komision

lokal i komunës së Pejës, ka argumente të mjaftueshme, një ndër to po e citoj sot, hartën e vitit 1974, e cila është e hartuar ekskluzivisht nga autorë serbë, malazias e kroatë. Nuk është asnjë shqiptar në hartimin e kësaj harte, andaj kjo hartë e ka atë argumentin e fuqishëm për anën e Kosovës.

Pra, hartuesit e kësaj harte janë: Profesor dr. Nikola Pavičević; Ljubomir Grujić, inxhinier i diplomuar; Miloshević Ljubomir, inxhinier i diplomuar; Katalina Petar, inxhinierë e diplomuar; Vasić Gradimir....

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Kurteshi, pyetje për ministren Edita Tahiri.

ISMAJL KURTESHI: Faleminderit! Tash ka ardhur edhe ministri Abrashi dhe kërkoj që edhe ai të përgjigjet e të mos ikë prej këtu kur të duhet të përgjigjet në pyetje. Pyetjen nëse s' e din , e ka lexuar dhe le të përgjigjet, kurse për ministreshën kështu:

Me buxhetin e shtetit të Serbisë, aktualisht po ndërtohen banesa kolektive për serbët në pjesën veriore, por edhe për serbët, që asnjëherë nuk kanë jetuar në Kosovë, pra, kolonët serbë, në lagjet ku shumica janë shqiptarë.

Në të njëjtën kohë shqiptarëve nuk u lejohet t'i rindërtojnë shtëpitë e tyre, në trojet e tyre të djegura nga Serbia.

Zonja ministre, a janë këto veprime të Qeverisë së Serbisë dhe komunës së integruar, sipas jush, të Mitrovicës në veri, në përputhje me marrëveshjen që ju e keni nënshkruar në Bruksel?

Nëse nuk janë në përputhje me Marrëveshjen e Brukselit, çka jeni duke ndërmarrë që ta pengoni atë që po ndodh në Lagjen e Boshnjakëve, përveç deklaratave pompoze, të cilat nuk e kanë asnjë efekt atje në terren?

KRYESUESI: Zonja Tahiri, e keni fjalën.

MINISTRJA EDITA TAHIRI: Faleminderit, i nderuar kryesues i Kuvendit!

Deputetë të nderuar,

Kabinet qeveritar,

I nderuar deputet Kurteshi

Çështja e ndërtimeve në pjesët që po i theksoni ju nuk ka qenë temë në dialogun e Brukselit.

Kjo çështje është diskutuar në përpjekje për të zgjedhur në Kosovë një kontekst, ku ka marrë pjesë Ministria përkatëse e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, kanë marrë pjesë kryetarët e dy komunave të Mitrovicës, partnerët ndërkombëtarë, Zyra e Bashkimit Evropian dhe Ambasada Amerikane. Dhe, në përpjekjet e tyre për të vënë rend dhe rregull në fushën e ndërtimeve, u involvohen edhe çështjet të ndjeshme politike, që i theksuat ju, pra ndërtimet ilegale apo tendenca për të sjellë kolonë. Është diskutuar dhe ka dalë një memorandum bashkëpunimi, i cili

ende nuk është nënshkruar, sepse kryetari i Mitrovicës, komuna veriore ende nuk është i gatshëm të nënshkruajë.

Mirëpo, këto janë çështje jo në kompetencat e dialogut të Brukselit. Ka qenë pra një aktivitet i ynë i brendshëm dhe unë do të thosha, për herën tjetër duhet të pyetet ministri i Ministrisë përkatëse.

Mirëpo, në qoftë se ju e keni vërejtur, kam qenë unë në Kroin e Vitakut së bashku me inspektorët e ndërtimit për t'i ndalë këto ndërtime, më 27 korrik të vitit të kaluar, ka qenë sepse unë e kam udhëhequr grupin punues që lidhet me procesin e integritetit të komunave veriore dhe meqë isha në krye të projektit dhe nuk mu dukte se duhet vetëm inspektorët të shkojnë, sepse ata janë shërbyes civilë, mu dukte se mua më takonte si politikane, si zëvendëskryeministre të shkojë dhe t'ua ndalë punimet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Ke pyetje shtesë, zoti Kurteshi?

ISMAJL KURTESHI: Zonja ministresh! Në Kosovë edhe fëmijët e kanë kuptuar që nga këto bisedime kurrëgjë s'ka fituar Kosova. Çdo gjë që po bëni atje, janë humbje për Kosovën.

Kur do ta kuptoni ju se po shkon në Bruksel dhe me këto bisedime po i shkaktoni dëme të pariparueshme Kosovës dhe po e favorizoni Serbinë duke i krijuar terren që të ndërhyjë në të gjitha fushat e jetës, këtu. Ju nuk po merreni me atë pjesë, por po merreni me ndarjen e zyrave të gjykatave të ndryshme dhe me imtësi shumë më të mëdha, të cilat duhet të jenë çështje kryekëput të Kosovës, ndërpritni këto bisedime se e shkatërruat këtë vend! Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! E doni fjalën, zonja ministresh? E ka fjalën zonja Tahiri!

MINISTRJA EDITA TAHIRI: Deputet i nderuar!

Dolët nga konteksti i pyetjes tuaj, sepse tema ishte për ndërtimet, dhe ato ilegale. Unë ju tregova se nuk është kompetencë nga fushëveprimtaria që unë e kam kompetente.

U morët me dialogun e Brukselit. T'ju them të drejtën, po i bie shkurt.

Me politika injorante dhe nihiliste, Kosova do të mbetet e izoluar. Kosova ka bërë përparime të mëdha me Marrëveshjen Stabilizim-Asociim. Është pranuar si shtet në procesin e integritetit evropian. Së shpejti nënshkruhet Marrëveshja e Stabilizim-Asocimit, pastaj do të ratifikohet.

Ne tash do të kërkojmë edhe statusin e kandidatit dhe po të mos ishte që ne jemi vizionarë si shtet dhe Qeveri, që politikat e fqinjësisë së mirë janë kriter për integritet evropian, natyrisht se do të mbeteshim me logjikën që e përmenda në fillim të fjalës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë, ishte një pyetje për ministrin Abrashi. Ministër, dëshironi të përgjigjeni? Urdhëroni!

MINISTRI ARBAN ABRASHI: Faleminderit, zoti kryesues!
Ministra,

Deputetë,

Në raport me lidhjen për marrëveshjen me Zvicër, sa për informatë, me marrjen e mandatit Qeveria e në këtë rast unë si ministër dhe kabinet, kemi filluar kontakte me Ambasadën Zvicerane dhe e kemi pranuar pyetësin e dytë, gjatë muajit mars.

Në koordinim me institucionet tjera, kemi filluar plotësimin e pyetësit i cili është shumë voluminoz, janë diku më shumë se 100 pyetje, dhe dua t'i falënderoj edhe institucionet tjera, në këtë rast Ministrinë e Punëve të Brendshme, Ministrinë e Shëndetësisë, TRUST-in dhe të tjerët, që kanë arritur t'i plotësojnë të gjitha kërkesat dhe pyetjet e parashtruara nga shteti zviceran.

Pyetësi momentalisht është në përkthim dhe besoj se deri në fund të muajit, në fillim të javës së ardhshme, do të dërgohet te pala zvicerane.

Indikacionet janë pozitive, kemi hasur në mirëkuptim të mirë edhe nga ana e tyre. Realisht, me dërgimin e pyetësit ne e kryejmë obligimin tonë ndaj tyre dhe shpresojmë që të hapim negociatat me ta për një model, të cilin do të fillojmë ta aplikojmë në Kosovë.

Gjithashtu kërkoj që mos ta politizojmë këtë çështje shumë. Është shumë komplekse dhe nuk kemi nevojë ta bëjmë këtë personale duke parashtruar pyetje, jemi këtu edhe jam përgjigjur edhe para Komisionit. Jo, u tha në televizion se po ik, s'jam duke ikur nga kurrkush, jam i gatshëm me u përgjigj në pyetje, po edhe të jam korrekt. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti Kurteshi ka pyetje shtesë?

ISMAJL KURTESHI: Së pari, ju ministrat nuk jeni mësues të deputetëve, por ju jeni shërbyes të këtij populli dhe jeni përgjegjës para deputetëve dhe ndërpritni këto farë ligjërata të kota e injorante, siç ishte e ministres, e cila po zhvat në vend të këtij populli dhe po i sjell dëme.

Dhe, pyetja ime shtesë për ty, është kjo zoti ministër: Në rekomandimet, në njërën nga 8 rekomandimet e Kuvendit të Kosovës, më 10 shtator të vitit 2010, pra para 5 viteve ka qenë:

Qeveria duhet të vendosë si prioritet rinegociimin e Marrëveshjes për sigurimet shoqërore në Zvicër.

Dhe tjetra - Qeveria duhet t'i procedojë në Kuvend ligjet që hapin rrugë për nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje.

A ka filluar procesi i procedimit të ligjeve, sepse aty duhet edhe do ligje, sigurisht të rregullohen, për të ardhur deri te një marrëveshje e duhur?

KRYESUESI: Zoti Abrashi, e ke fjalën.

MINISTRI ARBAN ABRASHI: Faleminderit, kryesues, deputetë!

Ligjet, besoj se infrastruktura ligjore është e mjaftueshme. Kemi të bëjmë me dy skema të reja të pensioneve që është invalidor dhe familjar, e gjithashtu edhe kategorizimi i skemës së kontributdhënësve.

Jemi duke punuar infrastrukturën e brendshme ligjore dhe besoj se, sa i përket paketës ligjore, i përmbushim kushtet dhe jemi në rregull me këtë.

Çështja kryesore dhe më e ndjeshme ka qenë pyetësi. Ai është në përkthim, sikur që thashë, dërgohet në fund të kësaj jave, varësisht prej çështjeve teknike të përkthimit dhe pastaj mbetet të pala zvicerane të shikojmë në takimet tjera si t'i qasemi tërë kësaj problematike.

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Deliu, pyetje për zëvendëskryeministrin Shala.

BLERTA DELIU-KODRA: Faleminderit, kryesues!

Meqë pyetja ime parlamentare drejtuar ministrit Shala është bërë para 4 javësh dhe lidhet me funksionimin e bordeve të Galerisë dhe bordeve tjera dhe të Këshillit artistik, mendoj që është e vonuar dhe e tërheq pyetjen.

KRYESUESI: Faleminderit! E keni edhe një pyetje. A e keni tërhequr edhe pyetjen e dytë?

BLERTA DELIU-KODRA: Pyetja e dytë i është drejtuar gabimisht nga administrata ministrit Kujtim Shala, por kjo pyetje kërkoj që t'i drejtohet ministrit të Arsimit, sepse lidhet me tekstet shkollore dhe mendoj që është ende aktuale për lëshimet e fundit të cilat janë bërë në tekstet shkollore të cilat përdoren në shkollat tona.

KRYESUESI: Faleminderit! Ministri i Arsimit nuk është këtu. Zoti Haxhi Shala, pyetje për kryeministrin Isa Mustafa. Kryeministri nuk është këtu. Jeni i lirë, nëse doni ta bëni pyetjen!

HAXHI SHALA: Faleminderit, kryesues!

Kjo pyetje kohë e gjatë është që e kam bërë, por, kryeministri pasi që nuk është këtu, duhet t'i drejtohem të na i jep disa sqarime rreth ndryshimeve të cilat i ka bërë në AKI, edhe pse është kompetencë e tij edhe e presidentit, por mirë është edhe Komisioni t'i ketë me shkrim të gjitha ato ndryshime që i ka bërë dhe të jemi të sigurtë para mediave dhe para publikut se pse kanë dhënë dorëheqje ose pse kanë bërë ndryshime në Agjencionin e Inteligjencës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Haskuka, pyetje për zëvendëskryeministrin Shala.

MYTAHER HASKUKA: Zoti zëvendësministër, pyetja ime është lidhur me ndërtimet në Kalanë e Prizrenit. Që nga viti 2008 në Kalanë e Prizrenit janë duke u zhvilluar projekte hulumtuese, gërmime arkeologjike, ndërmarrje konservimi, restaurimi dhe ndërtime të reja.

Gjatë vitit të kaluar, mbi terrenin arkeologjik shumëshëmbor, brenda Kalasë janë ndërtuar objekte të reja. Ndërtimi i objekteve të reja në Kalanë e Prizrenit kanë nxitur reagime nga banorët dhe ekspertët e trashëgimisë kulturore, që perceptojnë si degradim të lokalitetit arkeologjik.

Kalaja e Prizrenit është aset i trashëgimisë kulturore arkeologjike në mbrojtje të ligjit dhe ndërhyrjet degraduese nuk lejohen.

Bazuar në kornizën ligjore në fuqi, të gjitha projektet dhe aktivitetet e ndërhyrjeve fizike, në asetet e trashëgimisë kulturore, arkeologjike, përfshirë ndërhyrjet hulumtuese, gërmimet

arkeologjike, punët konservuese apo ngritja e objekteve të reja, duhet zbatuar sipas procedurave dhe kriterëve të përcaktuara në Ligjin numër 02/L-88 për trashëgiminë kulturore, neni 3, 4, 5, 7 dhe 8.

Pyetja ime është: Në bazë të cilave vendime, leje dhe plane janë duke u kryer ndërtimet e reja dhe intervenimet konservuese, restauruese në lokalitetin arkeologjik Kalaja e Prizrenit?

KRYESUESI: Zoti ministër, e ke fjalën.

MINISTRI KUJTIM SHALA: Faleminderit, zoti kryesues,

I nderuar zoti deputet,

Punimet në Kalanë e Prizrenit kanë filluar në vitin 2014, por në bazë të vendimit të ish- ministrit të Kulturës të datës 28 tetor 2013. Vendimi mbështetet në raportin e Komisionit për shqyrtimin e kërkesave dhe të projekt-propozimeve për ndërhyrje restauruese dhe ky vendim përcakton:

1. Lejimin edhe më tutje të gërmimit arkeologjik në hapësirat të cilat përcaktohen drejtpërdrejt nga bartësi i gërmimit dhe ai është Instituti i Arkeologjisë i Kosovës.
2. Lejimin e konservimit të kazamateve në qytetin e epërm;
3. Lejimin e konservimit të kazamateve në qytetin e poshtëm; dhe
4. Lejimin e shtigjeve të ecjes në hapësirat në të cilat gërmimi arkeologjik ka përfunduar.

Sa i takon pjesës qendrore të Kalasë, Komisioni ka kërkuar tri variante për rikonstruimin e hapësirës muzeore dhe këtë kërkesë e përshkruan edhe vendimi respektiv.

Ekipi punues ka përgatitur tri variante dhe Komisioni e ka zgjedhur variantin të cilin e ka konsideruar të përshtatshëm dhe në përputhje me parametrat e përcaktuar.

Pas kësaj, vendimi i ministrit i datës 28 tetor 2013 nuk është ndryshuar dhe nuk është plotësuar.

Mbi këtë bazë, Ministria i ka pezulluar punimet në atë pjesë të Kalasë dhe ka kërkuar nga Komisioni për shqyrtimin e kërkesave dhe projektpropozimeve për ndërhyrje restauruese, që ta trajtojë çështjen dhe për mënyrën e vijimit të punimeve, ne do të vendosim, varësisht nga vlerësimet që do t'i japë Komisioni. Faleminderit!

KRYESUESI: Ke pyetje shtesë, zoti Haskuka?

MYTAHER HASKUKA: Zoti zëvendëskryeministër dhe ministër, në aspektin e vendimit që e keni parashtruar, Kalaja e Prizrenit konsiderohet si objekt arkitektonik, ndërsa, sipas të gjitha listave që i ka Kosova, Kalaja e Prizrenit është objekt arkeologjik, dhe çfarëdo intervenimi në objektet arkeologjike duhet të kalojë nga institucionet kompetente dhe çdo projekt-propozim ose çdo projekt që bëhet duhet të kalojë nga Këshilli për Trashëgimi Kulturore të Kosovës.

Momentalisht nuk ka asnjë vendim ose asnjë projekt që ka kaluar nga Këshilli i Trashëgimisë Kulturore. Domethënë, janë dy sende këtu. Së pari vendimi është i bazuar në një listë të gabuar ose me qëllim është tejkaluar ajo që kalaja është objekt arkeologjik, dhe e dyta është që në këtë rast është dashur për ta dërguar në Këshillin për Trashëgimi Kulturore.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti ministër e keni fjalën.

MINISTRI KUJTIM SHALA: Faleminderit, zoti deputet!

Tani kjo çështja s'mund të zgjidhet retroaktivisht për çështjen të cilën keni pyetur ju konkretisht direkt dhe cila është shumë e rëndësishme. Unë ju dhashë përgjigje për atë pjesë. Meqenëse ka paqartësi dhe meqenëse vendimi nuk është ndryshuar dhe nuk është plotësuar ne i kemi pezulluar punimet dhe do ta ndjekim procedurën, do t'i marrim raportet dhe pastaj do të vendosim për vazhdimin ose jo të punimeve.

Po për vendimet e viteve të shkuara dhe për raportet që ka pasur ministria me Këshillin e Trashëgimisë së Kulturës, unë nuk mund të ndërhyj për gjëra të cilat kanë kaluar. Tash për tash, për pjesën e cila është kontestuar, ne i kemi pezulluar punimet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Zafir Berisha, pyetje për kryeministrin Mustafa.

ZAFIR BERISHA: Faleminderit, kryesues!

Meqë kryeministri si zakonisht mungon, unë do ta ngre këtë shqetësim në formë pyetjeje. Ka të bëjë me një proces që në kohë vazhdimisht kontestohet pasi të kryhet. Është fjala se në prill të vitit 2011 ka qenë një marrëveshje ndërmjet Mustafës, Thaçit dhe Pacollit për zgjedhjen e një kontesti të atëhershëm rreth presidentit, por në atë marrëveshje është premtuar dhe janë zotuar se do të fillojnë reformat zgjedhore. Në fakt, pozicioni i kryeministrit aktual ka qenë ndryshe dhe ai vazhdimisht është ankuar se po bllokohet nga vartësi aktual i tij.

Tash si kryeministër, a do të vazhdojë me reformën në Ligjin zgjedhor, pasi dihet që në një të ardhme të afërt mund të ketë probleme, veçanërisht me zgjedhjen e presidentit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Hoti, pyetje për kryeministrin Mustafa.

ENVER HOTI: Faleminderit, kryesues!

I nderuar Kabinet,

Të nderuar deputetë,

Edhe pse kryeministri mungon, unë do ta shtroj pyetjen. Çështja ka të bëjë lidhur me bartjen e kompetencave nga regjioni i Prizrenit në regjionin e Gjakovës për komunën e Malishevës dhe të Rahovecit.

Pyetja ime konkrete është kjo: Si dhe pse është bërë një bartje e tillë, me çfarë vendimi të Qeverisë nga regjioni i Prizrenit në regjionin e Gjakovës për këto dy komuna.

Të nderuar deputetë,

Qeveria komunale, qytetarët e këtyre dy komunave nuk janë pyetur dhe ndihen jashtëzakonisht keq, sepse këto qesin shumë vështirësi në realizimin e këtyre shërbimeve regjionale për këto dy komuna, e veçanërisht për qytetarët e komunës së Malishevës.

Komunat i kanë edhe asetet e tyre, bashkëpunimet në ndërmarrjet regjionale, po ashtu i kanë investimet e veta tradicionale dhe historike edhe në kuadrin njerëzor. Prandaj, sikur që ka ndodhur, këto bartje janë bërë në mënyrë të heshtur, apo për të mos thënë krejt në një mënyrë tinëzare.

Unë kërkoj një përgjigje për korrektësinë tuaj. Nga këshilltari ligjor i kryeministrit jam marrë në telefon dhe ai më ka thënë se nuk ka ndonjë vendim të Qeverisë, por kjo ka mbetur në kompetencë të ministrive të linjës dhe sinqerisht prej shqetësimeve të qytetarëve të këtyre dy komunave. Nëse s’e ka autorizuar dikë kryeministri për ndonjë përgjigje, unë vetëm e ngreh si shqetësim dhe kërkoj një mirëkuptim nga Komuna e Gjakovës. Nuk kemi asgjë kundër, e kemi një respekt të jashtëzakonshëm edhe si qendër, edhe për nivelin intelektual të qytetarisë, por vështirësitë në aspektin e kohës, në aspektin financiar dhe në aspektin e përgjithshëm për qytetarët e këtyre komunave janë jashtëzakonisht të mëdha dhe të papranueshme dhe qytetarët e këtyre dy komunave janë të shqetësuar. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Emini, pyetje për ministrin Krasniqi.

NJOMZA EMINI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Kolegë deputetë,

Pyetja është për ministrin Memli: Fillimisht ju përgëzoj për punën deri më tani dhe për iniciativat e reja që keni filluar.

Situata e drurëve është jo mjaft e mirë në Rrafshin e Dukagjinit, posaçërisht e drurëve halorë, meqë një pjesë e madhe e Alpeve Shqiptare janë të përbëra prej drurëve të tjerë.

Pyetja konkrete është: A është duke vazhduar me konfiskimin e drurëve halorë dhe drurëve tjerë që po priten pa leje në këto pyje nga Agjencia Pyjore e Kosovës. Po ashtu, në hapësirat e dëmtuara a po dihet saktësisht sa hektarë pyje janë rigjeneruar nëpërmjet procesit të pyllëzimit. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti Krasniqi!

MINISTRI MEMLI KRASNIQI: Faleminderit!

I nderuar kryesues,

Të nderuar deputetë,

E nderuara zonja deputete Emini,

Faleminderit për pyetjen, edhe pse konsideroj se ndoshta ishte dashur t’i drejtohet ministrit të Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, meqë Bjeshkët e Nemuna, bazuar me Ligjin për parkun kombëtar “Bjeshkët e Nemuna” administrohen nga Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit, që është në kuadër të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Dhe, që prej vitit 2013, Agjencia Pyjore e Kosovës, që është në kuadër të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural nuk administron, nuk pranon kërkesa dhe nuk menaxhon me ndonjë aspekt parqeve nacionale, siç janë edhe Bjeshkët e Nemuna.

Në pajtim me këtë, Agjencia Pyjore e Kosovës, më 25 janar 2013, ka nxjerrë edhe vendim për ndalimin e pranimi dhe shqyrtimit të të gjitha kërkesave për shfrytëzimin e pyjeve dhe tokave pyjore, të cilat përfshihen brenda parkut nacional “Bjeshkët e Nemuna”.

Gjithsesi më lejoni t’i jap disa informacione për pyetjen tuaj, për gjendjen dhe masat e marra në pjesën ku administron apo ka administruar Agjencia Pyjore e Kosovës.

Nga korriku 2010, në pajtim me nenin 18 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale dhe ndryshimplotësimin e Ligjit për pyjet e Kosovës, mbrojtja e pyjeve dhe dhënia e lejeve për prerje në territorin e një komune përcaktohet si kompetencë e deleguar nga niveli qendror në nivelin lokal.

Gjithashtu, konfiskimi i masës drusore nga shërbimi i mbrojtjes së pyjeve nëpër komuna është e hyrë tërësisht e komunës, e cila u nënshtrohet procedurave të prokurimit publik nga komuna.

Mbikëqyrja administrative e këtij ligji dhe e akteve nënligjore bëhet nga Ministria nëpërmjet Agjencisë Pyjore të Kosovës si organ kompetent për këtë fushë.

Mbikëqyrjen inspektuese të këtij ligji dhe akteve nënligjore e bën Inspektorati i Pylltarisë.

Për sa u përket masave të Inspektoratit në periudhën 2011-2012, ju informoj se janë konfiskuar me vendimet e Inspektoratit Pyjor 1 045 metra kub dru, kurse vetë Inspektorati ka konfiskuar 200 metra kub.

Është bërë regjistrimi i terreneve pyjore në ngastrat ku operatorët ekonomikë kanë pasur kontrata të shfrytëzimit, të kontraktuara nga komunat e rajonit të Pejës. Nga shtatë komisione profesionale të Agjencisë Pyjore janë konstatuar dëme pyjore në masën 3 500 metra kub në vlerë prej 500 deri 25 mijë euro. Në pajtim me këto konstatime janë marrë masa ligjore deri në shpëputjen e kontratave për dhjetë operatorët ekonomikë dhe në bashkëpunim me Policinë e Krimeve Ekonomike në Pejë janë iniciuar dhjetë padi penale për operatorët ekonomikë dhe për 16 zyrtarë përgjegjës për mbrojtjen e pyjeve në komunat e Pejës, Deçanit dhe Junikut.

Sa i përket çështjes së zgjerimit të sipërfaqeve pyjore, si me pyllëzim, po ashtu edhe me regjenerim natyral dhe... brenda dy inventarizimeve gjatë viteve 2003-2013 paraqesin një shtim të sipërfaqeve pyjore prej 5% apo 20 mijë e 200 hektarë shumica, prej të cilave është zgjeruar në mënyrë natyrale.

Agjencia Pyjore e Kosovës brenda...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Pyetje shtesë?

NJOMZA EMINI: Nuk kam pyetje shtesë. Faleminderit!

KRYESUESI: Dua ta shtoj për informatën, besoj që paskan kapur shumë lëndë drusore të prera. Unë mendoj se ditën vidhen njëmijë metra dhe barten nga ato bjeshkë, por sidoqoftë kjo është situata tash e 15 vjet. Atje po përfundon gjithçka, e ne po flasim këtu!

Prapë zonja Emini, pyetje për zotin Hoti.

NJOMZA EMINI: Faleminderit, kryesues!

Pyetja është ministrin Hoti: Disa komuna në të kaluarën nuk kanë përfshirë në listat e punëtorëve, por vetëm në regjister të pagave, personat që janë paguar nga komunat repektive. Në disa raste qytetarët janë ankuar se për një vend pune potencialisht paguhen dy individë, ndërsa vetëm njëra e realizon detyrën në bazë të kontratës.

Pyetja: A e ka harmonizuar Ministria e Financave listën e të gjithë punëtorëve dhe regjistrin e pagave nga të gjitha agjencitë dhe komunat e Republikës së Kosovës që të ndalet kjo praktikë dhe qytetarëve të Republikës së Kosovës t'u ofrohen shërbime korrekte? Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti ministër Hoti, e keni fjalën.

ABDULLAH HOTI: Faleminderit, kryesues!

E nderuara deputete,

Unë ju njoftoj që në bazë të Ligjit të buxhetit për arsim dhe shëndetësi ne i ndajmë grantet për komunën në përputhje me formulën për këto dy qëllime, për arsim ndahen normat për çdo 21 nxënës, është një normë mësimore. Për atë normë mund të punësohen një ose dy veta. Pra, në sistemin e pagave ... mund të ketë më shumë se sa norma mësimore. Por, pagesat që bëhen në bazë të kësaj, pra normë mësimore për 21 nxënës. Prandaj, mund të ketë në listë më shumë persona se sa që ka norma, e ky mund të jetë problemi, përndryshe kjo është kompetencë e decentralizuar complete e komunave. Në baza mujore, këto lista vijnë në Ministrinë e Administratës Publike dhe pastaj ekzekutohen në Ministrinë e Financave.

Pra, ju mund të shihni më shumë persona në listën e pagave, por si pagesa bëhen në bazë të normave. Nuk ka ndonjë problem në këtë drejtim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Ismajli, pyetje për ministrin Skender Hyseni.

FISNIK ISMAJLI: Është e pakuptimtë është java e katërt që po e shtroj pyetje për ministrin Skender Hyseni, ndërsa ai për katër javë nuk ka ardhur.

Unë po e përsëris prapë, meqenëse është e drejtë të përsëritet për një ngjarje të 22 shkurtit, e sot është 26 mars.

Zoti ministër, më 22 shkurt, në rrugën nacionale në komunën e Shtërpçës persona të nacionalitetit serbë me arsyetimin se po bëjnë festë nacionale kanë dalë për disa orë në këtë aks rrugor dhe të maskuar u kanë kërkuar të holla udhëtarëve nëpër vetura dhe autobusë.

Për ta hapur rrugën, ata jo vetëm se e kanë penguar qarkullimin e lirë shumë qytetarëve, por të maskuar kanë shkaktuar panik ndaj qytetarëve që udhëtonin për qendrat turistike të Prevallës e

Brezovicës, gjatë tërë kohës, asnjëherë të prekur prej Policisë së Kosovës, derisa në protestën e 27 janarit u rrahën brutalisht, e madje edhe u sulmuan me plumba gome protestuesit paqësorë pa maska vetëm pse kishin dalë ta ushtrojnë të drejtën e tyre demokratike për të protestuar.

Pyetja ime për ministrin është: A mund të na tregoni se çka nënkupton plani operativ i Policisë së Kosovës, për çka dhe pse është toleruar bllokimi i rrugës dhe kërkimi i të hollave për lejimin e kalimit me njerëz, të cilët kishin maska. Dhe po më intereson, nuk po kuptohet asnjëherë qartë se kur po ndërhyjnë Policia, e kur jo. A i bie kjo që në protestat e ardhshme edhe ne duhet të veshim maska për të mos hëngër dajak? Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Ministri ishte këtu, ju nuk ishit. Tash ministri nuk është, ju jeni. Kjo është gjendja. Zonja Bajrami, pyetje për ministrin Mahir Yagcilar.

VALDETE BAJRAMI: Faleminderit, kryesues!

Grupi Parlamentar “Nisma për Kosovën” dhe qytetarët e Republikës së Kosovës në rrugët nëpër vendin tonë, pos ditëve të punës, ditëve të vikendit shohim në qarkullim vetura të Qeverisë së Republikës së Kosovës, por jo vetëm në Kosovë, por kjo ndodhë edhe në vendet e rajonit, konkretisht shumë shpesh në vikend mund t’i shohësh ato vetura edhe në Republikën e Shqipërisë.

Siç jemi të njoftuar të gjithë deputetë dhe qytetarët e Republikës së Kosovës, ka qenë një tender i hapur për pajisje me GPS të veturave zyrtare të Republikës së Kosovës.

Pyetja ime është kjo, zoti ministër: Si është gjendja e GPS, mirëmbajtja e këtij programi dhe sa është funksional ky program? Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti ministër Yagcilar, e ke fjalën.

MINISTRI MAHIR YAGCILAR: Faleminderit, i nderuar kryesues i Kuvendit,

Të nderuar deputetë, ministra,

Zonja deputete,

Projekti i sistemit të menaxhimit të shpenzimeve të automjeteve nëpërmjet GPS është projekt i cili mundëson digjitalizimin e monitorimit të përdorimit të automjeteve dhe shpenzimet e karburantit.

Implementimi i projektit ka filluar në vitin 2010 dhe ka vazhduar deri në vitin e kaluar.

Gjithsej numri i veturave zyrtare të pajisura me GPS është 1 668. Sistemi është funksionalizuar në ministrinë, në Zyrën e Kryeministrit, disa agjenci të pavarura, Policinë e Kosovës, Doganën e Kosovës, ATK e të tjera dhe janë përfshirë shumica e automjeteve.

Aktualisht, sistemi shfrytëzohet vetëm në Policinë e Kosovës, ku monitorohen 642 automjete, gjë që nga stafi i Policisë ka edhe vlerësime pozitive, por ka edhe vlerësime që nuk e kanë efektin e duhur.

Është me rëndësi të theksohet se në kontratë është paraparë që në kuadër të instalimit të pajisjes të përfshihet edhe abonimi për monitorim njëvjeçar, që pas kalimit të kësaj periudhe në

pamundësi financiare për të vazhduar abonimin, pajisjet GPS nuk përcjellin informacione momentalisht në sistem, gjë që aktualisht veturat zyrtare të institucioneve, përveç në Policinë e Kosovës, nuk kanë mundësi të monitorohen.

Sistemi si i tillë është funksional vetëm nëse konsiderohet me rëndësi të ndahet buxhet për vazhdimin e abonimit dhe funksionalizimin e sistemit GPS në automjetet e pajisura në këto dhe shqyrtimin e mundësisë për zgjerimin e këtij projekti.

Lidhur me funksionalitetin e sistemit, institucionet shfrytëzuese kanë vlerësime të ndryshme. Mirëpo, vazhdimi i projektit prapë mbetet edhe nga aspekti financiar, por edhe nga aspekti i monitorimit dhe zbatimit të rregulloreve. Sa i përket GPS-së, institucioneve në këtë rast, edhe për shfrytëzimin e automjeteve, sepse nuk mjafton vetëm monitorimi, por nevojiten edhe të gjitha procedurat përcjellëse e të tjera.

KRYESUESI: Pyetje shtesë, zonja Bajrami?

VALDETE BAJRAMI: Po, zoti ministër, ju e përmendët një numër shumë të madh të veturave, të cilët janë të pajisura me GPS, mirëpo a e kanë funksional të gjitha dhe a raportojnë të gjithë te ju, në Ministrinë tuaj, për harxhimet të cilat i bëjnë këto vetura, pasi e dimë që është një kosto shumë e madhe dhe derisa disa ministri e kanë GPS dhe monitorohen e disa të tjera nuk e vendosin, tash dëshiroj të di ku qëndron problemi? A varet prej ministrit të japë ndonjë urdhër ose një rregullore që mos të vendosen GPS nëpër vetura të dikasterit të tij, apo kjo është vullnetin e të gjithë të tjerëve që të veprojnë si të duan.

MINISTRI MAHIR YAGCILAR: Po, faleminderit!

Këto pajisje janë pjesë teknike GPS, por nevojitet edhe abonimi pas kalimit njëvjeçar, i cili ka kaluar edhe sipas parashikimeve si një çështje financiare e kushtueshme, por prapë duhet të vlerësohet nëse ekziston nevoja të vazhdohet.

Dhe, aspekti tjetër për mua është pak më interesant, ose më e rëndësishëm. Në qoftë se bëhet monitorimi, atëherë cilat janë procedurat për zbatimin. Sipas rregulloreve të cilat janë ekzistuese dhe ligjeve, çdo institucion, çdo ministri dhe çdo institucion është përgjegjës sa i përket monitorimit dhe mbikëqyrjes së pajisjeve dhe në këtë rast shtrohet pyetja se sa mund të intervenohet edhe nga ministri i Administratës Publike. Por, dëshiroj të ju informoj se Qeveria para një muaji e ka marrë edhe një vendim që sa i përket kushtëzimit edhe përdorimit të automjeteve të kryhet edhe një monitorim më i lehtë, të largohen të gjitha ato automjete të cilat janë amortizuara dhe në të ardhmen të krijojmë një mundësi të shikojmë ku mund të kryhen kursimet më të mëdha.

Personalisht, unë mendoj që sa i përket shpenzimeve të karburanteve shumë më shumë janë shpenzime të mirëmbajtja e automjeteve dhe të çështjeve tjera. Kështu që ne besojmë që edhe në nivelin e Qeverisë do të bisedojmë për këto çështje dhe të shikojmë në të ardhmen që ta zvogëlojmë numrin e automjeteve në minimum dhe të shikojmë pastaj mundësi tjera që të mos cenohet edhe funksionimi i institucioneve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Pantina, pyetje për kryeministrin Isa Mustafa, nëse dëshironi ta shtroni pyetjen.

SHQIPE PANTINA: Faleminderit!

Në fakt, kjo pyetje do të duhej t'i drejtohej ministrit të Administrimit të Pushtetit Lokal, por i cili u bënë gati dy muaj tashmë që nuk është duke e ushtruar funksionin e vet dhe ka të bëjë me vendimin e kryetarit të Komunës së Ranillugut, Gradimir Mikiq, i cili ka propozuar që një rrugë atje t'i vihet emri i Slobodan Milosheviqit, i cili, siç e dimë, është drejtpërdrejt fajtor për vrasjen dhe masakrimin e mbi 12 mijë qytetarëve, përfshirë këtu edhe gra, fëmijë dhe të moshuar, dhe shkatërrimin e shumë objekteve, shtëpive, shkollave, e kështu me radhë.

Kjo është edhe një fyerje tjetër që u bëhet qytetarëve të Kosovës, pas asaj që u bëri Jabllanoviqi nënave të Gjakovës dhe protestuesve atje.

Pyetja për kryeministrin, e shpresoj se njëri nga ministrat ia përcjell atij, është se cilat janë masat që ai do të ndërmarrë karshi kryetarit të Komunës së Ranillugut, Gradimir Mikiq, por edhe Listës serbe, në përgjithësi, për fyerjet e vazhdueshme që ata i bëjnë, por edhe për shkeljet e ligjeve dhe të Kushtetutës.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Topalli, pyetje për ministrin Arban Abrashi.

FATON TOPALLI: Kjo pyetje është bërë bukur herët. Zoti Abrashi, skema e asistencës sociale që nga vitit 2012 deri në vitin 2015 ka pasur për çdo vit pak ndryshime sa i përket buxhetit. Buxheti ka qenë pak a shumë i njëjtë në këto katër vjetët e fundit. Bile dallimi ndërmjet vitit 2013 dhe 2012 është gjithsej 2 725 euro, ndërkohë që Buxheti i Kosovës gjatë kësaj periudhe ka ndryshuar vazhdimisht, por nuk është bërë ndonjë ndryshim sa u përket atyre mjeteve që do t'i marrin qytetarët që jetojnë nga asistenca sociale.

Do të doja të dija se sa ishte numri i përfituesve të asistencës sociale në vitet 2012, '13, '14 dhe '15.

KRYESUESI: Zoti Abrashi, e keni fjalën.

MINISTRI ARBAN ABRASHI: I nderuar kryesues,

Të nderuar deputetë,

Faleminderit për pyetjen! Është e vërtetë që buxheti për skema sociale ka qenë i pandryshueshëm realisht në dhjetëvjetëshin e fundit, me një dallim shumë të vogël tani është rreth 28 milionë euro dhe kjo shumë ka qenë që nga 10 vjet, e nevojat janë normalisht më të mëdha.

Sidoqoftë, ajo çka keni vërejtur është shumë e saktë, se ka filluar numri i rënies së atyre që përfitojnë. Kjo ka të bëjë me disiplinimin e skemës dhe zbatimin e kritereve dhe rregulloreve.

Sa për informatë, në vitin 2012, në dhjetor kanë qenë 31 mijë familje, në vitin 2013 në dhjetor 29 mijë familje, në dhjetor të vitit 2014 kanë qenë 27 389 familje, kurse sa për informatë në janar të vitit 2015 shifra e fundit është 27 280 familje.

Përpos disiplinimit të skemës, zbatimi i Ligjit 04/L-96 dhe Udhëzimit Administrativ gjithashtu ka ndikuar edhe aplikimi i softuerit në këtë vit, i cili i rregullon skemat përfitues në bazë të numrit personal dhe është vërejtur se një numër i familjeve kanë të hyra, domethënë realisht kanë përfituar prej skemave sociale, derisa kanë pasur të hyra dhe ky sistem tani po i përjashton në mënyrë automatike këto familje. Kanë pasur të hyra tjera, kanë pasur njerëz të punësuar, kanë përfituar prej skemave tjera dhe kjo po shihet në vazhdimësi.

Çka është me rëndësi të ceket është se ne jemi duke e shikuar këtë trend, ose në rishikim, ose vitin e ardhshëm, varësisht se sa mjete mund të kursehen do të bëjmë edhe indeksimin e skemës ose kompensimit, varësisht se sa kemi mjete edhe ndoshta edhe do të bëjmë rritjen e përfituesve atyre që e meritojnë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shtesë, zoti Topalli.

FATON TOPALLI: Nga ajo që shihet, tregon që është thjesht të përcaktohet një buxhet i caktuar dhe pavarësisht sa janë nevojat e qytetarëve.

Po shihet që ju po doni të kurseni ashtu siç kanë kursyer edhe qeveritë e kaluara, por pikërisht te njerëzit, te qytetarët tanë që kanë më së paku të ardhura. A është më mirë t'i zvogëloni numrat e ministrave, t'i zvogëloni rrogat e deputetëve, t'i zvogëloni rrogat e zëvendësministrave, sesa të kurseni në 100 gramë të bukës të 129 mijë qytetarëve sa jetojnë nga ndihmat sociale në Kosovë?

KRYESUESI: Zoti ministër, urdhëroni!

MINISTRI ARBAN ABRASHI: Faleminderit!

Edhe me këtë rast mendoj që nuk bën ta politizojmë këtë çështje, sepse janë kategori shumë e ndjeshme. Është një buxhet që unë e kam trashëguar, por me qejf do ta kisha rritur më shumë.

Ministria e Financave ka filluar shkurtimet buxhetore në shumë kategori, në luks e në paga, dhe është duke punuar në këtë drejtim. Çka është me rëndësi, në momentin e parë, së bashku me ministrin e Financave, do të bëjmë indeksimin që sjell rritjen e kompensimit për këto familje. Jemi duke menduar për ta, jemi duke punuar në atë drejtim, e në rastin e parë do ta rritim shumën e asistencës sociale. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Mustafa, pyetje për ministrin Abrashi.

SALIHE MUSTAFA: Faleminderit, kryesues!

Zoti ministër,

Ligji për pensione të financuara nga shteti është aprovuar nga Kuvendi në maj të vitit 2014. Mungesa e këtij ligji ka penguar që të nënshkruhen marrëveshjet bilaterale me shtetet evropiane, ku punojnë qytetarët tanë.

Meqenëse unë e mora përgjigjen që ia dhatë kolegut tim pak më parë, se jeni në negociata me shtetin e Zvicrës për nënshkrim të marrëveshjes, më intereson ta di nëse jeni në negociata, apo planifikoni me ndonjë shtet tjetër t'i filloni negociatat për nënshkrimin e marrëveshjeve, sepse sa

u përket ligjeve, ka qenë ky ligj dhe Ligji për sigurime shëndetësore, të cilat janë aprovuar, por dua ta di a jeni në negociata me ndonjë shtet tjetër? Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti ministër, e keni fjalën.

MINISTRI ARBAN ABRASHI: I nderuar kryesues,

Të nderuar deputetë,

Zonja Mustafa,

Faleminderit për pyetjen! Unë e kam përgatitur një përgjigje ndoshta pak më të gjatë sa për ta pasur një informatë edhe për marrëveshjet tjera dhe pastaj përgjigjem edhe në pyetjen.

Realisht, Republika e Kosovës ka nënshkruar dy marrëveshje ndërshtetërore në fushën e sigurimeve sociale, përkatësisht marrëveshje për këmbimin e përvojës për njohjen e së drejtës në pension me Republikën e Maqedonisë, në mars të vitit 2013, dhe me Malin e Zi, në maj të vitit 2014. Në janar të këtij viti e kemi nënshkruar marrëveshjen e bashkëpunimit për pensione ndërmjet Departamenteve të Pensionit të Kosovës dhe Institutit të Sigurimeve Shoqërore të Shqipërisë, e cila do t'i paraprijë një marrëveshje ndërshtetërore, e cila do të arrihet në vijim. Jemi duke punuar në këtë drejtim.

Ajo çka u tha për Zvicrën dhe shtetet tjera të Bashkimit Evropian, realisht ne jemi fokusuar për energjinë vetëm me shtetin e Zvicrës, pasi mendojmë që indikacionet janë më të mira dhe pasi ta arrijmë këtë marrëveshje, besoj që ky model do të hapë rrugë edhe për marrëveshje tjera me Slloveninë, me Gjermaninë, aty ku është edhe numri më i madh i bashkatdhetarëve tanë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shtesë? Jo! Në rregull! Deputetja Izma, pyetje për ministrin Rrahmani.

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit, nënkryetar!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të respektuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Pyetja ime, që është adresuar para tri javësh, ka të bëjë me çështjen e funksionimit të emergjencës qendrore në Klinikën Universitare. Është çështja që emergjenca qendrore në QKUK është takimi i parë i një qytetari me një gjendje të rëndë dhe familjarëve të vet me shërbimin shëndetësor. Aty shpesh ndeshemi me mungesë mjekësh ose infermierësh, aq më keq mund të mos ketë edhe vend ku të sistemohen pacientët, që eventualisht mund të jenë në një gjendje të rëndë, ose afërsisht të rëndë.

Ne e dimë edhe faktin që s'ka shërbime të mjaftueshme teknike, por shumica e pacientëve detyrohen të barten nga familjarët e vet në krahë ose me batanije, dhe thjesht një mundësi pra "gjendu si të duash".

I nderuar ministër,

Pyetja ime është kjo: A keni menduar në mandatin tënd se kjo çështje është shumë e rëndësishme dhe sa ju e keni analizuar gjendjen e shërbimeve në këtë departament? A ka buxhet të mjaftueshëm në këtë drejtim, apo ka mungesë stafi? Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti ministër Rrahmani, e keni fjalën.

IMET RRAHMANI: I nderuar kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Zonja deputete, faleminderit për shqetësimin rreth emergjencave, sepse ky është një shqetësim i vazhdueshëm edhe i Ministrisë së Shëndetësisë, por edhe imi si profesion shëndetësor i lëmisë së emergjencave.

Natyrisht që emergjenca është një lëmi shumë e re në sistemin tonë shëndetësor dhe ka 15 vjet që po ngrihen kapacitetet.

Është e vërtetë që ende nuk kemi arritur t'i futim emergjencat ashtu siç mendohet në gjithë territorin e Kosovës, respektivisht në gjitha institucione, duke përfshirë këtu edhe spitalet rajonale dhe njësitë e kujdesit primar. Dhe, është e vërtetë që Emergjenca në QKUK është e stërngarkuar nga rastet jo emergjente, aty diku rreth 70% e rasteve që trajtohen janë raste joemergjente dhe e marrin ndihmën aty. Kjo është edhe si pasojë e trendit global që pacientët kanë tendencë që shërbimet e tyre shëndetësore t'i marrin në emergjencë.

Po ashtu, është pasojë e një mungese të kujdesit sekondar shëndetësor në disa komuna, edhe në komunën e Prishtinës.

Natyrisht që aty ka edhe mungesë të stafit, por neglizhenca dhe mosprania e mjekëve sigurisht që do të duhet të trajtohet nga menaxherët direkt dhe ne sigurisht që këtë shqetësim do ta ngremë.

Ju them që punëtorët shëndetësorë të emergjencave deri tash nuk kanë qenë të stimuluar dhe gjithmonë i kanë hulumtuar të gjitha mundësitë që ta lëshojnë Emergjencën dhe të sistemohen diku nëpër reparte tjera dhe zakonisht aty kemi të bëjmë me fillestarë ose staf që nuk është i përgatitur sa duhet, mu për shkak të lëvizjes së punëtorëve në qendrat e tjera, ose në njësi të tjera.

Natyrisht që ne jemi duke punuar që këtë grup të punëtorëve shëndetësorë ta sistemojmë në grupin me rrezikshmëri dhe ata të kenë stimulim dhe motivim që të punojnë më shumë dhe të jenë në Qendrën Emergjente.

Tjetër? Mund të ju them që këto ditë është shpallur tenderi për Klinikën e re Emergjente dhe sigurisht që do të nënshkruhet kontrata nëse nuk kemi ndonjë problem gjatë procesit të ecjes së prokurimit dhe do të bëhet një ndërtim i një klinike që do të ndihmonte dhe do t'i lehtësonte edhe klinikat tjera nga mbingarkesa. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shtesë, zonja Izmaku?

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit, nënkryetar!

Unë e respektoj kohën e ministrit dhe përgjigjen me gjithë këto informacione. Të gjitha këto shqetësime ne nuk i kemi direkt tonat, mirëpo na adresohen prej qytetarëve. Nuk pretendoj që ju do të arrini t'i kryeni krejt punët, të cilat kanë mbetur keq gjatë gjithë këtyre mandateve qeverisëse, meqë vërtet asnjëri nga ne dhe partia ime nuk e bën kur prioritet çështjen e shëndetësisë.

Unë e kam pastaj edhe një pyetje tjetër. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetja tjetër nga zonja Izmak për ministrin Rrahmani.

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit, nënkryetar!

Këtë pyetje e kam shtruar para tri javësh, mirëpo po shihet që po kemi problem pak me kohën për adresimin e pyetjeve.

Pra, është një temë e cila edhe është konsumuar, mirëpo ne posaçërisht si gra na intereson, sepse kemi pasur shumë ankesa lidhur me skandalin e ndodhur në QKUK me rastin e lehonës, e cila, sipas informacioneve të marra, në mungesë të kujdesit nga infermieret që ishin kujdestare atë ditë, ajo u detyrua të lindë në korridor. Unë e di dhe kam dëgjuar shumë opinione dhe kam informacione që Komisioni i Shëndetësisë e ka vizituar vetë pacienten.

Mirëpo, i nderuar ministër, unë interesohem të di se çka keni bërë ju në këtë drejtim, a keni marrë informacione dhe, të ju them sinjerisht, jam befasuar që më shumë stafi i asaj klinike është interesuar që ta kurojë imazhin nëpërmjet një konference për shtyp se sa të interesohet se vërtet a ka ndodhur apo është ekzagjeruar, gjë që unë pak e besoj, pasi nënat në ato momente pak besojnë që të krijojnë drama, sepse ato interesohen për fëmijët dhe për shëndetin e tyre.

KRYESUESI: Zoti ministër, e keni fjalën.

MINISTRI IMET RRAHMANI: Faleminderit, kryesues!

Faleminderit zonja deputete!

Unë them që në momentin që e kemi marrë informacionin për shqetësimin që është ngrehur kemi kontaktuar me drejtorin e Shërbimit Spitalor dhe kemi kërkuar hulumtim. Natyrisht që ata kanë bërë hulumtimin dhe lënda është proceduar ...

Ju them me përgjegjësi se do të merren masa në Komisionin Disiplinor, eventualisht nga të gjeturat.

Ju them me përgjegjësi që informacionet që kanë rrjedhur në fillim se fëmija ka rënë në tokë nuk janë të vërteta, por lindja ka ndodhur në korridor dhe në prani të profesionistëve. Fëmija ka qenë mirë dhe është mirë ende dhe nuk kemi nevojë që ta dramatizojmë, por unë e përkrah edhe diskutimin e deputetit më herët që e ngrehu një çështje të trajtimit joadekuat dhe joreal të vlerësimit të punës të mantelbardhëve dhe ju ftoj publikisht që është koha e fundit që ne të punojmë bashkërisht, edhe politika, edhe media, edhe Qeveria, që të fillojmë ta trajtojmë me realitet punën e mantelbardhëve, se nuk është krejt keq, por ky trajtim i deritanishëm ka sjellë deri te humbja e besimit në shëndetësinë kosovare dhe ka krijuar një pakënaqësi, se çdo gjë është keq në shëndetësi.

Ju lutem, të punojmë t'i ngremë edhe çështjet e mira, t'i theksojmë ato, pa dashur t'i anashkalojmë defektet, pa dashur ta mbrojmë individin, i cili shkel rregullat dhe kodin e etikës profesionale. Faleminderit!

KRYESUESI: Pyetje shtesë, zonja Izmaçu?

XHEVAHIRE IZMAKU: Po, i nderuar ministër!

Është e vërtetë që ndoshta është ekzagjeruar, mirëpo sigurisht që rastet që na adresohen, po them edhe një herë kryesisht nga gratë, për këto çështje, jemi të vetëdijshëm se ne nuk duhet t'i gjeneralizojmë, që ka përkujdesje, ka njerëz dhe mjek që janë shumë profesionalë dhe në momentin kur ne do t'i marrin ato lajme të mira, patjetër se do t'i përdorim edhe si informacione në këtë Kuvend.

Mirëpo, nëse ne i adresojmë këto problematike, nuk duhet që staf i mjekësor t'i marrë këto si kritika, apo me mendimin, se ne duam të shohim vetëm zi. Pra, thjesht kemi nevojë që shqetësimet e qytetarëve t'i paraqesim këtu. Unë ju falënderoj për informacionet!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Bekim Hashiu i ka dy pyetje, por nuk qenka këtu. Zoti Nuredin Ibishi, pyetje për ministrin Agani. Ministri Agani nuk është, nuk është as ai. Zonja Kadrijaj, pyetje për ministrin Rrahmani.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, kryesues!

Ministër, kohë më parë është ngrehur një temë aktuale në mediat e Kosovës se ju në Gjilan e keni një ordinancë private, e cila është e regjistruar në emrin tuaj, por e cila asnjëherë nuk ka qenë e licencuar në Ministrinë e Shëndetësisë. Çka mund të na thonë për këtë temë?

KRYESUESI: Zoti ministër!

MINISTRI IMET RRAHMANI: Faleminderit, kryesues!

Edhe kjo çështja e ordinancës time është në kontestin e asaj çka thashë më herët që stërmadhohen çështjet dhe është hulumtuar rasti edhe nga Antikorrupsioni, dhe krejt është ok-ej. Ju garantoj që nuk ka kurrëgjë, vetëm ju them me sinqeritetin më të madh që më vjen keq prej pacientëve, të cilët më kanë kontaktuar dhe kanë pasur dëshirë t'i marrin shërbimet shëndetësore nga unë dhe unë prej vitit 2008 nuk kam punuar në atë ordinancë për shkak të pamundësisë të licencimit të ordinancës, sepse profesioni im - mjek i emergjencës - nuk parashihet në praktikën private dhe pyetja ka qenë pak më ndryshe, por unë po ju them që nuk punoj në privat prej vitit 2008. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shtesë, zonja Kadrijaj?

TIME KADRIJAJ: Faleminderit ministër për informacionin! Kjo për një kohë të gjatë është bërë temë edhe nëpër mediat sociale, megjithatë ju keni punuar dhe po rezulton që ju për aq kohë sa keni punuar keni qenë një shkelës i ligjit, sepse keni punuar duke i shkelur ligjet e Kosovës. Nuk e keni licencuar ordinancën dhe si mund t'ju besojmë tani që ju, në cilësinë e ministrit, që jeni njeriu që duhet t'i respektoni ligjet dhe t'i shtyni të tjerët në respektimin e ligjeve, ta bëni këtë punë.

KRYESUESI: Në rregull! Zonja Kadrijaj, e fundit, pyetje për kryeministrin Isa Mustafën.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, kryesues!

Edhe kjo pyetje është bërë para një muaji. Pyetja për kryeministrin ka qenë se sa nga ministrat e Kabinetit të tij punojnë edhe në detyra tjera shtesë, sepse nëse e shohim se në çfarë gjendje është Kosova, qoftë politike, ekonomike apo sociale, nuk e di çfarë performanse do të kenë ministrat, të cilët e kanë edhe një punë dytësore?

KRYESUESI: Koha për pyetje është shteruar, të tjerat i vazhdojmë në seancën tjetër.

Vazhdojmë me pikën e tretë të rendit të ditës:

3. Miratimi i procesverbalit nga seanca e mëparshme

Të nderuar deputetë, pyes nëse keni vërejtje në procesverbalin e seancës plenare, e mbajtur më 12 mars 2015? Nuk ka.

Konstatoj se Kuvendi e miratoi procesverbalin e seancës plenare, e mbajtur më 12 mars 2015.

Për rendin e ditës është lajmëruar kryetari i Grupit Parlamentar të PDK-së, zoti Grabovci.

ADEM GRABOCVI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, duke pasur parasysh rëndësinë e institucionit të Gjykatës Kushtetuese, ne propozojmë që kjo pikë e rendit të ditës të vihet si pika 6 e rendit të ditës, dhe pika 7 e rendit të ditës, votimi për Avokatin e Popullit, të shtyhet për nesër, duke parasysh se kjo seancë është e ngarkuar shumë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Kërkoj deklarinimin e kryetarëve të grupeve parlamentare. Zoti Beqiri e ka fjalën.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Edhe ne e konsiderojmë që është e arsyeshme që duhet të ketë vendosje dhe ky rirreshtim, nëse mund të thuhet i rendit të ditës, dhe ne jemi pro propozimit që u bë.

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të “Vetëvendosjes”, zoti Konjufca e ka fjalën.

GLAUK KONJUFCA: Ne konsiderojmë që dita e nesërme po ashtu e ka një problematikë shumë të rëndësishme, në të cilën do të trajtohet tema e Gjykatës Speciale dhe kryeministri do të jetë në interpelancën e thirrur nga Lëvizja “Vetëvendosje” për të raportuar lidhur me të, kështu që konsideroj që do të ishte mirë që kjo seancë e ditës së sotme t’i shterë të gjitha këto tema, ashtu që ditën e nesërme të jemi të përqendruar tërësisht në interpelancën ndaj kryeministrit.

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar të AAK-së, zonja Bujupi e ka fjalën.

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Kryetar, je lodhur apo nuk e di se çfarë ka ndodhur. Realisht, e dini edhe ju edhe anëtarët e tjerë të Kryesisë që kryeministri Mustafa, sipas Rregullores, është dashur

të jetë sot në interpelancë dhe me një dakordim të grupeve parlamentare, të përfaqësuara në Kryesinë e Kuvendit, ne u pajtuam që kjo të bëhet nesër, mirëpo me dakordimin e të gjithëve që e kemi një pikë të rendit të ditës, pika e parë në orën 10:00 të mëngjesit - interpelanca e kryeministrit Mustafa.

Tash këto përpjekje për të manovruar edhe për sjellë pika të tjera para interpelancës, janë edhe shkelje e marrëveshjes së djeshme, janë edhe të papranueshme, sepse kryeministri Mustafa, siç e thashë, është dashur që sot të raportojë para Kuvendit, por me kërkesë të grupeve parlamentare që vijnë nga pozita jemi pajtuar që kjo të ndodhë nesër.

Prandaj, Aleanca konsideron që nesër në orën 10:00 duhet të jetë kryeministri Mustafa në interpelancë, pastaj pikat tjera mund të mbeten në ndërkohë.

KRYESUESI: Faleminderit! Kështu është edhe kërkesa, nuk e ndryshojmë atë. Marrëveshja nuk ndryshon për nesër me asnjë kusht. Nga “Nisma”, zoti Hoti e ka fjalën.

ENVER HOTI: Faleminderit, kryesues!

Po ashtu, edhe ne e mbështetim që të jetë pika e fundit pas interpelancës të kryeministrit, nëse bartet për ditën e nesërme pika e shtatë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar “6+” keni qëndrim? Jo! Zoti Zemaj është paraqitur, apo e keni shtypur gabimisht? Në rregull, por nuk kemi debat!

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit!

Vetëm një fjalë shkurt, rendin e ditës e përcakton Kryesia, por është në dorën e deputetëve që ta plotësojnë dhe ta ndryshojnë, kështu që jo çdoherë çka thotë Kryesia dhe shefat e grupeve parlamentare vlen si marrëveshje. Për këtë arsye, Kuvendi vendos për rendin e ditës dhe këtu nuk ka ndonjë shpjegim tjetër.

KRYESUESI: Faleminderit! Sa i përket marrëveshjes për nesër, është marrëveshje e të gjitha grupeve parlamentare. Të gjitha grupet parlamentare i kanë pasur shefat e tyre dhe unë besoj se nuk do të ndryshojë sa i përket çështjes së interpelancës. Të tjerat pastaj. Atëherë, a jeni për propozim-mocionin e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike që pika 11 e rendit të ditës - Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit të posaçëm për zgjedhjen e një gjyqtari në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, në vend të pikës së 11, të jetë e renditur në pikën e gjashtë të rendit të ditës sot, dhe çështja e zgjedhjes së Ombudspersonit të shtyhet për nesër, pas interpelancës.

Kush është për? Shumica. Kundër? Shumica janë që të shtyhet. Nëse i doni numrat, por besoj se nuk ka nevojë. Atëherë, konstatoj që u miratua mocioni.

Vazhdojmë me pikën e katërt të rendit të ditës:

4. Shqyrtimi i Projektligjit për Ratifikimin e Marrëveshjes për financim ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim lidhur me Projektin për Eficiencën e Energjisë dhe Energjinë e Ripërtëritshme

Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar Projektligjin për ratifikimin e marrëveshjes dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim. Përfaqësuesi i Qeverisë, ministri Abdullah Hoti, është i ftuar që ta marrë fjalën dhe ta arsyetojë projektligjin.

MINISTRI ABDULLAH HOTI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar ministra,

Bazuar në planin kombëtar të veprimit për energji eficiente për vitet 2013-2015, Ministria e Zhvillimit Ekonomik ka vendosur për financimin e Projektit për Energji Eficiente dhe Energji të Ripërtëritshme nëpërmjet kredisë, kushtet financiare të së cilës i ka negociuar Ministria i Financave.

Ky projekt nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik është përfshirë në Ligjin e buxhetit vjetor, si dhe në kornizën afatmesme të shpenzimeve. Projekti në fjalë ka për objektiv që t'i reduktojë shpenzimet e energjisë në ndërtesat publike, duke investuar në eficiencë të energjisë dhe ta përmirësojë ambientin rregullativ për energji të ripërtëritshme dhe energji oficiente.

Përfituesit e kësaj marrëveshjeje do të jenë Qeveria qendrore dhe qeveritë komunale nëpërmjet uljes së shpenzimeve për energji në ndërtesat e rinovuara me ambient dhe funksionalitet më të përmirësuar, do të jenë ministrinë e linjës, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Ministria e Ambientit, Agjencia Kosovare për Energji Eficiente, Zyra e Rregullatorit nëpërmjet asistencës që do të jepet në zhvillimin e kornizës ligjore dhe instrumenteve tjera në këtë fushë, bizneset lokale, duke përfutuar prej mundësisë për të investuar në ruajtjen e energjisë, pacientët, studentët dhe qytetarë në përgjegjësi nëpërmjet kushteve më të mira në objektet publike.

Ministria e Financave ka negociuar me asociacionet ndërkombëtare për zhvillim, pjesë e Bankës Botërore, si kreditor për këtë projekt dhe është pajtuar me kushtet në vijim: Kredia në shumë prej 20,1 milionë SDA, që është ekuivalent me 25,5 milionë euro, me maturitet 25 vjet dhe me një grejs-periodhë prej 5 vjetësh.

Kushtet e kredisë janë të tilla që ofrojnë normën e interesit prej 1,25% në vit dhe tarifë të shërbimit prej 0,75%.

Ngarkesa në buxhet nga kjo kredi është mjaft e vogël, prej vitit të 6-të nga sot shuma që futet në ngarkesën në buxhet që vjen nga kjo kredi është 1,63 milion euro, që në bazë të projeksioneve buxhetore nuk paraqet ndonjë shumë të papërbalueshme për Buxhetin e Kosovës dhe unë ju ftoj që ta ratifikoni këtë marrëveshje.

Përpara se ta kryejë, nëse më lejoni një sqarim, në fakt një propozimi për amendamentim të këtij projektligji për shkak të një gabimi teknik që ka ndodhur në përgatitjen e marrëveshjes. Gjatë printimit të marrëveshjes për Eficiencë të Energjisë dhe Energji të Ripërtëritshme ndërmjet të Republikës të Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim, të datës 15 janar 2015, ka ndodhur një gabim teknik dhe pjesa e dytë e amortizimit, pra periudha nga 15 tetor 2029 - 15

prill 2039, është printuar si periudhë 15 tetor 2019 - 15 prill 2039, prandaj ne propozojmë sot këto dy amendamente të tilla që në neni 3, ku thuhet “dokumentet e bashkëngjitura”, të riformulohet si në vijim: “Bashkëngjitur me këtë projektligj është Marrëveshja e Financimit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim për Projektin e Eficiencës së Energjisë dhe Energjisë së Ripërtërishme. Kushtet e përgjithshme për grante dhe kreditë e Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim dhe letra sqarues për orarin 3, plani i amortizimit dhe amendamenti 2 është pjesa e dokumenteve të bashkëngjitura në projektligj, i bashkëngjitet letra sqaruese për orarin 3 të planit të amortizimit.

Unë ju falënderoj për vëmendje dhe ju ftoj që ta votojmë këtë projekt-marrëveshje. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

E ftoj kryetarin e Komisionit Funkcional, zotin Osmani, që ta arsyetojë raportin me rekomandime.

NASER OSMANI: Faleminderit, kryesues!

Projektligji ka për qëllim ratifikimin e marrëveshjes lidhur ndërmjet Qeverisë të Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim, që është agjenci e Bankës Botërore për financimin e Projektit për Eficiencën e Energjisë dhe Energjinë e Ripërtërishme.

Marrëveshja parasheh huazimin e një shume prej 20 milionë e 100 mijë SDR. SDR është e drejta speciale e tërheqjes, është për një valutë të këmbyeshme, që është e barasvlershme me 24 milionë e 980 000 euro, në bazë të konvertimit të valutës në euro. Sa për njohuri të deputetëve, ky kurs i tanishëm në ditën e sotme një SDR është i barabartë me 12,7 euro.

Projekti realizohet nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik. Qëllimi i marrjes është financimi i projektit dhe përmbushja e obligimeve në fushën e ofiçencës dhe burimeve të ripërtërishme, të cilat dalin nga traktati i komunitetit të energjisë dhe sekretari i komunitetit të energjisë të Komisionit Evropian.

Komponentë e marrëveshjes janë objektivat të cilat kanë qenë të parapara në dokumentin strategjik, plani kombëtar i veprimit për eficiencë të energjisë në Kosovë nga viti 2010-2018, që parasheh arritjen e caktimit të kursimit të energjisë elektrike deri në 9%.

Sa u përket kushteve të kredisë të kostos financiare, Qeveria e Kosovës obligohet t’i përmbushë të gjitha obligimet sipas marrëveshjes, duke përfshirë këtu pagesën e interesit prej 6,87 milionë euro. Sqaroj që në këtë 6,87 milionë euro ka të bëjë me normën e interesit, e cila është 1,25% vjetore në shumën e tërhequr, tarifa e shërbimit prej 0,75% vjetore në shumën e tërhequr, si dhe tarifa e zotimit prej 0,5% në shumën e patërhequr.

Afati i kthimit të kredisë do të jetë në një grejs-periudhë prej 5 vjetësh, ashtu siç e tha ministri dhe afat amortizimi prej 20 vjetësh. Kthimi i kredisë fillon më 2019 dhe do të bëhet me 40 këste, që do të zgjasë deri në vitin 2039.

Departamenti i Buxhetit në Ministrinë e Financave, në vlerësimin e tij ka deklaruar se zbatimi i marrëveshjes për periudhën afatmesme 2015-2017 nuk do të ndikojë në kosto shtesë në Buxhetin

e Kosovës, pasi aktivitetet që do të zhvillohen për implementimin e projektit janë të përfshirë në buxhetin e vitit 2015, por edhe në kornizën afatmesme të shpenzimeve, 2015-2017.

Komisioni për Buxhet dhe Financa, në mbledhjen e mbajtur më 17. 3. 2015, pasi e shqyrtoi projektligjin, e vlerësoi rëndësinë dhe kushtet e favorshme të marrëveshjes dhe mjetet që do të huazohen do të ndihmojnë në financimin e investimeve në efikasitet të energjisë në objektet publike, që do të ndikojnë në vendosjen e kriterëve dhe standardeve në energjinë e efikasitet dhe të ripërtëritshme dhe kosto më të ulët të shpenzimeve. Meqë kostoja financiare e marrëveshjes është trajtuar në kornizën buxhetore, komisioni njëzëri ka rekomanduar Kuvendit që ta ratifikojë këtë marrëveshje.

Po ashtu, dua të them që gjatë shqyrtimit të kësaj marrëveshjeje kemi vërejtur gabime teknike të cilat i përmendi ministri në versionin shqip, që si komision jemi pajtuar që ajo të rregullohet dhe i ftoj deputetët që ta votojnë këtë marrëveshje, e po ashtu edhe Grupi Parlamentar i LDK-së e mbështet marrëveshjen dhe rekomandimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa.

KRYESUESI: Faleminderit! Radha është e grupeve parlamentare. Zonja Hadërgjonaj e ka fjalën.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar Projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes për Financim të lidhur ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim për Projektin për Efikasitetin e Energjisë dhe Energjinë e Ripërtëritshme.

Meqenëse marrëveshja ka si qëllim dhe ka të bëjë në fushën e efikasitetit dhe burimeve të ripërtëritshme, të cilat obligime dalin nga traktati i komunitetit të energjisë dhe Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë të Komisionit Evropian dhe meqenëse ka kosto shtesë në Buxhetin e Republikës së Kosovës, meqenëse kjo kosto është e kalkuluar në buxhet dhe është e paraparë në kornizën afatmesme të shpenzimeve, atëherë Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e përkrah rekomandimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa për ratifikimin e kësaj marrëveshjeje dhe rekomandon deputetët që ta votojnë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nga “Vetëvendosje”, zoti Ymeri e ka fjalën.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryesues!

Deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Edhe Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” do ta votojë këtë marrëveshje.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Muharremaj, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, e ka fjalën.

BALI MUHARREMAJ: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë të Parlamentit të Kosovës,

Duke pasur parasysh rrethanat ekonomike, sociale dhe të financave publike dhe duke u nisur nga fakti se Kosova nuk është e ngarkuar me borxhe publike, që ia rrezikojnë stabilitetin buxhetor,

marrja në kushtet tona është shans i mirë për ta plotësuar mungesën e mjeteve financiare për financimin e projekteve, për investime të tilla për Kosovën. Nga ky aspekt, në parim nuk jemi kundër huamarrjeve, marrëveshjeve për financim kur këto bëhen projekte për investime kapitale me prioritet për vendin dhe kur kushtet e ofrimit të këtyre huave janë akceptueshme për ne.

Grupit Parlamentar të Aleancës i intereson ta dijë paraprakisht që këto hua a kanë të bëjnë me realizimin e projekteve investive, apo për ofrimin e shërbimeve lidhur me përgatitjen e projekteve në fjalë, kur dihet se kemi pasur probleme me projektet në të kaluarën që janë marrë për konsulencë.

Çështja tjetër për shqyrtimin e këtij rasti është mënyra e menaxhimit të kapitalit financiar të vendit. Fondet tona, Trusti dhe AKP-ja, rreth 1,5 miliard euro plasohen jashtë çmimit, kamata minimale ose baras me zero dhe, në anën tjetër, marrin hua ose kthejnë para me kamata të larta. A mund ta konsiderojmë këtë menaxhim efikas të pasurisë kombëtare të kapitalit financiar të vendit?

Edhe Grupi Parlamentar në parim do ta përkrahë këtë marrëveshje. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar “Nisma”, zoti Hoti e ka fjalën.

ENVER HOTI: Po ashtu, Grupi Parlamentar “Nisma” e mbështet këtë ratifikim të kësaj marrëveshjeje. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar “6+”, Fikrim Damka e ka fjalën.

FIKRIM DANKA: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Edhe Grupi Parlamentar “6+” e përkrah Projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes për Financim ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim lidhur me Projektin për Eficiencën në energji, sidomos në këtë kohë dhe në periudhën e ardhshme kur do të kemi probleme me energji. Kjo do të jetë një alternativë për ruajtjen e energjisë tonë, të cilën ne e prodhojmë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Mustafa.

MUHAMET MUSTAFA: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe unë po ashtu përkrah këtë projekt, sepse ngritja e eficiencës në shpenzimin e energjisë është njëra nga çështjet më të rëndësishme. Gjithashtu, është edhe fakti tjetër se Kosova e ka një ngarkesë relativisht të ulët me borxhe, që përbën diku rreth 10% të GDP-së. Megjithatë, kisha dashur që të gjitha marrëveshjet për hyrjen e ardhshme në borxhe të shoqërohen në më shumë llogari financiare, në aspektin e investimit dhe kthimeve të pritura.

Ne dëgjuam këtu faktin se kjo kredi është shumë e volitshme, gjë që është e vërtetë, dëgjuam për interesat e vogla, për periudhën e pushimit në kthim të kredisë dhe për një periudhë 20-vjeçare, brenda se cilës do ta kthejmë kredinë, por nuk dëgjuam se cilat do të jenë efektet e këtyre investimeve. Mendoj se pas çdo marrëveshjeje për kredi dhe hyrje borxh, ne duhet t'i kemi efektet

e matshme të kthimit të këtyre investimeve. Ndoshta ekzistojnë qeveritë, por ka qenë e udhës që kjo të prezantohet edhe kur vjen marrëveshja.

Sado që Kosova është pak e ngarkuar me borxhe, duhet të jetë e kujdesshme (ju lutem, a mund të dëgjohemi?), në çdo hyrje me borxhe, sepse këto do të kthehen, edhe pse 1 milion e diçka, sa tha ministri i Financave, nuk e ngarkon shumë buxhetin, por në qoftë se ne nuk kemi kthim nga këto investime, kur fillon implementimi, në qoftë se nuk e ulim koston e energjisë, atëherë kjo do të jetë ngarkesë, e nuk do të jetë e arsyeshme. Mu për këtë unë po plodoj që në të ardhmen t'i kemi disa të dhëna, e para, ndërsa e dyta që tash menjëherë ministrinë përkatëse të fillojnë t'i përgatitin projektet, sepse aftësitë absorbuese të 20 milionëve për tre vjet investime në efikasitet të energjisë duhen të jenë bukur të mëdha.

Përgatitja e projekteve, zbatimi i projekteve, përdorimi në vend të duhur dhe me nikoqirllëk i këtyre (zoti Zemaj, a do të më lejon të flas?), nevojitet një punë shumë vëllimore, sepse ndoshta me qindra, me mijëra projekte për këto tre vjet duhet të zbatohen që mjetet të përdoren me nikoqirllëk dhe të themi e kemi kthimin e duhur. Kaq! Faleminderit!

KRYESUESI Faleminderit!

Lus deputetët që janë jashtë të hyjnë në sallë, sepse nuk e kemi numrin e duhur për t'u votuar ligji dhe amendamentet. Zoti Raif Qela e ka kërkuar fjalën.

RAIF QELA: Të nderuar deputetë,

Të nderuar pjesëtarë të Kabinetit qeveritar,

I nderuar kryesues i Kuvendit,

Sot po i shqyrtojmë, ndër të tjera, edhe dy projektligje që kanë të bëjnë me ratifikimin e dy marrëveshjeve për financim ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim. Thënë më thjesht, dy ligje që kanë të bëjnë me ratifikim marrëveshjesh për marrje kredive të reja. Po merret borxh që të bëhen investime kapitale në dy fusha të nevojshme të jetës shoqërore në efikasitetin e energjisë dhe në energjinë e ripërtëritshme, që është tani pikë e rendit të ditës, si dhe në fushën e shëndetësisë, për të cilën fushë të gjithë pajtohemi se është në gjendje të rëndë, projektligji i së cilës do të trajtohet në pikën vijuese të rendit të ditës.

Për çështjen e efikasitetit të energjisë me bazë fosile dhe të energjisë të ripërtëritshme, nuk është vetëm detyrimi që ka Kosova karshi dy traktateve të Komisionit Evropian që na shtyn të ndërmerren investime në këtë fushë. Është interesi i madh edhe i Kosovës, por edhe i mbarë njerëzimit që ta ruajmë sa është e mundur energjinë dhe ta degradojmë sa më pak ambientin dhe pa dyshim se për çështje të tilla ia vlen të investohet dhe kur nuk ka mjaft para të gatshme, ka situata kur duhet të hysh në borxhe, por kam besim që edhe për këto dy çështje ia vlen të hyjmë në borxhe.

Pavarësisht se Kosova hyn në vendet që e ka borxhin më të ulët në rajon dhe sot nuk e ka gjendjen alarmante me borxhe dhe është akoma larg nga tejkalimi i kornizave ligjore, e kam një sugjerim për Qeverinë të ketë shumë kujdes që të mos marrë borxhe pa nevojë të domosdoshme, sepse ato mund të na shpëtojnë në çaste të caktuara, por mund të bëhen edhe barrë tepër e rëndë, mbase edhe e papërbalueshme në qafën e njomë të ekonomisë së Kosovës. Përvojat e shumë shteteve të botës na kanë treguar këtë. Faleminderit!

KRYESUESI: Atëherë, dua t' ju njoftoj që në sallë kemi 78 deputetë dhe ne nuk mund të futemi, as në votim të amendamenteve, as në votim të pikës së katërt... mund ta shqyrtojmë pikën e pestë...

5. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes për Financim ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim për Projektin për reformën shëndetësore

Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar projektligjin për ratifikimin e marrëveshjes dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim. Ftoj përfaqësuesin e Qeverisë, zotin Hoti që ta paraqesë dhe arsyetojë projektligjin.

ABDULLAH HOTI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Edhe ky projektligj është sjell para jush për ta ratifikuar marrëveshjen që ne kemi lidhur me Bankën Botërore, me Asociacionin Ndërkombëtar të Bankës Botërore, për një kredi për pjesën e shëndetësisë, në përputhje me deklaratën e prioriteteve të Qeverisë, të shprehur në kornizën afatmesme të shpenzimeve. Ministria e Shëndetësisë është kujdesur që ky projekt të futet në buxhetin e rregullt të Ministrisë.

Projekti në fjalë ka për objektiv që të kontribuojë në përmirësimin e mbrojtjes financiare për të varfrit nga shpenzimet shëndetësore dhe të përmirësojë cilësinë e shërbimeve për nënën dhe fëmijën dhe shërbimet për sëmundjet jorgjitëse.

Përfituesit nga ky projekt do të jenë shtresat e varfra, duke u liruar nga ngarkesa me hyrjen në fuqi të Ligjit për sigurimet shëndetësore, nënat dhe fëmijët, duke përmirësuar shëndetin e tyre dhe kujdesin shëndetësor ndaj tyre, shtresat e veçanta që nuk kanë mundësi ta përballojnë koston e shërbimeve shëndetësore, përfshirë këtu edhe minoritetet.

Kushtet financiare për këtë marrëveshje janë të njëjta me atë paraprake. Shuma e kredisë është 16,5 milionë SDR, që është ekuivalentë me 21 milionë euro, me një maturitet 25-vjeçar, me 5 vjet grejs-periudhë, me normë vjetore të interesit prej 1,25% vjetore dhe me një ngarkesë për buxhetin e Kosovës nga viti i 6-të prej 1,34 milionë euro. Unë ju ftoj që ta ratifikoni këtë marrëveshje. Faleminderit!

KRYEUESI: Faleminderit! Kryetari i Komisionit funksional, zoti Naser Osmani e ka fjalën.

NASER OSMANI: Faleminderit, kryetar!

Është fjala për kredi të dytë me të njëjtin asociacion ndërkombëtar, ku Ministria e Financave është garantues i kësaj kredie, ndërsa realizues do të jetë Ministria e Shëndetësisë.

Kredia në shumën prej 16 milionë e 500 mijë SDR, është çështje e barasvlershme me 20,45 milionë euro. Objektivat e këtij projekti, që do të realizohet nëpërmjet zbatimit të kësaj marrëveshjeje janë:

- Përmirësimi i mbrojtjes financiare nga shpenzimet shëndetësore për të varfrit,

- Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve për shëndetin prioritar të nënës dhe fëmijës,
- Përmirësimi i shërbimeve për sëmundjet jongjitëse,
- Përmirësimi i qasjes në shërbime cilësore të kujdesit parësor në komuna, përmes financimit për kokë banori, si dhe
- Sigurimi i mbështetjes për fuqizimin e kapaciteteve të Ministrisë të Shëndetësisë, për të kryer menaxhimin teknik dhe administrativ të projektit, duke përfshirë kryerjen e auditimeve, blerjen e pajisjeve dhe financimin e shpenzimeve operative.

Kushtet e kredisë janë po të njëjta, ashtu siç i tha ministri dhe siç është edhe në kredinë e mëparshme, domethënë, që do të përfshijë një periudhë të kthimit deri në vitin 2039.

Departamenti i Buxhetit në Ministrinë e Financave po ashtu, ka përgatitur vlerësimin e ndikimit buxhetor për Marrëveshjen për financim të projektit për shëndetësi, ku është deklaruar se zbatimi i këtij dokumenti për periudhën afatmesme 2015-2017 nuk do të ndikojë në kosto shtesë në buxhetin e Kosovës, pasi që aktivitetet që do të zhvillohen për implementimin e projektit janë të përfshirë në buxhetin e vitit 2015, por edhe në kornizën afatmesme të shpenzimeve, përkatësisht projekti, rishikimi i sektorit shëndetësor në kornizën buxhetore për vitin 2015-2017, është paraparë në kategorinë e shpenzimeve kapitale.

Komisioni për Buxhet dhe Financa po ashtu, sikurse për kredinë e parë, fton deputetët që ta përkrahin dhe votojnë marrëveshjen sipas rekomandimit, që njëherësh edhe Grupi Parlamentar i LDK-së e mbështet rekomandimin dhe do ta votojë marrëveshjen në tërësi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Radha është e përfaqësuesve të grupeve parlamentare. E ka fjalën zonja Hadërgjonaj, në emër të PDK-së.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar Kabinet qeveritar,

Deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, ka shqyrtuar Projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes të lidhur ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim, për projektin për reformën shëndetësore.

Partia Demokratike e Kosovës ka përkrahur një marrëveshje të tillë. Në mandatin e kaluar ne kemi miratuar ligje në shëndetësi, për sektorin e shëndetësisë, në brendinë e të cilave është e paraparë reforma në këtë sektor. Ne jemi shumë të angazhuar dhe të interesuar që të ndodhin reforma pozitive dhe të përmirësohet cilësia e shërbimeve shëndetësore dhe të ketë një qasje shumë më të mirë dhe një cilësi shumë më të mirë në sektorin e shëndetësisë.

Marrëveshja që është lidhur për 20,45 milionë euro është e arsyeshme sipas Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike. Ajo çka ne do të kërkonim, është që Ministria e Shëndetësisë të bëjë një planifikim të mirë të buxhetit, duke u bazuar në këtë marrëveshje, në mënyrë që të detajohen se cilat mjete do të shkojnë për investime kapitale dhe cilat mjete do të jenë për mallra dhe shërbime, meqenëse, kjo marrëveshje nuk ngarkon me kosto buxhetore buxhetin e Republikës së Kosovës, mirëpo sipas deklarimit nga Ministria e Shëndetësisë shohim që pjesa më e madhe e këtyre mjeteve janë të planifikuara për investime kapitale.

Prandaj, që të mos keni probleme në këtë fushë, është mirë që Ministria e Shëndetësisë vërtet ta ketë një planifikim të mirë, në mënyrë që marrëveshja të jetë e realizueshme dhe jo për shkak të mos planifikimit të saktë, të mbetet e perealizuar.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e përkrah rekomandimin e Komisionit për Buxhet dhe fton deputetët që ta miratojnë marrëveshjen e cila na ka ardhur në shqyrtim.

KRYESUESI: Faleminderit! Nga Grupi Parlamentar “Vetëvendosje”, zoti Ymeri e ka fjalën.

VISAR YMERI: Faleminderit!

Edhe Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” do ta votojë për ta ratifikuar këtë marrëveshje, e cila i ka disa investime të mira në sistemin e shëndetësisë, pra që do të duhej të ishin në shërbim të qytetarëve, nëse ato natyrisht menaxhohen ashtu siç duhet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nga Grupi Parlamentar i AAK-së, zoti Bali Muharremaj e ka fjalën.

BALI MUHARREMAJ: Faleminderit, kryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i Aleancës në parim do ta përkrahë këtë marrëveshje, këtë projektligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nisma, zonja Shukrije Bytyqi e ka fjalën.

SHUKRIJE BYTYQI: Faleminderit, kryesues!

Ne si Grup Parlamentar i Nismës për Kosovën, e kemi shqyrtuar këtë marrëveshje dhe do ta përkrahim në parim këtë projektligj për marrëveshje për reformën shëndetësore dhe është shumë e mirëpritur. Vetëm kërkojmë nga Ministria e Shëndetësisë, që ta zbatojë në përpikëri dhe t'i ndajë me prioritet, se vërtet edhe shëndetësia në Kosovë ka probleme të mëdha.

Ne do ta përkrahim këtë projektligj.

KRYESUESI: Faleminderit! Nga “6+”-i, zoti Damka e ka fjalën.

FIKRIM DAMKA: Faleminderit, zoti kryesues!

Edhe Grupi Parlamentar “6+” përkrah këtë marrëveshje, e cila do të jetë për projektin në reformën për shëndetësisë.

KRYESUESI: Faleminderit! Regjia, i bini ziles nëse ka mundësi, që të shohim nëse janë kthyer deputetët. Në sallë janë 68 deputetë. Atëherë, mendoj që kemi 81 deputetë.

Në sallë kemi 81 deputetë. Fillojmë me votimin, së pari të pikës së katërt të rendit të ditës, që kemi dy amendamente, që janë çështje të përvjedhura teknike, që i shpjegoi edhe ministri.

Për amendamentin 1, a ka kundër? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 2. A ka kundër? Nuk ka. Miratohet.

Votojmë me teknikë Projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes për Financimin lidhur ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim lidhur me Projektin për Eficiencën e Energjisë dhe Energjinë e Ripërtëritshme. Votojmë tash!

A ka dikush pa kartelë? Pa kartelë janë... a jeni për a kundër? Atëherë, me 79 vota me elektronikë, 2 pa kartelë, me 81 vota, konstatoj që Kuvendi miratoi Ligjin për ratifikimin e Marrëveshjes për financimin ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim lidhur me projektin për Eficiencën e Energjisë dhe Energjinë e Ripërtëritshme.

Tani hyjmë për ta votuar pikën e pestë të rendit të ditës, që është Projektligji për ratifikimin e Marrëveshjes për Financimin e lidhur ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim për Projektin për reformën shëndetësore.

Prapë kemi 81 deputetë, votojmë tani. Ju lus që të votoni. Kush s'ka votuar, ju lus... që unë po e përsëris edhe njëherë. Nuk është mirë, që i kemi 8 sekonda këtu dhe po kalon koha. Edhe njëherë po e përsërisim votimin.

Votojmë tani. Faleminderit! Pa kartela a është kush që voton për? I kemi 81 vota me elektronikë, një pa kartelë, bëjnë 82 vota, 1 abstenim. Konstatoj se Kuvendi miratoi Ligjin për ratifikimin e Marrëveshjes për financim e lidhur ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim për Projektin për reformën shëndetësore.

Kalojmë në pikën e gjashtë të rendit të ditës:

6. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit të posaçëm për zgjedhjen e një gjyqtari në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës

Komisioni i posaçëm, në bazë të nenit 6 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese ka zhvilluar të gjitha procedurat e parapara me ligj, për përzgjedhjen e kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese dhe Kuvendit ia ka paraqitur për votim listën e ngushtë prej tre kandidatëve. Kuvendi prej tre kandidatëve për gjyqtar të Gjykatës Kushtetuese propozon një kandidat për emërim nga presidentja e Republikës së Kosovës.

Sipas nenit 114, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, propozimi i kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese bëhet me 2/3-at e votave të deputetëve të pranishëm, që votojnë.

Të nderuar deputetë,

Meqë në Kushtetutë dhe me Ligjin për Gjykatën Kushtetuese nuk është definuar procedura e votimit në seancën plenare, propozoj që para se të fillojmë me votimin, për propozimin e një kandidati për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të miratohet procedura e votimit si në vijim:

1. Votimi i kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese bëhet me votim të fshehtë.

2. Deputeti i Kuvendit, prej tre kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese të rekomanduar nga Komisioni i posaçëm, voton për një kandidat për pozitën e gjyqtarit në Gjykatën Kushtetuese.

3. Nëse në votimin e parë asnjëri kandidat nuk merr numrin e nevojshëm të votave, kandidati që ka marrë më së paku vota, hiqet nga lista dhe votimi përsëritet me dy kandidatët e mbetur. Nëse edhe në votimin e dytë asnjëri kandidat nuk e merr numrin e nevojshëm të votave, përsëritet konkursi për zgjedhjen e një gjyqtari në Gjykatën Kushtetuese.

Lus deputetët që të deklarohen lidhur me procedurat e votimit. A jeni dakord? Kundër a ka? Nuk ka. Atëherë, meqenëse nuk është paraqitur askush për diskutim, propozoj që të fillojmë me zbatimin e procedurës së votimit të fshehtë.

Kërkohet krijimi i një Komisioni votues, në përbërje nga një deputet nga secili grup parlamentar, në mbështetje të zyrtarëve të administratës.

Zoti Adem Grabovci, kë e keni në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së?

ADEM GRABOVCI: Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, si anëtare të Komisionit, propozon zonjën Selville Halimi.

KRYESUESI: Zoti Ismet Beqiri, kë e keni ju?

ISMET BEQIRI: Faleminderit! Ne e propozojmë deputetin Armend Zemaj.

KRYESUESI: Zoti Glauk Konjufca, kë e keni në emër të Grupit Parlamentar?

GLAUK KONJUFCA: Ne propozojmë Albulena Haxhiun.

KRYESUESI: Në rregull! AAK-ja kë e ka?

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Deputetin Pal Lekaj.

KRYESUESI: Në rregull, zoti Pal. Nga Grupi Parlamentar Nisma, zonja Bajrami e ka fjalën.

VALDETE BAJRAMI: Nga Nisma është Shukrije Bytyqi.

KRYESUESI: Zonja Bytyqi. Nga “6+”-i? Zonja Shinik e ke fjalën.

MYFERA SHINIK: Teskyrederim! Bu komisiyona alti arti Parlamentar Gurubundan Kujtim Paçaku yneriorus.

KRYESUESI: Në rregull! Atëherë, e lus komisionin që t’i zërë vendet dhe të përgatitemi me listat e votimit.

Atëherë, fillojmë procesin e votimit:

Adem Grabovci, Adem Hoxha, Zoti Haskuka, Adem Salihaj, Agim Ademaj, Agim Aliu, Agim Çeku, Aida Dërguti, Albin Kurti, Albulena Haxhiu, Ali Sadriu, Alma Lama, Anton Çuni, Arben Gashi, Armend Zemaj, Fadil Demaku, Milazim Haliti, Azem Syla, Bali Muharremaj, Bekim Haxhiu, Besa Baftija, Besa Gaxherri, Besim Beqaj, Besnik Bislimi, Besnik Grainca, Blerim Shala, Blerta Deliu-Kodra, Bojan Mikiq, Danush Ademi, Faton Topalli, Daut Haradinaj, Donika Kadaj-Bujupi, Doruntinë Maloku, Duda Balje, Salije Mustafa, Elmi Reçica, Emilija Rexhepi, Enver Hoxhaj, Ethem Arifi, Fadil Beka, Fatmir Limaj, Famir Rexhepi, Fisnik Ismaili, Flora Brovina, Ganimete Musliu, Gëzim Kelmendi, Glauk Konjufca, Shaip Muja, Nait Hasani, Bardhyl Meta, Hatim Baxhaku,...

...Haxhi Shala, Synavere Rysha, Ilir Deda, Murat Hoxha, Ismajl Kurteshi, Ismet Beqiri, Enver Hoti, Jasmina Zhivković, Jelena Bontiq, Kadri Veseli, Kujtim Paçaku, Agim Kikaj, Labinote Demi-Murtezi, Lahi Brahimaj, Latif Gashi, Lirije Kajtazi, Luljeta Veselaj-Gutaj, Fikrim Damka, Margarita Kadriu-Ukelli, Melihate Tërmkolli, Hajdar Beqa, Mexhide Mjaku-Topalli, Milena Miliçević, Millka Vuletiq, Myfera Serbica-Shinik, Muhamet Mustafa, Mytahir Haskuka, Naim Fetahu, Naser Osmani, Nenad Rashiq, Nezir Çoçaj, Njomza Emini, Nuredin Ibishi, Nuredin Lushtaku, Pal Lekaj, Puhije Demaku, Raif Qela, Rafet Rama, Ramiz Kelmendi, Ramush Haradinaj, Qerim Bajrami, Rexhep Selimi, Rustem Berisha, Rustem Mustafa, Sabri Hamiti, Sadri Ferati, Safete Hadërgjonaj, Sala Berisha-Shala, Salih Morina, Salih Salihu, Sasha Milosavljeviq, Selvije Halimi, Shpetim Bulliqi, Shqipe Pantina, Shukrije Bytyqi, Slavko Simiq, Slobodan Petroviq, Teuta Haxhiu, Teuta Rugova, Teuta Sahatqija, Time Kadrijaj, Valdete Bajrami, Velimir Rakiq, Veton Berisha, Visar Ymeri, Vjosa Osmani, Xhavit Haliti, Xhevahire Izmaku, Zafir Berisha, Zenun Pajaziti.

A ka ndokush që s'ka votuar? Besoj se nuk ka. Komisioni është i lirë që të vazhdojë punën, hapjen e kutisë dhe numërimin e votave dhe të gjitha raportimeve që i takojnë, sipas Rregullores.

Regjia, fjalën e ka përfaqësuesja e komisionit, zonja Haxhiu!

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit! Atëherë, po vazhdoj me numërimin e fletëvotimeve.

- Bekim Sejdiu,
- Bekim Sejdiu,
- Bekim Sejdiu,
- Bekim Sejdiu,
- Bekim Sejdiu,
- Bekim Sejdiu,
- Bekim Sejdiu,
- Emrush Kastrati,
- Mazllum Baraliu,
- Mazllum Baraliu,
- Bekim Sejdiu,
- Bekim Sejdiu,
- Emrush Kastrati,
- Bekim Sejdiu,
- Bekim Sejdiu,

- Bekim Sejdiu,
- Bekim Sejdiu,
- Mazllum Baraliu,
- Bekim Sejdiu,
- Mazllum Baraliu,
- Bekim Sejdiu,
- Emrush Kastrati,
- E pavlefshme,
- Bekim Sejdiu,
- Bekim Sejdiu,
- Bekim Sejdiu,
- Mazllum Baraliu,
- Mazllum Baraliu,
- Bekim Sejdiu,
- Bekim Sejdiu,
- Bekim Sejdiu,
- Bekim Sejdiu,
- Mazllum Baraliu,
- Bekim Sejdiu,
- Bekim Sejdiu,
- Bekim Sejdiu,
- Bekim Sejdiu,
- Bekim Sejdiu,
- Mazllum Baraliu,
- Mazllum Baraliu,
- Mazllum Baraliu,
- Bekim Sejdiu,
- Emrush Kastrati,
- Bekim Sejdiu,
- Bekim Sejdiu,
- E pavlefshme, sepse i ka votuar të tre kandidatët,
- Bekim Sejdiu,
- Bekim Sejdiu,
- Mazllum Baraliu,
- Bekim Sejdiu,
- Bekim Sejdiu,
- Bekim Sejdiu,
- Mazllum Baraliu,
- Bekim Sejdiu,
- Bekim Sejdiu,
- Bekim Sejdiu,
- Bekim Sejdiu,
- Bekim Sejdiu,
- Bekim Sejdiu,
- Bekim Sejdiu,
- Bekim Sejdiu,

- Emrush Kastrati,
- Bekim Sejdiu,
- Mazllum Baraliu,
- Bekim Sejdiu,
- Bekim Sejdiu,
- Bekim Sejdiu,
- Bekim Sejdiu,
- Bekim Sejdiu,
- Bekim Sejdiu,
- Bekim Sejdiu,
- Bekim Sejdiu,
- Bekim Sejdiu,
- Emrush Kastrati,
- Bekim Sejdiu,
- Bekim Sejdiu,
- Mazllum Baraliu,
- Bekim Sejdiu,
- Mazllum Baraliu,
- Bekim Sejdiu,
- Bekim Sejdiu,
- Bekim Sejdiu,
- Bekim Sejdiu,
- Bekim Sejdiu,
- Mazllum Baraliu,
- Emrush Kastrati, si dhe e fundit,
- Bekim Sejdiu.

Pas pak do t'ju njoftojmë me rezultatet.

KRYESUESI: Regjia, mikrofonin Albulenës.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit! Në mbështetje të nenit 65, paragrafi 11 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 6 të Ligjit 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës dhe nenit 51 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni votues, i formuar me vendim të seancës, të datës 26 mars 2015, në përbërje nga një përfaqësues të secilit grup parlamentar, zonja Selviqe Halimi, Armend Zemaj, Albulena Haxhiu, Pal Lekaj, Shukrije Bytyqi dhe Kujtim Paçaku, pas procedurës së votimit të fshehtë dhe numërimit të votave të deputetëve të Kuvendit, për propozimin e gjyqtarit në Gjykatën Kushtetuese, në seancën plenare të mbajtur më 26 mars 2015, konstaton:

Në votim kanë marrë pjesë 89 deputetë,

Nga këta 89 deputetë, vota të pavlefshme kanë qenë 2. Pra, 2 fletëvotime të pavlefshme.

Votat e fituara për kandidatët e propozuar, janë si në vijim:

- Bekim Sejdiu, ka fituar 64 vota,
- Mazllum Baraliu, ka fituar 16 vota, dhe
- Emrush Kastrati, ka fituar 7 vota.

Në bazë të rezultateve të votimit, në pajtim me nenin 65 paragrafi 11 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 6 të Ligjit numër 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës dhe nenin 51 të Rregullores së Kuvendit, konstatohet se Bekim Sejdiu i propozohet presidentes së Republikës së Kosovës, për emërim gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë, në bazë të Komisionit votues, konstatoj se Kuvendi zgjodhi kandidatin Bekim Sejdiu, për gjyqtar të Gjykatës Kushtetuese. Ne do t'ia dërgojmë presidentes për emërim. I urojmë sukses në punën e tij.

A doni pauzë për drekë? Pra, marrim pauzë deri në orën 15:00.

* * *

Vazhdimi i mbledhjes pas pauzës

Mbledhjen e drejton nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.

KRYESUESI: Unë mendoj që kemi pritur mjaft. Fillojmë me pikën e shtatë të rendit të ditës:

7. Shqyrtimi i raportit të auditimit të sistemeve të prokurimit në Sektorin shëndetësor

Komisioni Funkcional për Mbikëqyrjen e Financave Publike e ka shqyrtuar raportin dhe Kuvendit ia ka paraqitur rekomandimet për miratim.

E ftoj kryetarin e Komisionit Funkcional, Besnik Bislimi, për arsyetimin e raportit me rekomandime.

BESNIK BISLIMI: Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, më 18 shkurt të këtij viti e ka pranuar raportin e Auditorit të Përgjithshëm që trajton sistemet e prokurimit në Sektorin shëndetësor.

Nisur nga numri i ndjeshëm i problemeve dhe shkeljeve të evidentuara, komisioni ka kërkuar dëgjim publik, ku të ftuar kanë qenë ministri i Shëndetësisë, zoti Imet Rrahmani, drejtori i QKUK-së, zoti Curr Gjocaj, sekretari i Ministrisë së Shëndetësisë, zoti Gani Shabani, dhe Auditori i Përgjithshëm, apo përfaqësuesi i Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm.

Për këtë dëgjim publik, ne si komision e kemi ftuar edhe Komisionin për Shëndetësi Punë dhe Mirëqenie Sociale, kontributi i të cilëve ka qenë jashtëzakonisht i çmueshëm dhe e shfrytëzoj rastin që secilin prej tyre ta falënderoj publikisht.

Gjatë këtij dëgjimi i diskutuan shumë të gjeturat e Zyrës së Auditorit, por edhe elemente të tjera me rëndësi për performansën e suksesshme, si të ministrisë, ashtu edhe të QKUK-së.

Në veçanti u trajtua mungesa e një strategjie të shkruar dhe të artikuluar mirë të prokurimit në Ministrinë e Shëndetësisë, strategji kjo që do të mundësonte një planifikim më të mirë të aktiviteteve të prokurimit në këtë institucion.

Ministria e Shëndetësisë vuan gjithashtu edhe nga një mungesë e theksuar e vlerësimit të nevojave reale me barna dhe të njëjtat nuk harmonizohen me mundësitë buxhetore dhe po ashtu janë evidentuar shumë mospërputhje ndërmjet sasisë së kërkuar të barnave dhe atyre të shpërndara, apo gjendjes së stokut.

Është konstatuar edhe një menaxhim joefektiv i kontratave të nënshkruara, si dhe është theksuar se personat përgjegjës brenda ministrisë për implementimin e reformave të iniciuara nuk janë pajisur sa duhet me përgjegjësitë e tyre të domosdoshme për këtë implementim.

Problem tjetër shumë me rëndësi është konstatimi se të gjeturat e Auditorit nga vitet e mëparshme vazhdojnë të përsëriten vit pas viti, gjë që reflekton mosgatishmëri të ministrisë që të punojë drejt evitimit të tyre.

Është atakuar edhe vetë Komiteti i Auditimit të Brendshëm i Ministrisë si jo me ndikim.

Përveç të gjeturave të Auditorit të Përgjithshëm, të dyja komisionet po ashtu kanë trajtuar edhe të gjeturat e organizatave të shoqërisë civile, përkatësisht Institutit Demokratik të Kosovës dhe raportit të tyre të monitorimit të prokurimit publik në Ministrinë e Shëndetësisë.

Ky raport evidenton shumë shkelje në prokurimin e barnave, në përpilimin e listës esenciale të barnave, në hulumtimin paraprak të tregut, në blerjen e barërave me patentë dhe për periudhën pas skadimit të patentave, që nënkupton çmime dukshëm më të larta, blerjet e barnave të kualitetit shumë të ulët, e të ngjashme.

Për të gjitha këto evidencime, ministri i Shëndetësisë dhe personat që e kanë shoqëruar kanë ofruar informacione shtesë, kanë raportuar për hapat e ndërmarrë deri më tani me planet e tyre të veprimit dhe kanë treguar gatishmëri për hapa energjikë në evitimin e shkeljeve të tjera.

Nisur nga ky dëgjim publik, Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike ka dalë me rekomandime konkrete për Ministrinë e Shëndetësisë dhe për vetë Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm.

Në vazhdim do të doja t'i ndaj me ju këto rekomandime për këto dy institucione.

Së pari, rekomandimet për Ministrinë e Shëndetësisë:

1. Kërkojmë që Ministria e Shëndetësisë në afat prej tre muajve ta hartojë strategjinë gjithëpërfshirëse të prokurimit për Sektorin e shëndetësisë dhe për këtë ta njoftojë Komisionin për Mbikëqyrjen e Financave Publike.

2. Ministria e Shëndetësisë të sigurojë që rekomandimet e auditimit të brendshëm dhe të jashtëm janë adresuar në mënyrë efektive për ta parandaluar përsëritjen e tyre nga viti në vit dhe për këtë të përgatisë raport me shkrim për Komisionin për Mbikëqyrjen e Financave Publike.

3. Ministria e Shëndetësisë të dizajnojë dhe zbatojë një rishikim referues të artikujve të barnave të rëndësishme të listës esenciale të barnave dhe për këtë ta njoftojë Komisionin për Mbikëqyrjen e Financave Publike dhe Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm.

4. Ministria e Shëndetësisë ta përgatisë një strategji për mjekët në specializim, dhe

5. Ministria e Shëndetësisë të funksionalizojë dhe forcojë sistemin informativ të shëndetësisë.

Në vazhdim, rekomandimet për Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm:

1. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm në auditimet e ndërmjetme të mbikëqyrë zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga raporti i auditimit për sistemin e prokurimit në Sektorin e shëndetësisë.

2. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm të rrisë numrin e auditimeve të performansës në Sektorin e shëndetësisë, në veçanti sa i përket listës esenciale të barnave, programit farmaceutik, si dhe mënyrës së furnizimit dhe mirëmbajtjes së pajisjeve medicinale.

Ne si komision jemi të vetëdijshëm për faktin se ministri është i ri në detyrë, andaj edhe rekomandimet tona i shohim më tepër si informim të tij për brengat e deputetëve dhe dëshirë për marrje publike të obligimeve për hapa konkretë në evitimin e tyre.

Këtyre rekomandimeve do t'i doja t'ua shtoj edhe një rekomandim që sot është më përcjellë nga shoqëria civile dhe që thërret për më shumë transparencë nga Ministria e Shëndetësisë.

Në raportin e publikuar sot nga Instituti Kosovar për Demokraci, Ministria e Shëndetësisë shquhet për shumë ankesa që kanë të bëjnë me sistemin e prokurimit, me ç'rast shumica e këtyre ankesave kanë të bëjnë me vlerësime jokorrekte të ofertuesve në tenderët publikë.

Andaj, edhe e kisha lutur publikisht ministrin e Shëndetësisë që të bëjë më tepër presion për rritjen e transparencës në institucionin që ai drejton.

Në fund, në emër të Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, rekomandoj apo sugjeroj deputetë të nderuar që ta aprovojmë këtë rekomandim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Radha është e përfaqësuesve të grupeve parlamentare. Kur të doni të diskutoni, shtypeni me kohë sustën. Zoti Naim Fetahu e ka fjalën.

NAIM FETAHU: I nderuar kryesues i Kuvendit,

Të nderuar deputetë,

Më lejoni që në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të diskutoj për këtë pikë të rendit të ditës.

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave publike, në bazë të nenit 62 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 4 mars 2015, e ka shqyrtuar raportin e auditimit të sistemit të prokurimit në Sektorin e shëndetësisë, të cilën e ka hartuar Zyra e Autorit të Përgjithshëm.

Ne e kemi shqyrtuar këtë raport bashkë me Komisionin për Shëndetësi dhe me ministrin e ri dhe me bashkëpunëtorët e tij.

I kemi realizuar të gjitha lëshimet, dobësitë dhe në bazë të një analize të plotë ne i kemi dhënë rekomandimet tona, të cilat pak më parë i lexoi kryetari i komisionit.

Vlen të përmendet që këto rekomandime i kemi bërë njëzëri si anëtarë të Komisionit për Mbikëqyrje të Financave Publike.

Por, përveç këtyre rekomandimeve, ne e kemi parë të arsyeshme që këtë çështje ta debatojmë në Parlament, bashkë me ju të nderuar deputetë, për t'i fuqizuar rekomandimet tona dhe mundësisht për të pasur edhe rekomandime shtesë që ndihmojnë në suksesin e sistemit të prokurimit në Ministrinë e Shëndetësisë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Hatim Baxhaku e ka fjalën.

HATIM BAXHAKU: Meqë unë jam anëtar i Komisionit për Shëndetësi dhe ne e kemi diskutuar, por unë nuk po flas në emër të Komisionit për Shëndetësi, por po them që jemi njoftuar me materien. E kemi diskutuar gjerë me Grupin Parlamentar dhe të gjeturat e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm i kemi konstatuar si të sakta.

Prandaj, Grupi Parlamentar i LDK-së do ta përkrahë këtë rekomandim rreth gjetjeve të Auditorit të Përgjithshëm. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Po ju anëtarët e komisionit, se këtu u lexuan tri rekomandime më shumë se që kanë ardhur me shkrim, dhe ne nuk mund ta votojmë raportin me tetë rekomandime, kur i kemi vetëm pesë rekomandime të shkruara. Prandaj, ta kemi të qartë që kur të diskutojmë çfarë situatë kemi.

Në emër të Grupit Parlamentar të “Vetëvendosjes”, Besa Baftija e ka fjalën.

BESA BAFTIJA: Faleminderit, kryesues!

Përshëndetje për të gjithë të pranishmit,

Të nderuar deputetë,

Se numri i problemeve në Sektorin e shëndetësisë është i madh, e veçanërisht në Sektorin e Prokurimit Publik na vërteton raporti i Auditorit, i cili ka më shumë se 30 faqe, e ku në secilën nga këto gjejnë të dhëna se ka shkelje, keqpërdorime të mëdha sa i përket shpenzimit të parasë publike për shërbime shëndetësore.

Më shqetësues është fakti se rekomandimet e nxjerra nga ky raport nuk janë marrë për bazë nga Ministria e Shëndetësisë, e për rrjedhim po përsëriten nga viti në vit.

Sipas këtij raporti, Ministria e Shëndetësisë nuk ka pasur as nuk ka strategji të prokurimit si dokument të shkruar, e cila do ta përcaktonte qartë procesin e prokurimit në Sektorin e shëndetësisë.

Ministria nuk e ka të funksionalizuar divizionin për monitorim në kuadër të Departamentit Farmaceutik, i cili mundëson vlerësimin e duhur të nevojave për barna. Si pasojë, nuk është bërë gati asnjëherë vlerësimi i duhur i nevojave. Praktikisht, ka mospërputhje në të gjitha fazat, që nga gjendja e stokut, sasia e kërkuar, e deri te distribuimi.

Ministria e Shëndetësisë nuk e ka funksionalizuar sistemin informativ shëndetësor, SISH-in, edhe përkundër faktit se janë dhënë mjete nga Qeveria e Luksemburgut në vlerë milionëshe, mjete të cilat nuk dihen se ku kanë shkuare e kush i ka shpenzuar. Për këtë rast duhet që sa më parë të hapet edhe hetim.

Keqpërdorime marramendëse janë bërë dhe bëhen në përpilimin e listës esenciale të barnave, duke qenë se shpenzimet më të mëdha nga prokurimi janë të destinuara për këtë listë.

Ka dyshime në mënyrën e përzgjedhjes dhe mungesës të transparencës nga Ministria e Shëndetësisë në këtë proces.

Numërohen qindra raste kur disa barna paguhen më shtrenjtë sesa paguhen në vendet e rajonit.

Në sistemin tonë kemi mungesë të listës së formës së çmimore referente.

Po ashtu, kompanitë e barnave dhe grupi i interesit kanë ndikuar dhe ende vijojnë të ndikojnë në përpilimin e listës esenciale.

Ka operatorë që kanë qenë përfaqësues i vetëm i një lloji të barit apo patentë, e ai asnjëherë nuk e ka fituar tenderin, ndërsa ministria ka kontraktuar me kompani të cilave ky operator ua ka shitur barin e patentuar.

Zbatimi i kontratave nga operatorët ekonomikë, të cilët e kanë fituar tenderin për furnizim me barna, nuk i kanë zbatuar kontratat në përpikëri, nuk i kanë furnizuar spitalet në kohë. Këta operatorë, edhe pse janë gjobitur nga autoriteti kontraktues, edhe pse kanë marrë referenca negative, prapë këta e kanë fituar tenderin në furnizim. E kjo shfaq dyshimin në lidhje biznesore, klienteliste, që mund të ketë autoriteti kontraktues me operatorin ekonomik.

Duke e ditur se buxheti aktual i Ministrisë së Shëndetësisë dhe ai i mëparshmi për farmacinë nuk i kanë mbuluar të gjitha nevojat e institucioneve shëndetësore me barna të listës esenciale, me rekomandim të Organizatës Botërore të Shëndetësisë është bërë ndarja në barna vitale esenciale dhe joesenciale, me qëllim që furnizimi me barna vitale të jetë 100%, sepse janë barna të cilat shpëtojnë jetë.

Mirëpo, kjo nuk ndodh, sepse kjo listë vitale e barnave është mbuluar në institucione shëndetësore vetëm me 50%, e dihet se në mungesë të tyre barnave pacientët kanë përfunduar edhe me fatalitet.

Është koha e fundit që Ministria e Shëndetësisë të dërgojë në ndjekje penale të gjithë shkelësit e ligjit në raport me të gjeturat e Auditorit, dhe jo vetëm ato që janë këtu.

Po ashtu, t'i shndërrojë vërejtjet e Auditorit në këtë plan pune konkret për t'i korrigjuar të gjitha, ama të gjitha këto parregullsi që po kushtojnë me jetën e qytetarëve tanë.

Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” e mbështet raportin, të bërë nga Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave, në bashkëpunim me Komisionin për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Bali Muharremaj, në emër të AAK-së, e ka fjalën.

BALI MUHARREMAJ: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë të Parlamentit të Kosovës,

Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e ka analizuar me kujdes raportin e performansës për sistemin e prokurimit në Sektorin e shëndetësisë, raport ky i hartuar nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm.

Auditimi është fokusuar në funksionimit e sistemit të prokurimit para reformës në projeksione pas reformës në Sektorin e shëndetësisë. Po ashtu, edhe në vlerësimin e nevojave në menaxhimin e kontratave, si dhe në të gjetura të tjera të auditimit në fushën e prokurimit.

Raporti përshkruan çështjet kryesore që kanë dalë nga auditimi i sistemit të prokurimit në Sektorin e shëndetësisë në tri vjetët e fundit në fokusin e auditimit të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm.

Të gjeturat nga ky raport i auditimit ishin: Ministria e Shëndetësisë nuk e posedon një strategji të shkruar dhe qartësisht ka artikuluar për prokurimin; Sektori i shëndetësisë nuk e ka bërë një vlerësim të duhur të nevojave për barna krahas buxhetit në dispozicion; nga analizat e bëra më sipër vërehet se ekziston mospërputhje në të gjitha fazat që nga gjendja e stokut, sasia e kërkuar, e deri te ajo e distribuuar; ka dobësi të shumta në cilësinë e të dhënave që rrjedhin nga sistemi informativ shëndetësor; Sektori i shëndetësisë nuk i ka menaxhuar kontratat në mënyrë efektive dhe proceset e kësaj fushe janë të dobëta; shkeljet në fushën e prokurimit janë përsëritur nga viti në vit.

Përkundër se reforma ka filluar, zbatimi i saj në praktikë është në fazën fillestare, si dhe përgjegjësitë e parapara nuk janë bartur te personat përgjegjës në shumicën e rasteve.

Bazuar nga të dhënat nga raporti i auditimit të performansës për Sektorin e shëndetësisë, si dhe bazuar në raportin e auditimit për pasqyrat vjetore financiare të Ministrisë së Shëndetësisë, mund të konkludojmë se Sektori i shëndetësisë, qoftë në nivelin primar, sekondar apo terciar, është shumë larg asaj që kërkohet.

Kjo për faktin, jo në mungesë të fondeve, ashtu siç thuhet në shumë raste, mirëpo kjo situatë është krijuar për shkak të keqmenaxhimit të institucioneve shëndetësore.

Ne do t'i rekomandojmë ministrit të Shëndetësisë, zotit Imet Rrahmani, që t'i fillojë reformat e thella në Sektorin e shëndetësisë në përgjithësi, duke filluar nga drejtorët e klinikave, e deri te drejtorët e departamenteve.

Mendoj se problem kryesor në tërë sistemin shëndetësor është faktori njeri. Është i kotë çfarëdo investimi në këtë sektor, nëse për këtë nuk merren masa për korrigjimin e dobësive të shkaktuara nga vetë faktori njeri.

Unë befasohem me disa qendra, ku në vend se të blihen barna, aty vendosen kamera të sigurisë, duke përfshirë edhe parkingjet e veturave.

Po ashtu, pothuajse reforma në shëndetësi nuk do të ndodhin përderisa ka persona të implikuar në krim brenda Sektorit të shëndetësisë.

Sipas kësaj, mund të konkludojmë se Ministria e Shëndetësisë nuk ka arritur ndonjë performansë të mirë në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit, e këtë më së miri e dëshmon ky raport i auditimit të performansës nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm.

Nga e gjithë kjo që u tha më lart, Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës i rekomandon ministrit të Shëndetësisë që të merret seriozisht me adresimin e të gjitha të gjeturave nga raportet e auditimit, si dhe personat përgjegjës për shkeljen e konstatuar të vihen para drejtësisë.

Edhe një herë, ju them që Grupi Parlamentar i aleancës në parim do t'i përkrahë këto rekomandime që kanë dalë nga Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar “Nisma”, zoti Hoti e ka fjalën.

ENVER HOTI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Grupi Parlamentar “Nisma për Kosovën” e ka trajtuar me kujdes raportin e Auditorit dhe me keqardhje mund të konstatojë se ai ka sjellë mjaft fakte, të cilat në sistemin e prokurimit paraqesin të meta në menaxhimin e parasë publike dhe menaxhimin e punës së këtij sistemi të prokurimit.

Ajo çka është më shqetësuese është se raporti i auditimit të jashtëm, kudo që ka audituar në sistemin e prokurimit, përfshirë edhe të gjeturat në auditimin e brendshëm të Ministrisë së Shëndetësisë, ka gjetur të shkelura, të cilat në vend që ato të merreshin si mundësi për ta përmirësuar punën e sistemit të prokurimit, aty nuk janë përfillur fare nga Ministria e Shëndetësisë dhe nga zyrtarët e prokurimit.

Po ashtu, çështje tepër shqetësuese është edhe përsëritja e të gjeturave dhe identifikimit të problemeve dhe dobësive që e kanë përcjellë në tre vjetët e fundit, 2011, 2012 dhe 2013 në sistemin e prokurimit në Ministrinë e Shëndetësisë, nuk janë përfillur dhe nuk janë marrë të njëjtat defekte, të njëjtat probleme janë përcjellë gjatë tre vjetëve.

Ne po ashtu e mbështetim raportin e komisionit, i cili ka ardhur këtu, por kërkojmë që në këtë raport të shtohet edhe diçka tjetër, që ka të bëjë me forcimin e Auditorit të Brendshëm, si dhe me marrjen e masave ndaj zyrtarëve, të cilët i kanë bërë këto shkelje.

Të nderuar deputetë,

Nëse rekomandimet të cilat dalin nga ky Komision dhe shkojnë vetëm në zyrën e ministrit të Shëndetësisë dhe nuk merren masa për zyrtarët, të cilët i shkelin rregullat ligjore dhe menaxhimin e parasë publike, atëherë sikur çdo organizatë buxhetore, edhe në këtë organizatë buxhetore vetëm do të përsëriten dhe do të vazhdojmë me identifikimin e problemeve dhe raportet e auditimit do të vijnë dhe do të mbeten nëpër sirtarët e ministrisë dhe si rekomandime të komisioneve.

Ne kërkojmë fuqishëm që të forcohet Auditori i Brendshëm në Ministrinë e Shëndetësisë dhe për përgjegjësit të merren nga organet kompetente, të tërhiqet vërejtja dhe të merren masa ligjore për shkeljet që i ka evidentuar raporti i auditimit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka, në emër të Grupit Parlamentar “6+”, zonja Balje.

DUDA BALJE: Zahvaljujem!

Parlamentarna grupa “6+” je vršila razmatranje izveštaja revizije sistema na zdravstvenom sektoru. Ono što smo uvideli, kao i svi što su do sada rekli, da su anomalije koji se vuku već mnogo godina u nazad. Kroz radu Komisije za javne financije zajedno sa Komisijom za zdravstvo imali smo javno saslušanje ministra, a došli smo do nekih rekomandacija koja su upućena direktno Ministarstvu.

Ja se iskreno nadam da će se te rekomandacija ozbiljno svaditi u cilju da se poboljša opšte stanje u zdravstvenom sistemu. Zahvaljujem!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zonja Rysha.

SYNAVERE RYSHA: Faleminderit, kryesues!

Procesi i prokurimit në sistemin shëndetësor është një temë, e cila po diskutohet shumë në Kuvend, media, nga shoqëria civile dhe aktorë tjerë të rëndësishëm në shoqëri. Besueshmëria mbi atë se si paraja publike po menaxhohet është shumë e ulët.

Nga shumë debate dhe raporte në lidhje me procesin e prokurimit në këtë sektor perceptimet janë jo të kënaqshme.

Në vazhdimësi, raportet shpalosin mangësinë nga fusha e menaxhimit të prokurimit në Sektorin shëndetësor.

Shpesh në media shkruhet për keqmenaxhimin e barnave të listës esenciale dhe ato janë më se të vërteta. Duket se ky është bërë një problem që nuk ka zgjidhje.

Të nderuar deputetë,

Këtu janë sfida të prokurimit në Sektorin shëndetësor, të cilat na paraqiten në raportin e auditimit të sistemeve të prokurimit në Sektorin e shëndetësisë, të cilin po e shqyrtojmë - raportin e performansës, të hartuar nga zyra e Auditorit Gjeneral në Kosovë për vitin 2013.

Duke e analizuar raportin vërehet se fushën e prokurimit në Sektorin e shëndetësisë e përcjellin shumë dobësi: mungesa e një strategjia të prokurimit të shkruar dhe mirë të artikuluar. Nuk ka vlerësim të duhur të nevojave për furnizime, sidomos për barna esenciale, planifikim, furnizim dhe shpërndarje jo e duhur e barnave, krahas buxhetit që ka në dispozicion Ministria e Shëndetësisë.

Kontratat nuk menaxhohen në projekte në mënyrë efektive. Janë theksuar vonesa në furnizime dhe kryerjen e punimeve, si dhe furnizime jashtë kontratës.

Të gjeturat në fushën e prokurimit janë përsëritur nga viti në vit. Rekomandimet e rëndësishme të Auditorit Gjeneral nuk janë përfillur fare nga Ministria e Shëndetësisë.

Raporti në fjalë e pasqyron një gjendje jo të mirë në përgjithësi në sektorin e prokurimit.

Ministria e Shëndetësisë i ka nisur reformat në këtë sektor, por zbatimi i tyre në praktikë ka hasur në vështirësi të theksuara. Përgjegjësitë e parapara me reforma ende nuk janë bartur plotësisht. Reforma, përveç stafit menaxheria, nuk i është komunikuar pjesës tjetër të stafit në Sektorin shëndetësor. Domethënë, Ministria e Shëndetësisë i ka nisur reformat ende pa e njoftuar stafin se kah do të shkojë ajo. Kjo paraqet edhe një problematikë tjetër në vete.

Konstatohet se ka nevojë urgjente për hartimin e specifikacionit dhe ndërmarrjen e masave praktike për të krijuar parakushte të mira për sukses, si dhe për të zvogëluar rreziqet dhe mangësitë në zbatimin praktik të reformave.

Në fund të raportit, Auditori Gjeneral ka dhënë disa rekomandime, të cilat Ministria e Shëndetësisë është e obliguar që t'i përmbushë me qëllim të përmirësimit të gjendjes së krijuar për vite me radhë.

Duke pasur kujdes të shtuar, sidomos gjatë hartimit të strategjisë së prokurimit gjithëpërfshirës të shkruar të integruar në Sektorin e shëndetësisë.

E këto dhe problematika tjera besojmë shumë se Auditori i ka trajtuar mirë dhe do t'i ketë parasysh Ministria e Shëndetësisë dhe do të merret me eliminimin e këtyre në vazhdimësi në viteve në vijim.

Duke i përkrahur rekomandimet e Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, janë tri rekomandime, të cilat i adresohen ministrisë. Unë do ta përfundoj fjalimin këtu, me shpresë se ato do t'i shërbejnë në mënyrë të duhur Ministrisë së Shëndetësisë në rritjen e performansës dhe ndryshimin e gjendjes aktuale. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Kadrijaj e ka fjalën.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Ndër vite, raportet e Auditorit të Përgjithshëm janë raporte alarmante që është dashur ta zgjojnë ndërgjegjen e Qeverisë, duke ditur se në çfarë situatë është katandisë shëndetësia kosovare.

Ministria e ka për obligim që rekomandimet e dhëna nga Auditori dhe Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike t'i implementojë, ndërsa kjo nuk ka ndodhur.

Edhe pse shëndetësia është sektor i rëndësishëm dhe të themi më vital, Qeveria përpos pohimeve deklarative asnjëherë nuk e ka pasur prioritet atë.

Kjo shihet nga buxheti i ndarë për këtë sektor, që krahasuar me vendet e rajonit është buxhet minimal, e nëse kësaj ia shtojmë edhe keqmenaxhimin nga ministria e deri te menaxherët, duke filluar nga shëndetësia primare, spitalet rajonale, e të mos fjalim për QKUK-në, sektorë që janë të përfshirë në afera të rënda korruptive, e personat e përfshirë në këto afera, në vend se të ndëshkohen, ata ngrihen në pozita menaxheriale, sepse janë njerëz të politikës.

Shëndetësia po lëngon, apo është e sëmurë, sepse njerëzit që e udhëheqin këtë sektor janë të sëmurë.

Nëse flasim për qendra një nga një, nuk shohim se diçka e mirë po ndodh, duke filluar nga emergjenca, intensive qendrore, gjinekologjia, kirurgjia, ku stafi punon me përkushtim, pa kushte elementare për punë. Aty mungon gjithçka, duke filluar nga barërat vitale, esenciale, ku pacientët duhet të paguajnë për gjithçka.

Gënjejmë nëse themi se shëndetësia është pa pagesë në Kosovë dhe unë them se shëndetësia në Kosovë kushton më shtrenjtë sesa në të gjitha vendet e rajonit, sepse këtu pacientët duhet të paguajnë për gjithçka, duke filluar për analizat laboratorike, për barna, për filmimet e ndryshme që kanë kosto të lartë buxhetore, e të mos flasim për pacientët, të cilët vuajnë nga leukimia apo nga kanceri, sepse barnat që ata duhet t'i blejnë e kanë një kosto të rëndë buxhetore, e është një kosto që xhepi i pacientëve kosovarë nuk e përballon do.

Të mbetemi me shpresë se kësaj radhe Qeveria do t'i implementojë rekomandimet e dhëna nga Auditori i Përgjithshëm dhe nga Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, në mënyrë që të gjitha këto të gjetura të mos përsëriten vit pas viti, sepse në këtë formë edhe po e dëmtojmë shëndetësinë, e cila edhe ashtu është mjaft e dëmtuar.

KRESUESI: Faleminderit! Zoti Baxhaku e ka fjalën.

HATIM BAXHAKU: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Sot para nesh e kemi raportin e Auditorit të sektorit të prokurimit në shëndetësi.

Prandaj, dua që në diskutimin tim të fokusohem në këtë çështje dhe të mos merrem me problemet tjera, të cilat janë të shumta në Sektorin e shëndetësisë.

E kam lexuar me kujdes raportin e auditimit, si të gjeturat, ashtu edhe konkluzionet e nxjerra nga ky auditim nga Zyra e Auditimit të Përgjithshëm, e po ashtu edhe rekomandimet e Komisionit për Mbikëqyrje të Financave Publike, të cilin e kanë formuar së bashku me Komisionin për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale dhe pajtohem plotësisht me të gjeturat, prandaj në këtë drejtim unë nuk dua të merrem më gjatë, sepse nuk kam çfarë të shtoj.

Unë dua të ndalem te disa çështje shumë praktike, të cilat i njoh shumë mirë, sepse unë ende jam aktiv dhe punoj çdo ditë dhe çdo ditë ballafaqohem me problemet, të cilat kryesisht janë për shkak të mungesës së barnave nga lista esenciale.

Dhe, mungesa e barnave nga kjo listë është burimi kryesor i pakënaqësive të shumta të qytetarëve, pastaj të mundësisë të keqpërdorimit, por edhe probleme më të mëdha, sepse ndikojnë në cilësinë e shërbimeve dhe në suksesin e mjekimit të pacientëve.

Prandaj, mua më pak më interesojnë keqpërdorimet, ndërsa më shumë më interesojnë se si mund të kontribuojmë, në mënyrë që furnizimi i institucioneve shëndetësore publike të bëhet sa më mirë të jetë e mundur me barna nga lista esenciale.

Dhe, në kuadër të kësaj, problemi kryesor për mungesën e barnave nga lista esenciale, përveç atij buxhetor, pra mungesës së buxhetit dhe buxhetit të vogël për këtë qëllim, janë edhe tri shkaqe të tjera.

Nën një, është mungesa e sistemit të informimit shëndetësorë, mungesa e të cilit po pamundëson ekzistencën e të dhënave të besueshme, të sakta në kohë të duhur të disponueshme, të cilat do të mund të analizoheshin me kujdes dhe me lehtësi dhe do të përdoreheshin për planifikimin dhe menaxhimin e suksesshëm të furnizimit me barna nga lista esenciale.

Prandaj, puna e parë që duhet të bëhet është sa më parë që të jetë e mundur të funksionalizohet sistemi i informimit shëndetësor.

Mungesa e dytë, apo shkak i dytë që shkakton mungesën e barnave nga lista esenciale është mungesa e protokolleve klinike, e cila pamundëson standardizimin e llojit dhe sasisë të medikamenteve, të cilët do të përdoreheshin për sëmundje dhe patologji të posaçme dhe kështu do të standardizoheshin në mënyrë cilësore sasia dhe lloji i barit, i cili do të përdorej te patologjitë e ndryshme.

Prandaj, edhe një propozim imi do të jetë se sa më parë duhet të përpilohen disa nga udhërrëfyesit klinikë, apo protokollet klinike, si quhen ndryshe.

Dhe, shkak i tretë i mungesës së barnave nga lista esenciale është mungesa e përgjegjësisë dhe llogaridhënies, duke filluar nga nivelet më të ulëta të mjekut deri te shefi i reparteve, departamenteve, pastaj në Departamentin Farmaceutik dhe në Ministrinë e Shëndetësisë.

Dhe, mund të them se faktori njeri, apo mungesa e përgjegjësisë dhe llogaridhënies është edhe faktori kyç i problemeve të këto dy shkaqet e para të cilat i përmenda si objektive.

Prandaj, kërkoj dhe pres nga Ministria e Shëndetësisë që sa më parë të funksionalizohet sistemi i informimit shëndetësor, përpilimi dhe përdorimi i protokolleve klinike, si dhe të futet në përdorim llogaridhënia dhe përgjegjësia morale dhe legale për të gjithë ata që janë përgjegjës për këtë gjendje. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Bulliqi e ka fjalën!

SHPEJTIM BULLIQI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Duke e parë raportin e Auditorit në Sektorin e shëndetësisë, vërtet mund të vijmë në përfundim se këtu kemi të bëjmë me një sektor, i cili është në gjendje relativisht të rëndë. Në qoftë se ndalemi dhe i analizojmë krejt këto shifra të buxhetit që është investuar për këto tre vjet në Sektorin e shëndetësisë dhe të gjitha këto lëshime të cilat janë nxjerrë nga Auditorit, duke filluar nga gjendja e stokut të barnave, pastaj mospërputhja e të hyrave dhe të dalave të këtyre artikujve, procedurat e ndryshme të hapura të tenderimi, pastaj përsëritja prej viti në vit e të gjeturave në këtë sektor, blerja e barnave nga lista esenciale në formë të ndryshme jo të drejta të tenderimit, e kështu me radhë, na bënë të kuptojmë që vërtet në këtë sektor ka probleme jashtëzakonisht të mëdha.

Sigurisht që ne nuk jemi ekspertë të kësaj fushe dhe ndoshta nuk mund të japim më shumë, por mjafton që të lexohet ky raport i këtij auditimi. Dhe, unë vetëm do të isha ndalur te problematika e gjendjes së stokut të barnave.

Në qoftë se mbështetemi në këto të dhëna të cilat janë nxjerrë nga Auditori i Përgjithshëm që është bërë në këtë ministri, faktikisht vetëm në qoftë se marrim parasysh një artikull, artikullin e amoksidilinit për vitin 2012, atëherë gjendja në stok na del që vërtet vetëm në këtë artikull kemi një sasi në 7 019 njësi më pak, e cila është jo e përputhshme. Domethënë, këto realisht janë sasi të cilat nuk dihet se kah kanë shkuar, përkatësisht thënë më mirë kah janë avulluar nga stoqet e barnave.

Pastaj, e njëjta gjë ndodh edhe me artikullin tjetër të gjilpërave, ku kemi gjithashtu një mospërputhje ndërmjet të hyrave dhe daljeve në stokun e barërave, ku prapë e kemi një sasi të caktuar prej 2 090 njësisht më pak.

E njëjta gjë ndodh edhe me artikujt tjerë, për të mos i numëruar të gjithë me radhë. Mirëpo, ç'është e vërteta, edhe tjetri problem, që është relativisht i shprehur në kuadër të këtij sektori, e kemi problematikën e porositjes së një numri të caktuar të barnave, të cilat realisht kërkohen në sasi më të vogël për t'u marrë, por realisht ato janë marrë në sasi shumë më të mëdha dhe sigurisht që meqë ka qenë sasia shumë më e madhe, faktikisht ato nuk janë shpenzuar dhe sigurisht që ky është prapë një keqmenaxhim, ose një keqpërdorim i gjendjes dhe kërkesave të këtij sektori për këta artikuj.

Sigurisht në qoftë se i analizojmë të gjitha këto probleme, unë desha të ndalem vetëm te ky problem, sepse po vërehet se krejt në këtë raport ka një sërë të gjeturash dhe ç'është më e keqja të gjeturat të cilat përsëriten nga viti në vit, mendojmë që është koha e fundit nga ministri i Shëndetësisë dhe zyrtarët përkatës në këtë resor që të marrin masa konkrete, në mënyrë që Sektorin e shëndetësisë ta nxjerrin nga kjo gjendje vërtet shumë e rëndë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk kemi kuorum për votim.

Vazhdojmë me pikën e tetë të rendit të ditës:

8. Propozimi për emërimin e anëtarit të Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës

Komisioni Funkcional për Legjislacion e ka shqyrtuar propozimin për emërimin e anëtarit të Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim.

E ftoj kryetaren e Komisionit Funkcional, zonjën Albulena Haxhiu, që ta marrë fjalën. Njëkohësisht i ftoj deputetët që të qëndrojnë në sallë dhe e ftoj regjinë që ta vendosë zilen, sepse nuk po dëgjohet. Unë nuk di kush u ka thënë ta ndalin zilen, ose le të merren deputetët, kryetarët e grupeve, këta po më thonë që e kanë ndaluar kënde, veç andej, nuk po di, se s'ka kuptim të mos votohet. A ka kuorum tash? Jo. Atëherë vazhdojmë, Albulena.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Komisioni, në mbledhjen e mbajtur më 9 mars 2015, e shqyrtoi propozimin e Shoqatës së Juristëve të Kosovës për emërimin e anëtarit të Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës dhe vlerësoi se propozimi për emërimin e anëtarit është në përputhje me nenin 3.3 të Ligjit numër 02/L-25 për themelimin e Institutit Gjyqësor të Kosovës.

Prandaj, duke marrë parasysh bazën ligjore të propozimit të institucioneve të përcaktuara me ligj dhe obligimin e Kuvendit për emërimin e anëtarëve të Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës, i rekomandoi Kuvendit që të emërohet anëtar kandidati i propozuar.

Pra, propozimi është që të emërohet anëtar i Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës kandidati Mazllum Baraliu, pra është anëtar nga Shoqata e Juristëve të Kosovës. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Sabri Hamiti.)

KRYESUESI: Faleminderit, zonja Haxhiu! Atëherë presim deklaratimet e kryetarëve ose përfaqësuesve të grupeve parlamentare.

Grupi Parlamentar i PDK-së, kush e merr fjalën? Zoti Reçica.

ELMI REÇICA: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Përshëndetje për të gjithë,

Grupi Parlamentar e ka analizuar situatën dhe realisht kërkon që të shkohet në votim menjëherë, pastaj seanca vendos kur të ketë deputetë të mjaftueshëm. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Reçica! Për Grupin Parlamentar të LDK-së, deputeti Armend Zemaj e ka fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Edhe Grupi i Lidhjes Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar propozimin për emërim në Këshillin Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës dhe sipas raportit edhe të Komisionit për

Legjislacion ai i plotëson kushtet dhe kriteret sipas ligjit në fuqi për plotësimin e Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës.

Një vërejtje jona parimore është që në organet, të cilat kanë të bëjnë me sistemin e drejtësisë në Kosovë është theksuar dhe theksohet vazhdimisht që ne kemi nevojë për njerëz të cilët nuk janë të ndikuar politikisht, janë të pavarur në veprimet e tyre dhe, mbi të gjitha, mund t'i kontribuojnë sistemit të drejtësisë, krijimit të kuadrove të pavarura në Republikën e Kosovës.

Andaj, kjo ka dalë edhe si vërejtje nga grupi dhe si emërim, edhe pse Shoqata e Juristëve e ka të drejtën legjitime ta propozojë një anëtar dhe personi në fjalë i plotëson kushtet dhe kriteret sipas Ligjit për Këshillin Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës.

KRESUESI: Faleminderit zoti Zemaj! Për Grupin Parlamentar të “Vetëvendosjes”, kryetari Glauk Konjufca e ka fjalën.

GLAUK KONJUFCA: Lëvizja “Vetëvendosje” e mbështet plotësisht propozimin e Komisionit për Legjislacion dhe ne mendojmë që personi i propozuar i përmbush të gjitha kushtet profesionale të cilat kërkohen për ta ushtruar me përgjegjësi funksionin të cilin kërkohet dhe përveç kësaj ne besojmë në integritetin moral dhe personal të zotit Baraliu për ta marrë këtë funksion.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Konjufca! Unë nuk kam të tjerë që janë paraqitur të komentojnë. Por, tash e kemi paraqitjen e zotit Fikrim Damka, nga Grupi “6+”. Urdhëro Damka!

FIKRIM DAMKA: Faleminderit, zoti kryesues!

Desha të them se Grupi Parlamentar “6+” nuk e përkrah Mazllum Baraliun për anëtar të Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës, arsyeja sepse ai vetë nuk i pranon komunitetet tjera, të cilat jetojnë në Kosovë. Faleminderit!

KRYESUESI: Për Grupin Parlamentar “Nisma”, deputeti Zafir Berisha e ka fjalën.

ZAFIR BERISHA: Edhe Grupi Parlamentar “Nisma” mbështet propozimin e Odës së Avokatëve dhe besoj se zoti Baraliu i plotëson të gjitha kushtet që kërkohen. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Berisha! Për Grupin Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, kryetarja e Grupit Donika Kadaj-Bujupi e ka fjalën.

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Faleminderit, kryesues!

Edhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës konsideron se janë plotësuar të gjitha kushtet dhe propozojmë që të shkohet në votim, domethënë e përkrahim kandidatin.

KRYESUESI: Atëherë më lejoni që të ju pyes dhe të ju propozoj, meqë nuk janë 61 deputetë brenda propozoj të vazhdojmë tutje dhe të kthehen të bëhet kuorumi i plotë për të votuar. A pajtoheni?

Kalojmë në pikën e nëntë të rendit të ditës:

9. Kërkesa e Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës për formimin e Komisionit Hetimor Parlamentar

Tetë deputetë nënshkrues të Grupit Parlamentar të AAK-së, në bazë të nenit 4, paragrafi 1, të Ligjit për hetimin parlamentar, e kanë iniciuar procedurën për formimin e Komisionit Hetimor Parlamentar lidhur me hetimin e situatës në Radiotelevizionin e Kosovës, RTK.

E ftoj përfaqësuesin e Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, që është shefja e grupit, Donika Kadaj-Bujupi, ta paraqesë dhe arsyetojë kërkesën për formimin e Komisionit Hetimor Parlamentar. Urdhëroni, zonjë!

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar koleg deputetë,

Para se të lexoj para jush kërkesën për formimin e Komisionit Hetimor Parlamentar, më lejoni të ju njoftoj se para pesë minutash i morëm dy vendime të menaxhmentit të RTK-së, i cili ka vendosur në mënyrë arbitrare ta shkarkojë kryetarin e Sindikatës dhe nënkryetarin, t'i nxjerrin prej pune pa asnjë informatë ose paralajmërim po për faktin se kanë ngrehur kërkesa të vazhdueshme që të hetohet nga Kuvendi gjendja e krijuar në Radiotelevizionin e Kosovës. Dhe, unë prej natyrës konsideroj që politika sa më shumë të qëndrojë larg mediave do të jetë më mirë.

Mirëpo, duke marrë parasysh se gjendja në RTK, themeluesi i së cilës jemi ne si Kuvend është alarmante dhe kërkon një ndërhyrje, sepse në vazhdimësi po shkelen jo vetëm parimet e etikës dhe parimet e medias dhe fjalës së lirë, dhe ky veprim i fundit po më vjen shumë keq që po duhet ta përmend në këtë foltore, por po ma kujton kohën kur RTP-ja është mbyllur edhe kur menaxhmentet e ndryshme të regjimeve kanë larguar punëtorë nga puna. Ndryshe s'kemi si ta shpjegojmë këtë vendim kaq arbitrar, pesë minuta pa u ngrehur kjo kërkesë.

Prandaj, në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, por edhe të deputetëve të tjerë dhe në mbështetje të nenit 65.9 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 4 të Ligjit për hetim parlamentar, Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës ka marrë vendim për ngritjen e Komisionit Hetimor.

Të gjitha të drejtat dhe përgjegjësitë e Komisionit Hetimor janë të rregulluara me Ligjin numër 3 për hetim parlamentar, të datës 4 qershor 2010.

Çështja: Hetimi i situatës së krijuar në Radiotelevizionin e Kosovës dhe arsyetimi.

Ky veprim ka ardhur duke u bazuar në shqetësimet e vlerësuara si alarmante në gjendjen e krijuar lidhur me zhvillimet brenda Radiotelevizionit të Kosovës.

Grupi Parlamentar i Aleancës konsideron se është momenti i fundit kur Kuvendi duhet të reagojë fuqishëm kundër të keqes në Radiotelevizionin e Kosovës që po e pengon përmbushjen e misionit të saj, për informim të drejtë dhe të paanshëm të publikut, i cili është edhe financues i RTK-së. Në veçanti, komisioni duhet të kërkojë llogari nga menaxhmenti i RTK-së për dështimin e propozimit të mekanizmit për përmbledhjen e tarifës së abonimit, gjë që është dashur të bëhej jo më vonë se 12 muaj nga hyrja në fuqi e Ligjit për RTK-në.

Në bazë të këtij ligji, RTK-ja do të financohej direkt nga buxheti i shtetit për një periudhë transitorë trevjeçare, periudhë e cila përfundon në prill të vitit 2015.

Për anëtarë të Komisionit Hetimor propozojmë që numri i anëtarëve të komisionit hetimor të jenë nëntë, kurse pas formimit të komisionit propozojmë që afati kohor brenda të cilit duhet të mbarojë mandati i Komisionit Hetimor të jetë tre muaj.

Konsideroj, edhe një herë po e theksoj, të nderuar kolegë deputetë, se kjo çështje i takon askujt më shumë se Kuvendit të Republikës së Kosovës, se përgjegjësit e këtyre shkeljeve duhet të dalin para ligjit që të zbardhen dyshimet mbi keqpërdorimet edhe financiare, sepse bëhet fjalë për taksat e qytetarëve të Kosovës, për punësimet e paligjshme, për ngufatjen e gazetarëve profesionistë, të cilët punojnë në RTK dhe, mbi të gjitha, për censurën për të cilën sot janë larguar prej punës nëpërmjet dy vendimeve shumë arbitrare ata të cilët i mbrojnë interesat e punëtorëve të RTK-së, respektivisht kryetari dhe nënkryetari i Sindikatës.

Unë ju ftoj që si deputetë përtej partive politike të reflektojmë dhe ta përkrahim themelimin e një komisioni hetimor. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja Kadaj-Bujupi! Kërkojmë deklaratimet e kryetarëve të grupeve, ose përfaqësuesve të tyre.

Për Grupin Parlamentar të PDK-së, deputeti Zenun Pajaziti e ka fjalën.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e ka vlerësuar kërkesën për formimin e një grupi hetimor nga radha e një grupi deputetësh nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës.

Ne konsiderojmë që është kohë e përshtatshme tanimë në këtë legjislacion që ta shtojmë mbikëqyrjen parlamentare në të gjitha fushat, në të gjitha mënyrat, në të gjitha mundësitë që na jep ligji për të gjitha institucionet.

Sa i përket RTK-së, tanimë është koha e rregullt e raportimit të tyre në Kuvend, këto ditë presim data 31 është dita e fundit e sjelljes së raportit në Komisionin Parlamentar dhe rrjedhimisht pastaj debati parlamentar, debati në Komision, të gjitha procedurat e aprovimit dhe debati parlamentar dhe po ashtu është koha kur ne për RTK-në ta kemi madje edhe një raport tjetër shtesë, nëse duhet ta lexojmë, ai është paraprak.

Legjislacioni i kaluar në përfundim ka mbetur në komision, pra kemi të bëjmë me dy raporte të munguara të këtij institucioni dhe është koha e përshtatshme tash që t'i kemi këto raporte, aq më tepër kur flitet për çështje financiare. Ne kemi nevojë edhe për një vlerësim të Auditorit të Jashtëm, është një detyrim i rregullt i këtij televizioni që duhet ta kemi, dhe raportit të Auditorit Gjeneral, raporte të tjera të ngjashme për ta kompletuar pamjen e funksionimit të këtij institucioni.

Rrjedhimisht, Partia Demokratike mendon që paraprakisht duhet të vazhdojmë, aq më tepër kur e kemi një kërkesë dhe një pikë të rendit të ditës edhe për debat parlamentar, mendojmë që duhet të konsumohen të gjitha këto dhe pastaj nëse është e nevojshme deputetët duhet të vendosin edhe për Komisionin Hetimor Parlamentar.

Çdo tendencë tjetër mendoj që do të ishte më shumë presion në Televizionin Publik, aq më tepër kur u përmend edhe nga deputetja që kemi të bëjmë me një periudhë kohore ku ne si Parlament duhet të vendosim për financimin e televizionit. Pra, paraprakisht duhet të merremi me çështjet madhore, kompetencat dhe përgjegjësitë që i kemi si Parlament, e pastaj të hyjmë në të gjitha çështjet që janë të hapura dhe që janë kompetencë normalisht e Parlamentit të Kosovës.

Pra, ne mendojmë që duhet të vazhdojmë me trajtimin e raportit të rregullt të Televizionit të Kosovës dhe më tutje pastaj nëse është e nevojshme mund të procedohet edhe me çështje tjera të mbikëqyrjes. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet Pajaziti! Për Grupin Parlamentar të LDK-së, deputeti Ali Sadriu e ka fjalën.

ALI SADRIU: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Ne para vetes sot i kemi dy pika realisht që lidhen me këtë temë. E para ka të bëjë me kërkesën e Grupit Parlamentar “Vetëvendosje” që të krijohet një komision hetimor dhe pika menjëherë e radhës është një debat rreth RTK-së.

Mendimi i Grupit Parlamentar është që këto dy pika të fuzionohen në një dhe unë do të mundohem ta paraqes arsyetimin pse duhet të ndodhë diçka e tillë.

Sipas dispozitave ligjore, RTK-ja është e obliguar që deri më 31 mars ta prezantojë një raport të performansës, do të thotë vetë menaxhmenti do ta prezantojë performansën e veprimit gjatë vitit 2014.

Në anën tjetër, nga kontaktet që unë kam pasur edhe sot me Auditorin e Përgjithshëm, Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, sepse Kuvendi e di, ka debatuar dhe këto probleme me RTK-në nuk janë të sotme, dhe këto vërejtje që i tha kolegja, ka edhe shumë e shumë të tjera që flasin, kanë ekzistuar edhe në vitet në radhë, ata e kanë bërë një auditim të performansës me konsulencë ndërkombëtare dhe është në fazën thuajse finale. Draft-raporti është hartuar, por mungesa e përkthimit dhe procedurave tjera që shkon sipas dispozitave ligjore ende nuk ka përfunduar, por premtimi i tyre është, unë po e bëj publik, që brenda muajit ata do të na sjellin raportin e auditimit të performansës.

Këto dy materiale i japin Kuvendit shumë të dhëna për ta parë gjendjen se si është zhvillua në vite dhe se çfarë është tani.

Nëse fuzionohen, unë po e ruaj të drejtën për diskutim më vonë për të gjeturat në bazë edhe të këtij draft-raporti, edhe të raporteve të mëhershme, që flasin për shqetësime vërtetë tepër të mëdha dhe është toleruar tepër shumë.

Akti që sot e komunikoi zonja Kadaj-Bujupi është shqetësim dhe është provokim për Kuvendin. Është provokim për Kuvendin, por të dhënat e mia që unë do t'i prezantoj janë të bollshme, meqë flasin për keqmenaxhimin, unë nuk po e them keqpërdorimin, por po t'i bëhet një shqyrtim më i thellë dhe shumëçka atje, sepse të dhënat flasin, por këtë po e ruaj dhe po e rezervoj.

Megjithatë, unë i apeloj Kuvendit që si institucioni më i lartë ta ruajmë kredibilitetin tonë edhe në trajtimin e kësaj teme dhe t'i fuzionojmë, të debatojmë, por brenda muajit ne do t'i kemi dy dokumente që janë bazike prej profesionalistëve, se po të shkojmë në hapin e formimit të Komisionit Hetimor sot, ne e dimë se ai ka mandat një muaj deri tre muaj dhe bëhet kryesisht nën ndikimin e politikës.

Grupi Parlamentar i LDK-së nuk është i interesuar që ky debat të zhvillohet mbi bazat e parimeve politike, por paraprakisht të bisedohet për proceset menaxhuese që kanë ndodhur dhe vazhdojnë të ndodhin në këtë institucion, e që rezultatet flasin për shumëçka se atje duhet të ndërmerren veprime. Por, kohën në mënyrë të rregullt e kemi më të shëndetshëm dhe më parimore.

Prandaj, ne nuk jemi për formimin e grupit hetues parlamentar, se ashtu kështu atje janë plotësuar kushtet dhe të dhënat që flasin vërtet do të bindemi në atë, sikur që u bindëm, ju kujtohet edhe me inicimin e Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike në mandatin e kaluar, edhe përkundër asaj që dy komisionet funksionale i patën dhënë vizë, ne e kemi refuzuar dhe është i vetmi rast kur dy herë i është refuzuar raporti i performansës, që sipas ligjit atje është dashur të shkarkohet.

Ligji për ndërmarrje publike, urdhëroni shikojeni, nëse në dy raporte nuk i miratohet, atëherë duhet parë përgjegjësia e Bordit. Ne nuk e kemi bërë atë, prandaj rrethanat e grumbulluara na flasin që ne duhet ta bëjmë një analizë komplete dhe mandej të marrim veprime konkrete.

KRYESUESI: Faleminderit! Për Grupin Parlamentar të “Vetëvendosjes”, kryetari Glauk Konjufca e ka fjalën.

GLAUK KONJUFCA: Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Deputetë të Kuvendit,

RTK-ja është transmetues publik dhe ashtu sikur për çdo institucion publik, ne kemi përgjegjësi dhe obligim ta përcjellim punën dhe funksionimin e tij.

E kemi detyrë si deputetë që ta mbikëqyrim punën e RTK-së dhe mënyrën se si ky institucion performon.

Qytetarët paguajnë për RTK-në, RTK-ja është themeluar nga Kuvendi, i jepet buxheti nga Kuvendi dhe ajo u raporton të zgjedhurve të popullit.

Por, ashtu sikur në shumicën e institucioneve publike, edhe në RTK ka ndodhur një ndërthurje ndërmjet kontrollit politik dhe keqpërdorimeve të shumta që i përkasin fushës së menaxhimit financiar.

Pretendimet e mbështetura për RTK-në dhe për keqpërdorimet aty vijnë nga katër burime të ndryshme.

Së pari, deputetët e këtij Kuvendi dhe komisioni përkatës që e ka për detyrë mbikëqyrjen e Radiotelevizionit të Kosovës ka ngrehur shqetësime të shumta për përgjegjshmërinë e RTK-së karshi këtij Kuvendi, i cili është themelues i saj.

Së dyti, shoqëria civile e ka vënë në pah nepotizmin në RTK, si dhe punësimet partiake të shumta që kanë ndodhur aty.

Së treti, vetë punëtorët që punojnë në RTK, si dhe sindikatat që janë përfaqësuese të interesave të punëtorëve të RTK-së kanë ngrehur pretendime të shumta për keqpërdorime financiare, dhe

Së katërti, kemi raporte të ndryshme ndërkombëtare, të cilat e ngrenë shqetësimin e një rritjeje të kontrollit politik dhe partiak mbi Radiotelevizionin e Kosovës. Dhe, shikojeni tash se çfarë po ndodh në Radiotelevizionin e Kosovës.

Fadil Hoxha, që është kryesues i sindikalistëve, e që i përfaqëson interesat e punëtorëve të RTK-së, si dhe zëvendësi i tij Arsim Halili shpunësohen vetëm pse paraqesin argumente për keqpërdorimet në Radiotelevizionin e Kosovës.

Ky është akt i papranueshëm i hakmarrjes së ulët kundër zërit kritik, dhe kjo është tendencë e qartë për frikësimin e të gjithë atyre që nuk janë të dëgjueshëm ndaj pushtetit qeveritar, i cili e ushtron kontrollin në RTK nëpërmjet Bordit, nëpërmjet redaktorëve, si dhe nëpërmjet drejtorit të saj.

Kjo është masë e qëllimshme ndëshkuese për disiplinimin e pakënaqësisë së punëtorëve të Radiotelevizionit të Kosovës.

Në këtë mënyrë krijohet praktika që në RTK e ke të garantuar humbjen e vendit të punës nëse e thua të vërtetën dhe nëse i demaskon manipulimet.

Prandaj, para se të mendosh për të vërtetën dhe para se ta thuash atë duhet të përgatitesh për persekutimin që të pret. Ky është kulmi dhe ky është një degradim aq serioz i transmetuesit publik, sa ne kemi nevojë për një ndërhyrje urgjente.

Dhe, e shfrytëzoj rastin të mos pajtohem fare me Grupin Parlamentar të LDK-së, i cili këtë shqetësim të Kuvendit të Kosovës dhe të grupeve e subjekteve parlamentare, që natyrisht janë parti politike, dëshiron ta vendosë në një trajtim partiak të kësaj çështje. Jo! Kur Kuvendi merret me RTK-në, ky nuk është trajtim partiak, e nuk është as politizim i kësaj çështjeje. Ne po merremi me një punë, e cila është detyrë edhe obligim yni. E kemi të përshkruar me Kushtetutë, e kemi të përshkruar me Rregullore, me detyrat, obligimet dhe përgjegjësitë e deputetit të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Prandaj, që të flasim për RTK-nëm që të krijojmë nëse ka nevojë edhe Komision Hetimor Parlamentar, që të bëjmë edhe debat, të cilit do t'i vijë radha tash pas kësaj pike, këto jo vetëm që janë detyrë e jona, por unë nuk shoh as kundërthënie ndërmjet këtyre dyjave.

Absolutisht nuk ka kurrfarë kundërthënies ndërmjet krijimit të Komisionit Hetimor Parlamentar, në njërën anë, dhe, në anën tjetër, debatit, që do të pasojë për RTK-në.

Nuk ka jo vetëm kundërthënie në aspektin e trajtimit tematik, por bile nëse doni nuk ka kurrfarë kundërthënie as në aspektin dinamik kohor. Çka ka lidhje? Krijohet Komisioni Hetimor, sepse ka të gjetje të mjaftueshme për një dëgjim publik, për një ftesë që ky Kuvend do t'ua bëjë anëtarëve të Bordit, drejtorit, punëtorëve që kanë fakte të rëndësishme për të na prezantuar.

Për këtë arsye, krijohet Komisioni Hetimor Parlamentar dhe unë nuk shoh kurrfarë prapavije partiake në këtë pikë.

Në të gjitha vendet e rajonit është e vërtetë që ka probleme me transmetuesit publik. Çdo kund këtu përreth në shtetet me të cilat kufizohemi, pushteti qeveritar bën çmos për ta shtënë në dorë televizionin publik. Por, Kosova është një rast drastik edhe për një arsye tjetër, që nuk mund ta hasni në këto vende të rajonit, që kanë probleme të tilla.

Përderisa në vendet e rajonit publiku ankohet që kryeministri po e kontrollon televizionin publik, Kosova është i vetmi vend në rajon, nuk e di nëse është edhe në botë, ku vetë kryeministri ankohet që televizioni publik është i kapur, dhe kjo ka ndodhur me zotin Mustafa, para tri javësh, kur ai në një intervistë del dhe ankohet duke thënë që nuk mund të jetë i pavarur dhe objektiv një televizion publik, i cili lajmet i fillon me Kadri Veselin, kurse kryeministrin e lë në minutën 20. Këto nuk janë fjalë të miat, këto nuk janë dyshime të miat! Këto janë fjalë të kryeministrit, i cili është i zgjedhur nga partia e LDK-së.

Do të thotë, këto janë shqetësime të përgjithshme, bile nëse doni edhe të vetë kryeministri. Pra, urojmë që këto shqetësime të kryeministrit tash nuk janë që të hiqet kontrolli i PDK-së e të zëvendësohet me kontrollin e LDK-së, sepse të mos harrojmë ne nuk kemi nevojë as për një RTK PDK-iste, as për një RTK LDK-iste, por kemi nevojë për një RTK profesioniste, dhe ashtu që kjo të ndodhë, RTK-në duhet ta nxjerrim nga statusi që e ka aktualisht. E, në çka është shndërruar aktualisht Radiotelevizioni i Kosovës? Radiotelevizioni i Kosovës, duhet ta themi të vërtetën është altoparlant i PDK-së dhe për këtë është ankuar edhe vetë zoti Mustafa.

Tash pres nga Lidhja Demokratike e Kosovës, që në përputhje me shqetësimet e kryeministrit të vet, ta përkrahë krijimin e këtij komisioni hetimor parlamentar. E sa i përket Partisë Demokratike, unë atyre nuk po u bëj thirrje, sepse zakonisht deri tash na kanë treguar që kurrë nuk votojnë kundër vetvetes.

KRYESUESI: Së pari ta tërheq vërejtjen ty Glauk, të parit, se të njoh më së shumti. Çështja është ta argumentoni nëse jeni për këtë komision apo jo? Mos ngrehni polemika se e keni në diskutim që e keni kërkuar ju, e i keni të gjitha orët përpara, pas nja 10 minutash. Bëhu korrekt! Jemi në pikën të deklaroheni për një kërkesë që e ka bërë një grup deputetësh i AAK-së për një komision hetimor.

Fjalën e ka, emër të “Nismës”, deputeti Zafir Berisha.

ZAFIR BERISHA: Faleminderit, kryesues!

Besoj se tash çdo gjë është e qartë se kërkesa për themelimin e një komisioni hetimor ka vend edhe për faktin se vetë deklaratat e menaxhmentit të RTK-së të bëjnë të dyshosh se diçka nuk është në rregull me RTK-në, derisa për shembull flitet për miliona euro borxhe. Drejtori gjeneral jep shifra tjera, menaxheri i Bordit jep shifra tjera, natyrisht edhe në cilësinë e qytetarit, e veçanërisht deputetit të bën të dyshosh se diçka nuk është në rregull, prandaj besoj se të gjithë duhet të pajtohemi që ne thjesht ta formojmë një komision hetimor për t’i hulumtuar dyshimet e bazuara edhe në opinion rreth keqpërdorimeve që përfliten.

Thënë të drejtën, RTK-ja më nuk është ndonjë zbulim epokal se është në shërbim të parapolitikës të caktuar, por është shumë me rëndësi që ne si Kuvend të kemi qëndrim të qartë rreth depolitizimit të saj dhe në këtë rast, thënë të drejtën, duke i hulumtuar dhe i bërë publike të gjeturat që mund të kapin shifra marramendëse dhe shqetësuese të keqpërdorimeve, ne përfundimisht atë parapolitikë kontrolluese të RTK-së do ta skajojmë dhe do ta çojmë aty ku e ka vendin.

Në anën tjetër, thënë të drejtën, unë rastësisht gjatë pauzës e takova një punëtor të RTK-së dhe besoni se frikohej të fliste në vend publik dhe nuk shkuan 10-15 minuta e dëgjojmë edhe këtë lajm, që Donika e prezantoi publikisht - largimin e dy kryesindikalistëve punëtorë të RTK-së dhe kjo nuk do koment se është metodë e dëgjuar kohëve të fundit vetëm në Moskë. T’i largosh punëtorët nga një ndërmarrje publike për shkak se kanë shprehur publikisht, në emër të sindikatës që e mbështetin debatin në Kuvendin e Kosovës dhe për këtë arsye të largohen prej pune kjo është ëmë shumë se komuniste. Unë besoj se është e mjaftueshme sjellja e sotme dhe e kohëve të fundit që ne si deputetë ta mbështetim idenë për themelimin e Komisionit Hetimor rreth RTK-së.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Berisha! Nga grupet parlamentare nuk kemi të paraqitur. Fjalën e ka Armend Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit nënkryetar!

Kolegë deputetë,

Çështja e Radiotelevizionit të Kosovës nuk është diçka e re që po bisedohet dhe po dëgjojmë këtu edhe në prezantimet, qoftë nga grupet parlamentare, qoftë nga deputetët dhe nuancat e të folurit, por edhe atë çka shpeshherë është thënë, është dëgjuar për qëllime të ndryshme, duke filluar nga to subjektive, e deri te ato parimore, që angazhohemi që të kemi institucione publike të pavarura dhe në harmoni me ligjin.

Një komision hetimor, i cili është i rregulluar me Ligjin për hetimin parlamentar, është e drejtë e deputetëve që të kërkohet për diçka që dyshohet që ndodh në një institucion publik apo shtetëror, që është më shumë kompetencë e Qeverisë. Nëse lexohet me vëmendje Ligji për hetimet parlamentare, aty kuptohet edhe esenca se çka dëshirojmë të hetojmë. Hetojmë diçka që nuk e dimë çka ka ndodhur, ose çka do të dalë në sipërfaqe. Edhe nga prezantimi që është bërë këtu në kërkesën e grupit të deputetëve për komisionin hetimor ka të bëjë me punën e Kuvendit dhe

përgjegjësinë e Kuvendit që e ka karshi këtij institucioni, i themeluar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Tash më lejoni t'i theksoj vetëm dy-tri veprime që është dashur dhe dy-tri përgjegjësi që janë të këtij Kuvendi karshi një institucioni publik, i themeluar dhe i mbikëqyrur nga komisionet parlamentare. Ne kemi Komisionin Funksional për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media; Komisionin për Buxhet dhe Financa; Komisionin për Mbikëqyrje të Financave Publike, që të tria këto komisione e bëjnë një punë të përbashkët, ta quaj ashtu, qoftë kjo në hetimin buxhetor, qoftë ajo në ndarjen buxhetore dhe kontrollin e pasqyrave financiare nga buxheti që ndahet për këtë institucion publik dhe tash nëse u apostrofohemi edhe të gjeturave, dhe këtu po thuhet që ka të gjetura, cili ka qenë veprimi i deritanishëm i këtyre komisioneve, por edhe i Kuvendit në tërësi. Të gjeturat nuk kanë rrugë tjetër, përpos Prokurorinë dhe gjykatat, dhe me një fjalë dua të them që institucioni i Kuvendit realisht duhet të mendojë se cila është çështja dhe zgjidhja më e mirë për një medium publik, siç është Radiotelevizioni i Kosovës.

Fatmirësisht, shumicës prej nesh që mund të jem edhe pjesë e diskutimeve, por edhe e debateve, nuk kemi interesa personale karshi këtij institucioni publik. Dikush mund të ketë edhe interesa personale, qoftë ato të punësimit, qoftë të biznesit, qoftë të ndikimit politik, qoftë të dhënies së lajmit të parë, të dytë dhe të tretë, por disa prej neve janë pak më të shkarkuar nga këto të tria që i thashë dhe nuk e kam personalisht dhe mendoj edhe me shumë deputetë që kemi biseduar, nuk e kemi këtë problematikë të tillë. Problemi është se cila është zgjidhja që Kuvendi i Kosovës dëshiron ta bëjë karshi institucionit publik se, nëse themi se sot është e PDK-së, PDK-iste, apo quhet LDK-iste, nesër, pasnesër mos e bëj Zot me qenë marksiste-leniniste, cila është zgjidhja që një medium publik t'ia futim në një rrugëtim të tillë?

Ne duhet të kërkojmë përgjegjësi nga ata që i ka emëruar Kuvendi i Kosovës. Ky Kuvend, me propozim të subjekteve politike dhe me përkrahjen nga shumica e grupeve politike dhe të anëtarëve të sot janë të Bordit, domethënë asnjëherë nuk është kërkuar përgjegjësi në këtë Kuvend.

E dyta, sipas ligjit, edhe si themelues, qoftë për burime të financimit, qoftë për kërkesën e përgjegjësisë ky Bord i RTK-së e zgjedh atë menaxhment që sot e ka dhe unë mendoj se këto nuk janë harxhuar. Kuvendi nuk i ka harxhuar këto përgjegjësi për të mbërri deri te një komision hetimor parlamentar, se nëse ekzistojnë të gjeturat, nëse ekzistojnë veprimet, qofshin ato të mira, qofshin ato të këqija, ato duhet të thuhën këtu, të japin rekomandime dhe të kërkohet përgjegjësi nga ata individë, apo qoftë edhe strukturë organizative. Përndryshe, tendenca për të mbizotëruar mbi një medium publik nuk i bën nder Kuvendit të Kosovës, por nuk u bën nderë as subjekteve politike.

Mbi të gjitha, ajo nënkuptohet edhe te qytetarët e vendit për një totalitarizëm apo për një ngufatje të fjalës së lirë në këtë institucion. E jona është që t'u japim përkrahje komisioneve parlamentare, të kërkojmë përgjegjësi në mënyrë zinxhirore edhe në kërkesën e raportimit se thuhet sot që një medium publik, ose ndonjë organizatë buxhetore nuk raporton dhe Kuvendi është i pafuqishëm karshi atij raportimi. Atëherë, cila është përgjegjësia e këtij organi më të lartë legjislativ dhe kjo është ajo që ne duhet ta shterojmë këtë temë të debatit për të mbërri te një komision hetimor dhe një kërkesë, me të cilën duhet të kërkohet llogari nga menaxhmenti i RTK-së.

Komisioni hetimor kërkon nga ata që i përgjigjen menaxhmenti i RTK-së, e ai është Bordi, që i përgjigjet Kuvendit, dhe unë shpresoj se këto duhet të analizohen mirë, pavarësisht asaj që qëllimi për ta zgjidhur që kjo është bërë temë aktuale, ne të gjithë po i dimë problematikat, qofshin ato të interferimeve të jashtme, qofshin të telefonatave të politikanëve, qofshin ndërhyrjet kush të dalë i pari, i dyti apo i treti, por unë mendoj se kjo nuk është zgjidhja. Zgjidhja është për ta krijuar një medium publik të pavarur, për t'i krijuar burimet e pavarura të financimit, të mos varemi as nga Kuvendi, e as nga Qeveria, dhe tek atëherë ne mund të mbërrijmë tek ajo që dëshirojmë.

Nëse të gjeturat janë faktike, ju lutem të adresohen në adresën, që është Prokuroria dhe gjykatat, nëse ka funksionim të sistemit të drejtësisë në vend, përndryshe edhe në të ardhmen do të ketë tentime të tilla të kërkesës të përgjegjësisë, edhe në mënyrë individuale, edhe në mënyrë të grupeve të caktuara.

Unë shpresoj që nuk do të ishte e dëmshme që nëse ne do të kërkonim komision hetimor parlamentar për një çështje që ne dyshojmë që po ndodh, por këtu po kërkohet ky komision hetimor për diçka që po e shohim se po ndodhë dhe këto janë dy gjëra të kundërta, andaj duhet të analizojmë mirë edhe atë çka e tha me qëllimin më të mirë, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, zoti Ali Sadriu, që të ketë bashkërendim të veprimeve, qofshin ato të komisioneve funksionale, qofshin ato të kërkesës së përgjegjësisë dhe raportimit dhe atëherë të vijmë te një konkluzion i përbashkët.

Si Kuvend i Republikës së Kosovës karshi një institucioni, i cili është themeluar nga vetë Kuvendi ynë. Faleminderit!

KRYESES: Gjithmonë po diskutojmë për një kërkesë. Kini kujdes, sepse ne e kemi pikë të rendit të ditës debatin. Atëherë, ruhuni se debati vjen për dy minuta. Fjalën e ka Alma Lama.

ALMA LAMA: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Por, meqë u hap debat, tash unë po i them ato mendimet e mia, duke qenë se jam edhe në Komisionin për Media dhe natyrisht që jam e lidhur edhe me media për shkak të profesionit.

Debati për Radiotelevizionin Publik është dashur të mbahet prej kohësh, madje edhe vetë komisioni hetimor është dashur të krijohet prej kohësh, sepse prej kohësh janë ngritur dy shqetësime të mëdha, që janë edhe dy problemet e mëdha të këtij televizioni të ashtuquajtur publik.

Së pari pavaresia editoriale dhe pëmbjatja e programacionit që është në shumicën e kohës propagandë dhe vini re kur them propagandë jam duke e përdorur një fjalë të parëndësishme. Është një fjalë shumë e rëndë, pasi propaganda është mjet i regjimeve diktatoriale.

Problem i dytë janë keqpërdorimet financiare për të cilat kolegët e mi do të flasin besoj edhe në debat dhe kanë folur edhe për mediat. RTK-ja financohet nga taksapaguesit, me një buxhet që ia ndan Kuvendi i Kosovës, ka status publik të televizionit publik, pra duhet t'i shërbejë publikut dhe të dyja këto janë komponente thelbësore që duhet ta bëjnë këtë televizion që i shërben interesit të publikut dhe të jetë transparent. RTK-ja normalisht duhet të japë llogari për çdo cent të shpenzuar dhe për mënyrën se si është shpenzuar.

Kjo do të thotë që RTK-ja do të duhej t'i raportonte me rregull në detaje Kuvendit të Kosovës si themelues i tij. Ajo çfarë ka ndodhur është se RTK-ja nuk i ka raportuar Kuvendit dhe, në anën tjetër, i ndihmuar edhe nga vetë deputetët që nuk e kanë kryer detyrën, ia kanë mundësuar Bordit dhe menagjmentit të sillet sipas qejfit me RTK-në.

Ne si komision e patëm një takim me Bordin e RTK-së para disa ditësh.

Takimi ishte skandaloz, ata nuk iu përgjijen asnjë pyetjejeje që ne drejtuam, pyetje thelbësore. Kjo falë edhe disa deputeteve që koketonin me ta. Jemi të informuar që menaxhuesit e RTK-së e kanë zhytur këtë media në borxhe prej miliona eurosh. Vetë ata nuk na kanë treguar në komision sa është borxhi i tyre. Këto borxhe kanë ndodhur për shkak se janë lidhur kontrata të paligjshme, të panevojshme me kompani të jashtme, janë punësuar me qindra njerëz pa nevojë. Më shumë se 900 veta sot punojnë në RTK, 300 nga të cilët janë futur vetëm dy vitet e fundit.

Në shumë raste, konkurset për punësime të reja janë shpallur vetëm formalisht, pasi personat që zgjidhen e fillojnë punën shumë kohë më parë. Ka me dhjetëra dëshmi që RTK-aj e ka shkelur Ligjin për financa publike, dhe kjo është arsyeja se pse ata nuk i sjellin raport Kuvendit. Këtu u fol se do të vijë më 31 mars, por ka nja 3 vjet që nuk vjen RTK-aj, ka bërë blerjen e produkteve të jashtme televizive pa e përfillur institucionin e tenderit.

RTK-ja prej disa vitesh ka krijuar më tepër shpenzime se sa të hyra. Do ta theksoj edhe një gjë, shumë me rëndësi që RTK-ja, në përgjithësi, menaxhuesit përpiqen ta përdorin si çadër është EBU-ja. Për sa u përket raporteve të IBIUS me RTK-në ka pasur një tendencë të qartë për ta përdorur EBU-në si mbështetës të këtyre politikave. Në Komisionin për Media në EBU edhe unë us kam shtruar pyetjen se a e monitoron EBU-ja punën e RTK-së, pra përmbajtjen programore dhe aspektin financiar, e përgjigjja e tyre ka qenë jo. Pra, ky institucion nuk e ka idenë se si performon RTK-ja, kështu që deklaratat e tyre nuk duhet të përdoren nga askush, pasi ata flasin thjesht në parime se si duhet të funksionojë një televizion publik, për themelimin e të cilit ata kanë kontribuar.

Unë mendoj që komisioni hetimor si tani, si pas debatit, është i nevojshëm të krijohet për të parë se çfarë ka ndodhur me paranë publike nga menaxhuesit e RTK-së. Mendoj se Bordi nuk e ka kryer punën e tij, është treguar plotësisht i paaftë dhe duhet të shkarkohet nga Kuvendi i Kosovës. E bashkë me Bordin e RTK-së duhet të shkojë edhe menaxhmenti.

Dëgjova këtu se çdo veprim që ndërmerret sot për RTK-në është presion mbi RTK-në. Në fakt, unë po shoh se RTK-ja po bën presion mbi Kuvendin dhe jam kundër çdo lloj manipulimi me opinionin publik.

Presion në fakt ka ndodhur pikërisht sot nga RTK-ja me largimin e dy punëtorëve të saj, që janë kryetari dhe zv/kryetari i Sindikatës. Ajo çfarë ka ndodhur me këtë largim është se është shkelur një e drejtë themelore, e garantuar me Kushtetutën e Kosovës nga menaxhmenti i RTK-së, që është e drejta për organizim sindikal. Ky është një veprim i paprecedent që dëshmon për gjendjen alarmante në RTK. Jua përkujtoj se ekziston një ligj që e mbron këtë të drejtë, e që është Ligji nr. 04/-L-011 për organizimin sindikal në Kosovë, kështu që kurdo që të krijohet komisioni, vota ime do të jetë për formimin e tij. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete! Deputeti Daut Haradinaj e ka fjalën. Gjithë jam duke e treguar kohën se po deklarohe mi për një propozim, gjithmonë secilit rend i kam thënë, por secili nuk po e merr vesh. Unë po ju them - jemi në fazën e deklarimit për një propozim. Kaq! Fjalën e ka Daut Haradinaj.

DAUT HARADINAJ: Faleminderit!

Po jua lexoj veç vendimin që sot e paska marrë drejtori i RTK-së dhe të kisha lutur kryesues, shpresoj që edhe opinioni publik ta kuptojë çfarë shkruan në pikën 1, kur ia ndalon gazetarit të marrë pjesë në objektet e RTK-së të punësuarit Arsim Halilaj, dhe më 26.3.2015 i shkëputet marrëdhënia e punës, përkatësisht i ndalohet hyrja në objektet e RTK-së për shkak se parqet rrezik potencial për shkaktimin e dëmit serioz ndaj RTK-së. Domethënë, kryetarit të Sindikatës së gazetarëve dhe nënkryetarit të Sindikatës së gazetarëve me një vendim të tillë u ndalohet sepse paraqesin rrezik potencial për ta dëmtuar imazhin e RTK-së dhe shihet hapur tendenca për ta dëmtuar. E di që nuk është debat, kryesues, dhe nuk dua as të ndalem në këtë temë, por po ju them edhe një herë që nuk duhet shqetësuar askush prej deputetëve në rast se krijohet komisioni hetimor, pasi kemi praktika në të kaluarën, siç tha kolegu nga LDK-ja, zoti Zemaj, e kemi bërë për AKP-në, kemi pasur për KEK-un. Asnjë gjë të keqe nuk ka në rast që ky komision hetues krijohet nga Parlamenti i Kosovës dhe e mbikëqyr një institucion, i themeluar nga Parlamenti i Kosovës.

Në rast se raporti i auditimit që vjen, ose raporti i RTK-së vjen me shkelje që disa herë nuk ka kaluar në këtë Kuvend dhe menaxhmenti i RTK-së e vazhdon punën ashtu sikur nuk ka ndodhur kurrëgjë. Ju kisha ftuar, kolegë deputetë, të gjitha këto çka janë në Parlament, askush prej tyre nuk ka nevojë për shqetësim, sepse nuk po i paragjykojmë. Edhe me Rregullore, iniciuesi i komisionit hetimor nuk e kryeson komisionin, do të thotë e merr një parti politike tjetër ta udhëheqë atë komision. Në rast se ne jemi të sigurt se aty nuk ka ndonjë dëm të caktuar, le t'i verifikojmë ato dokumente, le t'i shohim ato shkelje, le t'i heqim të gjitha ato dilema që po përfliten nëpër media, le ta sjellin raportin këtu në Kuvend me të gjeturat dhe në rast se është ok-ej. Është ok-ej në rast se jo të paktën t'i denoncojmë publikisht që organet e rendit ose ndjekësit të merren me ta. Kaq! Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Tash për Grupin Parlamentar “6+” është paraqitur për fjalë Qerim Bajrami.

ĆERIM BAJRAMI: Poštovani predsedavajući!

Poštovani poslanici,

Parlamentarna Grupa “6+” je u više navrata izrazila svoju zabrinutost vezano za emitiranje programa na Bosanskom, Turskom i Romskom jeziku na javnom servisu Radioteleviziju Kosova, dakle na Televiziji i na Radio. Ovom prilikom, ako se mi svi budemo dogovorili posle diskusije, dakle o problemima u Radioteleviziji Kosova i formiramo takvu istražnu komisiju ili ne formiramo, u svakom slučaju naš zahtjev će biti da pored svih ovih problema koji su izneti vezano za menadžiranje finansijskih sredstava, kadrovske politike, tehnike i tako dalje u Radioteleviziji Kosova, obavezno uđe u tim zaključcima, i naš zahtjev da ta komisija ili predsedništvo, dakle Skupština Kosova, koja je inače osnivač Radiotelevizije Kosova, uzme u razmatranje pod hitno ove naše zahteve da se proširi program na Bosanskom, Turskom i Romskom jeziku na Radioteleviziji Kosova na prvom kanalu, i da se pod hitno pokrene 15% predviđenih, dakle predviđenog emitiranja programa i na Radioteleviziji Kosova 2.

Kao što znamo, u međuvremenu je formiran taj kanal na Srpskom jeziku, nema nijednog procenta dakle svog programa na ovim drugim ne većinskim jezicima. Prema tome, gospodine predsedavajući, uskoro će ispred naše grupe, predsednik Skupštine dobiti zaseban zahtev da ovo

pitanje pod hitno postavi na Predsedništvo, i da se nađe institucionalno rešenje za ovo pitanje. Prema tome mi ćemo učestvovati u diskusiji, i nadamo se da će Skupština uzeti u obzir i ovu našu zabrinutost. Hvala!

KRYESUESI: E dëgjova edhe diskutuesin e fundit me interesim dhe me kujdes. Prapë nuk është në temë. Është krejt temë tjetër çfarë flet ky. Unë po ju thërras, tash do ta keni atë diskutim dhe flitni të gjitha.

Zotërinj deputetë, edhe një herë: këtu nuk janë 61 deputetë që të marrim vendim, atëherë meqë edhe tema është, po hyjmë ngadalë në temë, atëherë... Fjalën e kërkon Gëzim Kelmendi. Gëzim, do të hyjmë në debat, a e ke për propozimin si deputet që je i pavarur, a për çka? Për debat e merr fjalën, porsa të fillojë.

Regjia, Gëzim Kelmendit jepjani mikrofonin!

GËZIM KELMENDI: Fillimisht, kryesues, para se ta marrë fjalën, veç të lutem ma sqaroni një dilemë, a nuk po ju del aty në monitorin tuaj që nuk e kam shtypur sustën, apo kërkohet prej meje që unë ta ndërroj qasjen e diskutimit. Ma sqaro këtë çështje, a ju ka dalë emri im aty?

KRYESUESI: Jo, jo! Unë, përkundrazi, ku ta marr të kem qasje individuale, por mendimin thuaje lirisht.

GËZIM KELMENDI: Të lutem veç sqaroma këtë dilemë se edhe paradite e patëm këtë problem të njëjtin, a po del emri im në monitor? Mos është ndonjë gabim teknik?

KRYESUESI: Zotëri, kur flasin grupet parlamentare është situatë tjetër, këta shpeshherë edhe po harrojnë, po paraqiten vonë, tani thonë nuk na e dhe fjalën. Tjetër është diskutimi i individëve. Ty si individ, unë ta jap fjalën - fol, por është problemi i deklarimeve për një propozim të grupacioneve. Fjalën e ke, thuaj çfarë e ke ndërmend.

GËZIM KELMENDI: Faleminderit, kryesues!

Për sqarimin tuaj, nuk jam individ, por jam deputet i Kuvendit të Kosovës, e para. E dyta, unë u mundova...

KRYESUESI: Grupi është më i madh se deputetët për hesap timin...

GËZIM KELMENDI: Dhe e dyta, u mundova që i vetmi ta respektoj propozimin tuaj, por ndoshta ju humbi durimi. Unë po mundohem të kyçem në temë dhe po qëndroj në temë.

KRYESUESI: Fol, zotëri, fol!

GËZIM KELMENDI: Po, pra, ta marr fjalën, nuk është problem. Nuk po më lejon të flas. Në rregull krejt. Unë megjithatë po mundohem të jap kontribut, pikërisht për këtë kërkesë, për formimin e komisionit hetimor për Televizionin Publik të Kosovës, por unë paraprakisht dua ta jap një propozim, të ndërlidhur me përvojën e mandatit të kaluar. Përvoja me komisione hetimore nuk na ka kaluar mirë edhe në mandatin e kaluar, e veçanërisht kur kemi qenë një

dallim i ndjeshëm ndërmjet pozitës dhe opozitës, e lëre tash kur e kemi një dallim, një diskrepancë shumë të madhe ndërmjet pozitës dhe opozitës, prandaj mendoj se nuk kemi problem ne vetëm me Televizionin Publik të Kosovës, që ndoshta do të sqarohet tash në debat.

Ne kemi probleme shumë më të rënda. Unë mendoj që duhet fillimisht të sqarohet edhe puna e një komisioni hetimor për Kuvendin e Kosovës, ngase 2/3 e Kuvendit të Kosovës veprojnë konform kërkesave të Qeverisë të Kosovës, përjashtimisht disa deputetë dhe brenda pozitës, prandaj unë mendoj se nuk ka efekt ky komision për faktin se opozita është në numër diskrepancë shumë më të vogël se pozita. Kemi një dallim shumë të madh prej 2/3, e veçanërisht në një vend ku nuk ekziston një vullnet i tillë. Prandaj, le të mbetet të shtjellohet çështja e debatit të mëtutjeshëm.

KRYESUESI: Zoti deputet,

Unë edhe një herë me koncentrim të pafund ju dëgjova, por prapë ju arritët atje që doni të diskutoni kur ta kini materien dhe unë atë ju thashë prej fillimit. Tash më nuk kemi diskutues të tjerë, nuk kemi forum për të marrë vendim, sepse nuk janë 61 deputetë në sallë. Mendoj se ne duhet të vazhdojmë, sepse e kemi të njëjtën temë, kishte edhe ide që të bashkohen të dy temat, ka qenë ide edhe në Kryesi, por nuk ia kemi arritur. Mendoj se është mirë që të kalojmë në pikën për debat parlamentar për Radiotelevizionin e Kosovës dhe të flasim për të gjitha problemet, në mënyrë që në fund të kemi mundësinë të votojmë o rekomandime, o rreth komisionit hetimor.

A pajtoheni që të kalojmë në pikën e dhjetë të rendit të ditës, që ta vazhdojmë diskutimin për Radiotelevizionin e Kosovës?

Atëherë, nuk ka kuorum për të votuar. Ne e bëmë kështu edhe prej pikës tjetër, sepse nuk është hera e parë që kërkojmë kuorum.

10. Debat parlamentar për Radiotelevizionin e Kosovës

Deputetja Shqipe Pantina me 6 deputetë tjerë nënshkrues, nga Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje”, në bazë të nenit 15.8 të Rregullores të Kuvendit, ka kërkuar debat parlamentar lidhur me punën dhe funksionin e Radiotelevizionit të Kosovës. Fjalën e ka deputetja Shqipe Pantina, në cilësinë e propozuesit të çështjes.

SHQIPE PANTINA: Faleminderit, kryesues!

Unë veç dua të kërkoj nga menaxhmenti i RTK-së që pas vendimit arbitrar që e morën për t'i larguar dhe për ta shuar zërin sindikalist, të mos tentojnë ta shuajnë edhe zërin e deputetëve sot, duke mos transmetuar këtë debat, kështu që shpresoj se debati është duke u transmetuar dhe qytetarët do ta kuptojnë se çfarë po ndodh me institucionin e vetëm publik të informimit, i cili viteve të fundit ka shkuar drejtë degradimit deri në masën pothuaj se të shkatërrimit të tij.

Misioni kryesor i RTK-së është informimi i publikut, informimi i qytetarëve të Kosovës, ndër të tjera edhe për mënyrën e shpenzimit të parasë së tyre dhe marrjes së vendimeve që prekin drejtpërdrejt jetën e tyre. Por, RTK-ja ka dështuar ta bëjë atë fillimisht për vetë institucionin e vet.

Ky Kuvend ia ka miratuar RTK-së buxhetin prej 9 milion e 768 mijë e 500 euro, e që është 1 milion e 37.135 euro më shumë se vetë buxheti i Kuvendit. Pra, RTK-ja ka shumë më shumë se 1 milion buxhet se vetë ky Kuvend vetëm nga paratë e buxhetit të Kosovës, pa përfshirë këtu të hyrat që ata krijojnë nga marketingu dhe për mënyrën se si do t'i shpenzojnë këto para asnjëherë nuk ka sjellë një plan buxhetor, siç përcaktohet me nenin 21 të Ligjit për RTK, e i cili e obligon Bordin që ta miratojë buxhetin deri më 30 tetor të vitit paraprak, para se ta sjellë atë për miratim. Këtë e përmendi edhe zoti Sadriu në fjalën e tij.

Për më tepër, Bordi dhe menaxhmenti i RTK-së ka dështuar ta njoftojë Komisionin për Media dhe nuk e ka prezantuar buxhetin as në takimin e mbajtur me komisionin, e as nuk i ka dërguar përgjigjet me shkrim, ashtu siç i kemi kërkuar. Ne as sot nuk e dimë se sa është buxheti total i RTK-së, pa përfshirë të hyrat që krijojnë nga reklamat dhe si i harxhon RTK-ja këto para. Sa nga këto para shpenzohen për paga dhe mëditje, sa për mallra dhe shpenzime, sa për investimet kapitale, apo për subvencione? Ajo që dimë në fakt është rroga e drejtorit të përgjithshëm të RTK-së, e cila, sipas formularit të deklarimit të pasurisë në Agjencinë Kundër Korrupsion duket të jetë më e madhe se rroga e kryeministrit. Bile, edhe numri i këshilltarëve që ka drejtori i RTK-së është më i madh se numri i këshilltarëve të kryeministrit, ndonëse për këtë nuk ka asnjë të dhënë zyrtare, pasi asnjë nga vendimet e Bordit nuk janë bërë publike, edhe pse kjo kërkohet me nenin 38 të Ligjit për RTK-në, i cili e definon se veprimtaria e RTK-së është publike.

Po ashtu, edhe pas kërkesës sime si anëtare e komisionit, te i cili raporton RTK-ja, ne nuk kemi parë as edhe një vendim të Bordit. Ne nuk e dimë as sot se si ka vendosur Bordi për zgjedhjen e drejtorit të përgjithshëm, e për të cilin ka pretendime se është bërë jashtëligjshëm, ngase nuk ka pasur kuorum për marrjen e një vendimi të tillë.

Më tej, neni 30, pika 9, e obligon Bordin që të raportojë çdo tre muaj në komision, por qysh nga themelimi i Komisionit për Media në këtë legjislaturë, RTK-ja nuk e ka dorëzuar asnjë raport tremujor me shkrim. Edhe më keq akoma, raporti i fundit vjetor i publikuar i RTK-së, siç u tha edhe më herët, është bërë në vitin 2010. Arsyeimi i tyre se raportet nuk janë bërë publike, sepse ato nuk janë miratuar nga Kuvendi, vetëm sa shpërshtaq edhe më tej problemin tejet të madh të këtij institucioni, e as që bëhet fjalë për organizimin e debatit për raportin e menaxhmentit, ose mendimin e Bordit, siç e përcakton neni 38, pika 4 e ligjit. Dhe, jo vetëm kaq, por as statusi i RTK-së, dokumenti themelor i punës së RTK-së, nuk mund të gjendet në ueb-faqen e tyre. Dhe, si është e mundur që askush nuk ka dhënë përgjegjësi për gjithë këto shkelje ligjore?!

Fakti se askush deri më sot nuk është thirrur në përgjegjësi për këto dështime të drejtuesve të RTK-së, si duket vetëm sa i ka inkurajuar që të vazhdojnë me shkeljet e ligjit dhe lista e shkeljeve të ligjit nga ky institucion vazhdon, dhe ja disa shembuj: Menaxhmenti i RTK-së është dashur që menjëherë pas hyrjes në fuqi të Ligjit për RTK-në, siç përcaktohet në nenin 21, pika 5, t'i fillojë përgatitjet për zbatimin e mekanizmit për mbledhjen e parapagimit dhe t'i propozojë për shqyrtim të brendshëm dhe aprovim Bordit të RTK-së, por edhe pas më shumë se 3 vjetëve RTK-ja ka dështuar ta gjejë një mekanizëm për mbledhjen e parapagimit.

Neni 12 i Ligjit të RTK-së i lejon RTK-së që të angazhojë produksione të pavarura për ta mbuluar skemën programore dhe kjo duket të jetë një hapësirë, të cilën drejtuesit e RTK-së e kanë shfrytëzuar për të manipuluar me buxhetin e RTK-së për pasurimin e tyre personal.

Si anëtare e komisionit kam tentuar të mësoj se cilat janë emisionet që realizohen nga produksionet e jashtme për të cilat RTK paguan dhe sa është shuma që paguan për secilin emision dhe as edhe një informatë e vetme nuk i është ofruar komisionit. Në mungesë të informatave zyrtare që do të duhej të bëheshin publike nga vetë drejtuesit e RTK-së, mua më mbetet t'u besoj atyre që shkruajnë mediumet e tjera për RTK-në, e që janë: për emisionin e ashtuquajtur "Super-sfida", e që është një emision jo vetëm pa ndonjë vlerë edukative artistike, por në fakt ai e fyen edhe inteligjencën e shikuesve, RTK-ja ka paguar diku rreth 280 mijë euro, e që është 20 mijë euro më shumë se sa buxheti për kardiokirurgji, të ndarë nga Ministria e Shëndetësisë.

Vetëm për një episod të një seriali, të cilat janë komplet degraduese dhe pa etikë, e shpesh edhe me gjuhë fyese, RTK-ja paguan më shumë se 5 000 euro, po aq sa Ministria e Kulturës ka ndarë për një festival të tërë filmi.

Për ndriçimin e një emisioni të RTK-së paguhen rreth 70 000 euro në vit, përderisa blerja e pajisjeve për ndriçim do të kushtonte dy herë më lirë se sa kjo shumë. Ngjashëm ndodh edhe me pajisjet tjera për të cilat RTK-ja paguan çmime të majme, e të cilat nuk dihen në xhepat e kujt përfundojnë, pa e përmendur këtu fatin se këto ashtuquajtura emisione jepen në kohën më të shikuar të RTK-së dhe RTK-ja ka shkuar në atë pikë sa ka guxuar t'i largojë nga transmetimi lajmet e orës 23:00 për ta transmetuar një emision i ashtuquajtur "Sonte", e për të cilin fakt unë nuk kam asnjë shpjegim, por ju ftoj që ta shikoni nëse mund ta shihni atë deri në fund.

Dhe, për të gjitha këto, nuk dihet kush dhe si ka vendosur, mbi çfarë baze ligjore dhe sa para paguhen. A janë ndjekur procedurat e tenderimit siç parashihen me ligj? Kush ka qenë komisioni përzgjedhës? Cilat janë vlerat edukative që RTK-ja synon t'i përçojë nëpërmjet tyre emisioneve? Cili është roli i Bordit në gjithë këtë proces?

Keqpërdorimet e drejtuesve të RTK-së nuk mbarojnë me kaq. Punësimet pa konkurse dhe pa asnjë kriter profesional tashmë janë fenomen i njohur, nga i cili, përveç familjarëve e miqve të drejtuesve të RTK-së, kanë përfituar edhe familjarë e zyrtarë politikë, dhe RTK-ja, përveçse pa mëshirë i ka shpenzuar paratë nga buxheti tejet i varfër i Kosovës, drejtuesit e saj e kanë futur këtë institucion edhe në borxhe.

Me gjithë insistimin tim si anëtare e Komisionit për Media të mësoj shumë e saktë të borxheve dhe si ka ardhur deri te këto borxhe, nga drejtuesit e RTK-së nuk është dhënë një shpjegim. Vlera e borxhit pretendohet të jetë diku ndërmjet 3-5 milionë euro, kjo nga deklaratimet që ata kanë dhënë nëpër media.

Në fakt, lista e shkeljeve ligjore dhe e dyshimeve për keqmenaxhim e korrupsion nga drejtuesit e RTK-së është me të vërtetë e gjatë, dhe për t'i zbardhur këto dyshime duhet të bëhet një dehetim i detajuar dhe përgjegjësit të sillen edhe para përgjegjësisë penale.

Prandaj, unë i bëj thirrje Kuvendit, si themelues i RTK-së, të merret seriozisht me këtë institucion. Drejtuesit e RTK-së, që e kanë sjellë këtë institucion në këtë nivel të degradimit, të thirren në përgjegjësi dhe ndaj tyre të merren masa për ta shpëtuar këtë institucion nga shkatërrimi i tij.

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të propozuesit foli deputetja Shqipe Pantina. Edhe pse konsiderohet që ju i dini rregullat, po detyrohem t'ju përsëris - janë rregullat e funksionimit në bazë të Rregullores së Kuvendit. Së pari deklarohen grupet parlamentare, mandej deputetët. Unë e di që sekush është i rëndësishëm për vetvete, por tjetër është përfaqësimi i grupeve të individëve. Pra, më së pari grupet, pastaj deputetët e veçantë, qofshin të grupeve, qofshin pa grup, ky do të jetë rregulli.

Nën 2, meqë ka grupe të ndryshme, ka grupe që paraqiten më shumë deputetë, pastaj mos u hidhëroni që dikush flasin dy-tre më shumë, se aq janë.

Për të qenë korrekt deri në fund, e ju nëse mundeni, mbani mend, unë po ju regjistroj, po jap kohën, është ora 17:00 dhe shihni. Deri tash janë paraqitur këta deputetë: Lirije Kajtazi, Ali Sadriu, Sadri Ferati, Sali Morina, Adem Salihaj, Duda Balje, Blerta Deliu-Kodra, Time Kadrijaj, Xhevaire Izmaqu, Pal Lekaj, Qerim Bajrami, Shukrije Bytyqi, Emilija Rexhepi, Nenad Rashiq, Mytaher Haskuka, Teuta Haxhiu, Myfera Serbica-Shinik, Zenun Pajaziti dhe i fundit Ismail Kurteshi.

Pra, këta jeni deri tash. Nuk do ta merrni rend në këtë formë fjalën, për shkak se më së pari varet kush janë grupet, mbasandaj edhe të tjerët i kombinojmë nga pak, prej një partie në tjetrën. Dhe, më s'do t'i shpjegoj këto çështje.

Kush e ka fjalën në emër të PDK-së lidhur me pikën e rendit të ditës? Deputeti Zenun Pajaziti. Urdhëro.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Më duhet vetëm me një fjali të përsëris që Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike i mbështet të gjitha angazhimet që kanë të bëjnë me mbikëqyrjen parlamentare, me hetimet parlamentare dhe të gjitha angazhimet tona, për sa u përket kompetencave që i kemi me ligj e që kanë të bëjnë rreth institucioneve të pavarura dhe të gjitha institucioneve që ne i mbikëqyrim.

Këtu u përmend disa herë Komisioni. Po ju them, që unë jam edhe kryetar i Komisionit që mbulon këtë fushë. Është e vërtetë, që kemi pasur në agjendë disa aktivitete edhe për sa i përket RTK-së. Kemi pasur një takim të veçantë edhe me Bordin. Pastaj, me një iniciativë timen kemi pasur edhe një takim me EBU, me përfaqësuesit e tyre. Kam dashur ta konsumoj, si kryetar i Komisionit, në maksimum, kohën e cila ka të bëjë me përgjegjësitë e Kuvendit për trajtimin e ligjit, për rishikimin e ligjit dhe sidomos, në pikën që ka të bëjë me gjetjen e mundësive të financimit të RTK-së dhe kjo është përgjegjësi e jona.

Deputetët kanë pasur mundësi të bollshme në Komision, për t'i bërë pyetje pavarësisht përgjigjeve që i kanë pasur, nuk i kanë marrë nga ana e bordit, mendoj që mundësitë e tilla janë konsumuar. Nuk di pse, nuk është konsumuar kjo e drejtë e njëjtë nga anëtarët e Komisionit, që të kërkojnë edhe një debat të brendshëm brenda në Komision, të kërkojnë edhe aktivitete shtesë të Komisionit, për t'i trajtuar çështjet që sot debatohen këtu në seancë, po, është marrë një vendim i tillë i Kryesisë dhe ne duhet ta mbështesim. Tash jemi në një debat parlamentar para një kohe shumë të shkurtër, kur do ta kemi një debat të njëjtë, të ngjashëm, por atëherë pasi që ne si

Komision ta kemi trajtuar një raport të rregullt. Po besoj, që do ta kemi në dorë një raport edhe nga institucionet tjera relevante, raporte të munguara deri më tash.

Është e pafalshme për përgjegjësitë tona si deputetë të këtij Parlamenti, nëse nuk i trajtojmë të gjitha informacionet që kanë të bëjnë me funksionimin e këtij institucioni. Këtu u përmend edhe deri më tash, e kemi një raport të paaprovuar, ose të mohuar nga ky Kuvend, e kemi një raport tjetër të radhës, i cili ka mbetur në sirtarët e zyrave të këtij institucioni, për shkak të përfundimit të mandatit të kaluar dhe, tash e kemi kohën e rregullt për raportimin e Televizionit të Kosovës.

Nuk duhet të harrojmë po ashtu, që pas një debati i cili nuk ka qenë i largët, në këtë Kuvend për Radiotelevizionin e Kosovës, menjëherë pas këtij debati kemi pasur edhe një letër nga EBU. Këtu u tha që EBU nuk merret me çështjet e menaxhimit të brendshëm e financave.

Është e vërtetë, po EBU është institucioni evropian që përfaqëson transmetuesit publik të shteteve të Evropës dhe, është mirë që RTK tashmë është nën këtë ombrellë të EBU-së, pavarësisht që nuk është ende anëtar. Edhe me ftesën tonë, me kërkesën tonë, kemi pasur edhe një prezencë të tyre këtu. Besoj që ata do të jenë më të involvuar të na ndihmojnë, sidomos për gjetjen e mënyrës së financimit të Televizionit Publik.

Nuk dëshiroj që, aq më tepër në emër të grupit, të merremi me çështje të menaxhimit financiar. Është krejtësisht e padrejtë, ne para se me pas raporte valide edhe të Televizionit po edhe të pavarura të Auditorit Gjeneral, të Auditorit të Jashtëm, që me sa kam unë informata, është në përfundim, ose është i përfunduar. Dhe, nuk do të ishte mirë të flisnim vetëm për ne, nuk duhet t'i bëhemi këtu avokat i asnjërit prej grupeve të brendshme, ose gazetarëve, ose redaktorëve, ose drejtorëve. Ne na i përcakton sakt ligji përgjegjësitë tona, për ta mbikëqyrë punën e Radiotelevizionit të Kosovës dhe ne kemi zgjedhur njerëzit këtu në këtë Kuvend, është Bordi i Radiotelevizionit. Ne mund të flasim edhe për performansën e tyre, këtu në këtë Kuvend. Ata kanë përgjegjësinë e plotë që të merren me menaxhimin, menaxhmentin edhe për sa u përket kompetencave, po ashtu që ua ka dhënë ligji atyre.

Më lejoni, t'ju them që nuk është krejt mirë të flitet për këtë institucion dhe të mos, ajo që ne më së shumti na intereson, është folur për censurën, për politizimin, e tjerë, e tjerë... e përmenda letra e EBU-së konsiston kryesisht ajo letra pas atij debati, përmend presionin, ndërhyrjen, politizimin në Radiotelevizionin e Kosovës. Nuk dëshiroj të paragjykoj tash letrat e ardhshme ose EBU-në. Unë mendoj që duhet të jemi pa dallime politike në këtë Kuvend, të përgjegjshëm dhe ne duhet t'i bëjmë avokatinë më të mirë Televizionit Publik të Kosovës dhe, këtë na e lejon ligji. Mendoj ka shumë hapësirë për t'u bërë...

Të mos harrojmë edhe diçka, që krahasuar me nivelin e vendeve të regjionit, Televizioni i Kosovës, megjithatë nuk është nën hijen e televizioneve të tjera private, pra është shumë konkurrues në tregun medial. Unë mora edhe statistika nga një kompani që ka matur televizionet, pas Qeverisë, zgjedhjes së kësaj Qeverie deri nja dy-tri javët e fundit dhe, ka statistika që janë krahasuese me televizionet tjera dhe mendoj që Televizioni i Kosovës është kryesisht në nivelin e ngjashëm ose të përafërt me...

T'ju them vetëm disa statistika, besoj që e keni durimin, Radiotelevizioni 21, nëse doni për subjektet qeveritare, është kryeministri, përmendet për këtë periudhë, 193 herë, ministri i Jashtëm, 14 jashtëm, presidenti 52 herë, kryetari i Kuvendit, 13 herë, e kështu me radhë.

Sipas partive: PDK-ja, 89 herë... LDK 63 herë, AAK 43 herë, “Vetëvendosje” 83 herë.

Le të vazhdojmë me...

(Debat në sallë)

... do t'jua jap adresën, e shikoni vetë në internet, i keni të publikuara.

Te Televizioni i Kosovës RTK e keni, të ngjashme janë me institucionet, ju duket pak, por mendoj që duheni t'i përdorni shifrat. Partitë politike: PDK 28 herë, LDK 39 herë, AAK 43 herë, “Vetëvendosje” 50 herë, e kështu me radhë.

Më lejoni, të nderuar deputetë, t'ju them që ne këtu duhet të inkurajojmë, për sa i përket anës financiare, Komisionin për Mbikëqyrjen e Financave Publike, i cili me përgjegjësi të plotë, duhet ta trajtojë çdo informatë që merr edhe nga raporti i Radiotelevizionit, por edhe informata të tjera të institucioneve tjera të pavarura.

Po ashtu, ne duhet të inkurajojmë edhe institucionet tjera të sundimit të ligjit, që t'i trajtojnë të gjitha informatat që sot po bëhen publikisht këtu, ose që mund të bëhen. Nëse përmendet, se ka shkelje jo vetëm shkelje, keqpërdorime, madje përmenden edhe fondet milionëshe, e tjerë.

Ju e dini, që me Kodin Penal ato janë vepra penale. Do të ishte, po ashtu vepër penale edhe fshehja e mundshme e këtyre aktiviteteve, ose e këtyre informatave, që mund t'i keni ju si deputetë, ose të tjerët. Pra, duhet t'i inkurajojmë të gjithë ata që kanë informata të tilla, t'i deponojnë në institucionet e sundimit të ligjit, do të na bënin shumë mirë edhe neve të na sqaronin se çka po ndodh në atë institucion.

Informata që ju dhashë nga një institucion krejtësisht i pavarur, për prezencën e subjekteve, janë vetëm për ta bërë dallimin se çka prezantojnë televizionet dhe çka bëjnë në programet e tyre dhe, në anën tjetër, menaxhimi financiar dhe menaxhimi i brendshëm i tyre.

Ne e kemi edhe një avantazh në krejt këtë situatë të krijuar, se sivjet u skadon disa anëtarëve, ose shumicës së anëtarëve të Bordit, mandati. Mendoj që është mënyra më e mirë, që të gjithë që jemi këtu të përqendrohemi që të ketë kualitet sa më të mirë.

(Ndërprerje e incizimit)

KRYESUESI: Në emër të Grupit, fjalën e ka Zenun Pajaziti.

ZENUN PAJAZITI: E konsumoj të drejtën e kolegëve të mi deputetë... pra e kemi kohën e debatit parlamentar, do ta keni kohën e mjaftueshme të gjithë, që do të flisni.

Mendoj që një freskim i Bordit, ose në fakt do të ndodhë një regjenerim i Bordit, do ta ndihmojë shumë Televizionin e Kosovës, që t'i tejkalojë vështirësitë që i ka, problemet, pengesat, dobësitë, të gjitha ato që ne mund të konsiderojmë që janë gjetje në këtë. Po ashtu, është dhe procesi i digjitalizimit. Ju e dini, që ka edhe një afat nga Komisioni i Pavarur i Mediave, që të menaxhojë procesin e digjitalizimit. Mendoj që Televizioni i Kosovës duhet të kyçet ose duhet t'u japi mundësinë, ata duhet të kenë kapacitete që të marrin pjesë në këtë proces.

Një çështje krejtësisht tjetër, që si Kuvend i Kosovës duhet ta kemi parasysh, është edhe prona e Radiotelevizionit të Kosovës. Ju e dini që, Televizioni i Kosovës ka probleme serioze me pronën. Mendoj që ne shumë shpejt duhet të bëjmë zgjidhjet, ose duhet të ndihmojmë, ose duhet të merremi e të marrim vendime rreth pronës së Radiotelevizionit të Kosovës.

Edhe njëherë, i ftoj të gjithë deputetët, që po ashtu të kenë qasje sa më reale, për sa i përket Radiotelevizionit të Kosovës. Ftoj institucionet tjera, që sa më shpejt të na i sjellin raportet dhe vetë Televizionin e Kosovës, të na i sjell raportet e rregulla dhe, po ashtu e ftoj Kuvendin e Kosovës që të merret në plan të parë me gjetjen e mënyrës, se si do ta financojmë Radiotelevizionin e Kosovës.

Më lejoni krejt për në fund, t'ju them, që po ashtu është një kërkesë edhe nga Komisioni Evropian. Unë kam marrë pjesë në debatin e fundit për mekanizmin përcjellës për asocim-stabilizim dhe është kërkuar decidivisht, që Kuvendi sa më shpejt të gjejë mundësinë e financimit, ose mënyrën e financimit.

Nëse ne do të vonohemi pas muajit të ardhshëm, që të mos gjejmë një zgjidhje për financimin e Televizionit të Kosovës, kjo do të konsiderohet pastaj nga institucionet e BE-së edhe si presion i politikës, pavarësisht edhe institucioneve të Kosovës ndaj Televizionit, në rast se ata do të mbeten pa buxhet.

Deri më tash ne nuk kemi ndonjë vizion, si Kuvend i Kosovës i kemi tri propozime të Kuvendit të Kosovës, të vetë Televizionit dhe besoj, se ne do të gjejmë mënyrën më të mirë për gjetjen e zgjidhjes për financimin e Televizionit të Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: I dhamë pak kohë zotit Pajaziti, sepse foli edhe në emër të Grupit të vet dhe të Komisionit. Kush flet në emër të LDK-së? Deputeti Sadri Ferati. Sadri, deri në 10 minuta maksimalisht, por edhe më poshtë mundet.

SADRI FERATI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar kolegë,

Vazhdimisht e sidomos këtyre dy mandateve të fundit, që jam edhe dëshmitar i drejtpërdrejt, Grupi Parlamentar i LDK-së ka adresuar shumë shqetësime, që lidhen me punën e RTK-së.

Edhe pse, ne tani jemi në pritje të raportit vjetor të RTK-së, për t'u siguruar se a janë adresuar shqetësimet tona të ngritura më parë dhe për të parë arritjen e progresit dhe ngritjen e performansës së RTK-së, mendoj se nuk i bën keq edhe ky debat dhe është një rast i mirë që ne t'i kontribuojmë kësaj teme në debatin e sotshëm.

LDK është e përkushtuar ta ndihmojë RTK-n në përmbushjen e misionit të saj për një medium të fuqishëm në interes të publikut, për një RTK të pavarur, me një staf profesional dhe infrastrukturë moderne. Presim që shumë shpejt të kemi një RTK të digjitalizuar. Jemi të përkushtuar që të zgjidhet problemi i financimit të RTK-së, po ashtu edhe i pronës së RTK-së.

Pra, dëshmojmë se sa shumë e duam RTK-n dhe sa të përkushtuar jemi për një RTK të avancuar. Por, po kaq jemi të brengosur me shqetësimet që edhe këto ditë ngritën në raport në mënyrën e funksionimit të RTK-së, punën e menaxhmentit dhe Bordit të RTK-së. Shikoni se çka shkruan në Raportin e Progresit, deklaratat e Avokatit të Popullit që lidhet me lirinë e mediave dhe, unë edhe me këtë rast këtu, edhe pse nuk jam i njoftuar në detaje, po shpreh keqardhjen time për informacionet në raport me largimin nga puna të kryetarit dhe nënkryetarit të Sindikatës dhe pyes, çfarë rastësie është kjo, ku bash sot kur ne po diskutojmë për shqetësimet që ata i kanë adresuar, ata largohen nga puna. Dhe, nuk e di se si nuk paska mundur të presë kjo punë edhe për ndonjë ditë, edhe po që se ka pasur argumente, apo, është rastësi!

Reagimi i të punësuarve nëpërmes Sindikatës, që ngre zërin dhe është shumë kritik për trajtimin e tyre, mundësinë e një pune profesionale, avancimin, kushtet e punës, e tjera...

Flitet shumë për mënyrën e rekrutimit, gjegjësisht punësimit me preferenca, nepotizëm, duke mos respektuar procedura ligjore. Po ashtu, me shumë kritikë flitet për pavarësimin editorial të RTK-së. Ne jemi shumë të përkushtuar, që ta respektojmë pavarësinë e RTK-së, por njëkohësisht kemi të drejtë t'i ngremë disa pyetje. Sa janë borxhet momentale të RTK-së, si lindën këto borxhe të RTK-së, pse gjatë këtyre vjetëve, pra, të një RTK-je në borxhe, rritet numri i të punësuarve?

Unë mendoj se Greqia do ta kishte lakmi, se si zgjidhet kriza duke rritur numrin e të punësuarve, diçka që s'është dëgjuar deri më tash.

Sa është i madh dhe i pajustificueshëm numri i të punësuarve me detyra specifike, apo siç quhen në gjuhën popullore, kontratë mbi vepër, që ne e kemi sanksionuar që sa vite, që nuk lejohen këto lloj punësimesh. Po ashtu, janë ngre shumë shqetësime për shkeljen e procedurave gjatë blerjeve dhe shumë dyshime dhe dilema për kualitetin e këtyre blerjeve dhe sidomos, për emisionet e jashtme, po edhe për mallra dhe shërbime.

Dhe, ne me të drejtë shtrojmë pyetje, a është kjo mënyra më e mirë e zvogëlimit të borxhit të RTK-së dhe stabilizimi i RTK-së, për të mundur ta marrë të mbarën dhe për të tejkaluar situatën e vështirë, për të cilën edhe vetë punëtorët e RTK-së pajtohen.

Po ashtu, thuhet se drejtori ka dy zëvendës drejtorë që i parashkruan ligji, po i ka edhe dhjetë këshilltarë, që paguhet mirë e disa prej tyre s'i sheh kurrë, t'ua kesh lakmi.

Si menaxhohet paraja publike në RTK, sa janë adresuar dhe sa janë tejkaluar vërejtjet e Auditorit gjatë kontrolleve të kaluara? Dhe, pas gjithë këtyre dilemave, ne ndodhemi në një udhëkryq. Por, për një punë, për një çështje jam i sigurt, se ne duhet të shkojmë përtej këtij udhëkryqi dhe përtej këtyre dilemave dhe edhe për një çështje tjetër, jam më se i sigurt, se Kosova ka dështuar në krijimin e institucioneve të pavarura.

Ky Kuvend, pjesë e të cilit jam edhe unë, ka dështuar që t'i mbikëqyrë institucionet e pavarura, të hetojë dhe të veprojë aty ku janë parë dobësi dhe lëshime konform ligjit, i cili obligon këtë Kuvend për të vepruar.

Prandaj, unë mendoj që ne duhet sot t'i përkrahim rekomandimet, për të cilat do të flas më vonë dhe, në rast se argumentohen të gjitha apo një pjesë e këtyre, që thuhet, shqetësimeve që janë ngritur, atëherë Kuvendi duhet urgjentisht të marrë masa, pra të veprojë konform obligimeve, që përcaktohet me ligj dhe nuk kisha pasur dëshirë, që asnjëherë në të ardhmen këtij Kuvendi të mos i ndodh që të mos votohet një raport pune dhe të sillet sikur s'po ndodhë kurrgjë, si u votua, si s'u votua, si pat performansë, si s'pati performansë edhe diqysh sikur me qenë një mall i huaj që erdhi këtu, u duk pak, shkoi dhe, hajde ne vazhdojmë më tutje.

Nuk guxon ky Kuvend të sillet asisoj, por, duhet nëse ka nevojë të plotësohet Rregullorja e punës dhe aktet rregullative, por duhet të dihet se ne jemi përgjegjës, sepse ne jemi themelues. Pastaj, ne jemi ata të cilët kemi votuar ata njerëz, po të cilët ne i monitorojmë dhe në rast se, kemi dobësi, të meta, keqmenaxhim, është përgjegjësia jonë që të veprojmë, ose t'ia falim dikujt, ose t'ia sheshim dikujt ato prona, por jo kështu, para syve tanë të lejojmë e të degradohen më tutje.

Prandaj, unë edhe pse u befasova, prita nga përfaqësuesja e inicimit të debatit që do të kthehet në dokumentin që na e ka prezantuar dhe do t'i elaborojë argumentimet e argumentit, ne e dëgjuam një debat, respekt, por mendoj se nuk ishte dashur as të lejohet as nga kryesuesi, që të zhvillohet debati, ndërsa të mos arsyetohet vetë inicimi dhe rekomandimet.

Por, unë tani po i kthehem vetë rekomandimeve. Mendoj se pika e parë e rekomandimit, që flet për autorizimin e Auditorit të Përgjithshëm dhe pika 3, që flet për themelimin e grupit, pra parlamentar hetues, është një dublifikim i dy mekanizmave dhe unë mendoj, se derisa ne kemi mundësi që të autorizojmë një auditor e që është profesional dhe merret me mend, që edhe politikisht është neutral, atëherë duhet ta favorizojmë atë mekanizëm, që të na sjell vlerësimet e tij dhe ne të veprojmë.

Në rast se neve, në të ardhmen shumë shpejtë, na mungon një raport i tillë i auditorit, unë plotësisht pajtohem që Kuvendi duhet ta bëjë detyrën e vet. Por, tash për tash nuk ka nevojë, sepse edhe janë afatet ligjore, që mund të prolongohet, pastaj përkatësia e ndryshme partiake, por në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, duke synuar të njëjtat efekte, të njëjtat qëllime, sikurse edhe iniciuesi i debatit, por edhe sikur iniciuesit e krijimit, pra Grupi Parlamentar i Aleancës, i themelimit të grupit hetues, propozojmë këto konkluzione.

Pra, në bazë të asaj që u tha dhe me qëllim të adresimit të diskutimeve të këtij debati, propozojmë këto rekomandime, si në vijim:

Pra, është i njëjti, vetëm se fjala "autorizohet" është zëvendësuar me fjalën "rekomandohet", se është më adekuate. I njëjti rekomandim, sikur të iniciuesi, pra:

1. Rekomandohet një auditim i përgjithshëm i pasqyrave financiare dhe performansës së RTK-së në një afat sa më shpejt të mundshëm.

2. Kuvendi së bashku me shqyrtimin e raportit vjetor, kuptohet pas punës së tri komisioneve të parapara, të shqyrtojë edhe raportin e auditorit, po këtë raport që ne po e porosisim dhe, të propozojë rekomandime, me qëllim që të krijohen parakushtet për stabilizimin dhe zhvillimin e RTK-së, për të përmbushur misionin e saj në interes të qytetarëve të Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Në emër të Grupit “Vetëvendosje” kush do të flasë? Shkojmë tutje. Në emër të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, zoti Pal Lekaj.

PAL LEKAJ: I nderuar nënkryetar,

Deputetë,

Zonja dhe zotërinj,

Sa i përket debatit të sotëm, mund të them lirshëm, që ky debat duhet të sjellë rekomandime, duhet të sjellë një kontribut në favor të një zhvillimi çfarë të kërkojë qytetari dhe ky medium.

Është e vërtetë që nga gjithë parafolësit u tha se ka keqmenaxhim, ka keqtrajtim të gazetarëve, ka punësim, ka familjarizim dhe ajo që nuk duhet të pajtohem dhe duhet të zhveshim nga petku partiak është sot vendimi i marrur nga Bordi i drejtorëve të RTK-së, që të shkarkohen kryetari i Sindikatës dhe nënkryetari.

Janë bërë luftëra të tëra nëpër vite, që fjala e lirë, fjala që shkon dhe e përçon qytetarin, të ketë shprehje të lirë çdo gazetar dhe, ne sot e kemi marrë një shembull më të keq nga Bordi i RTK-së që ta mbyllë fjalën e lirë. Dhe, ju pyes juve, deputetë të nderuar, si do të vendosnit sot? A nuk është koha për të shkarkuar Bordin, vetëm me këtë veprim që e kanë marrë?

Ju, nëse nisemi nga ajo që të gjithë parafolësit e thanë, që auditimi ka ardhur për çdo vit fiskal këtu dhe, ma thoni, cilin veprim e ka marrë ky Kuvend, këta deputetë, që ka marrë masa ndëshkuese ndaj performancës negative të gjitha bordeve të ndërmarrjeve publike. Ma thoni një shembull, që ky Parlament ka pasur vendime ndëshkuese për keqmenaxhim, që kanë bërë bordet, nuk ka ndodhur kjo.

Prandaj, nuk e di pse hezitoni që të krijohet një Komision hetimor? Kujt i pengon? Do të më pengonte mua, nëse unë i kam duart në RTK dhe kam bërë shpëlarje të parasë publike. Nëse unë kam vjedhur paranë e qytetarëve në këtë bord dhe kjo do të më pengonte dhe do të isha munduar që të pengoj çdo komision hetimor.

Prandaj, deputetë të nderuar, ju kisha lutur që ne së paku të kjo ndërmarrje, që është një pasqyrë e mediumit publik, të zhvishemi prej petkut partiak dhe të mendojmë, që të fillojmë me plotësim-ndryshim të ligjit, që të kemi trupa monitoruese, meqë Kuvendi është themelues dhe, të kemi një mbikëqyrje të drejtpërdrejtë të Bordit të RTK-së.

Ajo që më duhet ta them është nëse keqpërdoren miliona, a nuk është kjo në përgjegjësinë e Kuvendit si themelues, që të monitorojë dhe të ndërmarrë masa? Nëse ka nepotizëm, a nuk është kompetencë e Kuvendit si themelues, që të marrë masa? Dhe, a jo që ne duhet të punojmë së bashku, është që të kemi një medium publik, profesionalist, që të kemi një medium, që menaxhon mirë dhe, mbi të gjitha, paranë e qytetarëve.

Vetëm po ua jap një shembull, janë 14 emisione që pa prokurim publik është bërë kontrata. A nuk është ky keqmenaxhim? A nuk është ky keqtrajtim i parasë publike? Dhe, çka duhet të ndodhë tjetër, derisa kur shkel ligjin?

Prandaj, nëse nisemi nga të gjitha këto keqmenaxhime, nëse nisemi nga ky jo profesionalizëm i drejtorit gjeneral dhe Bordit, atëherë ju kisha lutur që nga ky debat të mendoni më arsyeshëm dhe të formohet Komisioni hetimor, që do t'i trajtojë jo në mënyrë politike, jo për individë të caktuar, por për një të ardhme më të mirë, për një financim më të qëndrueshëm të RTK-së dhe për një profesionalizëm që shkon në favor të informimit të qytetarëve të Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Lekaj! Në emër të “Nismës”, Shukrije Bytyqi e ka fjalën.

SHUKRIJE BYTYQI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Të nderuar kolegë deputetë,

RTK-ja tanimë po dihet se është bërë çerdhe e punësimit të grupeve të ngushta të interesit dhe si mjet propagandues në duar të pushtetit dhe të Qeverisë së kaluar dhe tani edhe të Qeverisë së tashme.

RTK-ja dhe menaxhmenti i tij njihen për shkelje të shumta ligjore, po më së shumti mungesë të transparencës dhe llogaridhënies, anime politike të programeve informative, keqmenaxhime me financa publike, devijime të realitetit që ndodhin në terren, janë vetëm disa nga shkeljet që shoqërojnë këtë institucion, tani të vetëm publik.

Bordi i RTK-së si organ më i lartë duhet të fillojë të ushtrojë funksionin e vet mbikëqyrës dhe t'i adresojë shqetësimet e ngritura në veçanti nga Sindikata e punëtorëve dhe redaktorëve të RTK-së, për t'i dhënë fund shkeljeve ligjore dhe ndërhyrjeve në pavarësinë editoriale të këtij institucioni.

Themelues i RTK-së është Kuvendi i Kosovës e jo partitë politike, në të cilën po trajtojnë këtë institucion si të ishte pronë e tyre private, duke bërë ndërhyrje të vazhdueshme dhe të drejtpërdrejta në politikat redaktuese të këtij institucioni.

Të nderuar kolegë deputetë,

Menaxhmenti i RTK-së dhe Bordi i RTK-së asnjëherë nuk kanë bërë transparente vlerën e borxheve që ka ky medium publik. Kuvendi i Kosovës është themelues dhe financues kryesor i RTK-së, përmes Komisionit Parlamentar për Administratë Publike dhe Komisionit për Media duhet të kujdeset, në mënyrë që shpenzimet e parasë publike të jenë më transparente dhe t'i jepet llogari këtij Kuvendi.

Zhvillimet në RTK në punësime pa konkurs, në punësime me konkurse formale, emisioni ka treguar që këta janë të njëanshëm e këtë e dëshmojnë edhe më së shumti protestat e fundit, që kanë pasqyruar më së miri njëanshmërinë e këtij mediumi, i cili duhet të ishte në krah të realitetit në terren e të ndërpresë zhvillimet e drejtpërdrejta, duke akuzuar herë pas here protestuesit dhe duke i paraqitur në opinion publik, si agresorë.

RTK është themeluar me votën e përfaqësuesve të popullit dhe duhet t'i shërbejë popullit dhe qytetarëve në përgjithësi, duke sjellë kualitet, korrektësi dhe realitetin e pasqyruar në terren tek qytetarët. Por, këtu ndodh e kundërta. Ajo që ne shohim në RTK është vetëm zëri i partive të caktuara politike dhe i personave të caktuar publikë.

Televizioni publik i Kosovës së fundi nga punëtorët e vet po akuzohet për censurë, propagandë, anim politik në favor të partive të caktuara dhe për transmetim të lajmeve, sipas porosisë së zyrtarëve më të lartë e kulmi i të gjitha këtyre, të nderuar kolegë deputetë dhe të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës, është largimi i punëtorëve të Sindikatës së RTK-së, nga puna pa asnjë arsye.

RTK shkarkon redaktorin Halili dhe sindikalistin Hoxha, për shkak të, sipas mediumit publik, shkelje të vazhdueshme të kontratës. Dhe, është tepër banal arsyetimi i këtyre vendimeve. Drejtori i përgjithshëm i RTK-së Mentor Shala, ka marrë vendim, që të shkarkojë nga puna Fadil Hoxhën dhe Arsim Halilin, Hoxha është kryetar i Sindikatës së Pavarur të RTK-së, ndërsa Halili është zëvendës i tij.

Këto janë vendime, të cilat i ka publikuar RTK-ja sot, që vërtet nuk është asnjë shkelje, vetëm pse ata janë shprehur lirshëm për padrejtësitë dhe për shkeljet që bëhen në mediumin e vetëm publik. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Për Grupin “6+”? Kush flet për “6+”? Myfera Shinik.

MYFERA SHINIK: Faleminderit! Teşekkür ederim,

RTK konusunda detaylı tartışabilmemiz için 2014 yılının Eylül ayında elimizde raporun olması gerekirdi. Maalesef bu rapor olmadığı için detaylı analiz yapamıyacağız. Ama yine de toplulukların RTK ,’da diskrimine edildiğini kısaca birkaç noktada vurgulayacağım.

RTK her yıl teknoloji altyapısı için milyonlarca euro harcarken, topluluk yayınlarını Priştine dışındaki faaliyetleri takip etmek için bir kamera bile temin edemiyorlar. RTK internet yayınında Türkçe ve Boşnakça yayınlara yer verilmemektedir. Yasada RTK 1 ve RTK 2 yanında topluluklar kanalının açılabilmesi için finansal destek sağladığımızda açılabilir diye hüküm vardır, ama maalesef finansal destek olmasına rağmen RTK 3 v RTK 4 yasa ihlali ile Arnavutça yayına başlamıştır. RTK 2’de yüzde 15 topluluk yayınları zaman süresi yasada olmasına rağmen 2 yıldır hala başlamamıştır.

RTK genelinde işe alınan işçi sayısının çok fazla olduğunu, RTK 2’de 100 işçi işe alınırken diğer topluluklardan hiç kimse işe alınmamıştır, ki bu 100 işçi Sırp topluluğuna aittir. RTK radyosunda 3 Tğrk çalışanı işten ayrılmasına rağmen, ki bunlardan ikisi vefat etmiştir, rahmetle anıyoruz, biri de işten ayrılmıştır, bunların yerleri doldurulmamıştır. Buna hiç kimse iyi niyet diyeemz, tamamen art niyettir. Bütün bunları duymak, görmek istemeyen yöneticilerle birebir görüşsek de bunları söylememize rağmen sonuç alınamadı. Biz yine de bunun devamlı takipçisi olacağız, böyle ki yasayla uyumlu çalışmaların emcberi şekilde yerine getirilmesini sağlayacağız.

Teşekkür derim!

KRYESUESI: Në emër të grupeve deklarimet i dëgjuam. Fillojmë me deputetët. Blerta Deliu-Kodra e ka fjalën.

BLERTA DELIU-KODRA: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës.

Natyrisht, që si deputete e këtij Parlamenti nuk do të guxoja t'i jap vetes të drejtë që të përzihem në politikat redaktuese të Televizionit Publik edhe për faktin, se ne jemi themelues të këtij televizioni. Kuvendi i Kosovës do të thotë, është ai i cili e ka themeluar Televizionin Publik.

Po ashtu, dua që në fillim të ndaj shqetësimin lidhur me vendimin e menaxhmentit të RTK-së, i cili konsideroj se duhet ta shohë me shumë kujdes situatën e krijuar së fundmi dhe, në rast nevoje, natyrisht se duhet edhe Bordi të jetë pjesë e zhvillimeve të fundit.

Nëse ndalemi tek debatet e fundit, unë konsideroj se çfarëdolloj debati që bëhet për transmetuesin publik, përveç çështjes së financimit dhe pronës, është presion i drejtpërdrejtë në RTK-në. Dhe, në asnjë konventë a ligj ndërkombëtar e as vendor, nuk e justifikon një debat, ku kërkohet që politika, të cilët natyrisht jemi ne, të hetojë një medium.

Kjo në rast se, gjithsesi, në rast se raporti i auditimit vjen me shkelje, atëherë kjo është krejt e natyrshme, mirëpo pa një raport të detajuar, i cili do të ofrojë shkeljet, që u thanë këtu, atëherë konsideroj se kjo është veç presion publik mbi mediumin publik.

Mënyra se si ne duhet ta mbrojmë këtë medium është pikërisht t'u sigurojmë financim të mjaftueshëm që RTK-ja të përmbushë misionin e vet. Vetëm nëse mund të arrijmë që të sigurojmë, do të thotë, përmbushjen e këtij financimi të mjaftueshëm, atëherë ne duhet ta shohim një RTK të apolitizuar.

Nëse RTK nuk është duke e përmbushur obligimin e saj ligjor, atëherë prapë janë organet kompetente, të cilat duhet të konstatojnë një gjë të tillë. Prandaj, në kohën kur po negociohet Marrëveshja e Stabilizim-Asocimit, të bëjmë një ndërhyrje të tillë në një medium si RTK-ja, në këtë rast mendoj se është e pakuptimtë dhe do ta dëmtojë procesin. Prandaj, do të ishte e udhës që të punojmë në Ligjin e ri të RTK-së dhe të tregojmë se jemi shembulli më i mirë në rajon, që siguron liri të medias dhe shprehjes, duke u siguruar financim adekuat dhe pronë adekuate.

Këto ishin disa nga pikat, i nderuar kryesues, pres që të kemi një debat konstruktiv dhe të mos flasim për politizim, sepse unë kam qenë vetë gazetarë dhe asnjëra parti politike nuk mund ta gjuajë gishtin tek subjekti tjetër, sepse të gjithë janë... e kanë dikë në RTK, kanë dikë të punësuar në Televizionin Publik.

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e merr Lirije Kajtazi.

LIRIJE KAJTAZI: Faleminderit, kryesues!

Unë, siç e vërejtët, kisha ndërmend të marr fjalën edhe tek pjesa e parë, që ne e ndërlidhëm bashkë për formimin e Komisionit Hetimor, u dha qëndrimi i Lidhjes Demokratike të Kosovës.

Megjithatë, lajmi që erdhi për largimin nga puna të dy punëtorëve sindikalistë, kryetarit dhe nënkryetarit, zotit Hoxha dhe Halili, vërtet është shqetësuese për të gjithë ne dhe, e bën gjendjen alarmante për të parë edhe tani në këto momente, kur jemi në këtu, çfarë vlon atje, me forma të ndryshme të kërcënimit.

Ajo çfarë unë dëshiroj të vazhdoj më tutje, janë gjëra të cilat në emër të Grupit Parlamentar, përmendi zoti Sadri Ferati, shumë çështje të cilat kam planifikuar t'i them, u thanë nga ai saktësisht, sikur ajo habia për borxhet e bartura nga viti në vit e vazhdimisht me punësime të reja. A ka logjikë kjo punë kështu? Deri ku ka arritur ai numër, mënyra se si pranohen ata, kush janë ata?

Ndoshta, kjo është më e rëndësishmja, kush janë ata? Ngase, ne edhe nëse vazhdojmë të presim, aq shumë po trashet miqësia e parlamentarëve me RTK-në sa ndoshta pak kujt po i mbetet e të mos ketë konflikt interesi, për të folur për atje, ngase po punësohen të afërmit e tyre.

Pastaj, edhe shumat e majme të shpenzimit të parasë nga buxheti i RTK-së për projekte të jashtme, ku shkojnë ato, çfarë ofrojnë ato, mbi të gjitha cilësia? Dhe, ajo të cilën e kam ngritur, ndoshta edhe për atë po them gjërat që unë i përmenda ngjasojnë me ato të zotit Ferati. Kemi qenë të dy në Komisionin për Media edhe në mandatin e kaluar dhe shqetësimet që kemi ngritur më herët, janë bartur edhe tani.

Sa e sa vite vjen raporti i performansës, raporti vjetor i performansës së RTK-së edhe ai i menaxhimit të parasë publike, ato nuk kalojnë asnjëherë dhe askush nuk merret me këtë. Është shumë interesante se si i lejon vetes ky organ, që të kalojnë raportet dhe të mos ndërmerret asgjë, sikur me ato që kalohen, sikur me ato që ngecin, njësoj vazhdon të ndahet buxheti për ata, pa marrë masa se çfarë bëhet atje.

Këto janë gjëra, të cilat, besoj, qoftë në komisione hetimore, qoftë me vlerësime të raporteve vjetore apo të raporteve të auditimit, duhet të tërheqin vëmendjen e secilit nga ne që të ndërmarrim diçka, ngase vërtet aty diçka po vlon dhe gjendja në përgjithësi nuk është e mirë.

Edhe për cilësinë kemi çfarë edhe mbetet për të dëshiruar dhe të flasim, prandaj, ne të gjithë së bashku duhet të angazhohemi maksimalisht për të bërë atë që është e nevojshme. Presim, ndoshta edhe një muaj nuk është shumë, derisa të vijnë raportet, por çka me ato raporte? Po them, le të shikohet saktë, mos të jenë vetëm numrat ata të cilët e kalojnë një raport, po të jetë vlerësimi cilësor për një institucion publik dhe të paanshëm. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja Lirije Kajtazi! Aida Dërguti, e ka fjalën.

AIDA DËRGUTI: Afro 16 vjet pas lufte, nocioni i pronës dhe së mirës publike, jo që nuk është duke u kuptuar në esencën e vërtetë, po përmes kuptimit të kësaj të mire, ajo është duke u degraduar dhe duke iu nënshtruar grupeve të interesit e bile, edhe qëllimeve të politikës ditore. Për të nisur nga ndërmarrjet, që janë dhe ishin në pronësi publike, ato fillimisht u kategorizuan në ato publike dhe shoqërore e që kjo ndarje u shërbeu klaneve politike me karakter kriminal, që t'i zaptojnë më lehtë, të venë kontrollin mbi to dhe në fund, ose t'i shesin ose t'i falimentojnë.

Pra, i gjithë degradimi ishte në shërbim të transaksionit të pronës publike në pronësi të individëve të fortë.

Rasti i RTK-së është një ndër treguesit, se si pronësia publike, e cila është e mirë e të gjithë taksapaguesve të Republikës së Kosovës, mund të degradojë dhe të transformohet në çerdhen e militantëve partiakë dhe me detyra të parapërcaktuara.

Pra, përderisa RTK-ja është themeluar nga Kuvendi i Kosovës, ky medium publik më së paku i përgjigjet themeluesit të tij. Madje, raportimi gjithmonë bëhej dhe bëhet për katin e tretë të ndërtesës së Qeverisë, por jo edhe tek organi më i lartë legjislativ, i cili edhe e ka themeluar.

Kur në vitin 1990 filloi represioni serb, sidomos pas suprimimit të autonomisë së Kosovës, krahas masave të dhunshme që i drejtoi kah Kuvendi i atëhershëm i Kosovës, caku tjetër ishte Radiotelevizioni i Prishtinës. Beogradi dhe strukturat e regjimit të Millosheviqit ishin të vetëdijshëm, se një nga pjesët më vitale ku duhej të ushtrohej kontrolli, krahas Kuvendit, si industri institucionale, nga ku buron i gjithë organizimi institucional, ai e goditi ndërlidhësin e këtij institucioni me publikun.

Pra, Serbia goditi dy prodhues, aty ku prodhohej ligji si instrument i kontrollit shoqëror dhe Radiotelevizionin e Prishtinës, si institucion publik, ku prodhohej lajmi.

Gjendja aktuale në RTK mund të përshkruhet në dy dimensione e që janë: dimensionin formal dhe atë joformal.

Dimensionin formal është kryeredaktori dhe Bordi i RTK-së, i parapëlqyeri dhe i preferuari i subjektit politik, ndërkaj në dimensionin joformal është zyra e Qeverisë, nga ku jepen urdhrat.

Pra, RTK ka dy palë shefa: ata të brendshëm, që shërbejnë për disiplinimin e punëtorëve, ish-kryeministrat dhe ministrat, që kujdesen për politikat redaksionale. Bile, aq shumë është e mishëruar kjo ndarje funksionale, sa që ekzekutivi përkujdeset edhe për renditjen e lajmeve dhe përbërjen e tyre, klasifikimin dhe kohën e transmetimit. RTK-ja sot e shpërfaq jo vetëm një sistem të antivlerës, por ajo njëkohësisht shpërfaq edhe hegjemoninë e pushtetit. Ajo plasonte vetëm atë, e cila është e preferuara e pushtetit e brenda kësaj hegjemonie normalisht, që vend të rëndësishëm zë edhe ky sistem i pavlerave kulturo-arsimore.

Kjo hegjemoni e këtij pushteti është e projektuar, që ta shpërlajë mendjen e popullit nga proceset, që janë duke i ndodhur Kosovës, që nga procesi i bisedimeve e deri te themelimi i mekanizmave paralele, që e bëjnë Kosovën provincë dhe e zhveshin nga mëvetësia. Ky Kuvend ka miratuar buxhetin e RTK-së, që përbën një shumë prej 0,7% të totalit buxhetor apo thënë në terma monetarë 9 milionë e 768 mijë e 500 euro. Themeluesi i RTK-së madje, ka buxhet më të ulët se RTK-ja, përkundër faktit se RTK-ja ka edhe veprimtari komerciale. Pra, Kuvendi ka më pak buxhet për gati 1,5 milionë euro më pak.

Ky debat, mendoj se duhet t'i shërbejë Kuvendit dhe veçanërisht deputetëve të tij, që të vendosin mbi subjektivitetin e vet. Pra, ose ta definojnë se jo vetëm RTK-ja, por edhe organet tjera do të

jenë në mbikëqyrjen reale të Kuvendit, ose ky Kuvend do ta pranojë dominimin që po ia bën Qeveria, tash e sa kohë.

Zaten, edhe qëllimi kryesor i pushtetit është të prishë balancat në mes të pushteteve, për qëllim të dominimit dhe kjo po bëhet edhe përmes RTK-së. Dhe, Kuvendi ose do ta ushtrojë këtë sovranitet të besuar nga sovrani, ose do ta shprehë paaftësinë që të ushtrojë pushtetin si themelues, mbi këto institucione.

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete Dërguti. Fjalën e ka deputetja Time Kadriaj. Nuk është. Ani, atëherë Teuta Haxhiu. A është këtu. S'është as ajo, më vonë. Unë u përpoqa kishe nëpër grupe, në rregull. Shkojmë tutje! Duda Balje e ka fjalën.

DUDA BALJE: Zahvaljujem!

Znači uz potpunu podršku svega što je rečeno i od strane pozicije i opozicije vezano za RTK i za sve uočene anomalije i vezano za trošenje javnog novca i vezano za finansiranje i za rad Borda i svega, ja ću se malo osvrnuti na to kakav položaj manjinske redakcije imaju na RTK i na to koliko se od strane direktora i od strane Borda ne poštuje zakon koji smo ovde izglasali, a to je Zakon o RTK-u.

Mi vrlo dobro znamo da smo u toku prošlog mandata usvojili zakon, koji tačno govori o tome da kada se stvore finansijski uslovi, znači postoji član unutar zakona da se otvori kanal na jezicima koji nisu albanski i srpski. U momentu kada smo izglasali taj zakon postojao samo RTK-1 do dana današnjeg formirana su još tri kanala, znači RTK-2 samo na srpskom jeziku, RTK-3 News i RTK-4 koji se radi o nekim dokumentarnim programima.

Što se tiče redakcije na bosanskom jeziku u javnom servisu RTK-a imamo samo jednog urednika i tri novinara, i imamo samo jednog dopisnika. Bez neke želje da poredim Bošnjake sa Srbima na RTK-u, pošto smo manjine jel, redakcija na srpskom jeziku na RTK-1 ima urednicu i 5 stalno zaposlenih novinara a koliko dopisnika imaju o tome nisam mogla da nađem informacije, ni unutar samog RTK-a.

Možda je malo banalnost bila u tome što mi recimo dopisnike iz Sarajeva nemamo a oni ga imaju. Bosanski jezik se na RTK-2 uopšte ne čuje, znači uopšte nije ispoštovan zakon ponovo znači 15% učešća manjinskih zajednica na RTK-2 uopšte ne postoje. Termini emitovanja naših emisija na RTK-1 se stalno pomeraju u zavisnosti od dešavanja nekih važnih dešavanja, što sednice, što nekih fudbalskih utakmica, znači nemamo fiksne termine.

Kadrovskih problema, naravno ima puno. Na Radio u RTK-u takođe imamo identične probleme. Ja jesam deo parlamentarne grupe „6+“ jeste da se formira ova komisija, znači unutar Parlamenta i apsolutno sam za da se i ova komisija bavi i ovim našim problemima. Hvala puno!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete! Fjalën e ka Adem Salihaj.

ADEM SALIHAI: Të nderuar kolegë deputetë,
Zoti kryesues,

Ka vite e vite, besoj disa mandate të deputetëve, që flitet për RTK-n si medium publik. Flitet për keqpërdorime, flitet për një politikë redaktuese jo të mirë, flitet për ndikime të partive politike, për grupet mafioze aty, e tjera, e tjera, por, ky Parlament deri më sot nuk ka arritur që ta marrë një vendim adekuat, që të ndalet kjo dukuri.

Sot i patëm dy pika të rendit të ditës, që lidhen me këtë dhe kam frikë që sërish nuk do të bëjmë asgjë, do të jemi një institucion, që quhet institucioni më i lartë i Kosovës, vendimmarrës, por që s'mund të bëjë asgjë lidhur me këtë çështje.

Në fakt, RTK-ja po del si njëloj “perandorie mediale” që s’do të dëgjojë për askënd dhe që s’mund ta kontrollojnë institucionet e Kosovës, të cilat e kanë formuar atë, për informimin e drejtë të qytetarëve të Kosovës. Tash e shohim, që atje vlon vazhdimisht, ka keqpërdorim financiarë, menaxhohen keq financat publike, paratë e qytetarëve të Kosovës, ka një politikë të keqe të kuadrove, aty, ka një politikë programore krejt në kundërshtim me atë që presin qytetarët e Kosovës.

Pra, janë të gjitha aspektet që nuk duhet të jenë aty dhe, me vite RTK bën një politikë të tillë programore, që figurat e pastra mundohet t’i njollosë dhe figurat mafioze të krimit, i bën engjëj dhe heronj dhe, këtu shihet qartë, se ndikim i kujt është aty dhe kujt i shërben një medium publik, që paguhet nga paratë e qytetarëve të Kosovës.

Pra, unë mendoj që ky Kuvend duhet të marrë një vendim adekuat, që ta ndalë përfundimisht një dukuri të tillë dhe që mediumi publik të jetë vërtet një medium publik i asnjë partie politike, as i Qeverisë, por që do të informojë drejt dhe do të mbikëqyrë nga Kuvendi i Kosovës.

Deri më sot ky Kuvend nuk e ka bërë këtë mbikëqyrje. Vërtet, ka emëruar njerëz të Bordit, ka emëruar nën ndikim të partive politike dhe ata njerëz dhe ai bord i ka shërbyer ekskluzivisht ndonjë partie politike dhe asnjëherë informimit të drejtë të qytetarëve të Kosovës.

Tash flitet për miliona keqpërdorime dhe është e qartë, që atje vërtet ka keqpërdorime të mëdha financiare, ka tejkalime të buxhetit, madje njerëz të caktuar të strukturave mafioze kanë hapur kompani për prodhimin e serialeve të ndryshme, qofshin ato të tipit argëtues ose seriale televizive, dhe ato produkte pastaj i blen RTK-ja për interesa të grupeve të ndryshme dhe jo për interesa të qytetarëve të Kosovës.

Ne shohim një nivel artistik edhe të serialeve edhe të produkteve tjera në nivel të mjerueshëm, që nuk meritojnë të shikohen, një nivel, të themi, banal, seriale humoristike banale, që nuk ia vlen të shihen, por që paguhet para të shumta për prodhimin e tyre.

Duke marrë të gjitha këto parasysh, unë mendoj se ky Kuvend, qoftë përmes një Komisioni hetimor, qoftë përmes komisioneve të rregullta, që i ka, duhet të ndërmarrë hapa të nevojshëm, që ky medium përfundimisht njëherë të jetë medium publik dhe jo medium i grupeve të ndryshme mafioze, që madje-madje edhe njerëz që kanë guxim atje ta thonë një të vërtetë, automatikisht i largojnë nga puna.

Pra, ne nuk mund të lejojmë që një medium, që duhet të jetë shembull i fjalës së lirë, t'i largojë në këtë mënyrë, të themi, diktatoriale, njerëzit që kanë guxim ta thonë një fjalë aty për keqpërdorime të ndryshme.

Unë mendoj se është momenti i fundit ta bëjmë këtë dhe të mos jemi edhe më tutje një organ, që quhet më i larti në Kosovë dhe, që s'ka asnjë fuqi të ndërmarrë asgjë në këtë drejtim. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Salihaj! Fjalën e ka Xhevahire Izmaku.

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit, nënkryetar!

Para tri vjetëve, kur kemi diskutuar për ligjin e ri të RTK-së, në këtë Kuvend, sfidat i kemi përcjell, domethënë edhe propozimet që kanë qenë të ndërlidhura jo vetëm prej përfaqësuesve, prej nesh si deputetë, mirëpo edhe të shoqërisë civile. Edhe pse, ka ardhur deri tek përfundimi dhe miratimi i ligjit, sfidat që kanë qëndruar gjatë tërë diskutimeve për ligjin e ri, kanë mbetur ende të pazgjidhura.

Pra, janë tri çështje, siç është financimi i qëndrueshëm, mungesa e një prone legale dhe çështja e vendosjes, vërtet është zgjidhur vetëm çështja e kanalit të dytë dhe kjo vazhdon të ketë prapë probleme. Pra, fokusi im në këtë debat do të jetë një çështje e veçantë, e cila që tri vjet po diskutohet dhe ende nuk kemi arritur që të kemi një përfundim dhe të zgjidhim çështjen e pronës legjitime dhe adekuate për RTK-në. Edhe pse, me ligj e kemi paraparë që çështja e pronës së RTK-së të rregullohet me vendim të veçantë, në pajtim me këtë legjislacion, ne ende nuk kemi arritur që të krijojmë një hapësirë, e cila do të jetë një pronë legale dhe nuk do të jetë një kontest, i cili vazhdon që të diskutohet edhe më tutje dhe të jetë kontest edhe në kuadër të Agjencisë së Pronave.

Unë nuk kisha dashur të hyj në këtë, pasi që nuk jam kompetente të flas, mirëpo sipas një vendimi, prona e cila kontestohet, ku aktualisht është e vendosur selia e RTK-së, është një ish-pronë e Radiotelevizionit të Prishtinës dhe në këtë drejtim, mendoj që ka vend për të diskutuar ne si deputetë dhe të dalin propozimet e reja, të cilat do ta përmbyllnin këtë debat dhe këtë diskutim.

Ne mund të propozojmë dhe mund të marrim propozime, që RTK të ketë një pronë legale, jo në vendin ku është, konkretisht Komuna e Prishtinës, ka hapësira të cilat nuk do të thotë detyrimisht, që selia e Radiotelevizionit të Kosovës të jetë në qendër, pra mund të ketë edhe një seli në periferi dhe të vendosen të gjitha kanalet.

Në këtë drejtim, ne do t'i përmbyllim debatet, se RTK gjendet në një pronë jo legale, mirëpo do të përmbyllnim edhe një debat, i cili ka filluar të diskutohet nga RTK, kanali i dytë serb. Pra, ata ankohen se janë tmerrësisht keq në disa garazhe të cilat janë funksionalizuar, unë i kam disa fotografi. Ne si Komision i kemi parë, që është me të vërtetë nuk janë të pëlqyeshme për t'i vizituar dhe për t'i parë edhe institucionet tjera ndërkombëtare, që kanë bashkëpunim me transmetuesin publik.

Mirëpo, këto propozime sigurisht që ne nuk mund t'i bëjmë pa ardhur edhe prej institucioneve tjera, por ne mund të diskutojmë edhe në kuadër që edhe tani kemi filluar, dje në të vërtetë kemi

marrë një vendim si Komision Funksional, që të bëjmë riamendamentimin e ligjit, ku parësore e kemi çështjen e financimit të qëndrueshëm e pastaj mund të diskutojmë edhe për çështjen e pronës.

Një çështje tjetër, e cila mendoj se duhet të diskutohet, është çështja që kanali i dytë serb nuk e ka plotësuar detyrimin ligjor, për 15%-shin e përmbushjes programore nga komunitetet tjera. Unë edhe i dëgjova përfaqësuesit tjerë këtu, sigurisht që është e drejtë që ne të kërkojmë edhe tani kur të rishikojmë ligjin, që me gjithë kërkesat që të gjitha komunitetet i kanë, ne duhet pra të kërkojmë që 15%-shi sikurse është aprovuar dhe implementuar nga shumica e komunitetit, atëherë të vendoset edhe këtu, që komuniteteve tjera t'u lirohet hapësira e tyre brenda kanalit të dytë serb.

Ne si deputetë brenda anëtarëve të Komisionit Funksional për Media kemi pasur mundësi, që mandatin e kaluar të vizitojmë transmetuesin publik në Finlandë. Ka qenë një karakteristikë e njëjtë politike, ku transmetuesi publik finlandez ka pasur kanalin e dytë suedez dhe me të vërtetë e kemi parë se ka mundësi të funksionojë dhe këto çështjet e debateve, që ende vazhdojnë, të brendshme politike për t' i përmyllur, nëse ne krijojmë një hapësirë më të mirë publike, legale, si pronë e transmetuesit publik.

Mendoj që si pasqyrë e keqe e shtetit është, që të vazhdojë që disa hapësira të kanalit televiziv të RTK-së të duken si kampe refugjatësh. Po ashtu, është edhe një çështje që ne shumë shpejt do të përballemi me epokën digjitale.

RTK është e përgatitur për këtë fazë bashkë me operatorët tjerë, do të kenë mundësi që të krijojnë kanale të tjera dhe programe tjera, mirëpo në këtë hapësirë është e pamundur. Jo vetëm transmetuesi publik, por sigurisht edhe operatorët tjerë privat kanë për të kërkuar mbështetje prej institucioneve, ndoshta edhe prej nesh, për arsye se do të ketë karakteristika tjera ... veprimi të mediave.

Mendoj që prapë fokusi ynë si deputetë, më i shpejtë dhe më urgjent është çështja e zgjidhjes së financimit të qëndrueshëm dhe në këtë drejtim unë pres, që gjatë riamendamentimit të ligjit, ne duhet të bëjmë propozime, që i kemi lënë deri më tash të paplotësuara. Pra, nuk janë veç pjesë e mungesës së propozimit të menaxhmentit, por edhe ne i kemi obligimet tona si deputetë, me alternativa të cilat na kanë munguar deri më tani. Faleminderit për vëmendje!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete! Fjalën e ka Ismajl Kurteshi.

ISMAJL KURTESHI: Faleminderit!

Deputetë të nderuar,

Misioni i Radiotelevizionit të Kosovës, i cili financohet nga taksapaguesit e vendit tonë, është i rregulluar me Ligjin mbi Radiotelevizionin e Kosovës. Se sa i kushtohet rëndësi arsimit dhe kulturës në Ligjin për Radiotelevizionin e Kosovës mund ta kuptojmë, kur e shfetojmë Ligjin për Radiotelevizionin.

Por, sa pak i kushtohet rëndësi në praktikë këtyre dy fushave të rëndësisë së veçantë, duhet të përcillen programet e këtij televizioni. Në pikën 3 të nenit 3 të këtij ligji thuhet: “Radiotelevizioni i Kosovës ka mision informues, edukues, kulturor dhe argëtues.”

Kurse, në kreun e tretë të këtij ligji, në pjesën ku bëhet fjalë për parimet programore të RTK-së përshkruhen në detaje obligimet e RTK-së si në vazhdim:

Në pikën 1.3 thuhet se RTK është e obliguar të ofrojë përmbajtje edukative- arsimore të cilësisë së lartë, kurse menjëherë pas saj thuhet se RTK është e obliguar të ofrojë përmbajtje kulturore të cilësisë së lartë.

Përmes pikës 1.5 RTK obligohet të prodhojë edhe program artistik, siç janë dramat dhe të tjera dhe, në pikën në vijim, kërkohet nga RTK-ja të ofrojë prodhime të brendshme televizive të cilësisë së lartë për fëmijët, adoleshentët dhe të moshuarit.

Në pikën 1.12 RTK obligohet t’i kushtojë vëmendje të veçantë prodhimit të programit dhe sigurimit të informatave për nevojat e personave me nevoja të veçanta dhe më vonë nga kreu i këtij mediumi, kërkohet që rëndësi e veçantë t’i kushtohet programit për fëmijë dhe familje.

Me këtë ligj parashihet vendi i veçantë edhe për promovim të shkencës, por edhe kërkohet të rezervohet hapësirë e nevojshme për programet e cilësisë së lartë profesionale, që kanë të bëjnë me historinë dhe identitetin e Kosovës.

Ligji parasheh edhe realizimin e programeve për mbrojtjen shëndetësore, rurale, të ambientit, të sigurisë, dhe kështu me radhë. Edhe pse, ligji përshkruan detyrat për udhëheqjen e RTK-së dhe për realizimin e këtyre detyrave, Kuvendi i Kosovës ndan buxhet shumë të madh për kushtet e Kosovës, megjithatë, fatkeqësisht, RTK-ja nuk po i kryen obligimet e saja ligjore në fushën e edukimit, arsimit dhe kulturës.

Në këto fusha, ka vite që nuk po përmbushen obligimet as në aspektin kuantitativ e as në atë cilësor. Rrallë mund të shohin fëmijët tanë programe cilësore edukative, të prodhuara në RTK, në të cilat nuk përdoret gjuhë vulgare dhe nuk shihen aksione agresive të cilat natyrisht që janë të dëmshëm për krijimin e personaliteteve të këtyre fëmijëve. Në vend se në këto emisione të kultivohet dashuria ndaj punës, mësimi, atdheut e të tjera, këto fokusohen në programe të cilat e bëjnë të kundërtën.

Me keqardhje konstatojmë se emisionet për fëmijë, emisionet kushtuar arsimit dhe kulturës nga redaksitë përkatëse kanë qenë të përgatitura më mirë në aspektin profesional dhe ndikimin e tyre në edukimin e gjeneratave të reja gjatë viteve të 70-ta se sa po ndodh sot.

Edhe në emisionet argëtuese dhe serialet që e mbulojnë pjesën më të madhe të programit, sipas përshtypjes së shumicës së spektatorëve të këtij mediumi, vlerat që shihen në këto emisione janë në kundërshtim me interesin e spektatorëve të këtij mediumi.

Duke pasur parasysh rolin e televizionit në ndërtimin e personalitetit të fëmijëve, por edhe informimit të drejtë për çështje të rëndësishme për të rriturit, ne kërkojmë që RTK t’i përmbushë

obligimet e saja ligjore, si në aspektin kuantitativ po ashtu edhe në aspektin kualitativ në fushën e arsimit, edukimit dhe të kulturës, sepse dëmet që shkaktohen në mospërbushjen e këtyre obligimeve programore të cilat i përmenda më lart, konsideroj se e dëmtojnë Kosovën dhe të ardhmen e saj më shumë se çdo keqpërdorim material sado i madh që është dhe që është për çdo dënim.

Dhe krejt në fund, kjo që sot u kumtua se menaxhmenti ka përjashtuar udhëheqësit sindikalë, ma përkujtoi vitin 1990 kur mjaftonte që të ishe pjesëtar i Sindikatës së Pavarur dhe kjo ka qenë arsye e mjaftueshme që të shkosh nga puna. Po ky lajm i tmerrshëm, po e them edhe një gjë se si ka përfunduar atëherë, mbas një kohe të shkurtër ata që ishin në organet e dhunshme dhe që i përzunë sindikalistët, ata shkuan dhe sindikalistët u kthyen në vendet e tyre.

Mendoj se këtu, edhe në RTK dhe në Kosovë, do të kthehet e mbara së shpejti. Faleminderit!

KRYESUESI: E ka fjalën Nenad Rashiq.

NENAD RAŠIĆ: Hvala gospodine predsedavajući!

Poštovani narodni poslanici,

Ja ću o jednom specifičnom ili posebnom delu o radu Televizije Kosova da pričam. To je naravno da pretpostavljate da je u vezi sa RTK-2 ili drugog programa Radiotelevizije Kosova.

To je počelo neke 2008.godine, da budemo iskreni, kada smo prvi, od prvih sastanaka sa predstavnicima i diplomatima i lokalnim predstavnicima unutar Vlade, prvi put razgovarali o stvaranju odnosno o potrebi stvaranja jedne nove televizije koja bi bila autonomna, koja bi bila nezavisna, televizija koja je bila na srpskom jeziku i tada smo mi utvrdili da je to vrlo neophodno, čak šta više nužno da bi mogli da napravimo jednu novu organizacionu, jednu nepristrasnu političku misiju i od tog momenta ušli smo u proces pripreme odnosno tehničkog organizovanja za staranje RTK-2.

I na žalost, kao određeni ili većina političkih stvari kod nas na Kosovu taj period se odužio. Mi smo nekih dobrih 4, možda čak i 5 godina čekali na dobru političku volju, dobar politički momenat da bi došli do stvaranja jedne takve baze i u samom početku 2012. Godine mi smo dobili Nacrt zakona o RTK-2 koji je predstavljen onako na način koji bi trebao da bude vrlo profesionalan, tehnički dobro izgrađen i unutar same Radiotelevizije Kosova.

Da budem najiskreniji, od samog početka bio sam skeptičan zbog toga što sam se plašio tog uticaja politike koji u ovom slučaju ne bi trebalo da bude, a politike koja ponekad ne može da bude nepristrasne politike koja ponekad štiti samo svoje interese unutar partijske a ne interese šireg Kosova.

I kao Srbin stvarno sam se zalagao da mi imamo jednu profesionalnu ekipu koja će uspeti da iznese to na način koji neće biti orijentisan ni nijednoj političkoj partiji nego će biti stvarno onaj deo koji se tiče lokalnih vesti, prateći regionalne naravno, ali uvek izveštavati lokalnu.

Posle tog klimavog početka, da tako kažem, u uslovima koji su bili više nego skromni ja podsećam da i dan danas RTK-a funkcioniše u nekih 150 metara kvadratnih, ako se ne varam,

gde ima određen broj zaposlenih, gde ima nedostatak kamera, nedostatak vozila, nedostatak tehničkih uslova za transport od lokacije E na lokaciji B pa naravno od lokacije B na lokaciju C, zbog toga što je takav deo posla.

Ja mislim da smo posle ovog perioda od skoro 2 godine od implementacije zakona stvarno mogu da kažem da sam prijatno iznenađen rezultatima RTK-2 zbog toga što su na više načina pokazali da nije bitno politika, bitno je to nepristrasno izveštavanje.

I bez obzira na ono što je do sad ostvareno, uz velike napore, pre svega menadžmenta i svih radnika unutar RTK 2 moramo i više od toga.

Koristim ovu priliku da vas još jednom podsetim da stvaranje jedne nepristrasne, jedne autentične, izvorne misli na srpskom jeziku unutar Kosova jeste bitno. To je stepen demokratije, to je stepen pokazivanje naše snage kao demokratsko društvo i samo ukoliko budemo obezbedili dobre uslove u kojima mogu oni da rade verovatno će moći da napreduju.

Tu dolaze svakog dana na posao, ili ako ne svakog dana onda svakog drugog, zavisno od smena koje imaju, negde oko 80 Srba i ja sam zbog toga najiskrenije ponosan jer znam da oni ovde mogu da rade svoj posao onako kao što treba i naravno ne priklanjaju se nijednoj partiji koja bi, ajde da kažem tako verovatno bila i najveća njihova greška ukoliko bi to radili.

Ja vas molim da imate u obzir i čuo sam različite kritike na osnovu generalnog rada Radiotelevizije Kosova ipak nemojte da zaboravimo ono osnovno pravilo koju moramo da implementiramo svugde, a to je nepristrasnost medija i naravno omogućivanja normalnih uslova za rad. Ukoliko to ne budemo uspeali, postavlja se pitanje i samog našeg delovanja.

Ja mislim da RTK 2 u ovom momentu može biti predstavljen sigurno kao jedno ...sredstvo da se stvori jedna uspešna priča, deo koja funkcioniše striktno na tehničkoj bazi, koji zna šta je profesionalizam, i ja stvarno verujem da će tako ostati. Ali također verujem i u nas, verujem i u vas da možemo shvatiti važnost RTK 2 i samim tim favorizovati RTK 2 do te mere da im napravimo da uslovi budu korektni. Ne tražim ništa ni više a ni manje od onoga što imaju svaka odnosno većina televizijskih kuća. Hvala vam puno!

KRYESUESI: Faleminderit zoti deputet! Fjalën e ka deputetja Teuta Haxhiu.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Debati i thirrur nga deputetët për Radiotelevizionin e Kosovës, duhet të shikohet si detyrë dhe përgjegjësi e deputetëve të Kuvendit të Kosovës, për ta mbikëqyrë dhe monitoruar punën e RTK-së.

Ka kohë që shqetësime për mosfunksionimin e drejtë në RTK kanë ardhur edhe nga shoqëria civile, po janë ngritur edhe në Kuvend edhe në legjislaturën e kaluar.

Mosmiratimi i raportit të RTK-së si dhe raporteve të shumta të ndërmarrjeve në Kuvendin e Kosovës, janë shqetësime të vazhdueshme dhe duhet që Kuvendi të marrë vendime për llogaridhënie, sepse mosmiratimi i këtyre raporteve konsiderohet si mosfunksionim i drejtë.

Edhe pse në opinion është vërejtur se kohëve të fundit janë shtuar transmetimet e drejtpërdrejta nga ngjarjet e ndryshme, sidomos në debatet televizive, për çështje nga më të ndryshmet si dhe për ngjarjet e përditshme në vend, konsideroj se punëtorët e menaxhmenti i RTK-së edhe më shumë duhet të angazhohen për integritetin dhe pavarësinë editoriale, sepse ky është një faktor i rëndësishëm drejt zhvillimit të mediave në Kosovë.

Televizioni publik i Kosovës, në mungesë të zgjidhjes së problemit të financimit nga buxheti i Kosovës, problem i cili do të duhej të zgjidhej nga RTK-ja, sepse është e obligueshme me Ligj për RTK-në, problem i cili konsideroj se nuk është zgjidhur ngase iu ka konvnuar edhe menaxhmentit edhe bordit të RTK-së.

Pra, për të qenë më transparente, do të duhej të ishte e pavarur, pra, për derisa janë të varur nga institucionet e caktuara vendore dhe kompanitë e ndryshme e grupe të caktuara të interesit, të cilat zakonisht edhe zbatojnë politikat e veta. Prandaj, mediat si të tilla nuk mund ta ushtrojnë veprimtarinë e tyre në mënyrë të pavarur, mënyrë të cilën ne të gjithë do ta dëshironim.

Prandaj, ne si Aleancë, edhe në të kaluarën e kemi ngritur sa e sa herë këtë çështje, pra për të vepruar urgjentisht në këtë drejtim, çështje e cila është vonuar shumë dhe konsideroj se është pikërisht kjo çështje e cila po e bie në këtë situatë Radiotelevizionin e Kosovës, që është Radiotelevizion publik e që thjesht shumë herë nga qytetarët po thuhet që është televizion shtetëror, më mirë me thënë televizion i pushtetit, edhe në këtë Qeveri, por edhe në qeverinë e kaluar.

Për shumë emisione ne kemi pasur shumë e shumë probleme thjesht, dhe kemi ngritur shqetësimet tona në kuadër të përmbajtjes së RTK-së, edhe një herë po e potencoj se është shumë me rëndësi dhe është momenti i nevojshëm pasurimi i fizionomisë së emisioneve të këtij transmetuesi publik në funksion të ngritjes së cilësisë për krijimin e hapësirës më të madhe kur është fjala për programet edukativo -arsimore. Mirëpo, shqetësim kryesor i yni dhe i qytetarëve të vendit mbetet mos përfaqësimi i barabartë në mbulimin e ngjarjeve, qofshin të atyre ditore, por edhe i problemeve të gjitha fushave nëpër komunat tjera në Kosovë.

Plotësimi i programit informativ me ngjarjet dhe emisionet tjera, mendoj se do ta plotësonte dukshëm këtë zbrazësi dhe gjithë përfshirjes të komunave të tjera, në mënyrë që të krijohet një balancë në nivel vendor për faktin se qytetarët e Kosovës përballen me probleme jashtëzakonisht të mëdha e të cilat shumë pak transmetohen në Televizionin publik.

Kjo zbrazësi, ky mos mbulim gjithëpërfshirës transmetuesin publik, por edhe mediumet tjera është duke i përcjell në vazhdimësi. Qytetarët e Kosovës e vërejnë këtë më së miri prandaj janë të shqetësuar së tepërmi.

Strukturimi i objektivave programore të RTK-së është një element tjetër, i cili kërkon zbatim praktik dhe me përpikëri, që po mungon në RTK. Mendoj se rritja e performances pothuaj se në të gjitha sektorët programorë duhet të jetë edhe më tutje ndër objektivat kryesore të RTK-së.

Kosova më shumë se kurrë ka nevojë për fjalën e lirë në media, sepse një gjë e tillë është në funksion të përparimit dhe transparencës, për të cilën do të duhej të angazhoheshin të gjithë.

RTK-ja medoemos duhet të ishte shembull i kësaj lirie mediale, gjë të cilën deri më sot nuk e ka treguar.

Ne sot i bëjmë thirrje menaxhmentit të RTK-së që urgjentisht t'i kthejë punëtorët, përkatësisht kryetarin dhe nënkryetarin e Sindikatës së punëtorëve të RTK-së, ngase sindikatat historikisht kanë treguar se janë promotor i ndryshimeve pozitive, andaj kjo që ka ndodhur sot nga menaxhmenti nuk është në funksion të kësaj, pra thjesht duhet vepruar urgjentisht që këta punëtorë të kthehen në punë.

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete! Fjalën e ka Ali Sadriu.

ALI SADRIU: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Do të filloj nga kjo e fundit që kolegja e propozoi në kuptimin e asaj që ne duhet të veprojmë në kuadër të kompetencave tona.

Ne jemi institucion legjislativ. Gjithë përgjegjësinë që mund ta kërkojmë nga RTK është kërkesa nga Bordi, jo edhe nga drejtori ekzekutiv. Prandaj, edhe unë në mënyrë indirekte do ta përkrahja atë propozim, por duke kërkuar nga Bordi që t'i rishikojë vendimet e ngutshme dhe jashtëligjore me një urgjencë sa më të lartë.

Po i kthehem nga fillimi, atje ku pretendoja t'i prezantoj disa çështje të cilat nuk janë të sodit as të djehit, por janë të viteve të kaluara të cilat në këtë Kuvend janë prezantuar dhe janë nxjerrë në formë të rekomandimeve, që u janë dërguar edhe RTK-së për të hartuar një plan veprimi drejt adresimit të tyre. Jo që nuk është përgjigjur dhe nuk ka adresuar asgjë, por gabimet dhe lëshimet i ka vazhduar në një ritëm edhe më të përshpejtuar.

Paraprakisht po them se sipas Ligjit mbi auditimin dhe kompanitë publike, por edhe institucionet tjera, detyrimisht në bazë të ligjit janë të detyruar që në numër prej 50 punëtorë të punësuar duhet ta ketë një auditor.

Po ju njoftoj se unë, në dijeninë time në Radiotelevizion është vetëm një auditor i brendshëm. Është formuar Komiteti i auditimit të fundit me insistimin shumë këmbëngulës tonin dhe ka dhënë disa rezultate, por ato janë shumë minore karshi shkeljeve që kanë ndodhur.

Cilat janë problemet më të mëdha që vërtet do të duhej t'i shikojë, dhe unë i bëj thirrje nga këtu edhe Prokurorisë, të zgjohet nga gjumi, se ne nuk mund ta marrim rolin e tyre, por ata duhet që këto të dhëna të cilat unë do t'i prezantoj, janë nëpër raporte që i ka prezantuar auditori apo edhe Komisioni bashkërisht me vendimet e Kuvendit. Dhe, po të hulumtohen, atëherë shihet se ka shumëçka për t'u trajtuar dhe për t'u korrektuar.

Po fillojmë nga pasuria. Radiotelevizioni i Kosovës, edhe pse është trashëguese e Radiotelevizionit të Prishtinës, nuk e ka tërë pasurinë në trashëgimi të saj. Një pjesë të saj nuk e dimë kush e menaxhon. Pra, është mirë ajo të hulumtohet dhe të prezantohet.

Radiotelevizioni i Kosovës nga viti në vit, rrit borxhet e bartura, borxhet të cilat nuk i ka të planifikuara, veprime këto që janë në kundërshtim me ligjin dhe për lëshime shumë më të vogla

ne kemi pasur arrestime spektakulare, ndërsa këto që janë të prezantuara asnjëherë nuk kam vërejtur se janë hulumtuar. Unë po i prezantoj disa dhe po ju them se këto janë në raportet e auditorit, qoftë në kaluarën, në performansën në auditivet e rregullsisë, por jam entuziast se për herë të parë do ta kemi nga auditori edhe një auditim të performansës tash me një konsulent ndërkombëtar.

Borxhet nga viti 2011 janë bartur në vitin 2011, 3 milionë e 900 000. Gjatë këtij viti ka paguar borxhe të vjetra 3 milionë, por në fund i kanë ngelur 3 milionë e 900 000.

Në vitin 2012, nga borxhet që i ka trashëguar, i ka paguar 2 milionë e 500 000, por i kanë mbetur edhe më tutje, borxhe të reja, do të thotë ka paguar të vjetrat dhe ka hyrë në të reja, ka bërë shkelje prej vitit në vit, që për rregullat është diçka jo vetëm e jashtëzakonshme, por diçka shumë shqetësuese.

Dhe për vitin 2013 kur bartjen e borxheve e ka shumë prej 2,9 milionë, e ka pak më të vogël.

Dalim te punësimet. Nëse në vitin 2006 ka pasur 440 punëtorë, në gusht të vitit 2013, ka pasur 600 punëtorë, në kohën kur Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike ka mbajtur një dëgjim publik. Tani në RTK punojnë rreth 800 punëtorë me kontrata të rregullta dhe 200 punëtorë janë me kontratë mbi vepër. 200 punëtorë nëpër vite i ka bartur me kontratë mbi vepër, që është jashtë çdo rregulle.

Shkojmë më tutje. Tek punësimi, ka shumë shkelje të procedurave të mospërfilljes as të konkursit e as të kualiteteve të kërkuara në konkurs. Emërime pra, prej rasti në rast për të mbërriri te një rast kur Bordi i drejtorëve, i udhëhequr prej kryetarit Ismet Bexhetit, merr vendim që menaxhmenti të mos bëjë rekrutime të reja pa pëlqimin e Bordit, ndërkohë ndodhin përsëri punësime dhe mbërrin shifrën që unë posa e prezantova.

Këto dhe shumë fakte tjera, që janë shumë të rënda për atë që e njeh procesin financiar, unë mendoj se është material i bollshëm që Kuvendi të marrë veprim dhe që në start zoti nënkryetar, propozoj që të formohet një grup i cili do të bëjë propozimin e rekomandimeve. Ne i patëm do rekomandime, por rekomandimet duhet të rrjedhin si rezultat edhe i këtij debati, të përfshihen edhe këto ndryshime të reja, pra siç ishte ajo kërkesa që të shikohen vendimet që janë marrë kohëve të fundit në mënyrë të jashtëligjshme, pra Bordin ta autorizojmë shpejt ta kryejë këtë proces dhe t'i prezantojë Kuvendit, sepse edhe ashtu ne sot nuk kemi kuorum për të marrë një vendim adekuat. Do të thotë, dua ta kursej edhe kohën tuaj.

Krejt për të ardhur në fund, edhe unë i bashkëngjitëm propozimit të disave këtu që i dëgjova, që minoritetet jo serbe të trajtohen në kuotën e cila është e paraparë, në 15%. Vërtet ata kanë pasur ankesa edhe në sfera tjera dhe duhet të jemi të kujdesshëm edhe në sfera tjera t'i përmbahemi edhe atij kriteri. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.)

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Rexhepi e ka fjalën.

EMILIJA REDŽEPI: Zahvaljujem se predsedavajući!

Moja suština govora odnosi se na problematiku odnosno na javni servis Televizije Kosova odnosno program za manjinske zajednice, pre svega program za Bošnjačku zajednicu i osim onih 15 minuta koga svakodnevno imamo jednom nedeljno 45 minuta osećamo se malo diskriminirani iz razloga zato što nismo zastupljeni u određenim segmentima informativnog ili edukativnog programa nacionalne televizije.

U razgovoru sa generalnim direktorom Mentorom Šalja, dobili smo odobrenje da će se uređivačka politika u budućnosti menjati i bićemo zastupljeni bez obzira na nacionalnu pripadnost u svim sverama i možemo dati svoj doprinos iz svere ekonomije, zdravstva, prosvete ili iz nekih određenih drugih svera, a mi posedujemo kao zajednica određene stručne osobe, koje mogu biti dobri i dati svoj stručni doprinos u interesu naše države.

Što se tiče podrške pojedinih poslanika ovde, koje dobijamo za kanal RTK-2, ja imam jedno pozitivno iskustvo kada je u pitanju Bošnjačka zajednica odnosno zastupljenost naše zajednice za ovaj period u vremenskom periodu od godinu dana, od koliko i traje program na srpskom jeziku, sem toga da stalno u kontinuitetu vršimo politički pritisak da imamo tu zakonsku podršku odnosno da dobijamo redakciju na bosanskom jeziku, mi smo je i dobili faktički, naši su jedan određen broj novinara na treningu, to je tehnički problem ali ono što želim javno izneti i demantovati pojedine poslanike ovde iz redova manjinskih zajednica jeste ta objektivnost i jeste ta nepristrasnost Radiotelevizije Kosova na srpskom jeziku prema Bošnjačkoj zajednici.

Kada to kažem mislim da za ovaj period od godinu dana RTK-2 daje više vremenskog prostora Bošnjačkoj zajednici a odnosi se na razne reportaže posvećene problemima svakodnevnog života koje muče naše građane odnosi se na razne reportaže koje se pokazuju na tom kanalu a odnose se na položaj naših građana u ruralnim mestima. Takođe velika zastupljenost jeste na informisanosti iz sektora raznih udruženja sa kakvim se sve one aktivnostima se suočavaju i to se jako dobro prezentuje. S obzirom da deo iz koga ja dolazim Prizrenski region –određeni deo naše teritorije nema i dalje signal RTK-1 televizije, što je za mene i dalje taj problem prioritetan, RTK-2 je zastupljen preko kablovske televizije i zbog sličnosti bosanskog i srpskog jezika je jako prihvatljiv za našu zajednicu.

S toga, želim da uporedim sva ova današnja obraćanja ovde da nije baš tako kao što izgleda i da svi zajedno radimo na tome da RTK televizije bude zastupljena za sve manjinske zajednice na ravnopravnoj osnovi bez obzira da li je taj kanal RTK-1, RTK-2 ili RTK-3, ali ako mi manjinske zajednice se baziramo samo na program koji nam sleduje kao informativnog karaktera da li su to vjesti ili šta god daje, a nismo uključeni u razna kulturna dešavanja, a nismo uključeni u raznim debatama na političkoj sceni koje se emituju na nacionalnoj televiziji RTK-1 i ne možemo dati svoj doprinos, onda je to za mene veći problem nego da imamo samo minutažu od 15 minuta. Zahvaljujem se predsedavajući!

KRYESUESI: Faleminderit! Mytaher Haskuka e ka fjalën.

MYTAHER HASKUKA: Faleminderit, kryesues i Kuvendit!
Kolegë të nderuar,

Sot po flasim për një institucion publik për të cilin Kuvendi ka mandatin e mbikëqyrjes, prandaj nuk po e shoh pse bëhet aq panik apo kundërshtim ndaj këtij diskutimi.

Në aspektin e shqyrtimit tim unë do të shpreh punën e RTK-së nga perspektiva e të drejtave të punëtorëve dhe Sindikatës.

Të theksoj se për të mbrojtur integritetin dhe dinjitetin e punëtorëve, sindikatat janë ato organizata që e bëjnë këtë. Pa sindikata, nuk ka gazetari me dinjitet, prandaj nuk ka liri të shprehjes në media të lira.

Nuk mund të rregullohet sektori i mediave nëse pengohet organizimi sindikal i gazetarëve dhe i punonjësve të mediave. Çka është edhe më problematike, kjo ndodh në një institucion publik për informim siç është Radiotelevizioni i Kosovës.

Liria e mediave dhe liria e shprehjes janë të drejta të garantuara me Kushtetutë dhe me marrëveshje ndërkombëtare. Këto na obligojnë që shteti t'i mbrojë mediat nga sulmet dhe të mbrojë lirinë e shprehjes, por t'i mbrojë edhe të drejtat e individëve nga shpërdorimi i fuqisë mediale.

Fatkeqësisht këto liri janë të shkelura në Kosovë, siç janë të shkelura edhe liritë për organizim sindikal, asociim dhe tubim dhe të gjitha këto po bëhen nga ana e menaxhmentit të RTK-së. Kërcënimet ndaj gazetarëve, sulmet fizike, verbale, kërcënimet përmes rrjeteve sociale e në çdo formë tjetër janë bërë mjet për të cenuar lirinë e shprehjes jo vetëm nga kriminelët, por edhe nga menaxhmentet e mediave e këtu rasti më flagrant është ai i cenimit të së drejtës së shprehjes në institucionin publik RTK.

Para disa javësh të gjithë i pamë skenat e dhunës ku punëtorët dhe redaktorët e RTK-së ishin të penguar fizikisht nga sigurimi, do të thotë i Televizionit, dhe atyre u janë shqyer parullat me dhunë dhe me kërcënim.

Në një institucion publik i cili financohet nga qytetarët e Republikës, ku pagat dhe luksi i menaxhmentit është mbi supet e qytetarëve të varfër të Kosovës, pengimi i të drejtave sindikale të punëtorëve me intervenime të dhunshme në protesta është kulmi i cenimit të lirisë së shprehjes.

Këtë që po e them, nuk po e them vetëm nga ajo që po e shohim nëpër televizione, por edhe nga raportet e ndryshme të organizatave ndërkombëtare dhe ato vendore. Ndër të tjera, edhe Raporti i Komisionit Evropian, Raporti i Progresit për Kosovën për vitin 2014, ndër të tjera, konstaton:

Që transportuesi publik RTK-ja mbetet e varur nga financimi shtetëror dhe kjo e minon pavarësinë editoriale. Bordi i RTK-së është i votuar në bazë të preferencave politike, sindikata e RTK-së edhe pse ka vënë në dukje korrupsionin dhe mungesën së transparencës në punësimin dhe politikat e rekrutimit të RTK-së këto nuk janë shqyrtuar dhe qëndrueshmëria financiare afatgjatë e transmetuesit publik të Kosovës, vazhdon të jetë e pasigurt.

Këto janë konstatimet e Komisionit Evropian. Pastaj, institucioni i Avokatit të Popullit në raportin e tij, ndër të tjera thekson:

Mbetet shqetësues mosrespektimi i Ligjit të punës në RTK dhe në shumë media të tjera, veçanërisht në lidhjen e kontratave të punës së gazetarëve të gjitha profileve. Kjo çështje kërkon vëmendjen e institucioneve kompetente për të krijuar një ambient të favorshëm për gazetari cilësorë dhe në funksion të informimit të drejtë dhe të saktë të publikut.

Këto ishin konstatimet e Institutit të Avokatit të Popullit.

Dhe në fund, Organizata e mediave të Evropës Juglindore, në komunikatën e saj më 12 shtator 2014, po ashtu thekson:

Në RTK ekzistojnë probleme në aspektin e përkeqësimit financiar, çështjet organizative e programore dhe censurë editoriale të gazetarëve. Raportohet për presione të vazhdueshme mbi gazetarët profesionistë, punësime pa procedura të punësimit apo të mbulimit financiar.

Kjo organizatë e thërret menaxhimin e RTK-së të jetë më transparente në vendime dhe që RTK-ja t'i mbrojë gazetarët e saj dhe t'u japë atyre atmosferë të sigurt pune.

Po ashtu unë pata marrë edhe nga punëtorët drejtpërdrejt problemet të cilët ata i kanë brenda institucionit të RTK-së, por sot me largimin e dy sindikalistëve, pra kryetarit dhe nënkryetarit të Sindikatës, unë nuk po shkoj t'i ceku edhe problemet tjera të cilat punëtorët i kanë në punën e përditshme në RTK, por vetëm të shkoj edhe tek Ligji për organizimin sindikal, i cili në nenin numër 24, pika 2, thotë që për aktivitetet sindikale, përfaqësuese sindikale, pa pëlqimin e Sindikatës, nuk mund t'u ndërpritet kontrata e punës, nuk mund t'u caktohet vend tjetër i punës, nuk mund të ulet pozita e vendit të punës, nuk mund të fillojnë procedura disiplinore, nuk mund t'u zvogëlohet paga.

Të gjitha këto kanë ndodhur në RTK. Domethënë të gjitha këto pika, të cilat ligji i cek që nuk mund të bëhen, janë bërë ndaj sindikalistëve në RTK.

Në këtë aspekt, menaxhmenti i RTK-së, pos që nuk i respekton të drejtat e punëtorëve, në të njëjtën kohë shkatërron edhe perspektivën financiare të RTK-së, në aspektin e punësimeve të cilat nuk janë të planifikuara, por edhe nuk janë sipas kritereve dhe pa konkurse. Domethënë, në një raport të vitit 2013 nga ky institucion ceket se janë 600 të punësuar, ndërsa tash janë 940 të punësuar.

Këto zhvillime japin sinjale të qarta se gjendja e punëtorëve në RTK është alarmante, menaxhmenti i transmetuesit publik të Kosovës, duhet të sigurojë që RTK-ja t'i përmbushë detyrat e veta të parapara me ligjet e Kosovës. Domethënë, t'i respektojë të drejtat e punëtorëve për t'i shërbyer publikut, të jetë i pavarur, i paanshëm dhe i lirë nga ndikimet komerciale dhe ato të Qeverisë, në të kundërtën, Bordi dhe menaxhmenti duhet të shkarkohen.

Pengimi i aktiviteteve sindikale dhe angazhimi i sindikalistëve drejtpërdrejt dhe shantazhimi i sindikalistëve drejtpërdrejt, është shkelje e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, pos Ligjit për sindikatat, ajo është edhe shkelje e Kushtetutës dhe specifikisht të neneve 40, 42, 43 dhe 44.

Së këndejmi, Kuvendi i Republikës ka obligim kushtetues të garantojë mbrojtjen dhe sigurinë e të drejtave të gazetarëve të RTK-së si punonjës në mënyrë që gazetarët të kryejnë rolin e tyre të domosdoshëm në demokracinë tonë pa asnjë lloj pengese.

Mediat janë pasqyrë e shoqërisë dhe ato ndihmojnë që shoqëria të rregullojë vetveten, por nëse pasqyra është e turbulluar si me rastin e Kosovës, atëherë në vend të rregullimit kemi vetëm çrregullime, në vend të demokracisë, kemi diktaturë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Kadrijaj e ka fjalën.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Radiotelevizioni i Kosovës duke qenë medium publik, do të duhej të ishte zëri i qytetarëve dhe të zhvillonte politikën mediale në shërbim të interesit të përgjithshëm.

Për drejtuesit e tij, zbatuesit e të qenët publik në fakt po përdoren si maskë për t'i mbuluar shërbimet që në vazhdimësi ua bëjnë interesave private të pushtetmbajtësve. Sindikatat e punëtorëve të RTK-së dhe redaktorët e lajmeve kanë ngritur shqetësime të bazuara në lidhje me shkeljet e vazhdueshme të bëra nga menaxhmenti i RTK-së me rastin e punësimeve si dhe lidhur me ndërhyrjet e vazhdueshme, veçanërisht në përmbajtjen e emisionit të lajmeve.

Kosova ka një treg medial plural, një kornizë ligjore dhe kushtetuese të kënaqshme, dhe kuadër të bollshëm për profesionin e gazetarisë. Numri i gazetave, revistave, radiove, televizioneve e portaleve në internet, është me dhjetëra, të cilat një tregu prej 1.7 milionë banorësh do të mund t'i shërbenin informatë të lirë, të saktë dhe të paanshme. Garancitë më të larta ligjore, megjithatë mbesin të pazbatuara në praktikë.

Raportet ndërkombëtare na renditin në pjesën e fundme të listës së vendeve me liri të medias, ndërsa profesioni i gazetarëve mbetet i pasigurt në punëdhënie dhe në terren. Duke konsideruar lirinë e mediave si një ndër shtyllat e një shoqërie demokratike, mediat kanë rëndësi të barabartë karshi zgjedhjeve, llogaridhënies mes të institucioneve dhe politikës së tranzicionit në programin tonë të qeverisjes demokratike.

Kosova mbetet një nga shtetet e cila akoma po kalon në periudhën e tranzicionit në një shtet ndërtimi. Në shtetet e tilla me histori të strukturave autoritare, mediat janë një akt, një nga sektorët më të ndikuar. Për këtë arsye shumë institucione ndërkombëtare që punojnë në fushën e mediave fokusohen në monitorimin e lirisë së mediave në vende në tranzicion.

Një nga raportet kryesore të këtilla në Kosovë, mbetet Raporti i Progresit të Komisionit Evropian. Ky raport publikohet çdo vit, për secilin shtet i cili synon aderimin në Bashkimin Evropian dhe në të cilin shtjellohen përparësitë që shteti në fjalë i ka bërë rreth harmonizimit të legjislacionit dhe politikave të tij me ato të Bashkimit Evropian.

Në Raport të Progresit janë shënuar disa probleme në sferën e mediave në Kosovë, shumë nga të cilat përsëriten nga vitet e kaluara. Ndërkohë që në vitet e kaluara mungesa e legjislacionit për sa i përket lirisë së mediave, ka qenë problematike.

Në Raportin e Progresit për vite thuhet qartë se kërcënimet ndaj gazetarëve dhe redaktorëve, si dhe ndërhyrja politike mbetet një problem i vazhdueshëm.

Për më shumë, Raporti i Progresit tërheq vëmendjen për sa i përket ndërhyrjes politike në caktimin e anëtarëve të bordeve të Radiotelevizionit të Kosovës, si dhe Komisionit të Pavarur të Mediave, ky i fundit, përgjegjës për licencimin e transmetuesve, si dhe mbikëqyrjen profesionale dhe etike të tyre.

Ndërhyrja politike në këtë institucion ndodh nëpërmjet ndikimit të procesit të përzgjedhjes së organit më të lart vendimmarrës, Këshillit. Nga ana tjetër, kompensimi monetar i gazetarëve është i vogël, ndërkohë që nuk ka siguri në punë si pasojë e mungesës së marrëdhënies kontraktuale me punëdhënësin. Për më shumë, presionet e jashtme nga politika dhe bizneset e afërta me politikën, bëjnë që bordet redaktoriale dhe gazetarët të ndjejnë nevojën për vetëcensurë.

Shoqatat e pavarura të gazetarëve në vend janë jo efektive dhe shpesh bien pre e interesave të grupeve të caktuara të interesit, si rezultat gazetarët nuk përfaqësohen në mënyrë adekuate tek organet ligjvënëse, ku mungojnë mekanizmat e pavarura të trajtimit dhe nuk kanë një organizatë ombrellë që të mbrojnë interesat e tyre profesionale.

Megjithatë, provizionet e shumta për mediat në Kosovë duhet të harmonizohen në mes vete në mënyrë që të sigurohet të mos ketë dykuptimësi në mes provizioneve të ndryshme ligjore dhe që të bëhet interpretimi më i lehtë i tyre.

Mediat në Kosovë kanë shënuar shumë përparime të nevojshme për një sektor të tillë, në një demokraci të zhvilluar. Sidoqoftë, gazetarët dhe shtëpitë mediale vazhdojnë të përballohen me sfida, nga ato direkte si kërcënime dhe ato më të tërthorta si probleme financiare dhe mungesën e kapaciteteve.

Megjithatë, çështje parësore vazhdojnë të mbesin mekanizmat e rregullimit të sektorëve të ndryshëm medial, si dhe mbrojtja dhe përfaqësimi adekuat i gazetarëve.

Dhe, në fund, si mund të quajmë veprimin e menaxhmentit të RTK-së sot që me vendime arbitrare ka pushuar nga puna kryetarin dhe nënkryetarin e Sindikatës, me arsyetim se ata e kanë bërë publike problemet në këtë medium dhe ky veprim është i papranueshëm dhe të gjithë ne duhet të reagojmë. Kjo është në kundërshtim me Ligjin për organizimin sindikal. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Morina e ka fjalën.

SALI MORINA: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Sot u fol mjaft lidhur me çështjen e RTK-së. I patëm dy pika në këtë seancë dhe konsideroj se u tha mjaft edhe nga kolegët deputetë ku u fol që ndoshta kishte qenë mirë të pritet një raport i auditimit, i cili pritet shumë shpejt të silltet në Parlamentin e Kosovës, por mendoj se ka shumë raporte të cilat janë hartuar, sidomos nga Auditori gjeneral apo nga auditori i jashtëm duke u

nisur që nga viti 2010, 2011, 2012 e 2013 dhe RTK-ja vazhdon të ketë një menaxhim jo të mirë në realizimin e buxhetit sa i përket çështjeve financiare në përgjithësi.

Shumat e kontratave të lidhura gjithherë janë më të larta se sa buxheti i planifikuar dhe si pasojë e kësaj detyrimet e RTK-së janë rritur dukshëm dhe në mënyrë të pakontrolluar.

Shikuar raportet e auditimit të përgjithshëm paraqiten mangësi serioze gjatë procedurave të intervistimit, pra janë nga 2 apo 3 shkaktarë kryesorë që RTK-ja është ballafaquar kur vlen të theksohet çështja e buxhetit, çështja e rekrutimit të stafit dhe po ashtu punësimi në RTK mbi baza familjare, klanore dhe partiake.

Pra, RTK ende nuk ka arritur të vendosë kontroll dhe procedura të mjaftueshme në fushën e burimeve njerëzore. Në fushën e prokurimit, po ashtu edhe ky afion një konkurrencë jo të drejtë, siç parashihet në raportet e auditorit të përgjithshëm gjeneral dhe kjo mbetet që është njëra prej fushave më kritike e cila është vlerësuar nga këto raportet që u përmendën edhe më herët.

Kontrolli i pamjaftueshëm në evidentimin dhe monitorimin e të hyrave nga marketingu. Pra, kemi të bëjmë se një numër bukur i madh i të hyrave nga marketingu, Radiotelevizioni i Kosovës nuk i kontrollon apo nuk i monitoron siç duhet. U tha edhe nga kolegët tjerë, sipas Raportit të Progresit, që vjen në vitet paraprake, Raporti i Progresit, qëndrueshmëria ekonomike e mediave nuk është e sigurt. Kosova pra nuk ka rregull efektiv për transparencën e pronësisë së mediave dhe kjo rezulton në përqendrim të tepruar dhe shkelje të pavarësisë. Reklamat qeveritare kanë pasur ndikim në politikën redaktuese të disa mediave dhe kjo është thënë haptas në këtë Raport të Progresit me të cilin pritet që të kemi një menaxhim më të mirë në këtë drejtim.

Qëndrueshmëria afatgjate financiare e transmetuesit publik të Kosovës RTK-së vazhdon të jetë e paqartë, financimi i tij i tanishëm vjen kryesisht nga buxheti i shtetit i cili dëmton pavarësinë editoriale dhe sindikatat e RTK-së kanë vënë në dukje se në RTK ka korrupsion dhe mungesë të transparencës në politikën e punësimit dhe reduktimit të RTK-së.

Prandaj, edhe unë u bashkëngjitem edhe kolegëve këtu deputetë, rastin të cilin e ka bërë sot menaxhmenti i Radiotelevizionit, me shkarkimin e kryetarit të Sindikatës dhe njërit prej redaktuesve, do të ishte mirë që kthimi i tyre të bëhet sa më shpejt, sepse është aq e pakuptimtë që kur sot ne kemi pasur dy pika të rendit të ditës që kanë të bëjnë me Radiotelevizionin e Kosovës dhe menaxhmenti i RTK-së merr një veprim për largimin e tyre, mendoj se është shumë i dëmshëm për vetë menaxhmentin e njëkohësisht është shumë i dëmshëm edhe për shoqërinë e Kosovës në përgjithësi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Pantina e ka fjalën.

SHQIPE PANTINA: Në fakt unë e kërkoja fjalën më herët, kur si shenjë replike për zonjën Blerta Deliu, e cila shkoi, sepse tha nuk ka të konstatuara me shkelje e unë desha t'ia përsëris edhe një herë shkeljet të cilat kanë ndodhur dhe po vazhdojnë të ndodhin në RTK, prandaj ka bazë më se të mjaftueshme jo vetëm për krijimin e një Komisioni hetimor parlamentar, por edhe për punë të mëtutjeshme për Prokurorinë.

Unë do t'i kisha lutur edhe diskutuesit tjerë të cilët i dhanë disa prej rekomandimeve që ishin shumë të vlefshme, që t' i harmonizojmë bashkë me rekomandimet tona, e të cilat janë: të autorizohet Auditori i përgjithshëm të bëjë një auditim të detajuar rreth menaxhimit financiar të RTK-së. Deri më tani bëhet vetëm auditimi nga një auditor i pavarur, por jo edhe nga Auditori i përgjithshëm, i cili është duke bërë auditimin e performancës, por jo edhe atë financiare.

Rasti i sotëm i largimit nga puna të sindikalistëve e bën edhe më të domosdoshëm një inspektim të detajuar nga Inspektorati i punës, edhe pse në fakt edhe Inspektorati i punës ka qenë i anshëm dhe në vend që t'i mbrojë të drejtat e punëtorëve, ai më shumë ka mbrojtur dhe ka favorizuar menaxhmentin dhe ne po ashtu propozojmë krijimin e grupit hetimor parlamentar, sepse prej asaj çka u diskutua këtu u pa që ai është më se e domosdoshme, mirëpo për fushëveprimin edhe afatin kohor të Komisionit parlamentar, unë do të dëshiroja t'i harmonizonim bashkë me grupet tjera parlamentare dhe pasi edhe ashtu nuk ka kuorum sot ato t'i votojmë nesër.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Hoti e ka fjalën.

ENVER HOTI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

U fol mjaft lidhur me gjendjen në Radiotelevizionin e Kosovës. U konstatua se roli dhe misioni i tij ka devijuar nga ata që është themeluar dhe çfarë roli ka ky i vetmi transmissio që është në publik dhe që paguhet nga paraja e taksapaguesve të Republikës së Kosovës. Prandaj të gjitha këto konstatime u panë se janë me ndikime politike, janë me nepotizëm, janë me punësime të mbingarkuara, janë me devijime tjera e deri te ajo që ndodhi sot, që unë do ta quaja si turpi më i madh që ka ndodhur brenda Radiotelevizionit të Kosovës, siç është largimi i punëtorëve të saj me një arsyetim thjeshtë qesharak ku thuhet se si arsyetim kanë deklaratimet e atyre sindikalistëve kanë tentuar të krijojnë përshtypje negative për RTK-në duke e dëmtuar imazhin e RTK-së.

Për çfarë imazhi dhe për çfarë përshtypje negative mund të bëhet fjalë këtu? Cili është imazhi i RTK-së?

Megjithë respektin që kam për shumë njerëz që punojnë aty dhe janë profesionalë, por që nuk kanë mundësi të punojnë, nuk u jepet mundësia e hapësirës që ata ushtrojnë punën e vet profesionale për shkak të ndikimeve dhe strukturave që janë krijuar aty. Bordi drejtues apo drejtuesit në përgjithësi në Radiotelevizionin e Kosovës unë do t'i kisha quajtur me një përkufizim, jo si drejtues të Radiotelevizionit të Kosovës, por që janë shndërruar në një klub politik të cilët adresojnë dhe shtyjnë përpara agjenda të grupeve politike dhe tërësisht, siç e thashë në fillim të fjalës time, kanë devijuar nga roli dhe nga misioni që ata e kanë.

Prandaj, ata të nderuar punëtorë të cilët kanë ngritur çështje të caktuara e që janë edhe të evidentuar në raporte të ndryshme të auditimit dhe të institucioneve tjera lidhur me gjendjen në Radiotelevizionin e Kosovës, ata nuk e kanë dëmtuar imazhin e RTK-së, por kanë tentuar që të thonë të vërtetën lidhur me gjendjen që është aty.

Një tjetër shqetësim mua që më erdhi bukur i befasishëm, është qëndrimi i disa kolegëve këtu, mandej dëgjuam edhe një qëndrim që ishte jashtëzakonisht në kuptimin më të mirë do të thosha i papërshtatshëm, që e tha, le të presim edhe pak se ndoshta disa anëtarëve të Bordit do t' ju

përfundojë edhe kontrata. Atëherë, deri kur do të presim ne se ata anëtarë të Bordit, aty të bëjnë edhe më tutje shkarravina, ashtu siç ka ndodhur deri më tani dhe ne mandej të marrin ndonjë qëndrim.

Unë nuk e kuptoj qëndrimin e disa deputetëve këtu dhe ndoshta edhe një grupi politik, pse janë kaq refuzues karshi një kërkesë që është shumë më e arsyeshme dhe rekomandimi që i ka sjell grupi i “Vetëvendosjes” që i kemi përpara, i mbështes plotësisht, dhe mendoj se këto rekomandime nëse futen në jetë, Parlamenti do ta marrë rolin i cili i takon dhe do t’i ndihmojë në radhë të parë Radiotelevizionit të Kosovës, neve dhe të gjithë qytetarëve të vendit.

Prandaj, nuk ka ndonjë arsye, është një retorikë tërësisht e papranueshme e atyre që bëjnë një refuzim të tillë për të ecur më tutje të gjithë së bashku. Nuk ka asnjë prapavijë dhe asnjë tentativë politike nga asnjë grup këtu që mund të bëhet një ndërhyrje e tillë ose me tentativa të tilla në Radiotelevizionin e Kosovës.

Thirrja jonë është që të ndikojmë dhe marrim masa si institucion që na takojnë dhe ta shndërrojmë gjendjen për së mbari dhe së miri, sepse atje u faktua nga shumë folës, nga shumë deputetë këtu se gjendja është jashtëzakonisht e rëndë dhe e pa pranueshme që të lejohet edhe më tutje të vazhdojë me ritmin e tillë. Ju faleminderit për vëmendje!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Maloku e ka fjalën.

DORUNTINË MALOKU-KASTRATI: Faleminderit!

Fillimisht shpreh shqetësimin tim për largimin nga puna të dy sindikalistëve të Radiotelevizionit të Kosovës, zotëriut Fadil Hoxha dhe zotëriut Arsim Halili.

Si përfaqësuese e popullit kërkoj urgjentisht nga Bordi i Radiotelevizionit të Kosovës që t’i kërkojë menaxhmentit të RTK-së që ta shfuqizojë këtë vendim absurd.

Të nderuar deputetë,

Radiotelevizioni i Kosovës, si transmetues publik duhet të funksionojë në përputhje me ligjin për RTK-në sa i përket aspektit profesional dhe duhet të japë përgjegjësi për mënyrën e menaxhimit të shfrytëzimit të parasë publike.

Për punën e RTK-së prej kohësh ka kritika të shumta, e zgjidhja për transmetuesin publik është shumë e thjeshtë, kërkon vetëm gatishmërinë për zbatimin e Ligjit për RTK-në dhe natyrisht të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Duke qenë se kam punuar vet aty për më shumë se 12 vjet, ju them me përgjegjësi të plotë se ajo çka duhet të bëjnë një pjesë e politikëbërësve në Kosovë është që t’i çojnë duart lartë nga Radiotelevizioni i Kosovës, duke e hequr njëherë e përgjithmonë ndikimin politik nga ky institucion, i cili është themeluar nga Kuvendi i Kosovës në shërbim të informimit të drejtë dhe të paanshëm të qytetarëve.

Kjo mund të bëhet vetëm duke e pavarësuar financiarisht transmetuesin publik. RTK-ja duhet t'i gjejë vetë urgjentisht mënyrat e financimit nga ana e publikut, në mënyrë që ta përmbushë obligimin ligjor që t'i përgjigjet vetëm publikut dhe interesave të tij.

Radiotelevizioni i Kosovës duhet ta ketë një bord me njerëz kompetentë të pavarur dhe të ndershëm, të cilët më pas do të duhej ta zgjidhin një menaxhment, i cili nuk do të ishte i ndikuar në asnjë formë nga politika. E deri në përzgjedhjen e anëtarëve të rinj të Bordit të RTK-së, Komisioni parlamentar për Media duhet të angazhohet seriozisht që përbërja aktuale e Bordit dhe menaxhmentit të RTK-së të funksionojë në përputhje me misionin e transmetuesit publik dhe në përputhje me Ligjin për RTK-në dhe atë për menaxhimin e financave publike.

Konsideroj se Kuvendi i Kosovës në një afat sa më të shkurtër duhet t'i ofrojë mbështetje Bordit dhe menaxhmentit të RTK-së për t'i gjetur format e reja të financimit nëpërmjet taksës për RTK-në, e cila më pas do ta zhvendoste ndikimin e politikave ditore të partive politike mbi transmetuesin publik tek qytetarët. E qytetarët e Republikës së Kosovës duhet ta dinë se për sa kohë që RTK-ja subvencionohet nga pushtetet, Kosova nuk do të ketë kurrë transmetues publik, por vetëm shtetëror. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Deda e ka fjalën.

ILIR DEDA: Të nderuar deputetë,
Zonja e zotërinj,

Gjendja në Radiotelevizionin e Kosovës është rezultat i klientelizmit dhe i instrumentalizimit të transmetuesit publik dhe një marrëdhënie e tillë definohet me anë të tendencës për maksimalizim të përfitimit politik nga një parti politike, ajo në Qeveri, e PDK-së dhe ekonomik njëjtë të rrethëve të cilat janë afër kësaj partie dhe grupeve klanore, ekonomike dhe pjesëtarëve të tjerë.

RTK-ja sot po që një kohë përfaqëson interesat politike vetëm të Qeverisë dhe atë vetëm një anëtar të Qeverisë të Partisë Demokratike të Kosovës. Domethënë, RTK-ja është vegël në duar të një partie dhe mjet i propagandës qeveritare.

Censura shihet edhe në vendimet arbitrare se çka mund të raportojnë korrespondentët e RTK-së të cilët ndodhen në shtetet kyçe perëndimore. Dhe kjo i hap disa pyetje. E para është se si munden të gjithë korrespondentët në Bruksel, qoftë të mediave vendore apo ndërkombëtare, të raportojnë në një frymë për situatën dhe për marrëdhëniet BE - Kosovë, e në RTK nuk ka vend për këtë lajm.

Si është e mundur që raportet kritike nga Brukseli kurrë nuk gjejnë vend në Radiotelevizionin e Kosovës dhe vetëm në Radiotelevizionin e Kosovës?

Si është e mundur që në Uashington kemi thirrje të korrespondentit vetëm në kohë të krizave të mëdha të Qeverisë dhe qeverisëse dhe nuk ka konsistencë në raportimet, qoftë të korrespondentëve nga Brukseli, qoftë nga Uashingtoni edhe për sfidat të cilat e presin Kosovën, sfidat të cilat raportohen nga çdo korrespondent tjetër.

Kjo tregon se RTK-ja nuk është televizion publik. RTK-ja është televizion partiak dhe nuk i shërben interesit të qytetarëve, sidomos... këtë aspektin të cilin unë po e diskutoj që ka të bëjë me korrespondentët e RTK-së jashtë Kosovës, që t'i informojë qytetarët e Kosovës ashtu siç e do me ligj për gjendjen tonë dhe për vështirësitë të cilat ndodhen në këto kryeqendra drejt Kosovës. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Ibishi e ka fjalën.

NUREDIN IBISHI: I nderuar kryesues,

Të nderuar deputetë,

Mendoj se shumë çështje po i përsërisim, por si do që të jetë, mirë është edhe ato kur përsëriten thuhet më ndryshe.

Kuvendi i Kosovës është themelues dhe përgjegjës për funksionimin e RTK-së si medium publik, ato që duhet të kihen parasysh. RTK-ja e ka një buxhet më të madh se vetë Kuvendi. Kuvendi i Kosovës me gjithë Komisionin për Media dhe komisionet tjera në periudhën e kaluar ka dështuar të bëjë mbikëqyrjen e duhur të RTK-së. Kjo është më se e evidente, por dihet një buxhet, një raport buxhetor se si miratohet dhe ajo kalon ku ta di unë prej viti në vit.

Mendoj se duhet ndërmarrë masa të menjëhershme. Kuvendi duhet të marrë vendim të menjëhershëm duke i rekomanduar Bordit të RTK-së që të kërkojë nga menaxhmenti të tërheqë vendimin për shkarkimin e dy punonjësve dhe njëkohësisht udhëheqës të Sindikatës, të cilët aktualisht janë në grevë. Ne ishim edhe me zonjën deputete Ganimete atje dhe realisht ishte ende në progres çështja e grevës dhe tash në këtë kohë është rast i paprecedentë kur janë ata në grevë dhe menjëherë i shkruhet vendimi për largim nga puna, ky është rast i veçantë.

Mandej, njëri ka qenë punëtor në Njësinë për Hulumtime, tjetri redaktor i lajmeve. Nuk jam për krijimin e Komisionit hetimor, për atë se shkeljet janë më se evidente dhe jam për hetime nga policia dhe Prokuroria si dhe masave tjera gjyqësore. Komisioni për Media dhe komisionet tjera duhet ta shqyrtojnë situatën e krijuar dhe të dalin me rekomandime të cilat duhet të miratohen nga Kuvendi.

Gjithashtu, pakicat duhet të kanë pjesën e duhur të programit e jo vetëm t'i kushtohet gati tërësisht kjo pjesa e pakicave të programit në gjuhën serbe. Është më se e evidente çështja që edhe televizioni në këtë rast, por edhe të ndërmarrjet publike ku aspekti i mbikëqyrjes nga Bordi apo menaxhmenti, dihet fort mirë si shkon ajo, dhe të njëjtën situatë e kemi edhe në RTK. Pra, mendoj se mungesa e menaxhmentit menaxhon me zhytje të vazhdueshme dhe shkelje çfarë po ndodhin atje dhe njëkohësisht dështimi i Bordit të RTK-së të ushtrojë mbikëqyrje dhe të ndërmarrë masa për përmirësimin e gjendjes dhe kjo gjendje përcillet prej viti në vit.

Mendoj se është momenti dhe situata e fundit që Kuvendi nëpërmjet vendimeve çfarë i thashë se duhet t'i ndërmarrë dhe Komisioni funksional, por edhe komisionet tjera, ai i financave, dhe tjerë të ndërmarrin masa të duhura me qëllim që gjendja të tejkalohet.

KRYESUESI: Faleminderit! E fundit është zonja Sahatqija.

TEUTA SAHATQJA: RTK-ja është e themeluar nga Kuvendi dhe i përgjigjet e raporton Kuvendit. Në mandatet e kaluara kemi parë se raportet e RTK-së, të cilat ajo është e obliguar t'i sjellë, nuk janë aprovuar nga Kuvendi i Kosovës.

Edhe ky debat këtu tregon se situata në RTK është e keqe, ka keqpërdorime, që e vërtetojnë, së paku ato financiare, e vërtetojnë auditori. Përndryshe, për keqpërdorime dhe keqmenaxhim tjetër, flitet edhe në raportet e ndryshme ku adresohen problemet, si nga Komisioni Evropian, nga Drejtoria e përgjithshme, në Raport të Progresit, në shqetësimet ceken për pavarësinë editoriale të transmetuesit publik, për pavarësinë buxhetore dhe shumë e shumë çështje tjera.

Në fakt, nëse i analizojmë numrin e të punësuarve, do të shohim se RTK-ja është shndërruar në një servil punësimi, pa kritere. Në 2013 thuhet se kanë qenë 600 punëtorë, ndërsa në 2015, 932. 698 me kontratë, ndërsa 284 me kontrata mbi vlerën. Flitet edhe për shumë çështje tjera për mbi 10 këshilltarë që as kryeministri nuk i ka aq, janë këshilltarë të cilët paguhen dhe të cilët marrin edhe ekstra vlera për punë që përveç këshillimit, punojnë aty.

Kryetari i Sindikatës dhe redaktori i RTK-së janë larguar nga puna dhe paramendo kur, në ditën kur debatohet për RTK-në. Mendoj që vetë fakti është tepër shqetësues, shqetësues dhe tregon jo guximin apo më mirë të them një mos lodhje duke treguar se nuk lodhen as për Kuvend, as për raporte, as për ligj, as për asgjë tjetër.

Ne e dimë që organizimi sindikal është i rregulluar me ligj dhe ndërmarrja nuk mund të shpallë luftë kundër sindikatave. Është e drejtë për të protestuar, e drejtë e garantuar me legjislacion.

Borxhet milionëshe, mungesa e transparencës, mungesa e menaxhimit të mirë, tregon se ky menaxhment është stërkequr dhe nuk e kryen punën në mënyrë profesionale dhe transparente.

Në anën tjetër, Bordi është treguar totalisht i paafte për të menaxhuar këtë situatë dhe si i tillë as menaxhmenti dhe as Bordi nuk meritojnë që ta kryejnë mandatin e rregullt, por të shkarkohen dhe menjëherë të thirret edhe prokurori i cili duhet të merret me atë.

Pajtohem gjithashtu edhe me auditorin i cili vazhdimisht ka sjell raporte të kualifikuara, që do të thotë raporte të këqija, të bëjë edhe një auditim dhe me këtë auditim të merret edhe prokurori dhe të zgjidhet çështja e transmetuesit publik. Në fakt transmetuesi publik duhet të ekzistojë, por mënyra se si funksionon është një mënyrë komplet e kundërt prej asaj se çfarë është paramenduar dhe çfarë duhet të jetë një institucion i cili i përgjigjet Kuvendit të Kosovës.

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka tjerë të paraqitur. Fjala është e zonjës Pantina, 5 minuta në bazë të Rregullores.

SHQIPE PANTINA: Faleminderit, kryesues!

Në fakt ajo çka unë propozoj, që thashë edhe më herët, është që duke parë edhe diskutimet që u bënë nga kolegët deputetë, u vërtetua që në fakt RTK ka probleme të mëdha, por propozimet ishin nga më të ndryshmet, duke filluar nga krijimi i Komisionit Hetimor deri te shkarkimi i Bordit, kështu që ajo çka unë propozoj është që të ulemi të gjitha grupet parlamentare t'i

harmonizojmë rekomandimet dhe t'i votojmë nesër, në seancën e nesërme, nëse pajtohen edhe grupet tjera, meqenëse edhe ashtu nuk ka kuorum tani.

KRYESUESI: Faleminderit! Merruni vesh ju nesër, grupet apo përmes kryetarëve të grupeve parlamentare dhe nëse mund të krijoni dhe të bëni një dokument të përbashkët dhe për ta votuar do të ishte shumë mirë.

Atëherë e mbyllim seancën dhe mirupafshim nesër në orën 10:00. Siç e dini, nesër është interpelanca.

* * *

E premte, më 27 mars

Vazhdimi i mbledhjes plenare, e filluar më 26 mars

Mbledhjen e drejton nënkryetari i Kuvendit, z Xhavit Haliti.

KRYESUESI: Pra, meqenëse kërkuam në 15:30 dhe ja u bë 16:00, akoma nuk janë në sallë aq deputetë sa duhet të jenë për të votuar, po konstatoj që edhe propozimi i zotit Reçica, le të shtyhet për ndonjë mbledhje tjetër, meqenëse nuk pati vullnet që ta fusim në votim.

Dhe, tani po vazhdojmë me punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, e filluar më 26 mars 2015.

Në sallë s'ka deputetë, sepse kemi për të filluar me votimet që kanë ngelur pa u votuar. Është paraqitur zonja Musliu.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuara kolege dhe ju kolegë deputetë,

Sot nuk e kisha në plan ta marr fjalën, meqë sot është një ditë shumë e dhembshme, dita kur në Izbicë, është përvjetori i masakrës më të madhe që ka ndodhur në Kosovë.

Mirëpo, nuk mund të rri pa folur, sepse më shtyn deklaratimet dashakëqija dhe përçarëse të deputetëve, zotit Zemaj dhe deputetes Maloku, nga Lidhja Demokratike e Kosovës.

Ju deputetë, tash e shumë kohë flisni dhe shpërndani shpifje dhe dezinformata monstruoze të paqena kundër Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, protagonistëve të saj.

Ju paraqiteni si engjëj, apo paraqiteni edhe si përfaqësues engjëjsh e bëni sehir dhe sa i përket Gjykatës Speciale. Ju edhe vrasjet për motive të ulëta kriminele, përpiqeni t'i jepni ngjyrimë politike. Juve ju kujtohen deklaratimet e zyrtarëve ndërkombëtarë në rastin e vrasjes së Tahir Zemajt, kur thoshin: u vra një kriminel nga kriminelët.

KRYESUESI: E kemi përfunduar atë...

GANIMETE MUSLIU: Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë të Kosovës,

Partia e Zemajt tash e 17 vjet ka mbledhur dëshmi të rrejshme kundër Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

KRYESUESI: E kemi përfunduar atë...

GANIMETE MUSLIU: Tash e 17 vjet kudo e akuzon Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, për krime e vrasje. Tash e 17 vjet shpifni për UÇK-në, herë si marksiste, herë si terroriste, e kur ua do puna besa edhe si islamiste e quani.

Për kujtesën tuaj, vetëm nga një degë e Lidhjes Demokratike, në vitin 2000, në Tribunalin e Hagës u dorëzuan mbi 500 faqe dosje kundër njerëzve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, në Prizren.

Mbi 700 faqe dosje u dorëzuan për ndodhitë në rrethinën e Rahovecit dhe Suharekës kundër UÇK-së, për vitet 1998-1999. Këto dosje kanë edhe nënshkrimin e zyrtarëve të Lidhjes Demokratike të Kosovës. Vetëm për rrethinën Pejë, Deçan dhe Gjakovë, degët e LDK-së ua dorëzuan zyrtarëve të Hagës rreth 2000 faqe, si dëshmi të fabrikua në kuzhinë e mirëpërgatitur tuajën, gjoja për krimet e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Pra raporti i Dick Martit është rezultat edhe i këtyre dosjeve të dorëzuara nga Shtabi i Lidhjes Demokratike të Kosovës, për Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës.

KRYESUESI: Ganimete, ndërprite...!

GANIMETE MUSLIU: Dhe, ju lus, që kur të dilni e të flitni për Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Armend, e ke kërkuar fjalën edhe ti, pasi ta përmendi emrin. Do ta lija krejt atë punë. Zoti Zemaj e ka fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Unë nuk do të shtoj kurrgjë më shumë, se sa fytyra e vërtetë, që tregohet, e përuljes së asaj që ne e quajmë deputet dhe përfaqësues të qytetarëve të vendit. Kjo tregon që këtu në Kosovë, ka akoma njerëz, me një mendësi të mykur, mbi të gjitha e ndikuar nga grupet kriminale, që e kanë përdhosur dhe damkosur Kosovën, jo që nga lufta dhe paslufta, por me vite të tëra.

Kjo është trashëgimi e keqe e atyre që nuk e duan këtë shtet të pavarur, nuk e duan sovran dhe mbi të gjitha, nuk e duan sundimin e rendit dhe të ligjit. Ushtria Çlirimtare e Kosovës mbetet sinonim i luftës për liri e pavarësi, por nuk mbetet pronë e rrugaçëve, e hajnave, e kriminelëve, e të bijve të Rankoviqit. Faleminderit shumë!

KRYESUESI: Kundër-replikë ka zonja Musliu.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, zoti kryesues!

E di që e vërteta dhemb, por kjo është e vërteta. Faktet dhe dokumentet që kanë dorëzuar në Hagë, janë fakte dhe dokumente, të cilat do të mbesin gjithmonë në arkivat e historisë.

Prandaj, ky është vetëm fillimi dhe, sa herë që ju të keni nevojë për fakte të tilla, ne do të jemi të gatshëm. Faleminderit!

KRYESUESI: Teutë, a dëshiron edhe ti të flasësh? Nuk po hapim tash debat për këtë çështje. U krye. Po të lus si koleg. Po, nuk kam hapur debat, Teutë. U keqpërdor kjo edhe...

Kemi 61 deputetë në sallë, vazhdojmë. Hyjmë në votim.

Zotërinj deputetë, regjia le t'i bjerë ziles. Është pika e shtatë e rendit të ditës, që ka ngelur pa u votuar.

7. Shqyrtimi i raportit të auditimit të sistemeve të prokurimit në Sektorin shëndetësor

Përgatitemi për votim dhe votojmë tash. A ka dikush që voton pa kartelë?

Albulena, një, pa kartelë. A voton për apo kundër? Do të thotë për. Në rregull.

Duhet ta përsërisim, disa s'kanë votuar. Ju lus që t'i zini vendet dhe t'i vendosni kartelat.

66 deputetë në sallë. Edhe njëherë po pyes kush është pa kartelë? Albulena, një, tjetër s'ka pa kartelë, edhe ajo e deklaroi votën për. Atëherë votojmë edhe një herë.

Votojmë tani! Kërkoj falje, unë e kam shtypur kartelën e kryetarit dhe e tërheq një votë. Janë 62 vota me elektronikë, mbasin 61 dhe 1 pa elektronikë e Albulenës, bëjnë 62 vota për, asnjë kundër, asnjë abstenim dhe konstatoj se Kuvendi miratoi rekomandimet e Komisionit funksional për Mbikëqyrjen e Financave Publike lidhur me raportin e auditimit të sistemeve të prokurimit në sektorin shëndetësor.

Pika e tetë e rendit të ditës:

8. Propozimi për emërimin e anëtarit të Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës

Diskutimet për këtë pikë të rendit të ditës kanë përfunduar në seancën e djeshme, mirëpo në mungesë të kuorumit procedimi me votim është shtyrë për sot.

Në vazhdim kërkoj deklarinimin për emërimin e zotit Mazllum Baraliu, anëtar i Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës.

A jeni gati për votim? Votojmë tash!

Nuk ka numër të mjaftueshëm të votave dhe duhet të përsëritet votimi edhe një herë... Unë nuk po ju kuptoj, a s'po doni të votoni a si është puna. Mund të abstenojnë ata që s'duan të votojnë. Mirëpo, ne duhet të votojmë dhe t'i kemi 61 deputetë më së paku. 1 është pa kartelë, zonja Albulena Haxhiu dhe tjerët i kanë kartelat të vendosura.

Këtu po thotë, janë të pranishëm 83 deputetë, sipas elektronikës. Atëherë, edhe një herë po e përsëritim votimin dhe votojmë tash!

Në qoftë se ka ndonjë grup parlamentar diçka për të thënë, le të urdhërojë. Por, që tri herë po votohet dhe s'kalon, e për këtë unë s'kam çka të bëj.

Pika e nëntë e rendit të ditës:

9. Kërkesa e Grupit Parlamentar të AAK-së për formimin e Komisionit Hetimor Parlamentar

Diskutimet për këtë pikë të rendit të ditës kanë përfunduar në seancën e djeshme, mirëpo, në mungesë të kuorumit, procedimi dhe votimi është shtyrë për sot.

Në vazhdim kërkohet deklarimi me votim për formimin e Komisionit hetimor parlamentar sipas kërkesës së deputetëve të nënshkruar të Grupit Parlamentar të AAK-së.

E kam një sqarim procedural. Neni 4, paragrafi 4 i Ligjit për hetimin parlamentar parasheh:

- Në rastet e iniciativës nga një Komision i përhershëm parlamentar ose grup deputetësh, që përbëjnë më pak se 1/3 e anëtarëve të Kuvendit, Kuvendi mund të vendosë me shumicë të thjeshtë të votave për ngritjen e Komisionit.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tash.

Konstatoj se 25 janë për, 34 kundër dhe 3 abstenime, nuk kalon.

I paskemi dy pika të rendit të ditës për të njëjtat çështje. Pika e dhjetë e rendit të ditës ka qenë debati parlamentar.

(Ndërhyrje)

Pra, është shteruar edhe kjo dhe po e kalojmë. Ismet, po e kryejmë këtë e pastaj vazhdojmë.

(Ndërhyrje)

Po, por ta them unë, e pastaj jemi në rregull. Diskutimet për këtë pikë të rendit të ditës kanë përfunduar në seancën e djeshme, mirëpo në mungesë të kuoromit procedimi me votim është shtyrë për sot. Ju lus për qetësi, të nderuar deputetë!

Në fund të diskutimeve të debatit të djeshëm është konstatuar se i propozuari i çështjes do t'i harmonizojë rekomandimet e propozuara me të gjitha grupet parlamentare. Ftoj deputeten Shqipe Pantina, në cilësinë e propozueses të çështjes të paraqes propozimin me rekomandime.

SHQIPE PANTINA: Faleminderit, kryesues!

Ne kemi diskutuar edhe me grupet tjera parlamentare dhe rekomandimet janë hartuar në bashkëpunim me deputetin Sadri Ferati, nga Grupi Parlamentar i LDK-së, të cilin nuk po e shoh se është i pranishëm.

Pra, i kemi hartuar bashkë, dhe unë po i lexoj.

Kuvendi i Republikës së Kosovës, më 26 mars 2015, ka debatuar në lidhje me Radiotelevizionin e Kosovës.

Pas diskutimeve me grupet parlamentare, qëndrimet në lidhje me rekomandimet janë harmonizuar, andaj në mbështetje të nenit 65, pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 6.1 të Rregullores së Kuvendit, Kuvendi i Republikës së Kosovës, në mbledhjen plenare të mbajtur më 27 mars 2015 të miratojë këto rekomandime:

1. Kuvendi i Republikës së Kosovës, si organ themelues i Radiotelevizionit të Kosovës, i kërkon Bordit të RTK-së, si organ më i lartë mbikëqyrës që urgjentisht t'i adresojë të gjitha problemet e ngritura në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Bordi i RTK-së në veçanti duhet të shqyrtojë përjashtimin nga puna të kryetarit dhe nënkryetarit të Sindikatës së punëtorëve të RTK-së dhe për këtë të ndërmarrë veprimet e nevojshme ligjore dhe të njoftojë Kuvendin në kohën sa më të afërt.

2. Kuvendi i rekomandon Auditorit të Përgjithshëm që të bëjë një auditim të detajuar rreth menaxhimit financiar të RTK-së, dhe

3. Së bashku me shqyrtimin e raportit vjetor të RTK-së, i cili duhet t'i dorëzohet Kuvendit jo më larg se me 31 mars, të shqyrtohet edhe raporti i performansës dhe raporti financiar i RTK-së, i hartuar nga Auditori i Përgjithshëm.

Pas shqyrtimit të raportit dhe bazuar në të gjeturat e tij, Kuvendi do t'i ndërmarrë veprimet siç përcaktohet me ligjet në fuqi, përfshirë edhe krijimin e një komisioni parlamentar hetimor për RTK-në.

Do të thotë, këto janë rekomandimet që i kemi harmonizuar bashkë me zotin Ferati. Faleminderit!

KRYESUESI: Pra, është mirë të deklarohen grupet parlamentare lidhur me rekomandimet e propozuara për votim. Nga PDK, a ka dikush të deklarohet lidhur me rekomandimet? Zoti Reçica e ka fjalën.

ELMI REÇICA: Faleminderit, zoti kryesues!

Ne biseduam me shefin e Grupit Parlamentar dhe këta kanë kërkesë që u vyen konsultimet shtesë dhe unë jam për atë që të shtyhet votimi i këtyre rekomandimeve, nëse duam vërtet të arrijmë atë çka është debatuar dje. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti Beqiri e ka fjalën.

ISMET BEQIRI: Unë nuk e mohoj se s'është diskutuar, por vërtet kemi nevojë vetëm edhe për pak konsultime. Pra, unë propozoj dhe kërkoj që në seancën e parë të radhës të jenë këto rekomandime. Pra, nëse ka diçka të shtohet, shtohet e nëse jo shkojmë me ato që u lexuan. Por, po them, kërkesë e Grupit është që të jenë këto në seancën e radhës.

KRYESUESI: Në rregull! Grupi Parlamentar Vetëvendosje, zoti Konjufca.

GLAUK KONJUFCA: E para, këto rekomandime janë dakorduar, bashkë me Sadri Feratin, i cili aty është paraqitur si përfaqësues i Grupit të Lidhjes Demokratike të Kosovës.

E tash, do të ishte mirë që edhe ai të flet, por s'po di çka ka ndodhur me fatin e zotit Sadri Ferati, të cilin nuk po e shoh në seancë këtu. Ku ndodhet ai person... a e keni rrëmbyer a çka u bë me të, sepse s'po e shoh kurrkund. Dhe, do të kishte qenë mirë edhe ai vetë të flasë për këtë çështje,

sepse mendoj që ka një konsensus dhe siç po e shoh këtu ka edhe kuorum për t'u votuar këto rekomandime me të cilat nuk ka kurrfarë problemi dhe do të ishte qenë shumë mirë të krijohet ai Komision hetimor parlamentar.

(Ndërhyrje)

Po, veç nuk ka nevojë të shtyhet seanca. Nëse këta i kanë të qarta çka do të dëshironin të shtonin në ato tri rekomandime, ne për 15 minuta, nuk është kurrfarë problemi mundemi t'i dakordojmë ato rekomandime.

KRYESUESI: Zoti Beqiri, e keni kërkuar fjalën prapë.

ISMET BEQIRI: Unë kërkesën e thashë. Zoti Konjufca, unë flas në emër të Grupit dhe po ta heq merakun, Sadriu është shëndosh e mirë. S'ka nevojë me e lyp. Unë zoti nënkryetar edhe një herë po e përsëris, kërkoj në emër të Grupit dhe atë e kemi dërguar dhe propozuar t'i sqarojë, t'i shohë. Edhe një herë kërkojmë që kjo të bëhet në seancën e radhës dhe të jetë kjo pikë veç votimi. Po flas pra në emër të Grupit.

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Kadaj e ka fjalën.

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Kryesues, mungesa e seriozitetit, edhe ndryshimi i vendimeve dhe i marrëveshjeve paraprake nuk shkon në favor të zgjidhjeve të problemeve. Unë po konsideroj se ne për 5 minuta a 10 minuta shtesë mundemi prapë të dakordohemi dhe ta qesim në votim.

Gjendja në RTK nuk është që pret deri sa dikujt t'i dalë gjumi ose të merret vesh brenda grupi. Kemi diskutuar dje gjithë ditën, sot jemi në seancë gjithë ditën. Janë harmonizuar qëndrimet, duhet të hidhet në votim dhe shpresoj të votohet, sepse është në të mirën e përgjithshme dhe jo të një subjekti politik. Duhet pasur pak ma shumë guxim të veprohet kur merrni përgjegjësi për diçka, e jo çdo dy minuta të tërhiqeni prej çdo nisme, iniciative ose kërkesë për të hetuar një çështje mbi të cilën njerëzit edhe kanë marrë vota.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Hoti e ka fjalën.

ENVER HOTI: Faleminderit, kryesues! Grupi Parlamentar Nisma për Kosovën e mbështet këtë rekomandim duke marrë parasysh se kjo është edhe një produkt i dalë dje nga debati në Parlament nga të gjithë deputetët që kanë qenë këtu, nën një, dhe është një produkt i harmonizimit që e kanë pasur, siç thanë "Vetëvendosja" dhe LDK-ja dhe mendoj që s'ka arsye të shtyhet. Ne e mbështesim plotësisht. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Bajrami e ka fjalën!

ĆERIM BAJRAMI: Hvala predsedavajući!

Parlamentarna Grupa "6+" nije konsultirana oko završnih zaključaka i mi tražimo da se obavezno uvrste i naše diskusije u zaključcima oko problematike na RTK. Prema tome, hoćemo dodatne konsultacije i slažemo se da se ponovo sedne i da se sve to dogovori na valjani način, s

tim što je naš zahtev da i naše diskusije odnosno naši zahtevi prema RTK budu uključeni u jednoj od tački zaključaka. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! Unë e kisha lutur Grupin parlamentar të Vetëvendosjes, të AAK-së dhe të Nismës që të kenë parasysh qëndrimet e tri grupeve tjera parlamentare dhe të mos hyjmë sot në votim, por ta shtyjmë për javën tjetër.

Unë besoj që do të ishte më mirë që t'i harmonizojmë qëndrimet dhe të votojmë në seancën e ardhshme se sa të votohet sot kundër dhe pastaj të detyrohet dikush të bëjë procedurë të re. Zoti Konjufca e ka fjalën.

GLAUK KONJUFCA: Po unë po e parashtroj alternativën e deklaruar këta kryetarët e grupeve, që e përbëjnë edhe mazhorancën.

A ka mundësi, për një alternativë, për t'u konsultuar për 30 minuta, deri në orën 17:00 dhe për t'u votuar në orën 17:00.

(Ndërhyrje)

Pse jo, nuk po e di arsyen? Plus është problemi se në RTK kemi situatë të jashtëzakonshme dhe rekomandimet që kanë të bëjnë edhe me ato shpunësimet që janë bërë disi në mënyrë arbitrare...

KRYESUESI: Unë, aq sa po shoh Glauk, më mirë është të shtyhet për seancën e ardhshme ose ta bëjmë një seancë vetëm për këtë çështje. S'po e shoh këtë të mundshme për sot...

GLAUK KONJUFCA: Po së paku të na jepni një arsyetim, pse të hënën, pse jo të premten?

(Ndërhyrje)

KRYESUESI: Po, por s'ka pasur konsultime të domosdoshme ose s'ka pasur konsultime të mjaftueshme. E kemi një grup parlamentar atje që po e kërkon të veten dhe unë po shoh se votimi do të jetë jo në përputhje me kërkesat që i ka Grupi Parlamentar. Unë e qes në votim dhe s'kam problem! Këta, po kërkojnë që të shtyhet për seancën e ardhshme. Kjo është kërkesa dhe nuk donë tjetër të bisedojnë. Kështu, janë sinjalet.

Pra, do të ishte mirë të deklaroheni ju, sepse kërkesa është e juaja për ta formuar Komisionin dhe për t'i miratuar ato rekomandime. Ajo që mund ta bëj, është ta qes në votim ose të pranoj variantin ta shtyjë.

GLAUK KONJUFCA: Po na nuk pajtohem. Si opozitë, po flas këtu në përgjithësi dhe mendimin po e jep të gjitha grupeve opozitare parlamentare, për arsye se situata nuk pret, mirëpo nëse nuk pajtohen këta përfaqësuesit e mazhorancës atëherë së paku le ta hedhin në votim. Pra, ne nuk pajtohem që të shtyhet kjo.

KRYESUESI: Po, s'e kam problem ta hedh në votim.

(Ndërhyrje)

OK! E hedhim në votim. Po, urdhëro, se ti je nënshkruese! Zonja Pantina e ka fjalën.

SHQIPE PANTINA: Atëherë, vetëm sa për sqarim, rekomandimet tona fillestare kanë qenë të ndryshme me rekomandimet që i prezantova sot, këto rekomandime janë hartuar së bashku me zotëriun Ferati. Nuk i kemi amendamentuar ose ndryshuar rekomandimet tona fillestare, por i kemi hartuar bashkë. Dhe zoti Ferati erdhi në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, prandaj nuk po e kuptoj çka ndërroi brenda 10 minutave.

KRYESUESI: Zoti Beqiri, prapë po insiston të shtyhet, zoti Reçica, ashtu. Zoti Qerim Bajrami, po kërkon të shtyhet dhe konsultohet prapë me ju.

Unë e qes në votim propozimin e grupeve parlamentare të pozitës që të shtyhet votimi deri në arritjen e një konsensusi lidhur me rekomandimet e bëra.

Kush është për, që të shtyhet? Në rregull! Kush është kundër? Në rregull, s'po i numërojmë se shumica është për t'u shtyrë.

Atëherë, pika e dhjetë e rendit të ditës lidhur me rekomandimet e dhëna nga debati parlamentar për Radiotelevizionin e Kosovës, shtyhet për seancën e ardhshme. Është çështja vetëm për votimin.

11. Zgjedhja e Avokatit të Popullit

Komisioni FunkSIONAL, në pajtim me Ligjin për Avokatin e Popullit dhe me Rregulloren, e ka shqyrtuar propozimin e panelit rekrutues për përzgjedhjen e kandidatëve për pozitën e Avokatit të Popullit dhe rekomandimin me emrat e 4 kandidatëve për pozitën e Avokatit të Popullit, të renditur sipas alfabetit të mbiemrit, ia ka proceduar Kryesisë së Kuvendit.

Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 23 mars 2015 e ka shqyrtuar rekomandimin e Komisionit dhe të njëjtin e ka proceduar për shqyrtim në seancë plenare.

Rekomandimi i komisionit së bashku me emrat e 4 kandidatëve u është shpërndarë deputetëve.

Ftoj kryetaren e Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore dhe Persona të Pagjetur dhe Peticione, zonjën Lirije Kajtazi, që të shpjegojë procesin e rekrutimit të kandidatëve dhe të arsyetojë rekomandimin e Komisionit.

LIRIJE KAJTAZI: Faleminderit, kryetar!

Tani para jush prezantoj raportin me rekomandime për përzgjedhjen e kandidatëve për Avokat të Popullit, duke filluar me arsyetimin nga e para.

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, si Komision parlamentar bart obligimin e realizimit të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, e cila përcakton Avokatin e Popullit si kategori kushtetuese me mandatin që të mbikëqyrë dhe

promovojë të drejtat dhe liritë e qytetarëve nga veprimet apo mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike.

Si rrjedhojë, Ligji numër 03/L-195 për Avokatin e Popullit si dhe Rregullorja për zgjedhjen dhe shkarkimin e Avokatit të Popullit numër 04/L-5-049 saktëson mandatin e po ashtu edhe zgjedhjen e Avokatit të Popullit si vijon:

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Personat e Pagjetur dhe Peticione, në mbledhjen e mbajtur më 20 janar 2015 ka miratuar vendimin për shpalljen e konkursit për Avokatin e Popullit dhe ai është shpallur nga 24 janar 2015 dhe ka qenë i hapur deri më 12 shkurt të vitit 2015.

Kanë aplikuar 21 kandidatë dhe të gjithë janë ftuar në intervistë ngase i kanë plotësuar kushtet formale dhe juridike dhe ndërkohë që në intervistë me vullnetin e tyre janë paraqitur 90 kandidatë.

Pastaj është formuar paneli rekrutues i cili ka prezantuar spektrin politik të subjekteve politike të cilat janë në këtë Kuvend, përkatësisht edhe në Komisionin e të Drejtave të Njeriut, nga Lidhja Demokratike e Kosovës, unë Lirije Kajtazi, si kryesuese e panelit; Salije Mustafa nga subjekti i PDK-së; Teuta Haxhiu, nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, Mytaher Haskuka nga Grupi “Vetëvendosje”, Valdete Bajrami nga Nisma; Kujtim Paçaku nga “6+” dhe Slavko Simiq, nga Lista serbe, i cili ka munguar komplet gjatë punës, me arsyetimin i cili qëndron edhe me mungesën e pjesëtarëve tjerë të komunitetit serb në institucione.

Intervistimi është bërë në një proces transparent dhe të monitoruar. Ata sot i kemi në sallë këtu dhe i përshëndes dhe vlerësimi në përzgjedhjen e kandidatëve është bazuar në njohuritë në fushën e të drejtave të njeriut, njohuritë për autorizimet kushtetuese e ligjore të institucionit të Avokatit të Popullit, instrumentet dhe mekanizmat vendorë dhe ndërkombëtarë, sfidat aktuale të këtij institucioni, aftësitë për menaxhimin e stafit dhe po ashtu aftësia në menaxhimin e buxhetit meqenëse po ashtu ka të bëjë me menaxhim buxheti.

Dhe pas këtij vlerësimi dhe votimi të fshehtë, secili anëtar i panelit ka bërë vlerësimin në mënyrë të fshehtë dhe kështu raporti përfundimtar është proceduar në Komision.

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, në mbledhjen e mbajtur më 9 mars 2015 miratoi raportin e panelit rekrutues dhe vendosi që Kuvendit t’i paraqet këtë rekomandim:

I rekomandohet Kuvendit për votim kandidatët për Avokat të Popullit, të radhitur sipas alfabetit të mbiemrit, si vijon:

- Mazllum Baraliu, 79 pikë;
- Shqipe Ibraj-Mala, 78 pikë, si dhe
- Suzan Novobërdaliu, 78 pikë;
- Veton Vula, 88 pikë.

Rekomandimi me katër kandidatë.

Bazuar në nenin 8 të Ligjit për Avokatin e Popullit, Komisioni ia rekomandon Kuvendit 3 kandidatë për Avokatin e Popullit, ndërkaq ne e lexuam që ishin 4. Rekomandimi me 4 është bazuar në faktin se 2 kandidatët e fundit j anë poentuar me pikë të njëjta dhe për këtë arsye ne i kemi bartur që të dy në procedim të mëtejshëm në mënyrë që të vijë në shprehje edhe vlerësimi profesional të cilin paneli e ka pasur parasysh dhe mos të na vijnë në shprehje ndoshta vlerësime teknike me forma tjera, të cilat kishin mund ta favorizojnë njërin edhe tjetrin, aq më tepër me faktin se Ligji për Avokatin e Popullit dhe Rregullorja për zgjedhjen e Avokatit të Popullit nuk e saktëson procedurën se si duhet të procedohet më tutje në rast se kandidatët e fundit mund të vijnë me pikë të njëjta.

Andaj, Komisioni i rekomandon Kuvendit para procedimit në votim, ta miratojë rekomandimin e Komisionit për procedim me 4 kandidatë për Avokat të Popullit.

Votimi për kandidatë për Avokat të Popullit bëhet në mënyrë të fshehtë. Neni 9 i Ligjit saktëson se Avokati i Popullit zgjidhet me shumicën e votave të gjithë deputetëve të Kuvendit dhe në rundin e parë votohet pak më shumë ndoshta për procedura meqenëse herën e kaluar, e dini që ka pasur nevojë për t' u rikthyer në çështje, prandaj unë mendoj që edhe kryesuesi i seancës mund t'ua jap këtë shpjegim. Megjithatë kemi vendosur si komision se është e nevojshme që të bëhet edhe një gjë e cila precizohet edhe në Rregullore.

Në rundin e parë votohet për 4 kandidatë. Në rast se asnjëri nga kandidatët nuk zgjidhet për Avokat të Popullit në rundin e parë, në rundin e dytë votohet për 2 kandidatë që kanë fituar numër më të madh të votave nga rundi i parë.

Kur asnjëri kandidat nuk zgjidhet për Avokat të Popullit në rundin e dytë, në rundin e tretë votohet për njërin nga ta, respektivisht për kandidatin që ka marrë numër më të madh të votave nga rundi i dytë.

Në rast se pas 3 rundave të votimit nuk zgjidhet Avokati i Popullit, Kuvendi normalisht se obligohet të fillojë nga e para nga konkursi e tutje, do të thotë detyrohem të rishpallim konkursin, gjë të cilën s' do ta dëshironim edhe ne si Komision edhe ju bashkërisht.

Për fund, Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione kërkon nga ju që ta miratoni këtë rekomandim dhe që të procedohet më tutje për votim. Faleminderit kolegë deputetë dhe faleminderit kryesues!

KRYESUESI: Faleminderit! Unë kërkoj një minutë të konsultohem me kryetarët e grupeve parlamentare dhe me anëtarët e Kryesisë.

(Ndërprerje e incizimit)

Në marrëveshje me anëtarët e Kryesisë dhe kryetarët e grupeve parlamentare, votimi shtyhet për seancën e ardhshme. Arsyetimin e kanë të gjithë. Ne po ju them, në sallë jemi 64 a 65 deputetë. Për t' u zgjedhur Avokati i Popullit neve na duhet të paktën të jenë 65 deputetë për votim.

Ne e kemi pasur një përvojë të keqe, por duhet shtyrë ndoshta edhe 6 muaj për ta shpallur rishtas konkursin, për të konkurruar kandidatët dhe për të vazhduar me gjendjen ekzistuese, kështu që besoj se kryetarët e grupeve parlamentare do të organizohen më mirë për seancën e ardhshme.

Unë e kam edhe një pikë, ajo është pikën e dymbëdhjetë:

12. Propozimi i grupeve parlamentare për zëvendësimin e anëtarëve në komisionet parlamentare

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës ka propozuar që deputetja Melihate Tërmkolli të emërohet anëtare e Komisionit parlamentar për Mbikëqyrjen e Agjencisë Kosovare për Inteligjencë.

Gjithashtu edhe Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje”, ka propozuar emërimin e deputetit Ilir Deda, anëtar në Komisionin për Buxhet dhe Financa, në vend të deputetit Visar Ymeri.

Kërkoj nga ju ta miratoni. Faleminderit! Me kaq i mbyll punimet e seancës së sotme. Mirupafshim në seancën e ardhshme!

* * *

E enjte, më 2 prill

Vazhdimi i mbledhjes plenare, e filluar më 26 dhe e vazhduar më 27 mars

Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

I nderuari Kabinet qeveritar, përkatësisht zoti ministër,

Para se të vazhdojmë me seancën plenare, më lejoni të ju njoftoj se mbrëmë, në një aksident komunikacioni, e ka humbur jetën deputeti i Kuvendit të Republikës së Kosovës nga Lista serbe, zoti Velimir Rakiq.

Më lejoni që në emrin tuaj dhe në emrin tim personal t'i shpreh ngushëllime familjes së deputetit Rakiq, Listës serbe dhe zgjedhësve të tij.

Ju ftoj që në respekt të kujtimit të kolegut Rakiq ta mbajmë një minutë heshtje.

(Një minutë heshtje)

Ngushëllime!

Vazhdojmë me punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të filluar më 26 mars 2015, e të vazhduar më 27 mars 2015.

Konstatoj se në sallë janë të lajmëruar me kartela vetëm 39 deputetë. Ju kisha lutur, meqë po shihet se ka më shumë deputetë në sallë, t'i futni kartelat dhe fillojmë me pikat, si në vijim.

1. Votimi i rekomandimeve nga debati parlamentar për Radiotelevizionin e Kosovës

Diskutimet për këtë pikë të rendit të ditës kanë përfunduar në seancën plenare, të mbajtur më 26 mars 2015. Ndërsa në seancën e mbajtur më 27 mars 2015, Kuvendi ka vendosur që propozim-rekomandimet të harmonizohen ndërmjet grupeve parlamentare dhe të procedojnë për votim.

E ftoj deputeten Shqipe Pantina, në cilësinë e propozuesit të çështjes, për paraqitjen e propozim-rekomandimeve. Ju lutem, deputete!

SHQIPE PANTINA: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Prej datës kur ne e kemi mbajtur debatin për RTK-në, në fakt gjendja në këtë institucion veçse është përkeqësuar. Unë besoj që edhe ju i keni parë punëtorët e RTK-së tek janë duke protestuar edhe në këto momente para hyrjes së Kuvendit.

Prandaj, unë shpresoj se këto rekomandime të gjejnë zbatim menjëherë dhe pa vonesa nga institucionet përgjegjëse të cilave u janë drejtuar.

Kuvendi i Republikës së Kosovës, më 26 mars 2015, ka debatuar për Radiotelevizionin e Kosovës. Pas harmonizimit të qëndrimeve me grupet parlamentare PDK, LDK, LVV, AAK, "Nisma" dhe "6+", në mbështetje të nenit 65, pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

dhe nenit 6, pika 1 të Rregullores së Kuvendit, Kuvendi i Republikës së Kosovës, në mbledhjen plenare të mbajtur më 2 prill 2015, miraton këto:

R e k o m a n d i m e

1. Kuvendi i rekomandon Auditorit të Përgjithshëm që të bëjë një auditim të detajuar rreth menaxhimit financiar të RTK-së,

2. Së bashku me shqyrtimin e raportit vjetor të RTK-së të shqyrtohet edhe raporti i performansës dhe raportet financiare të RTK-së, të hartuara nga Auditori i Përgjithshëm,

Pas shqyrtimit të raportit dhe bazuar në të gjeturat e tij, Kuvendi do t'i ndërmarrë veprimet siç përcaktohen me ligjet në fuqi, duke mos e përjashtuar edhe krijimin e një komisioni parlamentar hetimor për RTK-më.

3. Të zbatohet ligji për RTK-në, neni 8, nga pika 3 deri te pika 6, për përfaqësimin e programit për komunitetet joshumicë joserbe, dhe

4. Kuvendi i Republikës së Kosovës, si organ themelues i RTK-së, i kërkon Bordit të RTK-së, si organi më i lartë mbikëqyrës që urgjentisht t'i adresojë të gjitha problemet e ngrehura në Kuvendin e Kosovës. Bordi i RTK-së, në veçanti duhet ta shqyrtojë përjashtimin nga puna të kryetarit dhe nënkryetarit të Sindikatës së Punëtorëve të RTK-së dhe të ndërmarrë veprime të nevojshme ligjore, e për këtë ta njoftojë Kuvendin deri më 15 prill 2015.

Pra, ju ftoj edhe një herë të gjithë që t'i miratojmë këto rekomandime. Faleminderit!

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

Atëherë vazhdojmë me votimin e propozim-rekomandimeve lidhur me punën dhe funksionimin e Radiotelevizionit të Kosovës, të harmonizuara nga grupet parlamentare.

Presim edhe pak!

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim! Ju lutem, deputetët të cilët kanë ardhur tani, t'i vendosin kartelat për votim. Votojmë tash!

Në votim kanë marrë pjesë 78 deputetë, për kanë votuar 76, kundër nuk ka, abstenuan 2 deputetë.

Konstatoj se Kuvendi i miratoi rekomandimet lidhur me punën dhe funksionimin e Radiotelevizionit të Kosovës, të propozuara nga grupet parlamentare.

Kalojmë në pikën e dytë:

2. Zgjedhja e Avokatit të Popullit

Në seancën e mbajtur më 27 mars 2015, kryetarja e Komisionit Funksional, zonja Lirije Kajtazi e ka shpjeguar procesin e rekrutimit të kandidatëve dhe i ka paraqitur rekomandimet.

Në vazhdim, çdo deputet mund t'i parashtroj pyetje kryesueses së komisionit lidhur me procesin e përzgjedhjes. I kisha lutur deputetët që të deklarohen lidhur me rekomandimin e Komisionit Funkcional për procedim me katër kandidatë, si dhe procedurën e votimit për zgjedhjen e Avokatit të Popullit.

Po e shoh se nuk ka të lajmëruar. Atëherë vazhdojmë.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim! Më falni, edhe një herë kisha pasur dëshirë që kur t'i lexoj këto ta kemi vëmendjen.

Unë do ta përsëris edhe një herë.

Në seancën e mbajtur më 27 mars 2015, kryetarja e Komisionit Funkcional, zonja Lirije Kajtazi e ka shpjeguar procesin e rekrutimit të kandidatëve dhe i ka paraqitur rekomandimet.

Në vazhdim, çdo deputet mund t'i parashtroj ndonjë pyetje ose sqarim shtesë kryesueses së komisionit lidhur me procesin e përzgjedhjes. Në qoftë se nuk ka, atëherë deputetët duhet të deklarohen lidhur me rekomandimin e Komisionit Funkcional për procedim me katër kandidatë, si dhe për procedurën e votimit për zgjedhjen e Avokatit të Popullit.

Ta keni vëmendjen në atë që e ka sqaruar kryetarja e Komisionit Funkcional. Atëherë, a mund të shkojmë në votim drejt?

Lus regjinë dhe deputetët të përgatitemi për votim! Votojmë tash!

Lus kryetaren e Komisionit Funkcional, a ka mundësi edhe një herë t'i sqarojë procedurat dhe rekomandimet.

(Reagime nga salla)

E atëherë çka? I kemi vetëm 47 vota, duhet proceduar. Edhe një herë?

Atëherë regjia dhe deputetët, ju lutem, do të votojmë edhe një herë. Përgatitemi për votim. Votojmë tash!

Kanë votuar 79 deputetë, për 71 deputetë, kundër 2 deputetë, kemi 6 abstenime.

Konstatoj se ajo për çfarë kemi votuar është se miratohet rekomandimi i Komisionit Funkcional për procedim me katër kandidatë, si dhe procedura e votimit për zgjedhjen e Avokatit të Popullit.

Për zbatim të procedurës së votimit, ftoj kryetarët apo përfaqësuesit e grupeve parlamentare që ta propozojnë nga një anëtar në Komisionin votues.

Komisioni votues do të mbështetet prej zyrtarëve të Administratës së Kuvendit. Ftoj përfaqësuesit e grupeve parlamentare që ta propozojnë nga një anëtar për Komisionin votues.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, kryetar!

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës për këtë komision e propozon deputeten Selvi Halimi.

KRYETARI: Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës?

ISMET BEQIRI: Faleminderit!

Ne s'po themi si përfaqësues të përhershëm, po aty diku, e propozojmë për komision deputetin Salih Morina.

KRYETARI: Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje”?

GLAUK KONJUFCA: “Vetëvendosja” e propozon deputetin Mytaher Haskuka.

KRYETARI: Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës?

DONIKA KADA BUJUPI: Në emër të Aleancës do të jetë deputetja Teuta Haxhiu.

KRYETARI: Lista serbe nuk ka deputet, edhe Nenad Rashiqi si deputet më duket nuk qenka këtu. Grupi Parlamentar “Nisma”?

VALDETE BAJRAMI: Grupi Parlamentar “Nisma” e propozon Shukrije Bytyqin. Faleminderit!

KRYETARI: Grupi Parlamentar “6+”?

MYFERA SHINIK: “6+” parlamente grupu Duda Balje.

KRYETARI: Lus deputetët për një miratim formal të këtij komisioni vetëm me ngritje dore.

Konstatohet se Kuvendi i emëroi anëtarët në Komisionin votues për zgjedhjen e Avokatit të Popullit. E kisha lutur komisionin që të fillojmë me procedim, ndërsa deputetët do të ftohen të votojnë sipas listës.

E kishim lutur komisionin t'i zërrë vendet. Atëherë fillojmë nga i pari:

Adem Grabovci, Adem Hoxha, Adem Salihaj, Agim Ademaj, Agim Aliu, Agim Çeku, Aida Dërguti, Albin Kurti, Albulena Haxhiu, Ali Sadriu, Alma Lama, Anton Çuni, Arben Gashi, Armend Zemaj, Fadil Demaku, Milazim Haliti, Azem Sylja, Bali Muharremi, Bekim, Haxhiu, Besa Baftija, Besa Gaxherri, Besim Beqaj, Besnik Bislimi, Blerim Grajinca, Blerim Shala, Blerta Deliu, Bojan Mitiq, Danush Ademi, Faton Topalli, Daut Haradinaj, Donika Kadaj-Bujupi, Doruntinë Maloku-Kastrati, Duda Bale, Salije Mustafa, Elmi Reçica, Emilija Rexhepi, Enver Hoxhaj, Etem Arifi, Fadil Beka, Fatmir Limaj, Fatmir Rexhepi, Fisnik Ismaili, Flora Brovina, Ganimete Musliu, Gëzim Kelmendi, Glauk Konjufca, Shaip Muja, Nait Hasani, Bardhyl Meta, Hatim Baxhaku, Haxhi Shala, Synavere Rysha, Ilir Deda, Murat Hoxha, Ismail Kurteshi, Ismet

Beqiri, Envet Hoti, Jasmina Zhivković, Jelena Bontić, Kujtim Paçaku, Agim Kikaj, Labinotë Demi-Murtezi, Lahi Ibrahimaj, Latif Gashi, Lirije Kajtazi, Luljeta Veselaj-Gutaj, Fikrim Damka, Margarita Kadriu-Ukelli, Melihate Tërmkolli, Hajdar Beqa, Mexhide Mjaku-Topalli, Milena Miliçević, Milka Vuletić, Myfera Serbica-Shinik, Muhamet Mustafa, Mytaher Haskuka, Naim Fetahu, Naser Osmani, Nenad Rashić, Nezir Çoçaj, Njomza Emini, Nuredin Ibishi, Nuredin Lushtaku, Pal Lekaj, Puhije Demaku, Raif Çela, Rafet Rama, Ramiz Kelmendi, Ramush Haradinaj, Qerim Bajrami, Rexhep Selimi, Rustem Berisha, Rustem Mustafa, Sabri Hamiti, Sabri Ferati, Safete Hadërgjonaj, Sala Shala-Berisha, Salih Morina, Sali Saliu, Sasha Milosavljević, Selviqe Halimi, Shpejtim Bulliqi, Shqipe Pantina, Shukrije Bytyqi, Slavko Simiq, Slobodan Petrović, Teuta Haxhiu, Teuta Rugova, Teuta Sahatqija, Time Kadrijaj, Valdete Bajrami, Veton Berisha, Visar Ymeri, Vjosa Osmani, Xhavit Haliti, Xhevahire Izmaçu, Zafir Berisha, Zenun Pajaziti, Kadri Veseli...

KRYETARI: Po, urdhëroni! Tash, deputetë, komisioni e ka fjalën për rezultate.

TEUTA HAXHIU:

Veton Vula,
Veton Vula,
Mazllum Baraliu,
Mazllum Baraliu,
Veton Vula,
Shqipe Ibraj-Mala,
Mazllum Baraliu,
Suzan Novobërdaliu,
Veton Vula,
Mazllum Baraliu,
Veton Vula,
Veton Vula,
Shqipe Ibraj-Mala,
Veton Vula,
Veton Vula,
Mazllum Baraliu,
Suzan Novobërdaliu,
Suzan Novobërdaliu,
Veton Vula,
Shqipe Ibraj-Mala,
Shqipe Ibraj-Mala,
Suzan Novobërdaliu,
Veton Vula,
Shqipe Ibraj-Mala,
Veton Vula,
Shqipe Ibraj-Mala,
Shqipe Ibraj-Mala,
Veton Vula,
Mazllum Baraliu,
Shqipe Ibraj-Mala,

Suzan Novobërdaliu,
Veton Vula,
Shqipe Ibraj-Mala,
Suzan Novobërdaliu,
Shqipe Ibraj-Mala,
Mazllum Baraliu,
Shqipe Ibraj-Mala,
Veton Vula,
Veton Vula,
Veton Vula,
Veton Vula,
Veton Vula,
Mazllum Baraliu,
Veton Vula,
Veton Vula
Shqipe Ibraj-Mala,
Suzan Novobërdaliu,
Suzan Novobërdaliu,
Veton Vula
Mazllum Baraliu,
E pavlefshme,
Shqipe Ibraj-Mala,
Shqipe Ibraj-Mala,
Shqipe Ibraj-Mala,
Suzan Novobërdaliu,
Veton Vula,
Veton Vula,
Mazllum Baraliu,
Shqipe Ibraj-Mala,
Veton Vula,
Shqipe Ibraj-Mala,
Suzan Novobërdaliu,
Veton Vula,
E pavlefshme,
Shqipe Ibraj-Mala,
Veton Vula,
Suzan Novobërdaliu,
Veton Vula,
Suzan Novobërdaliu,
Suzan Novobërdaliu,
Veton Vula,
Suzan Novobërdaliu,
Veton Vula,
Veton Vula,
Shqipe Ibraj-Mala,

Shqipe Ibraj-Mala,
Mazllum Baraliu,
Veton Vula,
Suzan Novobërdaliu,
Shqipe Ibraj-Mala,
Shqipe Ibraj-Mala,
Shqipe Ibraj-Mala,
Suzan Novobërdaliu,
Veton Vula,
Mazllum Baraliu,
Suzan Novobërdaliu,
Shqipe Ibraj-Mala,
Veton Vula,
Mazllum Baraliu,
E pavlefshme,
Suzan Novobërdaliu,
Veton Vula,
Suzan Novobërdaliu,
Suzan Novobërdaliu,
Suzan Novobërdaliu,
Mazllum Baraliu dhe
Shqipe Ibraj-Malaj.

KRYETARI: Urdhëroni zonja deputete, e keni fjalën. Ju lutem deputetë, e kemi rezultatin përfundimtar.

TEUTA HAXHIU: Votat e fituara për kandidatët e propozuar janë si në vijim:

Mazllum Baraliu, ka fituar 14 vota,
Shqipe Ibraj-Mala, ka fituar 25 vota,
Suzan Novobërdaliu, ka fituar 21 vota,
Veton Vula, ka fituar 35 vota.

Nga lista e fletëvotimit hiqen dy emra që kanë më pak vota, pra Mazllum Baraliu dhe Suzan Novobërdaliu. Votimi përsëritet për dy kandidatët tjerë, pra janë Veton Vula dhe Shqipe Ibraj-Mala.

KRYETARI: Faleminderit, zonja deputete!

Atëherë për një moment shumë të shkurtër, çështje teknike, vazhdojmë me votimin e dytë. Kisha kërkuar nga deputetët dhe komisioni të qëndrojmë kështu si jemi.

E kishim lutur komisioni t'i zërë vendet për arsye që të vazhdojmë me procedurën e votimit të dytë.

Komisioni, ju lutem, zini vendet! A e zgjedhim një komision të ri, se paska abstenuar. Por, le të vijmë ju lutem për arsye se edhe publiku është duke na përcjellë: Selville Halimi, Salih Morina, Mytaher Haskuka, Teuta Haxhiu, Shukrije Bytyqi, Duda Balje.

Atëherë i kemi vetëm katër anëtarë të komisionit, mund të fillojmë nga shtatë sa janë, përdërisa të tjerët vijmë:

Zenun Pajaziti, Zafir Berisha, Xhevahire Izmaqu, Azem Sylja, Xhavit Haliti, Vjosa Osmani, Visar Ymeri, Veton Berisha, Velimir Rakiq, kërkoj falje për të ndjerin, Valdete Bajrami, Time Kadrijaj, Teuta Sahatqija, Teuta Rugova, Teuta Haxhiu, Slllobodan Petroviq, Sllavko Simiq, Shukrije Bytyqi, Shqipe Pantina, Shpejtim Bulliqi, Selville Halimi, Sasha Millosavljeviq, Salih Salihu, Salih Morina, Blerim Shala, Sala Berisha-Shala, Safete Hadërgjonaj, Sadri Ferati, Sabri Hamiti, Rustem Mustafa, Rustem Berisha, Rexhep Selimi, Kadri Veseli, Qerim Bajrami, Ramush Haradinaj, Ramiz Kelmendi...

(Drejtimit e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.)

...Rafet Rama, Raif Qela, Puhije Demaku, Pal Lekaj, Nuredin Lushtaku, Nuredin Ibishi, Njomza Emmini, Nezir Çoçaj, Nenad Rashiq, Naser Osmani, Naim Fetahu, Mytaher Haskuka, Muhamet Mustafa, Mufera Shinik, Salihe Mustafa, Elmi Reçica, Emilija Rexhepi, Enver Hoxhaj, Etem Arifi, Fadil Beka, Fatmir Limaj, Fartmir Rexhepi, Fisnik Ismajli, Flora Brovina, Ganimete Musliu, Gëzim Kelmendi, Glauk Konjufsha, Shaip Muja, Nait Hasani, Bardhyl Meta, Hatim Baxhaku, Haxhi Shala, Synavere Rysha, Ilir Deda, Murat Hoxha, Ismail Kurteshi, Ismet Beqiri, Enver Hoti, Jasmina Zhivkoviç, Jelena Bontiq, Kadri Veseli, Kujtim Paçaku, Agim Kikaj, Labinot Demi, Lah Ibrahimaj, Latif Gashi, Lirije Kajatazi Luljeta Veselaj, Fikrim Damka, Margarita Kadriu, Melihate Trmkolli, Hajdar Beqa, Mexhide Mjaku-Topali, Milena Miliqeviq, Milka Vuletiq, Duda Balje, Dorontinë Maloku Kastrati, Donika Kadaç-Bujupi, Daut Haradinaj, Faton Topalli, Danush Ademi, Bojan Mitiq, Blerta Deliu, Blerim Shala, Blerim Grajinca, Besnik Bislimi, Besim Beqaj, Besa Gaxherri, Besa Baftia, Bekim Haxhiu, Bali Muharremaj, Milazim Haliti, Fadil Demaku, Armend Zemaj, Arben Gashi, Anton Çuni, Alma Lama, Ali Sadriu, Albulena Haxhiu, Albin Kurti, Aida Gërguti, Agim Çeku, Agim Aliu, Agim Ademaj, Adem Salihaj, Adem Hoxha, Adem Grabovci.

Regjia, bjeri ziles në qoftë se ka mbetur dikush pa votuar jashtë sallës, le të futet brenda për të votuar. A ka dikush që nuk ka votuar? Nuk ka. Atëherë, filloni procesin e numërimit ju.

Regjia, komisioni do të fillojë me numërimin e votave:

TEUTA HAXHIU:

Veton Vula,
Shqipe Ibraj-Mala,
Shqipe Ibraj-Mala
Shqipe Ibraj-Mala
Shqipe Ibraj-Mala
Shqipe Ibraj-Mala
Shqipe Ibraj-Mala

Shqipe Ibraj-Mala
Veton Vula
Shqipe Ibraj-Mala
Shqipe Ibraj-Mala
Shqipe Ibraj-Mala
Shqipe Ibraj-Mala
Shqipe Ibraj-Mala
Veton Vula
Shqipe Ibraj-Mala
Shqipe Ibraj-Mala
Shqipe Ibraj-Mala
Veton Vula
Shqipe Ibraj-Mala
Shqipe Ibraj-Mala
Shqipe Ibraj-Mala
Veton Vula,
Veton Vula,
Veton Vula
Veton Vula
Veton Vula
Veton Vula
Veton Vula
E pavlefshme,
Shqipe Ibraj-Mala
Shqipe Ibraj-Mala
Veton Vula
E pavlefshme,
Shqipe Ibraj-Mala
Shqipe Ibraj-Mala
Shqipe Ibraj-Mala
Veton Vula
E pavlefshme
Shqipe Ibraj-Mala
Veton Vula,
E pavlefshme,
Shqipe Ibraj-Mala
Shqipe Ibraj-Mala
Veton Vula,
Veton Vula,
Veton Vula,
Veton Vula,
E pavlefshme,
Shqipe Ibraj-Mala,
Shqipe Ibraj-Mala,
Shqipe Ibraj-Mala,

Veton Vula,
Veton Vula,
Shqipe Ibraj-Mala,
Veton Vula,
Veton Vula,
Shqipe Ibraj-Mala,
E pavlefshme,
Shqipe Ibraj-Mala,
Shqipe Ibraj-Mala,
Veton Vula,
Veton Vula,
Veton Vula,
Shqipe Ibraj-Mala,
Shqipe Ibraj-Mala,
Shqipe Ibraj-Mala,
E pavlefshme,
Shqipe Ibraj-Mala,
E pavlefshme,
Shqipe Ibraj-Mala
Veton Vula,
Veton Vula,
Veton Vula,
Veton Vula,
Shqipe Ibraj-Mala,
Shqipe Ibraj-Mala,
Shqipe Ibraj Mala,
E pavlefshme,
Shqipe Ibraj-Mala,
Shqipe Ibraj-Mala,
Veton Vula,
Veton Vula,
E pavlefshme,
E pavlefshme,
Shqipe Ibraj-Mala,
Veton Vula,
Veton Vula,
Shqipe Ibraj-Mala,
Shqipe Ibraj-Mala,
E pavlefshme,
Shqipe Ibraj-Mala,
Veton Vula,
Veton Vula,
Veton Vula,
Veton Vula,
E pavlefshme,
E pavlefshme,

Shqipe Ibraj-Mala,
Veton Vula,
Veton Vula,
Veton Vula,
Shqipe Ibraj-Mala,
Veton Vula,
Veton Vula,
Shqipe Ibraj-Mala,
Shqipe Ibraj-Mala,
Veton Vula,
Shqipe Ibraj-Mala,
Shqipe Ibraj-Mala,
Veton Vula,
Veton Vula,
Veton Vula,
Veton Vula,
Shqipe Ibraj-Mala,
Veton Vula,
Veton Vula,
Veton Vula,
Veton Vula,
E pavlefshme,
Shqipe Ibraj-Mala,
Veton Vula,
Veton Vula,
Veton Vula,
Shqipe Ibraj-Mala,
Shqipe Ibraj-Mala,
Shqipe Ibraj-Mala,
Veton Vula,
Shqipe Ibraj-Mala,
Veton Vula,
Shqipe Ibraj-Mala,
Shqipe Ibraj-Mala,
Veton Vula,
Veton Vula,
E pavlefshme,
E pavlefshme,
Veton Vula,
E pavlefshme,
Veton Vula,
Veton Vula,
Shqipe Ibraj-Mala,
Shqipe Ibraj-Mala,
E pavlefshme dhe
Shqipe Ibraj-Mala.

Pas procedurës së votimit të fshehtë në rundin e dytë dhe numërimit të votave të deputetëve të Kuvendit për zgjedhjen e Avokatit të Popullit në mbledhjen plenare të mbajtur më 2 prill 2015, komisioni konstaton se:

Në votim kanë marrë pjesë 88 deputetë, 12 nga votimet ishin të pavlefshme.

Votat e fituara për kandidatët e propozuar janë si në vijim:

- Shqipe Ibraj-Mala i ka fituar 34 vota,
- Veton Vula i ka fituar 42 vota.

Kandidati Veton Vula hyn në listën e fletëvotimit për raundin e tretë. Kandidatja Shqipe Ibraj-Mala hiqet nga lista e fletëvotimit për rundin e tretë.

Pra, Veton Vula shkon në rundin e tretë, nga konstatimet e Komisionit.

KRYESUESI: Atëherë, lus që të përgatiten listat e votimit dhe të fillojmë, po mendoj të vazhdojë i njëjti komision.

Tani e dini që duhen 61 vota për t'u zgjedhur. Në qoftë se nuk i fiton 61 vota, përsëritet konkursi, sipas ligjit.

Komisioni, ju lus që t'i zini vendet tuaja.

Adem Grabovci, Adem Hoxha, Adem Salihaj, Agim Ademaj, Agim Aliu, Agim Çeku, Aida Dërguti, Albin Kurti, Albulena Haxhiu, Ali Sadriu, Alma Lama, Anton Çuni, Arben Gashi, Armend Zemaj, Fadil Demaku, Milazim Haliti, Azem Syla, Bali Muharremaj, Bekim Haxhiu, Besa Baftija, Besa Gaxherri, Besim Beqaj, Besnik Bislimi, Blerim Grainca, Blerim Shala, Blerta Deliu, Bojan Mitiq, Danush Ademi, Faton Topalli, Daut Haradinaj, Donika Kadaj-Bujupi, Doruntinë Maloku- Kastrati, Duda Balje, Salije Mustafa, Elmi Reçica, Emilija Rexhepi, Enver Hoxhaj, Ethem Arifi, Fadil Beka, Fatmir Limaj, Fatmir Rexhepi, Fisnik Ismaili, Flora Brovina, Ganimete Musliu, Gëzim Kelmendi, Glauk Konjufca, Shaip Muja, Nait Hasani, Bardhyl Meta, Hatim Baxhaku, Haxhi Shala, Synavere Rysha, Ilir Deda, Murat Hoxha, Ismail Kurteshi, Ismet Beqiri, Enver Hoti, Jasmina Zhivković, Jelena Bontiq, Kadri Veseli, Kujtim Paçaku, Agim Kikaj, Labinotë Demi, Lahi Brahimaj, Latif Gashi, Lirije Kajtazi, Luljeta Veselaj, Florim Damka, Margarita Kadriu, Melihate Tërmkolli, Hajdar Beqa, Mexhide Mjaku, Milena Miliçević, Milka Vuletiq, Mufera Shinik, Muhamet Mustafa, Mytahir Haskuka, Naim Fetahu, Naser Osmani, Nenad Rashiq, Nezir Çoçaj, Njomza Emini, Nuredin Ibishi, Nuredin Lushtaku, Pal Lekaj, Puhije Demaku, Raif Qela, Rafet Rama, Ramiz Kelmendi, Ramush Haradinaj, Qerim Bajrami, Rexhep Selimi, Rustem Berisha, Rustem Mustafa, Sabri Hamiti, Sadri Ferati, Safete Hadërgjonaj, Sala Berisha-Shala, Sali Morina, Salih Salihu, Sasha Milosavljeviq, Selvije Halimi, Shpejtim Bulliqi, Shqipe Pantina, Shukrije Bytyqi, Slavko Simiq, Slobodan Petroviq, Teuta Haxhiu, Teuta Rugova, Teuta Sahatqija, Time Kadrijaj, Valdete Bajrami, Veton Berisha, Visar Ymeri, Vjosa Osmani, Xhavit Haliti, Xhevahire Izmaqu, Zafir Berisha, Zenun Pajaziti.

(Drejtimin e mbledhjes e merr kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.)

KRYETARI: Ju lutem, për vëmendje!

TEUTA HAXHIU:

E pavlefshme,
Veton Vula,
Veton Vula,
Veton Vula,
Veton Vula,
Veton Vula,
E pavlefshme,
Veton Vula,
Veton Vula,
Veton Vula,
Veton Vula
Veton Vula,
Veton Vula,
E pavlefshme,
E pavlefshme,
Veton Vula,
Veton Vula,
E pavlefshme,
E pavlefshme,
E pavlefshme,
Veton Vula
Veton Vula,
E pavlefshme,
Veton Vula
Veton Vula,
Veton Vula,
E pavlefshme,
Veton Vula,
Veton Vula,
E pavlefshme,
E pavlefshme,
Veton Vula,
Veton Vula,
Veton Vula,
Veton Vula,
E pavlefshme,
Veton Vula,
Veton Vula,
Veton Vula,
E pavlefshme,

Veton Vula,
Veton Vula,
Veton Vula,
E pavershme,
Veton Vula,
Veton Vula,
E pavlefshme,
E pavlefshme,
E pavlefshme,
Veton Vula,
E pavlefshme,
Veton Vula,
Veton Vula,
Veton Vula,
Veton Vula,
E pavlefshme,
Veton Vula,
Veton Vula,
Veton Vula,
Veton Vula,
Veton Vula,
E pavlefshme,
E pavlefshme,
Veton Vula,
Veton Vula,
Veton Vula,
Veton Vula,
Veton Vula,
Veton Vula,
E pavlefshme,
E pavlefshme dhe
Veton Vula.

KRYETARI: Ju lutem për vëmendje! Komisioni prapë e ka fjalën.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

Kandidati Veton Vula i ka fituar 49 vota, të cilat nuk janë të mjaftueshme për t'u zgjedhur Avokat i Popullit, andaj konkursi duhet të përsëritet në bazë të Ligjit për Avokatin e Popullit.

KRYETARI: Atëherë, vazhdojmë me pikën e tretë, të vazhdimin të seancës.

3. Votimi i anëtarit të Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës

Diskutimet për këtë pikë të rendit të ditës kanë përfunduar në seancën e mbajtur më 26 mars 2015.

Në seancën plenare të mbajtur më 27 mars 2015, është votuar dy herë për propozimin e lartshënuar, mirëpo ka munguar numri i nevojshëm i pjesëmarrjes në votim. Të paktën duhen 61 deputetë.

Andaj, duhet të përsëritet votimi. Kërkoj nga deputetët të marrin pjesë në votim, duke votuar për, kundër ose abstenim.

Në vazhdim kërkohet deklarimi me votim edhe një herë për emërimin e zotit Mazllum Baraliu anëtar i Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës.

Kisha kërkuar që përmes ziles të ftohen edhe një herë deputetë dhe të përgatitemi për votim. Do të presim 30 sekonda.

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.)

KRYESUESI: Zoti Lekaj, e zonja Bale, uluni është kohë për votim.

(Drejtimin e mbledhjes e merr kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.)

KRYETARI: Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tash!

Pra, janë 70 vota në mënyrë elektronike, 42 vota janë kundër, 24 vota janë për dhe 4 abstenime.

Konstatoj se Kuvendi nuk e emëroi zotin Mazllum Baraliu anëtar të Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës me mandat dyvjeçar.

Me këtë i mbyll punimet e seancës së sotme. Mirupafshim në seancën e radhës, e cila fillon në orën 14:00!

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*